



AKADEMIA E FORCAVE TË ARMATOSURA
INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK
REVISTË TEORIKO-SHKENCORE
SHTATOR 2022

REVISTA USHTARAKE

(edicioni i dytë)

INSTITUTI KËRKIMOR SHKENCOR USHTARAK © 2022

Botim i Akademisë së Forcave të Armatosura
Miratuar me vendim nr. 2, datë 26.09.2022
të Bordit Drejtues të Revistës Ushtarake

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake
Kryetari i Bordit
Gjeneral Brigade Dr. **Albert Mullai**

Anëtarët e Bordit
Kolonel Msc. **Ulsi Rexhaj**
Kolonel (R) Dr. **Ahmet Leka**
Kolonel Msc. **Hysni Gjergji**
Prof. Asoc. Dr. **Teki Kurti**
Dr. **Etleva Smaçi**
Kolonel Msc. **Emëror Hajdarasi**
Kolonel Msc. **David Rroku**
Msc. **Blerina Vorpsi**

Përgatiti për botim
Grupi i Redaktimit dhe Publikimit
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)

ISSN 2227-8133 (Print), ISSN 2227-8141 (Online)
Copyright © 2022 nga Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak në Akademinë e Forcave të Armatosura.
Copyright © 2022 by the Military Scientific Research Institute of the Academy of Albanian Forces.

Akademia e Forcave të Armatosura zotëron liri akademike dhe respekton detyrimet ligjore të përcaktuara shprehimisht në ligjin për Arsimin e Lartë si dhe të gjitha aktet e tjera ligjore që janë të detyrueshme për institucionet publike.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë qëndrim zyrtar të Ministrisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm të FARSH dhe Akademisë së Forcave të Armatosura. Autorët e shkrimeve nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes. Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shtrembërimet e fakteve si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Akademia e Forcave të Armatosura
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak
Shtypur: shtator 2022

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË

Analiza, vlerësime, sinteza në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale.....	7
---	----------

Siguria dhe evoluimi i saj si koncept

Kolonel (R) Dr. Ahmet Leka Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA.....	9
--	---

Koncepti i ri i “paralajmërimit strategjik” përmes “informimit publik”

Kolonel Msc. Hysni Gjergji Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA.....	27
--	----

Koncepti strategjik dhe sfidat e NATO-s, Madrid 2022

Vlerësime dhe reflektime

Kolonel Msc. David Rroku Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA.....	39
---	----

Lidhja e kimit të organizuar dhe terrorizmit- rrezik për sigurinë

Znj. Msc. Ekleva Baxhaku Akademia e Forcave të Armatosura Nënkolonel (R) Alqi Nikolla Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA.....	61
---	----

Skenarët gjeopolitikë dhe gjeostrategjikë për mjedisin e sigurisë në rajon, bazë e dokumenteve strategjike të sigurisë dhe mbrojtjes

Nënkolonel Msc. Eduart Pillaha Qendra e Kontroll-Raportimit, FAJ.....	81
--	----

Reflektime dhe dallime midis konceptit strategjik të NATO-s, Madrid 2022 dhe atij në Lisbonë 2010

Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA.....	95
---	----

Faktorë kërcënues ndaj sigurisë kombëtare të shteteve të Ballkanit Perëndimor

Nënkolonel Msc. Bajazit Muceku Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA.....	107
--	-----

Ukraina, origjina e konfliktit

Msc. Roland Tashi

AlSM, Ministria e Mbrojtjes..... 121

Rëndësia e përgatitjes fizike në Forcat e Armatosura

Dr. Valbona Zekaj

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA, AFA..... 127

RUBRIKA E DYTË

Zhvillimi inovativ, sinergji e re në fushën e kapaciteteve ushtarake..... 135

Krijimi i ekosistemit të inovacionit, mjedis i favorshëm për hapësirën e sigurisë

Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Msc. Elsa Koçi

Drejtorja e Shifrës, MM..... 137

Rreziqet kibernetike ndaj sigurisë së Republikës së Shqipërisë në vitet në vijim

Major Edvin Nure

Drejtorja J6, SHPFA..... 153

RUBRIKA E TRETË: Studime historike..... 165

Reformimi i Ushtrisë Popullore në kuadër të anëtarësimit në Traktatin e Varshavës (1955-1956). Ndikimi në politikën e brendshme

Dr. Eva Smaçi

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Dr. Shpëtim Madani

Qendra e Gjuhëve të Huaja, AFA..... 167

Përpjekje për konsolidimin e shkollës ushtarake në vitet 1950-1971

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA..... 179

Krijimi i ushtrisë kombëtare shqiptare nga qeveria e përkohshme e Vlorës (1912-1914)

Kolonel në pension Sali Onuzi..... 197

Kujtesë për bashkëpunëtorët..... 207

RUBRIKA E PARË

Analiza, vlerësime e sinteza në fushën e mbrojtjes e të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale

Në këtë rubrikë janë përmbledhur shkrime që trajtojnë çështje aktuale rreth mjedisit të sotëm të sigurisë kombëtare dhe rajonale, kërcënimeve dhe sfidave tona të cilat janë aq të ndryshme sa edhe të shumta, si dhe rolit të Shqipërisë dhe faktorit shqiptar në sigurinë dhe stabilitetin e rajonit tonë. Një nga sfidat që aktualisht ndodhet në kufijtë tanë dhe jo vetëm, është një Rusi më agresive dhe më e sigurt në vetvete – një komb me të cilin Aleanca ka punuar për më shumë se dy dekada pas Luftës së Ftohtë, që të ndërtojë një partneritet. Një tjetër sfidë është lufta kundër terrorizmit, ku ne duhet të sigurojmë adresimin jo vetëm të problemeve të tanishme por edhe shkaqet rrënjësore.

Zhvillimet dhe nismat rajonale të bashkëpunimit në fushën e sigurisë, në dy dekadat e fundit, kanë prirje pozitive dhe janë të orientuara drejt krijimit të një mjedisi të përbashkët sigurie, të cilat janë të pasqyruar edhe në dokumentet kryesore strategjike të vendeve të rajonit.

Një vizion të ri të integruar me dimensione të gjera sipas shfaqjeve të kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë jep Koncepti i ri Strategjik i NATO-s 2022. Në referencë të këtij koncepti, lidërshipi shqiptar duhet të vlerësojë tërë procesin dinamik të transformimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura duke mbajtur frymën që përcjell ky samit, me synimin për të rivlerësuar ambicien e politikës sonë, rishikimin e dokumenteve madhore të sigurisë dhe mbrojtjes (SSK, SU), vizionin perspektiv të zhvillimit të FA-2030, si dhe çështje

të planëzimit të mbrojtjes, sigurisë, mbështetjes dhe modernizimit.

Gjithashtu, i gjithë procesi i studimit akademik, kërkues dhe shkencor duhet të mbështetet te vlerësimet dhe reflektimet e Konceptit Strategjik të NATO-s, çështjet e së cilës të studiohen mirë për të kuptuar rrugën që duhet të bëjmë në kuadrin e procesit të planifikimit të NATO-s, si dhe reflektimit në dokumentet e Procesit të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes së vendit.

SIGURIA DHE EVOLUIMI I SAJ SI KONCEPT

Kolonel (R) Dr. Ahmet Leka

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Trajtesë e shkurtuar. Në këtë shkrim trajtohen në mënyrë të përmblëdhur pikëpamje dhe qëndrime të filozofëve të ndryshëm rreth konceptit të sigurisë, shkaqeve të luftës, zhvillimit të konflikteve dhe argumentimeve të ndryshme për zbutjen apo shmangien e konflikteve. Nga mënyra se si trajtohet kjo temë mjaft komplekse e luftës dhe shkaqeve të saj, si pjesë e pashmangshme e ekzistencës njerëzore, janë kristalizuar dy linja mendimi dhe qëndrimi midis filozofëve politikë që përbëjnë një ndryshim thelbësor midis mendimtarëve "realistë" dhe "idealistë". Krahas këtyre dy shkollave të mendimit, në shkrim trajtohet edhe një linjë e tretë mendimi, as pesimiste as optimiste, e përfaqësuar nga filozofi holandez Hugo Grotius, e pasqyruar gjerësisht në literaturën e marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila kundërshton si qasjet hobsiane, ashtu dhe kantiane.

Më tej trajtohen pikëpamjet realiste dhe ato kontestuese rreth konceptit të sigurisë. Ku qëndrojnë dallimet ndërmjet qasjes realiste dhe asaj kontestuese? Çfarë roli luan shteti në raport me sigurinë, po sistemi ndërkombëtar? Kur flitet për termin "siguri", për çfarë sigurie bëhet fjalë, për atë kombëtare, individit apo grupi? Cilat janë dimensionet e sigurisë në raport me shtetin, kombin, ushtrinë dhe kërcënimet klasike?

Në përfundim, jepet një analizë dhe vlerësim mbi punën studimore e shkencore që është bërë prej dekadash të tëra në të kaluarën lidhur me sigurinë, si dhe mbi domosdoshmërinë e trajtimit të saj si objekt i studimit dhe kërkimit shkencor dhe përfshirjes së çështjeve të sigurisë në kurrikulat e shkollave dhe universiteteve tona si një disiplinë akademike më vete.

Fjalët kyçe: koncepti strategjik i sigurisë, konflikt, luftë, kërcënim, rrezik, mendimi hobsian, kantian, grotian etj.

Hyrje

Historia njerëzore është e lidhur me historinë e luftërave. Në studimin e tij klasik “Njeriu, shteti dhe lufta”, Kenneth Waltz¹ përshkruan mosmarrëveshjet midis filozofëve klasikë rreth shkaqeve të luftës. Janë të shumta pikëpamjet dhe qëndrimet rreth luftës, disa e shohin si rezultat i papajtueshmërive në natyrën njerëzore, të tjerë e konsiderojnë strukturën e shtetit si një përcaktues vendimtar të luftës. Shumë studiues e filozofë e përqendrojnë vëmendjen e tyre në natyrën anarkike të sistemit ndërkombëtar në të cilin individët dhe shtetet duhet të veprojnë.

Nga mënyra se si trajtohet kjo temë mjaft komplekse e luftës dhe shkaqeve të saj, si pjesë e pashmangshme e ekzistencës njerëzore, janë kristalizuar dy linja mendimi dhe qëndrimi midis filozofëve politikë që përbëjnë një ndryshim thelbësor midis mendimtarëve "realistë" dhe "idealistë".

Këto dy shkolla të mendimit, nga ana tjetër, pasqyrojnë traditat dalluese "hobesiane"² dhe "kantiane"³ në filozofinë klasike. Krahas këtyre dy rrymave, ekziston gjithashtu një traditë të tretë, shkolla "grotiane"⁴, e pasqyruar në literaturën e marrëdhënieve ndërkombëtare, e cila kundërshton qasjet hobsiane dhe kantiane. Cilat janë dallimet midis tyre? Ndërsa, hobsianët nuk shohin asnjë mundësi për të lëvizur përtej botës thellësisht të dhunshme në të cilën jetojmë, kantianët, nga ana tjetër, argumentojnë se është e mundur të tejkalohet konflikti i dhunshëm dhe të kalohet në një ekzistencë më paqësore. Studiuesit grotianë, në të kundërt, pranojnë se dhuna dhe lufta janë jashtëzakonisht të vështira, nëse jo të pamundura, për t'u çrrënjësuar plotësisht, por edhe argumentojnë se është e mundur të zhvillohen rregulla dhe norma që ndihmojnë për të "zbutur" anët më të këqija të dhunës dhe luftës. Në këtë kuptim, grotianët janë më optimistë se hobesianët dhe më pesimistë se kantianët.

¹ Waltz, Kenneth, shkencëtar politik amerikan, autor i librit “Njeriu, shteti dhe lufta”, 1959.

² Hobbes, Thomas, filozof anglez, autor i librit “Leviathan”, 1651.

³ Kant, Immanuel (1724-1804), filozof gjerman dhe një nga mendimtarët qendrorë të iluminizmit, i njohur me veprat mbi epistemologjinë, metafizikën, etikën dhe estetikën.

⁴ Grotius, Hugo, (1583–1645), jurist, filozof, shkrimtar dhe diplomat holandez gjatë shekullit të 17-të.

Pyetja e përhershme - a mund të çrrënjosen lufta dhe dhuna - ka qenë në qendër të studimit të marrëdhënieve ndërkombëtare që nga koha kur ajo u bë një disiplinë sistematike akademike pas Luftës së Parë Botërore (1918), kur kjo temë filloi të trajtohej gjerësisht në katedrat dhe institutet angleze. Fillimisht, deri në vitin 1945 mbizotëroi teoria idealiste, për një rend më të madh ndërkombëtar të paqës, duke pretenduar mbështetje të gjerë pasi Lidhja e Kombeve dukej se ofronte njëfarë shprese. Megjithatë, më vonë, gjatë Luftës së Ftohtë, realizmi u bë shkolla mbizotëruese e mendimit, ç'ka do të thoshte se lufta dhe konflikti i dhunshëm u panë nga shumë mendimtarë në këtë epokë konfrontuese si tipare të përhershme të marrëdhënieve ndërshtetërore që shtrihen në historinë njerëzore. Gjatë Luftës së Ftohtë, për shkak të lindjes së dy blloqeve ideologjike, lindje dhe perëndim, u pa e nevojshme ngritja e aleancave në çështjet e sigurisë. Me krijimin e Traktatit të Varshavës (1955), siguria e vendeve perëndimore ishte në rrezik, ndaj dhe u miratua koncepti i parë strategjik i NATO-s për mbrojtjen e Aleancës⁵, me mision: “Të koordinojë në kohë paqeje fuqinë ushtarake dhe ekonomike, me synimin për të krijuar një pengesë të fuqishme për çdo komb apo grup kombesh që kërcënojnë paqen, pavarësinë dhe stabilitetin e familjes së kombeve të Atlantikut të Veriut”.

Kjo përbënte një qasje realiste në trajtimin e çështjeve të sigurisë në aspektin global, duke përbërë në të njëjtën kohë një ridimensionim në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. Megjithatë, me përfundimin e Luftës së Ftohtë, fundi i konfliktit intensiv ideologjik midis Lindjes dhe Perëndimit ishte një pikë kthese e madhe në historinë ndërkombëtare, duke sjellë një paradigmë të re në të cilën dhuna ndërshtetërore gradualisht do të bëhej një gjë e së kaluarës dhe vlerat e reja komunitare do të sillnin bashkëpunim më të madh midis individëve, shoqërive dhe shteteve. Pikërisht në këtë kohë, debati rreth luftës, konflikteve dhe çështjeve të sigurisë u rizgjua. Filloi një idealizëm i ri, i cili pasqyroi pikëpamje më optimiste për zhvillimin e një shoqërie civile globale paqësore, megjithëse për disa të tjerë, realizmi i “vjetër” konsiderohej qasja më e mirë për të menduar për sigurinë ndërkombëtare. Nga këta të fundit, bashkëpunimi shihej si i përkohshëm duke parashikuar se realitetet e ashpër të pasigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare së shpejti do të rishfaqeshin. Kjo perspektivë u përforcua dhe u vërtetua pas ngjarjeve të 11 shtatorit 2001 dhe të tjera më vonë, ç'ka treguan për vërtetësinë e qasjes realiste.

Epoka e re e pas Luftës së Ftohtë ishte një qasje e re për të menduar për natyrën e sigurisë në përgjithësi, e cila ka pasur një ndikim të rëndësishëm në fushën e marrëdhënieve ndërkombëtare. U krijua një mjedis i ri sigurie, gjithashtu një mendim i ri për zhvillimin e të menduarit për “sigurinë” nga origjina e saj

⁵ Koncepti Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së Atlantikut të Veriut, i njohur si DC 6/1, miratuar në dhjetor 1949.

tradicionale në perspektivat më të reja të shfaqura në periudhën e pas Luftës së Ftohtë. Filluan të studiohen pikëpamjet tradicionale të marrëdhënies ndërmjet sigurisë kombëtare dhe sigurisë ndërkombëtare dhe ndikimin që këto ide kanë pasur në të menduarit bashkëkohor. Pra, u pasua me një këndvështrim të ri të termit "siguri" dhe një studim të "mendimit të ri", duke përfshirë një rikonceptualizim të sigurisë në nivel global.

Pas Luftës së Ftohtë, strategjia e NATO-s ishte të çarmatoste veten, duke shpresuar "të varte shpatën dhe mburojën", duke i zëvendësuar ato me një "përzierje të balancuar forcash" për të zbatuar qasjen e re të gjerë ndaj sigurisë. Koncepti strategjik i NATO-s pas Luftës së Ftohtë (i pesti që nga krijimi i Aleancës) përcaktonte se: "Aleatët kërkojnë, nëpërmjet kontrollit të armëve dhe çarmatimit, të rrisin sigurinë dhe stabilitetin në nivelin më të ulët të mundshëm të forcave në përputhje me kërkesat e mbrojtjes". Në vijim të mirëbesimit dhe partneritetit, konceptet strategjike të NATO-s e çuan më tej këtë transformim, duke synuar për "një ekuilibër optimal" midis forcave të reagimit ndaj krizave të gatishmërisë së lartë dhe atyre që janë të afta të përgatiten për "skenarin më të keq - por shumë të largët - në shkallë të gjerë"- operacionet për mbrojtjen kolektive (1999 dhe 2010).

Këto koncepte të Aleancës, me kalimin e kohës u ridimensionuan duke i dhënë rëndësi nevojës për parandalimin e konflikteve nëpërmjet shtimit të fuqisë së re të rëndësishme politike dhe ushtarake në radhët e saj. Vitet e fundit, qasja realiste është sfiduar në mënyrë të arsyeshme nga qasje alternative (që ofrojnë njohuri të reja të rëndësishme) e megjithatë realizmi mbetet një qasje e fuqishme si për studimin, ashtu edhe për praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare në fushën e sigurisë.

1. Teori dhe pikëpamje rreth konceptit të sigurisë

Pikëpamjet tradicionale "realiste" rreth sigurisë. Që nga Traktati i Vestfalisë në vitin 1648, shtetet janë konsideruar si aktorët më të fuqishëm në sistemin ndërkombëtar. Ato kanë qenë standardi universal i legjitimitetit politik më të lartë për të rregulluar marrëdhëniet me njëri-tjetrin. Në këtë aspekt, kjo do të thotë se siguria është parë si detyrim parësor i qeverive shtetërore. Ata kanë qenë të mendimit se nuk ka alternativë veçse të kërkojnë mbrojtjen e tyre në atë që është përshkruar si një botë e "vetë ndihmuar". Në debatin historik për mënyrën më të mirë për të arritur sigurinë kombëtare, filozofët si Hobbes, Machiavelli⁶ dhe Rousseau prireshin të përshkruanin një tablo mjaft pesimiste të implikimeve të sovranitetit shtetëror. Sistemi ndërkombëtar shihej si një arenë mjaft brutale në të cilën shtetet do të kërkonin të arrinin sigurinë e tyre në kurriz të fqinjëve të tyre. Marrëdhëniet ndërshtetërore shiheshin si një luftë

⁶ Makiaveli, Nikolo (1469-1527), politikan, diplomat, filozof, historian dhe poet nga Firenze, Itali.

për pushtet pasi shtetet përpqeshin vazhdimisht të përfitonin nga njëri-tjetri. Sipas kësaj pikëpamjeje, paqja e përhershme, në kuptimin “kantina”, nuk kishte gjasa të arrihej. E vetmja gjë që shtetet mund të bënin ishte që të përpqeshin të balanconin fuqinë e shteteve të tjera për të parandaluar ndonjë nga arritja e hegjemonisë së përgjithshme. Kjo ishte një pikëpamje që ndahej nga historianët e shkencëtarët politikë si Edward H. Carr⁷ dhe Hans Morgenthau⁸, të cilët zhvilluan atë që u bë e njohur si shkolla e mendimit realist, pas Luftës së Dytë Botërore. Kjo pikëpamje kryesisht pesimiste e marrëdhënieve ndërkombëtare u nda nga më shumë studiues, politologë e filozofë të tjerë bashkëkohorë si: Kenneth Waltz (1979), John Mearsheimer (1990) etj.

Sipas këtyre studiuesve 'neo-realistë', siguria ose pasiguria është kryesisht rezultat i strukturës së sistemit ndërkombëtar ('realistët strukturorë'). Struktura e anarkisë shihet si shumë e qëndrueshme. Implikimi i kësaj është se politika ndërkombëtare në të ardhmen ka të ngjarë të jetë po aq e dhunshme sa politika ndërkombëtare në të kaluarën. Në librin e tij “Back to the Future”, John Mearsheimer⁹ argumentoi se fundi i Luftës së Ftohtë kishte të ngjarë të sillte një kthim në balancën tradicionale shumëpalëshe të politikës së pushtetit të së kaluarës, në të cilën nacionalizmi ekstrem dhe rivalitetet etnike do të çonin në krizë besimi, në paqëndrueshmëri të gjerë dhe konflikt. Mearsheimer e shikonte Luftën e Ftohtë si një periudhë paqeje dhe stabiliteti të sjellë nga struktura bipolare e pushtetit që mbizotëronte. Me rënien e këtij sistemi, ai parashikoi se do të kishte një kthim në llojin e rivaliteteve të fuqive të mëdha që kishin dëmtuar marrëdhëniet ndërkombëtare që nga shekulli i shtatëmbëdhjetë. Për filozofët neo-realistë, si Mearsheimer, politika ndërkombëtare përfshin një proces të pamëshirshëm konkurrimi në të gjitha fushat e veçanërisht nëpërmjet luftës, çka nënkupton se pavarësisht marrëdhënieve ndërmjet shteteve, bashkëpunim i tillë ka kufijtë e tij. Ai “kufizohet nga logjika dominuese e konkurrencës së sigurisë, të cilën asnjë bashkëpunim nuk mund ta eliminojë”. Prandaj, paqja e vërtetë afatgjatë, ose një botë ku shtetet nuk konkurrojnë për pushtet, ka shumë pak gjasa që të arrihet. Qëllimi i realistëve, si ata klasikë ashtu edhe neo-realistët është të 'shpjegojnë' botën ashtu siç e shohin ata. Në një kuptim pozitivist, ata pretendojnë të zhvillojnë koncepte dhe ligje universale të vlefshme, të përgjithshme, të cilat ofrojnë një bazë për parashikimin e së ardhmes. Për shkak se bota ka qenë kryesisht e dhunshme në të kaluarën, kështu ka gjasa të vazhdojë. Mësimet e së kaluarës sugjerojnë se mënyra më e mirë për të arritur sigurinë është të kërkes pushtet.

⁷ Carr, Edward H., (1892-1982), historian, diplomat, gazetar dhe teoricien i marrëdhënieve ndërkombëtare.

⁸ Morgenthau, Hans Joachim (1904 – 1980), jurist dhe shkencëtar politik gjermano-amerikan.

⁹ Mearsheimer, John Joseph (1947), shkencëtar politik amerikan dhe studiues i marrëdhënieve ndërkombëtare.

Siguria si një koncept kontestues. Tradicionalisht, shumica e studiuesve, politologëve dhe filozofëve kanë rënë dakord se siguria është një "koncept i kontestuar". Shumë teoricienë në fushën e politikës, me termin "siguri" nënkuptojnë ruajtjen e lirisë nga kërcënimet e ndryshme, ruajtjen e vlerave thelbësore (si për individët ashtu dhe për grupet), por mbetet një mosmarrëveshje e madhe në aspektin nëse fokusi kryesor i studimit duhet të jetë në sigurinë "individuale", "kombëtare" apo "ndërkombëtare". Historikisht dhe tradicionalisht, literatura ka qenë e dominuar nga siguria kombëtare, e përcaktuar kryesisht në terma të militarizuar, pra siguria kombëtare, integriteti shtetëror. Fusha kryesore e interesit priret të jetë në aftësitë ushtarake që shtetet e tyre duhet të zhvillojnë për t'u përballur me kërcënimet me të cilat përballen. Kohët e fundit, megjithatë, kjo ide e sigurisë është kritikuar dhe shumë ekspertë të marrëdhënieve ndërkombëtare kanë propozuar një koncept të zgjeruar të sigurisë duke zgjeruar kufijtë e sigurisë kombëtare, për të përfshirë konsiderata të tjera rreth sigurisë si ato politike, ekonomike, shoqërore, mjedisore, si dhe ushtarake¹⁰. Pra, siguria përkufizohet në terma më të gjerë ndërkombëtarë. Kjo përfshin shtetet që të kapërcejnë "politikat e sigurisë tepër të vetë-referencuara" dhe të mendojnë për interesat e sigurisë të fqinjëve të tyre. Pra në këtë kontekst siguria si koncept ka evoluar, po kështu edhe thelbi i kërcënimeve të sigurisë kombëtare apo ndërkombëtare. "Kuatridhja e Sigurisë i përmbahet Konceptit të gjerë të Sigurisë, i cili përcaktohet nga Siguria Shtetërore, Siguria Shoqërore dhe Siguria Njerëzore".¹¹

Në fillim, gjithçka kishte të bënte me kërcënimet konvencionale ushtarake. Koncepti Strategjik i NATO-s i vitit 1991 (i gjashti në radhë që nga krijimi), në riformulimin e tij kishte bërë një ndryshim të madh evolutiv, ku thelbi ishte se tashmë kërcënimet nuk ishin përcaktuar vetëm ato konvencionale, por ishin përcaktuar pesë përmasat e reja të sigurisë: ushtarake, politike, sociale, ekonomike dhe mjedisore¹². Prej vitit 2010, shqetësimet në nivelin e NATO-s

¹⁰ Buzan, Barry, "Njerëzit, Shtetet dhe Frika", fq. 214-242.

¹¹ Siguria shtetërore lidhet me shumë me masat për sigurinë dhe mbrojtjen tradicionale të vendit dhe ka të bëjë kryesisht me ruajtjen e sovranitetit, mbrojtjen e tërësisë territoriale dhe të pavarësisë. Shqipëria, në përputhje me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, respekton parimin themelor të sigurisë dhe mbrojtjes kolektive.

Siguria shoqërore lidhet me sigurinë dhe mbrojtjen e popullsisë civile dhe të grupeve shoqërore nga emergjencat e shkaktuara nga natyra, incidentet industriale ose gabimet njerëzore, si dhe nga terrorizmi, kërcënimet asimetrike e hibride, krimi i organizuar, korrupsioni etj. Mbrojtja e shoqërisë në kohë paqeje, krize e lufte është një nga detyrat kryesore të institucioneve të sigurisë së vendit.

Siguria njerëzore synon mbrojtjen e të drejtave të njeriut sipas Rezolutës 1674 të OKB në kuadrin e "përgjegjësisë për të mbrojtur" popullsitë nga gjenocidi, krimet kundër njerëzimit, spastrimet etnike, krimet e luftës etj. Sipas rastit, Shqipëria merr pjesë dhe kontribuon për sigurinë njerëzore, bazuar në ligjin ndërkombëtar dhe kushtetutën e vendit, duke bashkuar përpjekjet me institucionet ndërkombëtare ku ajo është anëtare.

¹² Sipas përkufizimit klasik të Shkollës Europiane të Kopenhagës.

evoluuan nga kërcënimet jotradicionale deri në sfidat e reja të sigurisë, duke përfshirë këtu terrorizmin, përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë, sulmet kibernetike, ndërprerjen e furnizimit me energji, ndryshimet klimaterike dhe migracionin, më pas kërcënimet hibride shtuan listën e evolucionit të kompleksitetit të çështjeve të sigurisë¹³. Të gjitha këto ndryshime në fushën e sigurisë sollën një qasje të re të Aleancës, duke iu përgjigjur këtyre sfidave me një koncept të ri për mbrojtjen strategjike të NATO-s¹⁴.

Politika e jashtme, ushtarake dhe ekonomike e shteteve, kryqëzimet e këtyre politikave në fushat e ndryshimit ose mosmarrëveshjes dhe struktura e përgjithshme e marrëdhënieve që ato krijojnë, analizohen me synimin për të arritur *sigurinë kombëtare dhe/ose ndërkombëtare*. Siguria lidhet më së shumti me zbutjen e kërcënimeve ndaj vlerave të çmuara. Megjithatë, përdorimi në mjedisin e sigurisë kemi mjaft variabël të panjohur që lidhen me ndryshimin e rreziqeve dhe kërcënimeve, ky mbetet një përkufizim i ndryshueshëm, i paqartë dhe një pasqyrim i natyrës së qenësishme të sigurisë si një “koncept thelbësisht i kontestuar”.

Siguria në kontekstin modern ka shumë koncepte kyçe të lidhura me të si: pasiguria, lufta, terrorizmi, gjenocidi dhe vrasjet masive, konflikti etnik, detyrimi, *siguria njerëzore*, varfëria, dëmtimi i mjedisit, shëndeti dhe sigurisht nocioni tradicional i sigurisë ushtarake. Koncepte të tilla gjenerojnë domosdoshmërisht debate të pazgjidhshme rreth kuptimit dhe zbatimit të tyre sepse, siç thekson Richard Little¹⁵, ato përmbajnë një element ideologjik që i bën provat empirike të parëndësishme si një mjet për zgjidhjen e mosmarrëveshjes. Siguria e Aleancës është ndikuar dhe mund të ndikohet nga zhvillimet politike edhe përtej kufijve të saj. Si shembull konkret dhe mjaft domethënës është agresioni i pajustificuar i Rusisë ndaj një shteti sovran siç është Ukraina, i cili ka rrezikuar sigurinë jo vetëm në Evropë, por dhe më gjerë. Përdorimi i armëve konvencionale shkatërruese nga ana e Rusisë tregon se rreziku konvencional mbetet eminent, çka solli një reflektim dhe qasje tjetër në hartimin dhe zhvillimin e një koncepti të ri strategjik të NATO-s, në samitin e fundit¹⁶.

“Sekreti i jetëgjatësisë së NATO-s ka qenë aftësia për të lexuar me saktësi mjedisin e jashtëm, por edhe përshtatja e saj me rrethanat. NATO është organizata e vetme dhe faktor parësor për organizimin e Përdimit në këtë

¹³ Chifu, Iulian “Technology and Democracy. The Impact of the Evolution of Security and International Relations”, 2019, p. 24.

¹⁴ Samiti i Lisbonës, Portugali 2010.

¹⁵ Little, Richard, ish-kryetar i Shoqatës Britanike të Studimeve Ndërkombëtare dhe aktualisht profesor Emeritus në Universitetin e Bristolit dhe anëtar i Akademisë Britanike.

¹⁶ Samiti i NATO-s, Madrid, qershor 2022.

periudhë të konkurrencës më të fortë gjeopolitike, por edhe ideologjike”¹⁷.

2. Dimensionet e sigurisë

Përtej sigurisë shtetërore (dimensioni i referencës). Kur flasim për dimensionin e sigurisë, gjëja e parë që na shkon në mendje është se kujt i referohemi si koncept, pra, siguria e kujt duhet të ruhet. Historikisht, koncepti i vërtetë i sigurisë ka qenë i lidhur me konsolidimin e kombit, ku në këtë mes shteti si vetmi aktor garantues legjitim në politikën e marrëdhënieve siguronte sovranitetin.

Pjesa më interesante dhe më origjinale e filozofisë së Hobsit¹⁸ është mësimi i tij mbi moralin dhe shtetin. Që kur lindi shoqëria njerëzore, njerëzit, në realitet, ishin të barabartë nga natyra. Mirëpo, në gjendjen natyrore para ekzistimit të shtetit, secili dëshironte ta ruajë lirinë e vet dhe ta sigurojë atë nëpërmjet pushtetit mbi të tjerët. Në këtë kontekst, kur nuk kishte ligj, nuk kishte prone natyrore, nuk kishte drejtësi dhe padrejtësi, ekzistonte vetëm lufta me dy elementet e saj forcën dhe mashtrimin. Me evoluimin e shoqërisë njerëzore, kjo gjendje pasigurie dhe imorale nuk mund të vazhdonte pasi ishte e rrezikshme njësoj për të gjithë njerëzit, ndaj ata u detyruan t'i japin fund luftës në interes të paqes. Njerëzit krijuan garantuesin dhe siguriesin e sigurisë së tyre që ishte shteti. E gjithë forca iu delegua sovranit, i cili kishte në duart e veta pushtetin absolut dhe të pandashëm. Megjithatë siguria e shtetit, mbeti në terma relativisht të pasigurt në kontekstin e një sistemi ndërshtetëror të marrëdhënieve ndërkombëtare, pra në sundimin e territorit të kombit dhe ruajtës së kufijve të tij përballë shteteve të tjera. "Kuptimi i interesit kombëtar është mbijetesa - mbrojtja e identitetit fizik, politik dhe kulturor kundër shkeljeve të shteteve të tjera kombëtare"¹⁹.

Në kuadrin e një monopoli ndërkombëtar të pushtetit dhe autoritetit, të gjitha shtetet vendosin si detyrë primare të tyre mbijetesën kombëtare. Mjedisi strategjik sot është shumë më i ndryshëm nga ai i mëparshmi, një ndryshim që ka sjellë një mënyrë tjetër për konceptimin dhe përballimin e rreziqeve dhe kërcënimeve ndaj sigurisë globale dhe kombëtare. Gjendja e rëndë në të cilën ndodhet sot një botë multipolare dhe e kërcënuar nga armët atomike nuk është tjetër, veçse manifestimi ekstrem i një dileme me të cilën shoqëria njerëzore duhet të përballë që nga fillimi i historisë. Në ditët e sotme, rasti më tipik është agresioni i pajustificuar i Rusisë ndaj një shteti sovran siç është Ukraina, i cili ka rrezikuar sigurinë jo vetëm në Evropë, por dhe më gjerë.

¹⁷ Wess Mitchell, ish-ndihmëssekretari amerikan i Shtetit, anëtar i Grupit të Reflektimit "NATO 2030: Të bashkuar për një epokë të re."

¹⁸ Hobbs, Tomas, një nga filozofët më të shquar të Anglisë.

¹⁹ Morgenthau, autor i librit "Politics among Nations", 1948.

Përdorimi i armëve konvencionale shkatërruese nga ana e Rusisë tregon se rreziku i konvencional mbetet eminent, çka duhet reflektuar në qasje tjetër në hartimin dhe zhvillimin e dokumenteve strategjike.

Në këtë kontekst, shtetet duke u përpjekur për të arritur sigurinë nga një sulmi të tillë, ata janë të shtyrë të fitojnë gjithnjë e më shumë fuqi për t'i shpëtuar ndikimit të fuqisë së tjerëve. Kjo, nga ana tjetër, i bën të tjerët më të pasigurt dhe i detyron ata të përgatiten për më të keqen. Meqenëse askush nuk mund të ndihet plotësisht i sigurt në një botë të tillë konkurruese, atëherë sfidat e sigurisë dhe rritja fuqisë kombëtare ngelen prioritete themelore të shteteve. "Në anarki, siguria është qëllimi final më i lartë"²⁰. Megjithatë kjo ide kombëtare, si zgjidhje e sfidës së sigurisë ndaj sovranitetit dhe integriteti territorial të një shteti nuk mbeti e padiskutueshëm, por është pasuar me debate të shumta nga teoricienët e ndryshëm. Historikisht, teoricienët liberalë si John Locke dhe Immanuel Kant theksuan se shteti është vetëm një instrument për sigurimin e publikut. Ata ngritën idenë e kohës duke sfiduar të menduarit realist se shteti është qendër e gjithçkaje dhe duke argumentuar se siguria është një koncept më i gjere dhe se shoqëria duhet të jenë pika kryesore referuese për politikën e njerëzve, ndërsa fokusi i politikës dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në përgjithësi duhet të jetë shoqëria. Pra lindi koncepti i sigurisë shoqërore, që do të thotë që një grup apo kolektiv jeton në siguri dhe liri në mënyrë që të mund të zhvillojë produktivitetin dhe pasurinë e tyre²¹.

Përtej sigurisë ushtarake (dimensioni i çështjes). Nënshkrimi i Traktatit të Vestfalisë në vitin 1648 i dha fund luftës tridhjetëvjeçare dhe shënoi lindjen e Evropës moderne si një kontinent me shtetet sovraane. Me krijimin e shteteve moderne siguria mori një dimension të ri konceptual, duke e lidhur atë kryesisht me çështjet ushtarake. Kjo vinte nga fakti se siguria më e madhe dhe shqetësimet kryesore për shtetet përcaktoheshin nga sulmet ushtarake dhe rreziku për t'u pushtuar. Në këtë pikëpamje, interesat tradicionale të sigurisë kombëtare ishin të lidhur pothuajse vetëm të natyrës ushtarake. Siguria ushtarake barazohej me sigurinë kombëtare, kështu që siguria ushtarake konsiderohej më e rrezikuara nga shtetet armiqësore.

Termi i sigurisë ishte i lidhur me çështjet ushtarake shtetërore dhe mori një perspektivë realiste në kërcënimet shtet-shtet dhe parandaluese gjatë Luftës së Ftohtë, duke u fokusuar në strategjinë dhe vendimin bërthamor sovjetik²². Pas viteve 60', me krijimin e lëvizjeve nacionalçlirimtare të ashtuquajturës "Botë e Tretë", përpos kërcënimeve ushtarake shtetërore lindën dhe kërcënime

²⁰ Waltz, Kenneth, "Theori of International Politics", 1979.

²¹ Wæver, Ole, professor of international relations at the Department of Political Science, University of Copenhagen, "Securitization and Desecuritization", 1993.

²² Kissinger, A. Henry, "Nuclear Weapons and Foreign Policy", 1957.

ushtarake joshtetërore të perceptuara për kohën si kërcënime “komuniste” ndaj interesave të SHBA-së dhe Perëndimit, duke sjellë në të njëjtën kohë dhe nevojën për zhvillimin e strategjive të reja të “luftës së kufizuar” dhe kundër rebelimit”²³.

Kërcënimet ushtarake joshtetërore, asimetrike vazhduan në mënyrë më të sofistikuar në kohët e mëvonshme duke kulmuar me sulmet terroriste të 11 shtatorit 2001, të kryera nga rrjeti militant islamik Al-Kaeda kundër Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kohët kanë treguar se edhe grupet e vogla kanë fituar kapacitetin për të shkaktuar disproporcion, duke dëmtuar dhe si rrjedhim duke sfiduar seriozisht sigurinë e një shteti. Në ditët e sotme janë zhvilluar komponentë të rrezikshëm që sfidojnë sigurinë, përtej komponentit klasik ushtarak. Kjo është arsyeja përse koncepti i sigurisë sot nuk i referohet vetëm shteteve armiqësore, por edhe aktorëve joshtetërorë si burim i kërcënimeve ushtarake.

Përtej sigurisë kombëtare (dimensioni gjeografik). Kur flasim për termin “siguri”, gjëja e parë që na shkon në mendje është siguria në nivel kombëtar, në kuptimin tradicional të këtij termi. Pyetja që shtrohet është: se kur flasim për nocionin siguri kombëtare cila është shtrirja e shqetësimeve të sigurisë gjeografikisht? Historikisht, realistët, me siguri tradicionale kuptonin vetëm strategjinë (politikën) zyrtare të sigurisë që zbatohet në nivel kombëtar. Ata e konsideruan të gabuar hartimin e politikave të sigurisë përtej shtetit edhe nëse problemet globale të sigurisë ekzistonin, zgjidhjet i kërkonin në çdo rast në nivel kombëtar. Siguria kombëtare pra i referohet sigurisë së shtetit territorial duke përcaktuar drejt qëllimet, rrugët dhe mjetet. Mirëpo, problemet e sigurisë me kalimin e kohëve gjithnjë e më shumë morën karakter global, për shkak të kërcënimeve dhe rreziqeve me karakter global. “Problemet që po tronditnin botën kërkonin zgjidhje globale, por nuk kishte agjenci globale për t’i siguruar ato”²⁴.

Shtetet në përgjithësi dhe në veçanti ato në nivel rajonal, ndajnë pothuajse shumicën e rreziqeve dhe kërcënimeve të njëjta ose të përafërta. Mjedisi i sigurisë vazhdimisht i ndryshueshëm solli si domosdoshmëri një qasje të re në përballimin e sfidave të sigurisë. Shtetet filluan të zhvillojnë strategji të përbashkëta për të mbrojtur interesat e tyre të përbashkëta në nivel rajonal.

Në nivel global, themelimi i NATO-s në vitin 1949 shënoi dhe zhvillimin e një “komuniteti sigurie” transatlantike. Strategjitë dhe organizatat e përbashkëta të sigurisë zhvillohet kur shtetet integrohen politikisht me njëra-tjetrën, duke hequr dorë nga dhuna si mjet për zgjidhjen e konflikteve ndërmjet tyre dhe duke zhvilluar ide dhe plane të përbashkëta se si të vendoset dhe ruhet stabiliteti rajonal e më gjerë. Politika e sigurisë në nivel rajonal formësohet

²³ Blaufarb, S. Douglas, “The Counter-Insurgency Era”, botim i vitit 1977.

²⁴ Waltz, Kenneth, “Theory of International Politics”, 1979.

thellësisht prej atyre shteteve që jetojnë brenda një komuniteti ndërkombëtar dhe që priren për marrëdhënie paqësore. Studiues, shkencëtarë dhe filozofë kryesorë kryejnë studime dhe shqyrtojnë çështje të sigurisë në organizatave, në kontekste të ndryshme historike dhe rajonale në vendet ku ato ekzistojnë, shfaqen dhe ndoshta ku janë vështirë të zbulohen. Vlen të përmendet se në shumë rajone të botës ka mjaft nisma, projekte dhe komitete të përbashkëta sigurie, duke kapërcyer tashmë nocionin e ngushtë të sigurisë kombëtare²⁵. Shembuj tipikë për rajonin tonë ballkanik janë mjaft nisma dhe projekte të përbashkëta në fushën e sigurisë e më gjerë.

Përtej kërcënimeve klasike (dimensioni i rrezikut). Dimensioni i katërt dhe ndoshta më i rëndësishëm i ndryshimit konceptual të sigurisë lidhet me kuptimin e rrezikut. Tradicionalisht, sfidat politike dhe rreziqet ndaj shteteve janë përcaktuar në bazë të kërcënimeve të marrëdhënieve, aleancave ushtarake, synimeve armiqësore, aftësive ushtarake në raport me njëra-tjetrën. Pas Luftës së Dytë Botërore, bota ishte e ndarë në dy blloqe me baza ideologjike krejtësisht të ndryshme, në atë perëndimor që përfaqësonte sistemin kapitalist dhe atë lindor që përfaqësonte sistemin komunist. Shpërthimi i bombës së parë atomike ruse në vitin 1948, për nënshkruesit e paktit të Brukselit do të nënkuptonte se ishte prishur ekuilibri ndërmjet lindjes dhe perëndimit në Europë. Për të mënjanuar, zvogëluar dhe zbutur kërcënimet dhe rreziqet ndërmjet shteteve dhe blloqeve, doli si domosdoshmëri zhvillimi i aleancave. Pra, shteteve të perëndimit u lindi si domosdoshmëri krijimi i një blloku ushtarak padyshim shumë më të gjerë se mundësitë e tyre reale²⁶. Në këto rrethana, më 4 prill 1949 u nënshkrua Pakti i Atlantikut të Veriut në Uashington. Qëllimi kryesor i këtij pakti ishte ndihma reciproke në rast agresioni në Europë dhe në Amerikën Veriore. Ky pakt gjeti shprehjen e tij në krijimin e Organizatës të Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO), e cila u ngarkua me krijimin e një force ushtarake nën një komandë të përbashkët ushtarake²⁷.

Krijimin e NATO-s dhe zhvillimin e lëvizjeve antikomuniste në Europë, Bashkimi Sovjetik i shikonte me frikë e dyshime dhe arriti në përfundimin se duhej të merrte masa kundërvepruese ndaj Bllokut Perëndimor me vendet e tjera komuniste në sferën e ndikimit të saj të interesit. Kështu, më 1949 themelohet Këshilli për Ndihmë Reciproke Ekonomike (SEV), ndërsa në vitin 1955 formohet Blloku Ushtarako-Politik – Traktati i Varshavës, ku anëtar i këtij pakti ishte edhe Shqipëria.

Tashmë, Lindja dhe Perëndimi qëndronin të armatosur përballë njëri-tjetrit.

²⁵ Adler, Emanuel; Barnett, Michael, "Security Communities", 1998.

²⁶ Karl, Grimberg, "Historia Botërore dhe Qytetërimi", vëll. 12, Shtëpia botuese "Uegen", fq.185.

²⁷ Po aty.

Ky rast shënon paradigmen e tensioneve politike dhe ushtarake, të armiqësive, rreziqeve dhe kërcënimeve të ardhshme ndërmjet Bllokut Perëndimor (Shteteve të Bashkuara dhe aleateve të saj në NATO) dhe Bllokut Lindor (Bashkimit Sovjetik dhe shteteve satelite të saj). Kjo periudhë e quajtur “lufta e ftohtë”, sipas doktrinës Truman zgjati nga 12 marsi 1947 deri në shpërbërjen e Bashkimit Sovjetik më 26 dhjetor 1991.

Në këtë mjedis gjeostrategjik të sigurisë, armët bërthamore u bënë instrumenti i politikës së dhunës, por nga ana tjetër, ato ndikuan në evitimin e një lufte ndërmjet superfuqive me përmasa botërore dhe pasoja të paparashikueshme. Në konceptin e sigurisë së dy superfuqive qëndronte faktori tekniko-teknologjik. Në këto kushte tensioni ndërmjet dy superfuqive lindi edhe teoria e negociatave nga “pozitat e forcës”. Nga situatat e forta lindin marrëveshjet.

Këto marrëveshje dhe traktate të arritura në balancimin dhe kufizimin e armëve konvencionale bërthamore pothuajse ruajtën “status quo”-në deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë. Përtej rreziqeve e kërcënimeve ushtarake, u perceptuan edhe rreziqe të tjera të përhapura për gjendjen sociale dhe mirëqenien e shoqërive, ky koncept i pasigurisë si një kërcënim simetrik u bë i paqëndrueshëm. Në kohët e ndërvarrësive së madhe sociale dhe ekonomike të një vendi, rreziqet nuk janë domosdoshmërisht vetëm të natyrës së kërcënimeve ushtarake nga kundërshtari. Pasiguria duhej të matej në mënyra alternative, duke përfshirë si kërcënimet prej ndikimeve të jashtme, ashtu dhe faktorët ekonomiko-socialë. “Nëse dilema e sigurisë për të gjitha shtetet do të ishte forca ushtarake, komponentët e saj mbështetës (të cilët natyrisht përfshijnë një element të madh ekonomik) do të ishin qartësisht burimi dominues i fuqisë”²⁸.

Duhet theksuar se gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë u zhvilluan në ekuilibër dy koncepte kryesore të sigurisë, ai i zhvillimit teknologjik të balancuar dhe koncepti i zhvillimit social-ekonomik.

Me ndryshimin e politikës së sigurisë, pas Luftës së Ftohtë, me konceptin e “cënueshmërisë”, kuptojmë vetëm një hap të vogël drejt paradigmaticës së sigurisë së ardhshme. Sot, rreziqet mbizotërojnë në të gjitha diskutet për politikën e marrëdhënieve ndërkombëtare. I ashtuquajtur “rreziku i qartë dhe aktual” i Luftës së Ftohtë është zëvendësuar nga “rreziqet dhe sfidat” e paqarta dhe të paparashikueshme për të ardhshmen. Përhapja e armëve të dëmtimit në masë (ADM), terrorizmi transnacional, krimi i organizuar, degradimi i mjedisit, ndryshimi i klimës globale dhe pandemitë dhe shumë çështje të tjera diskutohen në aspektin e pasigurisë dhe rrezikut. Ngjashmëria e tyre qëndron në papërcaktueshmërinë relative të tyre.

²⁸ Keohane, Robert O.; Nye, Joseph S., “Power and Independence”, 1977.

2. Siguria dhe trajtimi akademik i saj

Siguria strategjike si një disiplinë më vete. Pavarësisht se siguria në aspektin e studimit na duket si një koncept i kontestuar, kjo nuk i ka penguar vendimmarrësit politikë, ekspertët e politikave apo akademikët dhe studiuesit e ndryshëm të zhvillojnë një interes të vazhdueshëm për kuptimin e sigurisë duke e shoqëruar me një rritje të studimeve të sigurisë, si dhe kërkimit shkencor në këtë fushë. Ky zgjerim i kuptimit të sigurisë ka pasur ndikimet e veta në jetën shoqërore, politikat shtetërore, si dhe riformulimet e konceptit të sigurisë në nivel shtetëror, në kuadër të Aleancës dhe nivel global. Siguria është baza universale e themelore e shoqërisë, pra çështje e të gjithëve. “Siguria është baza universale e shoqërisë njerëzore e materializuar në shtetet sovrane”²⁹. Sot, ndërsa koncepti i sigurisë është bërë gjithëpërfshirës, vihet re një interesim dhe një rritje e numrit të nëndisiplinave akademike brenda shkencave politike në përgjithësi dhe marrëdhënieve ndërkombëtare në veçanti, duke riformatuar teori, axhenda dhe programe të kërkimit metodologjik të studimeve të sigurisë, në institucionet akademike dhe shkencore.

Ky zhvillim akademik ka bërë që siguria të trajtohet si një nga konceptet kryesore të kontestuar brenda akademisë dhe politikës në shekullin e kaluar. Kjo ka bërë gjithashtu që çështjen e sigurisë dhe studimin e saj ta shikojmë si një temë që ndryshon vazhdimisht.

Pra, krahas studimeve të shumta në fushën e historisë, sociologjisë dhe përtej vlerësimit dhe frikës për një fushë kërkimore gjithnjë e më të fragmentuar, një rëndësi e madhe po i kushtohet studimeve në fushën e sigurisë. Mjedisi i sigurisë vazhdon të jetë i paparashikueshëm dhe rreziqet e kërcënimeve të sotme vazhdojnë të evoluojnë gjithnjë e më shumë drejt natyrës asimetrike, hibride dhe kibernetike. Bota e dekadës së ardhshme do të jetë shumë e ndryshme, ku fuqitë e mëdha konkurruese, kanë agjenda të zgjerimit të fuqisë dhe ndikimit të tyre në rrafshin global, por dhe në atë rajonal dhe kombëtar. Tashmë, krahas rreziqeve dhe kërcënimeve të njohura, po shfaqen edhe rreziqe të rinj me karakter global, sidomos nga pandemitë, ndryshimi i klimës dhe “rreziqet teknologjike”. Ky kompleksitet dhe kjo paparashikueshmëri e mjedisit të sigurisë shtrojnë nevojën e kërkimit shkencor me synim identifikimin, analizën, vlerësimin dhe përcaktimin e qasjeve për përballimin e tyre. Fusha e sigurisë dhe mbrojtjes është shumë e gjerë dhe shumë dimensionale, ku përfshihen siguria ushtarake, ekonomike, njerëzore, shëndetësore, energjetike, mjedisore, ushqimore, kufitare dhe kibernetike, të cilat janë ndikuar në mënyrë të përhershme nga ndryshueshmëria e mjedisit të sigurisë dhe rreziqeve e kërcënimeve të ditëve të sotme. Në këtë pikëpamje objektivi i kërkimit shkencor është si rritja e

²⁹ Hobbes, Thomas, “Leviathan”, viti 1651.

njohurive dhe kuptueshmërisë të realitetit të mjedisit të sigurisë dhe dukurive ushtarake, i cili fillon me parashtrimin e një apo disa pyetjeve kërkimore mbi çështjen që na preokupon apo dukurinë që na intereson. Kërkimi shkencor në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes është përcaktimi i parashikimeve në formën e vizioneve dhe skenarëve të zhvillimeve të mundshëm të së ardhmes, si dhe sfidave për përballimin e tyre, gjë që jep drejtpërdrejt ndikim në transformimin e çështjeve sigurisë si koncept. Shkenca Ushtarake në përgjithësi dhe kërkimi shkencor në veçanti kanë qenë prezent dhe bashkudhëtar të çështjeve të teorisë ushtarake dhe aplikimit të teknologjisë si një disiplinë e vetme.

Shkenca Ushtarake, në përgjithësi, sipas librit “Për Luftën” është përkufizuar si disiplina që përshkruan teoritë, konceptet dhe metodat për angazhimin e forcave të armatosura³⁰.

Kërkimi shkencor sot, është një proces gjithëpërfshirës dhe ndikues në transformimin e çështjeve të sigurisë, i cili përkufizohet si “...një proces i qëllimshëm, sistematik dhe shkencor i mbledhjes, analizimit, klasifikimit, organizimit, paraqitjes dhe interpretimit të dhënave për zgjidhjen e problemit, për parashikimin apo zbulimin e së vërtetës, ose për zgjerimin apo verifikimin e njohurive ekzistuese, të gjitha këto për ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës njerëzore”.

Nëpërmjet studimeve në fushën e sigurisë, së pari, përcaktohet gjendja aktuale e studimeve të sigurisë, si pikënisje, duke nxjerrë në pah statusin e saj të kontestuar disiplinor dhe, mbi këtë bazë, bëhet lidhja e ngushtë ndërmjet historisë konceptuale e sigurisë me zhvillimin konkret të studimeve të sigurisë.

Interesimi i vazhdueshëm i studimeve rreth sigurisë ndërkombëtare na tregon se siguria përfaqëson një vlerë qendrore në rritje brenda shoqërive moderne. Studimet e mirëfillta në fushën e sigurisë i kane fillimet e veta post Luftës së Dytë Botërore, duke evidentuar dy momente kryesore përfundimtare: shpikja e bombës atomike dhe tensionet ideologjike. Në këtë periudhë, zhvillimi i teknologjisë bërthamore solli në të njëjtën kohë edhe përplasjet ideologjike rreth kushteve për parandalimin dhe shkatërrimin e ndërsjellë, pra një përplasje ideologjike ndërmjet lindjes dhe perëndimit që zgjati deri në përfundimin e Luftës së Ftohtë. Dalja në dritë e armëve bërthamore, nëpërmjet zhvillimit të raketave balistike ndërkontinentale, bëri të nevojshme një ridimensionim rreth strategjisë dhe fuqisë ushtarake bërthamore, si dhe trajtimit të sulmeve parandaluese gjatë Luftës së Ftohtë.

³⁰ Clausewitz, Von Carl, “On War”, edited and translated by Michael Howard And Peter Paret, Princeton University Press Princeton, New Jersey, shih: <https://press.princeton.edu/books/paperback/9780691018546/on-war> ; hyrë më 07.09.2021.

Lufta bërthamore ishte “e paimagjinueshme”³¹. Me rritjen e garës bërthamore ndërmjet dy superfuqive, Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimit Sovjetik, lindi si domosdoshmëri adaptimi i strategjive të reja të reciprocitetit dhe të reduktimit gradual të armëve bërthamore. Strategjia e tensionit ndërmjet superfuqive dhe zhvillimi i skenarëve strategjikë solli një zhvillim dhe konkurrencë të madhe në revolucionin tekniko-teknologjik në fushën ushtarake dhe për pasojë një vëmendje të madhe të studiuesve dhe shkencëtarëve në këtë fushë. Profesori dhe psikologu amerikan Charles Egerton Osgood propozoi një strategji të re “Graduated Reciprocation in Tension Reduction” (GRIT)) në 1962, e cila nënkupton një qasje ndryshe psikologjike për të zgjidhur tensionin e sjellë nga gara e armëve bërthamore midis dy superfuqive³².

Tradita e kërkimit shkencor në fushën e sigurisë shtrihet shumë më tej dhe më e gjere se sa analizat që fokusohen në pasojat e revolucionit bërthamor dhe bipolaritetit. Disa studiues kanë vërejtur se studimet e sigurisë dhe studimet strategjike ishin sinonim në periudhën e hershme të zhvillimit të tyre (të përbashkët) me teorinë e parandalimit.

Ka pikëpamje të ndryshme në lidhje me fushat e kërkimit në fushën e sigurisë. Ato përmbliken në dy rryma kryesore, na atë të studimeve e kërkimeve strategjike me një fokus të ngushtë në strategjinë e sigurisë kombëtare dhe në atë që lidhet me nocionin se siguria është më e gjere dhe në të njëjtën kohë zgjerohet vazhdimisht. Përpjekjet për të ripërcaktuar konceptin mbi sigurinë janë orientuar shpesh here vetëm në axhendat e politikave të shteteve-kombe, duke mënjeluar një sërë fushash të reja sigurie, si të drejtat e njeriut, ekonominë, mjedisin, epidemitë etj., të cilat janë identifikuar dhe argumentuar fuqishëm, si në pikëpamjen normative ashtu dhe empirike si çështje konceptuale që lidhen me sigurinë. Mungesa e qartësisë konceptuale në fushën e sigurisë shpesh ekzagjeron dallimet dhe errëson ngjashmëritë midis kuptimeve të ndryshme mbi sigurinë³³.

Ngjarjet historike dhe debatet akademike kanë pasur ndikim në institucionalizimin e studimeve të sigurisë si një fushë e veçantë kërkimore. Zhvillimi i disiplinave të ndryshme në strukturat akademike, institute dhe qendra studimore, nxitja e mendimit politik, financimi, publikimet, kontaktet publike dhe rrjetet kërkimore shkencore marrin një rol vendimtar edhe për studimet e sigurisë. Në fakt në historinë e studimeve për sigurinë do të shohim se kemi periudha të dallueshme për sa i përket marrëdhënieve ndërkombëtare që dominohen, kryesisht, nga çështjet e sigurisë duke filluar me ashtuquajtur

³¹ Brodie, Bernard, me librin “Strategjia në epokën e raketave” ai ndihmoi në krijimin e një mjedisi intelektual për shmangien e një katastrofe bërthamore.

³² Osgood, Charles Egerton (1916-1991), psikolog dhe profesor amerikan, autor i librit “Graduated Reciprocation in Tension Reduction”.

³³ Baldwin, David A., “The concept of security, Review of International Studies” 23, (1997), fq. 5-26.

“epokë e artë” në vitet ‘50 deri ‘60, rritja çështjeve ushtarake dhe zhvillimi traktateve mbi kontrollin e armëve në vitet ‘70-’80, fundi i luftës së ftohtë 1990, epoka e pas 11 shtatorit 2001, si dhe se fundi periudha që përkon me agresionin rus në Ukrainë shkurt 2021 e në vazhdim. Në të gjitha këto periudha, sidomos duke filluar nga viti 1980 e deri më sot debati mes mbrojtësve të një koncepti të ngushtë dhe të gjerë të sigurisë pothuajse ka shërbyer si pikënisje në zhvillimin e teorive të ndryshme mbi temën, teoritë dhe metodologjitë e studimeve të sigurisë si dhe statusit disiplinor të kësaj fushe.

Vitet e fundit ka interes akademik gjithnjë e në rritje për sa i përket politikës vizuale të sigurisë, e cila ka qenë prej kohësh termi kryesor në një objekt studimi. Zhvillimi i koncepteve strategjike alternative kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në mënyrën se si çështjet e lidhura me sigurinë janë studiuar. Mendojmë se kërkohet një kuptim gjithëpërfshirës dhe kritik mbi çështjet e sigurisë dhe mbi këtë bazë një vëmendje të shtuar në trajtimin e tyre nga të gjithë shoqëria dhe veçanërisht nga komuniteti i studiuesve, akademikëve dhe kërkuesve shkencorë. Pavarësisht se çështjet e sigurisë zënë një vend të rëndësishëm në trajtimin e tyre brenda marrëdhënieve ndërkombëtare, ka ardhur koha për nga rëndësia që kanë marrë, ato duhet të përfshihen dhe trajtohen si disiplinë më vete jo vetëm në Akademinë dhe Kolegjin e Mbrojtjes, por edhe në shkollat dhe universitetet civile.

Përfundime

- 1) Analizat mbi sigurinë dëshmojnë se siguria bashkëkohore, do të thotë siguri në nivel të individit, shoqërisë/shtetit dhe sistemit ndërkombëtar, e cila manifestohet në përpjekjet e entiteteve të lartpërmendura për sigurimin e tyre, me mjete të ndryshme në marrëdhëniet mes tyre.
- 2) Siguria ka qenë, është dhe do të mbetet baza universale e vlerave, zhvillimit dhe prosperitetit të shoqërisë njerëzore.
- 3) Format e ndryshme të sigurisë, si nevojat, qëllimet, vlerat, gjendja, vullneti i vetëdijshëm apo aksioni, përbëjnë bazën e elementeve strukturore të individit në nivele të ndryshme të strukturës shoqërore.
- 4) Ndryshimet e vazhdueshme dhe të paparashikueshme në mjedisin e sigurisë globale, veçanërisht në Evropë pas Luftës së Ftohtë, diktojnë qasje dhe aspekte të reja të sigurimit të sigurisë në nivel të sistemit ndërkombëtar.
- 5) Siguria mbetet një fushë e hapur studimi në aspektin e përkufizimit të saj, duke pasur gjithmonë karakter kontestues, për shkak të mjedisit, rreziqeve dhe kërcënimeve që ndryshojnë në mënyrë të vazhdueshme.
- 6) Në fushën e teorive dhe pikëpamjeve të ndryshme, “Teoria realiste” mbetet

qasja më e fuqishme si për studimin, ashtu dhe për trajtimin e sigurisë në praktikën e marrëdhënieve ndërkombëtare.

7) Siguria kombëtare duhet të shihet e lidhur ngushtë në një proces simbiozë me sigurinë rajonale dhe atë globale.

8) Zhvillimi i kapaciteteve të sigurisë duhet të mbajnë parasysh ndërtimin e një përjasjeje rajonale e globale të sigurisë dhe mbrojtjes.

9) Zhvillimi dhe trajtimi i çështjeve të sigurisë si një disiplinë në vete në kurrikulat e akademike, institute dhe qendra studimore, merr një rol vendimtar për studimet e sigurisë.

Bibliografia:

1. Adler, E., & Barnett, M. (1998). Security Communities. Cambridge: Cambridge University Press.
2. Baldwin, David A. (1997). The concept of security, Review of International Studies.
3. Blaufarb, Douglas S. (1977). The Counter-Insurgency Era.
4. Buzan, B. (1991). People, States and Fear; An Agenda for International Security Press.
5. Clausewitz, Von Carl, "On War", edited and translated by Michael Howard And Peter Paret, Princeton University Press Princeton, New Jersey, shih: <https://press.princeton.edu/books/paperback/9780691018546/on-war>
6. Chifu, Lulian. (2019). "Technology and Democracy. The Impact of the Evolution of Security and International Relations".
7. Doktrina e Përbashkët, DP-01, ed.II, 2017.
8. Grimberg, Karl, Historia Botërore dhe Qytetërimi", vëll.12 "Uegen".
9. Hobbes, Thomas. (1651). Leviathan.
10. J.Morgenthau, H. (1978). Politics among Nations, the struggle for power and peace
11. Keohane, Robert O. & Nye, Joseph S. (1977). Power and Independence.
12. Kissinger, Henry A., (1957). Nuclear Weapons and Foreign Policy.
13. Koncepti Strategjik për Mbrojtjen e Zonës së Atlantikut të Veriut, i njohur si DC 6/1, miratuar në dhjetor 1949.
14. Kushtetuta e RSH.
15. Mearsheimer, J. (1994/95). The False Promise of International Institutions. International Security

16. Mitchell, Wess; NATO 2030: Të bashkuar për një epokë të re.
17. Morgenthau, Hans. (1948). Politics among Nations: The Struggle for Power and Peace.
18. Osgood, Charles (1962). Graduated Reciprocation in Tension Reduction.
19. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, 2019.
20. Strategic Concept for the Defence and Security of the Members of the North Atlantic Treaty Organization, 2010.
21. Strategjia e Sigurisë Kombëtare të RSH, 2014.
22. Strategjia Ushtarake e RSH, 2015.
23. Waever, Ole (1993). Securitization and Desecuritization.
24. Waltz, K. (1979). Theory of International Politics. Reading: Addison-Wesley

KONCEPTI I RI I “PARALAJMËRIMIT STRATEGJIK” PËRMES “INFORMIMIT PUBLIK”

Kolonel Msc. Hysni Gjergji

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Paralajmërimi në kohë i vendimmarrësve politikë dhe ushtarakë për agresion ushtarak nga një fuqi armike ka qenë misioni kryesor i inteligjencës ushtarake në të gjithë historinë e luftërave. Epoka digjitale e luftës, përveç të tjerave, solli ndryshim rrënjësor në konceptin e përdorimit të informacionit për lidhshypin politik dhe ushtarak, duke anuar në “kushtrim” për publikun vendas dhe ndërkombëtar. Qasja në “inteligjencën publike” e çdo qytetari të Ukrainës, madje dhe në mbarë botën, me informacion në kohë reale, u arrit vetëm nëpërmjet një smartphone, që kishte akses në internet. Përgatitja për agresion e Rusisë falë informimit publik u denoncua publikisht në media, duke shmangur kanalet e diplomacisë dhe duke e përballur Moskën me prova të qarta, me figurë, zë, film e imazh kryesisht nga OSINT¹. Postulati “Sekreti i fuqisë së shërbimit sekret qëndron te sekreti” u lëkund dhe besohet të jetë objekt i rivlerësimit për komitetin dhe doktrinat e inteligjencës së NATO-s për të ardhmen.*

Shekulli digjital, padyshim do të ndryshojë dhe përshtatë shumë koncepte dhe doktrina, ku inteligjenca dhe dy kategoritë kryesore të saj, burimet e fshehta dhe burimet e hapura, besoj se do të jenë objekt rishikimi dhe përditësimi.

Fjalët kyçe: paralajmërim strategjik, inteligjencë publike, inteligjencë ushtarake, burim sekret (i fshehur) i informacionit, burim i hapur i informacionit, sekret, media, koncept, doktrinë

¹ OSINT -Open Source Intelligence (Burimet e hapura të inteligjencës bazuar kryesisht nga media, rrjetet sociale, publikimet, deklaratat zyrtare etj.)

Hyrje

Qëllimi i këtij punimi është që, nëpërmjet analizës së fakteve të grumbulluara e të publikuara, metodave, studimeve të kategorive tradicionale të grumbullimit të informacionit nga inteligjenca, bashkuar këto edhe me përvojën e fituar nga shtetet dhe ushtritë në një konflikt real të armatosur, të propozohen adaptime dhe ndryshime në doktrinat e zbulimit, kundërzbulimit dhe sigurisë. Digjitalizimi i luftës në veçanti, ka nxjerrë në dukje sfida të reja për zgjidhje, në raportin midis “burimeve sekrete” dhe “burimeve të hapura mediatike të informacionit”. Këto kërkojnë kurajë për t’u pranuar dhe përshtatur në dokumentet e agjencive të zbulimit, të cilat ndryshojnë ngadalë dhe me kujdes. “Vigjilenca për zbulimin në kohë të planeve të kundërshtarit në “lumin” informativ me dezinformacion, gjykoj se është një tjetër arsye pse agjencitë e inteligjencës ushtarake duhet të riklasifikojnë burimet, nën dritën e kërcënimeve të reja dhe tradicionale, ballkanike dhe kombëtare shqiptare”². “Paralajmërimi strategjik” për një agresion ushtarak, si mision i zbulimit strategjik për lidhshimin politik dhe ushtarak, vlerësoj se duhet të bëhet paralelisht edhe me “informimin e publikut”. Populli, që të dërgojë bijtë e tij në luftë, meriton të dijë dhe të bindet që inteligjenca dhe forcat e armatosura janë në misionin e tyre kushtetues, në mbrojtje të integritetit territorial, sovranitetit të vendit dhe jetës së qytetarëve të saj.

1. Dilema e rëndësisë midis informacionit për lidhshimin dhe publikut të informuar

Deri sot ideja e inteligjencës ka dominuar si produkt informativ vetëm për vendimmarrësit politikë dhe komandantët ushtarakë në luftë. Publiku duhej të shikonte vetëm rezultatet dhe, në bazë të tyre, hamendësonte se kjo ishte arritur si rezultat i punës së inteligjencës. Parimi “nevojë për njohje” i kufizon përdoruesit dhe njohësit e produktit informativ të prodhuar nga inteligjenca. Suksesi i inteligjencës është pranuar deri tani me “sekretin e nevojshëm” të kryerjes së operacioneve dhe larg syrit të publikut. Leksioni i inteligjencës,

² Ivana Stradner është këshilltare e Qendrës Barish për Integritetin e Medias në Fondacionin për Mbrojtjen e Demokracive, ku kërkimi i saj përqendrohet gjerësisht në kryqëzimin e së drejtës ndërkombëtare dhe sigurisë. Më konkretisht, ajo është përqendruar në hapësirën kibernetike, sulmet kibernetike dhe luftën hibride ruse.

pas 6 muajsh nga pushtimi rus i Ukrainës, tregoi se “fshehtësia” nuk është gjithmonë e dobishme, pasi ajo e vonon informimin e popullsisë, jeta e të cilit rrezikohet dhe nuk ka kohë për t’u përgatitur moralisht për të dërguar bijtë e tij në frontin e luftës. Ka gjithashtu një paragjykim që inteligjenca si produkt, i përket vetëm shtresës së arsimuar dhe drejtuesve të institucioneve, kryesisht për të përmirësuar dhe korrigjuar vendimmarrjen. Informacioni për publikun, nga ana e shërbimeve të inteligjencës, ka qenë deri sot shumë i kufizuar, kontrolluar dhe ndoshta i ndaluar deri në një farë mase.

Nga shkurti deri tani në shtator 2022 po provohet që agresioni rus mbi Ukrainë është “lufta më e mbuluar mediatikisht në mënyrë dixhitale në histori”³. Shtetet perëndimore në këtë luftë guxuan për herë të parë të shmangin sekretet e informacioneve të shërbimeve të tyre të inteligjencës, të pajustificuara duke i “deklasifikuar” menjëherë. Paralajmërimet për përgatitjen e agresionit rus u bënë në këtë mënyrë bindëse dhe koherente, si për qeveritë aleate ashtu dhe për opinionin publik. H.J. Davies⁴ vlerëson ndryshimin e qasjes së konsumatorit të inteligjencës nga lidhshipi te publiku, si një risi që duhet përqaftuar. Shfaqja në media e informacionit “sekret” bëri të mundur të hidhen poshtë në kohën e duhur përpjekjet e Moskës për mohim, mashtrim, propagandë dhe dezinformacion. Diskretitimi i planeve të pushtuesve rusë nuk mund të bëhej “live”, në spektrin dhe cilësinë e kërkuar vetëm me informacion “sekret”, pasi ai aktivizohet ngadalë, humbet kohë dhe zhvlerësohet shpejt.

Roli i burimeve të hapura të medias ishte thelbësor në këtë operacion, ndoshta për herë të parë, në historinë e luftërave. I pyetur pse mendonte që sulmi rus mbi Ukrainë do të ndodhte, Biden u përgjigj: - “Ne kemi të dhëna shumë të sakta nga inteligjenca”⁵. Komuniteti i inteligjencës i SHBA dhe aleatëve i analizonte burimet e hapura hap pas hapi dhe qëllimisht i jepte akses gazetarëve të shikonin dhe raportonin se si po armatosej dhe përgatitej për luftë Rusia.

Përpjekja për të informuar publikun e thjeshtë deri tani, kërkonte deklasifikim të analizuar e të përzgjedhur me kujdes, por edhe të shpejtë të inteligjencës, për arritjen e efektit pozitiv maksimal. Fushata “hibride” e aleatëve perëndimorë synoi të “bombardojë” hapësirën mediatike me “të vërtetat”?! Lufta hibride e aleatëve të Kievit me të “vërtetat” u vu përballë luftës hibride me “dezinformacionin”, spiunazh, sabotazh dhe subversionin” e

³ Sipas shkrimit të studiuesit britanik Matthew Ford për The Telegraph, 19 dhjetor 2021.

⁴ Shkruar nga profesor Philip H. J. Davies, drejtor i Qendrës Brunel për Studime të Inteligjencës dhe Sigurisë (BCISS) në Universitetin Brunel, Londër, në lidhje me inteligjencën, kundërzbulimin si dhe doktrinat e zbulimit në SHBA dhe UK, në Ukrainë, më 19 maj 2022.

⁵ Në konferencën për shtyp më datë 21 shkurt, Presidenti Biden deklaroi se ai është i sigurt që Putin ka vendosur të sulmojë Ukrainën.

drejtuar nga Moska dhe përshkruar në doktrinën Gerasimov⁶.

Media e furnizuar nga intelijenca paraqiste fakte të dukshme, të matshme dhe të prekshme nga shumë njerëz, rreth qëllimit dhe agresionit ushtarak rus, që po përgatitej. Domosdoshmëria për të ndarë të vërtetat në Ukrainë, përballë dezinformacionit rus, ishte thelbësore për strategjinë e re të informimit dhe të fitimit të mbështetjes së publikut⁷.

Rasti i Ukrainës është një strategji e re e impaktit të inteligjencës së drejtpërdrejtë dhe në kohën e duhur, pasi intelijenca teorikisht cilësohet një “ushqim që prishet shpejt” i cili, nëse nuk konsumohet në kohë, bëhet i padobishëm. Për të arritur në këtë pikë të “koherencës” i është kushtuar vëmendje e veçantë iniciativave të ndërmarra nga UK dhe SHBA, si dhe disa nga shtetet më të vogla të Evropës, për një koncept të ri të përdorimit efektiv të inteligjencës paralajmëruese. Ky koncept do t'i afrojë shtetet perëndimore që të marrin mbështetje masive publike dhe të dënojnë agresorin dhe planin e tij, para se sulmi të ndodhë.

Skenari i ri i paralajmërimit strategjik, zbatuar për skenarin rus në Ukrainë, “bleu” kohë për të ndihmuar, ndërgjegjësuar, pajisur dhe trajnuar ukrainasit në përgatitjet e tyre luftarake mbrojtëse. Qeveritë perëndimore nga ana e tyre filluan që në janar 2022, të deklasifikonin informacionin, analiza dhe vlerësime, për të mbështetur Kievin dhe përgatitur opinionin publik kombëtar dhe botëror. Intelijenca parandaluese përdori konceptin e “paralajmërimit”, në të cilën publiku gjente të vërtetat e provuara të qëllimeve dhe aftësive të kundërshtarit në kohë reale, i cili përpiqej t'i mbante ato të fshehura, por pa sukses. “Intelijenca nga burime të hapura nga popullsia, është thelbësore për vendin tim, pasi aplikacioni i shërbimeve publike të qeverisë ukrainase, “Diia”⁸, u lejon qytetarëve të postojnë foto dhe video, bashkë me vendndodhjet gjeografike. Qytetarët e zakonshëm, me celularët e tyre, kanë mundësi për të imagjinuar veten, si një “operator” të dronit Bayraktar”⁹.

2. Dixhitalizimi i luftës nevojë për të adaptuar doktrinat e inteligjencës dhe sigurisë

Informacioni ushtarak që lidhet me armikun, historikisht ka pasur shpejtësinë e përhapjes së tij, të lidhur me mjetin që e transmetonte: fillimisht me korrier,

⁶ Doktrina e Gjeneralit Gerasimov, SHSHP të Rusisë, publikuar në 2013, thotë: “Rregullat e luftës kanë ndryshuar. Roli i mjeteve joushtarake për arritjen e qëllimeve politike dhe strategjike është rritur, madje në shumë raste ato kanë tejkaluar fuqinë e armëve të zjarrit, në efektivitetin e tyre”.

⁷ Marrë nga deklarata publike e A Blinken, më 12 prill 2022.

⁸ Diia- aplikacioni i shërbimit digjital të shërbimeve në Ukrainë me 23 milion përdorues dhe me moto; shteti si shërbim dhe jo si mashtrim.

⁹ Marrë nga intervista e Mykhailo Fedorov, ministri i transformimit dixhital i Ukrainës, për gazetën “The Washington Post”.

më vonë me kalë, automjet, anije, me avion dhe së fundmi në mënyrë digjitale ose thënë ndryshe, në kohë reale.

Përgatitja për luftë e Rusisë kundër Ukrainës nuk u maskua dot, por u ndoq dhe ndodhi në sy të çdo personi kudo në botë që zotëronte thjesht një *smartphone*. Motorët e kërkimit dhe satelitët privatë komercialë ofronin "free" pamje, foto dhe video drejtpërdrejt nga terreni. Imazhet nga kompania amerikane e teknologjisë hapësinore "Maxar"¹⁰ dhe postimet e mbledhura në mediat sociale në fillim të vitit 2022, shfaqnin grumbullim të pazakontë të forcave dhe tankeve ruse. Këto shfaqeshin për herë të parë në mediat botërore dhe sociale, duke shënuar një hap të ri të informimit publik. Këto pamje të pakundërshtueshme bashkë me të dhënat sekrete dhe HUMINT¹¹ çuan në përfundimin se Rusia së shpejti po përgatitej të kryente një agresion kundër Ukrainës. Paralajmërimi ishte i qartë dhe armatosja e Rusisë po bëhej "live", në sy të gjithë botës, falë medias.

Inteligjenca në epokën digjitale, duke filluar me pushtimin e Ukrainës, hap një kapitull krejtësisht të ri në përdorimin politik, ushtarak dhe diplomatik të inteligjencës, si dhe në marrëdhëniet ndërkombëtare. Gjatë vitit 2022, për herë të parë u bë rritja e transparencës publike nëpërmes inteligjencës ushtarake "të klasifikuar", të dominuara nga "burimet e hapura mediatike".

Para 24 shkurtit, në përgatitjen për luftën e ardhshme, u bë shkëmbim i informacionit mes shteteve dhe qeverive aleate, si dhe informimi i publikut për të vërtetat e synimeve të Moskës. U nda për herë të parë ndoshta informacion i shërbimeve të inteligjencës, me median botërore prestigjioze. Publikimi nuk u mbingarkua, nuk u komplikua dhe nuk la vend për keq interpretim, pavarësisht nga zhurma mediatike dhe dezinformacioni rus. Dr. Neveen Shaaban Abdalla¹² analizon më 11 maj 2022, se si lidhen kërcënimet me njëritjetrit, duke theksuar nevojën për ndërveprim midis agjencive me njëra-tjetrën nga njëra anë, si dhe me median nga ana tjetër.

Ky kryqëzim informacioni bëri të mundur që politikanët, diplomatët dhe gjeneralët në NATO ose jashtë saj të zbulojnë dhe të japin "kushtrimin" në kohë për përgatitjet agresive të Rusisë. Suksesi i inteligjencës paralajmëruese për agresionin rus ishte në thelb aplikim i zhdërvjellët i metodave dhe teknikave

¹⁰ Maxar është partneri satelitor privat i qeverisë amerikane, që ofron imazhe satelitore, inteligjencë cilësore, anije kozmike dhe robotikë për eksplorimin e hapësirës, kërkimin shkencor dhe sigurinë kombëtare.

¹¹ Informacion i grumbulluar nga burime njerëzore dhe agentë sekretë të shërbimeve të inteligjencës.

¹² Dr. Neveen Shaaban Abdalla, lektor për marrëdhëniet ndërkombëtare të mbrojtjes dhe sigurisë, i specializuar fushën e terrorizmit, kundërterrorizmit dhe inteligjencës për Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut.

të krijuara qysh një shekull më parë, por të pazbatuara. Sot terreni digjital i luftës ka bërë që skenarët “fals” dhe realiteti të përhapen më shpejt dhe më larg, madje duke përdorur të njëjtat kanale komunikimi.

Në një postim të titulluar “*#Stop the lies and share the truth*”¹³ provohet me video, dëshmitarë realë okularë, persona të mbijetuar, me figurë dhe me zë; mashtrimi rus në Ukrainë. Është detyrë e secilit, - shprehet Blinken, - që të përhapë të vërtetën që po ndodh në Ukrainë, duke e quajtur këtë si pikën e fillimit të kundërshtimit dhe dënimit të këtij agresioni brutal dhe gjakatar. Rusët kanë përgatitur një ushtri të hakerëve dezinformatorë, të cilët kanë mision të penetrojnë në rrjetet sociale të figurave të rëndësishme politike dhe ushtarake dhe të komentojnë "pozitivisht" sulmin në Ukrainë, si dhe të godasin me spiunazh, subversion dhe sabotazh¹⁴.

Pavarësisht aftësive të larta të demonstruara nga aleatët perëndimorë për të zbuluar në kohë planet ruse, jo të gjithë partnerët arritën në të njëjtat parashikime. Në kohë reale u arritën të bashkoheshin shumë “gurë” të “mozaikut rus”, i cili qartësohej dita-ditës.

Inteligenca rreth aftësive të personelit, pajisjeve, teknikës luftarake, armatimit dhe infrastrukturës së armikut është relativisht e thjeshtë, përballë vlerësimit të “qëllimit” dhe të “kohës” që kundërshtari zgjedh për sulm. Saktësia e vlerësimit të sulmit, natyrisht nuk e penguan Putinin për të filluar luftën, por bindën dhe i dhanë kohë Ukrainës dhe fuqive perëndimore të hynin të përgatitur në konfliktin e armatosur, pasi ishin paralajmëruar në kohë¹⁵.

3. Suksesi i paralajmërimit strategjik ushtarak: është përgjigjja e pyetjes "kur?"

Asnjë luftë nuk ka filluar me lajmërim dhe njoftim të ditës së sulmit nga agresori. Është kundërshtari ai që përcakton afatin kohor të sulmit që planifikon të kryejë. Në të gjitha doktrinat luftarake, befasia vlerësohet si një avantazh që punon në anën e armikut deri në momentin e sulmit. Koha e një sulmi, ka qenë dhe do të jetë gjithmonë e vështirë të parashikohet, kështu që zbulimi strategjik ushtarak duhet të jetë i kujdesshëm për dhënien e “kushtimit”. Kjo do të thotë që gjithmonë duhet të jemi vigilentë për të papriturën, për befasinë që është armë në dorë të armikut. Sfida e inteligjencës ushtarake në çdo luftë ka qenë gjithmonë zbulimi i “qëllimit” të liderit dhe i kohës “kur” ushtria kundërshtare do të sulmojë.

¹³ Antony Blinken, prononcim i datës 24 prill 2022 “Ndal gënjeshttrat dhe përhap të vërtetat”.

¹⁴ Gazeta “The Guardian”, botim i datës 9 maj 2022.

¹⁵ Erik Dahl, profesor në universitetin e Kopenhagës “Suksesi dhe dështimi i inteligjencës”; <http://press.georgetown.edu/book/georgetown/intelligence-and-surprise-attack>, July 2013.

Gjatë agresionit rus në Ukrainë, megjithëse pamjet *live* të ushtarëve dhe tankeve ruse nuk mund të fshiheshin, koha e sulmit dhe qëllimi i Putinit nuk ishin “vizive” dhe duhej të gjendeshin në bazë të gjykimit dhe analizimit të disa fakteve dhe faktorëve. Përgjigja e pyetjes “kur” bëhet më e ndërlikuar dhe më e vështirë, nëse ne përpiqemi të kuptojmë synimet e liderëve autokratë, aq më tepër kur këta janë edhe ekspertë të shërbimeve sekrete, si Vladimir Putin.

Projektimi i linjës logjike dhe i arsyetimit tonë si ekspertë ushtarakë, në vendimmarrjen e kundërshtarit, është i vështirë dhe të çon drejt rezultateve të gabuara. Është vërtetuar se vetëm bërja e “avokatit të djallit” rezultoi si një nga rrugët drejt suksesit. Për të zbuluar vendimin e kundërshtarit, duhet futur në kokën e tij, të përpiqesh të mendosh, gjykos, analizosh dhe të funksionosh si ai. Të arsyetosh si një amerikan, gjerman apo shqiptar për sjelljen e mundshme të një rusi, është e gabuar pasi ndërtimi i proceseve të gjykimit dhe arsyetimit, nuk janë të ngjashme. Shkërmoqja e paparashikuar e ushtrisë afgane, fill pas largimit të trupave të koalicionit, ndodhi si pasojë e këtij gabimi analitik, ku faktorët historikë, socialë, religjiozë, arsimorë, gjeografikë, ekonomikë, politikë etj., nuk u vlerësuan sa dhe si duhet.

“Pika thelbësore, që duhet analizuar për zbulimin e synimeve të armikut, është planifikimi, përgatitja dhe trajnimi i ushtrisë, të cilat mund të zgjasin deri në një vit. Periudha e vendosjes së forcave dhe mjeteve në formacion luftarak dhe fillimi i sulmit, është mjaft e shkurtër”¹⁶.

Pothuajse çdo luftë ka ardhur dhe ka filluar me spekulime, akuza dhe kundërakuza për dështimin apo suksesin e parashikimit të inteligjencës ushtarake, lidhur me kohën e fillimit të saj.

Për zbulimin e “qëllimit të Putinit dhe kohës së mundshme të sulmit”, perëndimi u bazua kryesisht në stërvitjet e shtuara ushtarake ruse përgjatë vitit 2021 dhe dy “eseve” patriotike të Putinit¹⁷, publikuar disa muaj para sulmit. “Tani po shohim përqendrimin më të madh të forcave ruse në kufijtë e Ukrainës, që nga viti 2014”¹⁸. Ekspertët e sigurisë ishin të bindur nga stërvitja “Zapad-21”¹⁹, e cila nxori në pah qëllimin afatgjatë të bashkimit të forcave bjelloruse, nën strukturat ushtarake Ruse. Në “Zapad-21” ishin deri në 200,000

¹⁶ Douglas Nicoll, ish-zyrtar i inteligjencës britanike MI6, raport i publikuar në “The telegraf”, 21 shkurt 2022.

¹⁷ “On the Historical Unity of Russians and Ukrainians”, ese me 5000 fjalë publikuar në mediat qeveritare të Moskës dhe përkthyer në shumë gjuhë, 17 qershor 2021.

¹⁸ Deklaratë e Sekretarit të Shtetit Antony Blinken në një takim në selinë e NATO-s në 17 janar 2022.

¹⁹ Zapad-21 ishte stërvitje ushtarake e drejtuar nga Rusia dhe zhvilluar nga 3 deri 16 shtator 2021. Ishin të ftuar 17 shtete nga këto nëntë ishin shtete pjesëmarrëse: Mongolia, Armenia, Kazakistan, Tajikistan, Kirgizstan, Serbia, Rusia, India dhe Bjellorusia. Tetë të tjerat ishin vëzhguese: Pakistani, Kina, Vietnami, Malajzia, Bangladeshi, Myanmar, Uzbekistani dhe Sri Lanka.

trupa ndërsa të dhënat e publikuara²⁰ vlerësonin se Rusia po vendoste deri në 175,000 trupa përgjatë kufirit ukrainas, duke përfshirë 100 grupe batalione, të afta këto për një sulm konvencional në fillim të vitit 2022. Analizat e DIA²¹, formuluan paralajmërimin e Blinken drejtuar ministrit të Jashtëm rus Sergei Lavrov gjatë bisedimeve në Kopenhagë se; “Rusia do të përballej me pasoja të rënda, nëse do të ndërmernte një sulm ushtarak kundër Ukrainës”.

Drejtuesit e MI6²² nga ana e tyre u bindën për mundësinë e një pushtimi, sepse panë që njësitë kryesore luftarake të vendosura për Zapad-21, nuk u kthyen në venddislokimet e tyre, por qëndruan në Bjellorusi, me rezerva të mëdha municionesh. Pamjet satelitore shfaqën në sy të botës, grumbullimin e trupave ruse, tankeve dhe logjistikës së nevojshme, për të mbështetur një agresion.

Välislouureamet²³ informoi saktësisht për operacion ushtarak konvencional: “Në vlerësimin tonë, Forcat e Armatosura Ruse janë të gatshme të nisin një operacion ushtarak frontal kundër Ukrainës, nga gjysma e dytë e shkurtit me përfshirjen e mbi 150,000 trupave, që janë të dislokuara nga të gjitha rajonet ushtarake të Rusisë. Ky është përqendrimi më i madh ushtarak nga Rusia, në 30 vitet e fundit”.

Megjithatë kishte edhe dallime mes aleatëve të NATO-s. Shefi i Shtabit të FA të Francës²⁴ deklaroi për shtyp se: “Një pushtim rus ishte pjesë e opsioneve të kaluara të vitit 2021. Nëse kjo do të ndodhë, shërbimet tona inteligjente mendojnë se pushtimi i Ukrainës do të kishte një kosto monstruoze dhe rusët kishin edhe mundësi të tjera të planëzuara”. Dy javë pas sulmit, u raportua në media, se Gjenerali Eric VIDAUD i DGSE²⁵ do të largohej nga posti i tij para kohe, për “informacione të pamjaftueshme” mbi kërcënimin rus ndaj Ukrainës. Francezët kishin të drejtë se pushtimi ka ardhur me një “kosto monstruoze” për rusët, por kjo është e papranueshme vetëm për standardin evropianoperëndimor. Francezët nuk e kuptonin se çfarë kostoje ishte i gatshëm të paguante Putin, për të arritur qëllimet e tij. Shqetësimi i liderëve perëndimorë për jetët e humbura, ekonomitë e shkatërruara, vendet e punës, tregtinë, mirëqenien publike, popullaritetin dhe elektoratin, rezultuan se nuk janë të rëndësishme për qëllimet strategjike të Moskës.

Po kështu nga Gjermania, kreu i BND²⁶-së Bruno Kahl u shpëtua nga forcat speciale gjermane, pasi ishte në Ukrainë më 24 shkurt, për bisedime të

²⁰ Gazeta “Washington Post”, 21 dhjetor 2021.

²¹ DIA- Agjencia e Inteligjencës së Mbrojtjes e SHBA.

²² MI6 - Shërbimi i Inteligjencës së Jashtme i Mbretërisë së Bashkuar.

²³ Shërbim inteligjent estonez.

²⁴ Deklaratë e gjeneralit Thierry Burkhard, në konferencë me gazetarët, më 14 janar 2022.

²⁵ Shërbimi i inteligjencës franceze.

²⁶ Shërbimi i inteligjencës gjermane.

planifikuara që më parë²⁷. Ai nuk besonte dhe nuk kishte informacion për një sulm konvencional rus, në atë ditë.

Përveç Francës dhe Gjermanisë, edhe një këshilltar i afërt me Zelenskin besonte dhe deklaronte se Putini po bënte bluf. Vlerësohej që Putini do t'i arrinte qëllimet e tij me presion, pa luftë pasi analiza për leadershipin e Zelenskit nga ana e rusëve ishte e nënvlerësuar dhe rezistenca ukrainase ishte minimizuar.

Me gjithë faktet e dukshme, zyrtarët amerikanë e mbajtën një rezervë besimi, nëse ishte marrë një vendim për kohën e sulmit, apo jo. Ndryshe nga qëndrimi në Afganistan, SHBA dhe UK lëvizën shpejt për të blinduar Ukrainën si në aspektin luftarak, ashtu edhe në rritjen e morali të tyre. "Putini nuk e ka marrë ende vendimin, por qeveria ruse po i jep shumë rëndësi planifikimit operacional për një sulm të afërt ushtarak"²⁸. SHBA-të filluan të publikonin në media informacione mbi subversionin rus: "Rusia ka drejtuar shërbimet e saj të inteligjencës që të rekrutojë zyrtarë aktualë si dhe ish-zyrtarë të qeverisë ukrainase për t'u përgatitur që të marrë qeverinë e Ukrainës dhe për të kontrolluar infrastrukturën kritike të saj, me një forcë pushtuese ushtarake"²⁹. "Ne nuk kemi parë deri sot prova që Rusia ka tërhequr forcat nga kufijtë e Ukrainës. Rusia vazhdon të rrisë kapacitetet ushtarake pranë kufirit të Ukrainës³⁰. Putin, si ekspert i vjetër i inteligjencës, kishte frikë nga rrjedhja e informacionit dhe spiunazhi amerikan, prandaj e maskonte atë vazhdimisht.

Vlerësimi i shërbimeve të inteligjencës amerikane dhe NATO-s se Putini nuk do të shpallte vendimin deri në minutën e fundit për t'u mbrojtur nga "frika e rrjedhjes së brendshme", rezultoi i saktë. Pesë ditë para pushtimit, Presidenti Biden tha se ishte "i bindur" për një sulm që do të ndodhte në "ditët e ardhshme".

Edhe në këtë luftë, intelijenca amerikane dhe aleatët e përcaktuan me saktësi përgjigjen e pyetjes "kur".

Përfundime

1. Liderët autoritarë, si në kohë paqe ashtu dhe në kohë lufte, kanë më shumë frikë publikun e informuar, sesa ushtrinë e kundërshtarit.
2. Epoka e digjitalizimit të luftës, e Inteligjencës Artificiale, luftës kibernetike,

²⁷ Publikuar në gazetën "Der Spiegel" më 26 shkurt 2022.

²⁸ Deklaratë e Jake Sullivan, këshilltari i sigurisë kombëtare në Shtëpinë e Bardhë, pas vizitës të drejtorit të CIA-s Bill Burns në Moskë, më 21 dhjetor 2021.

²⁹ Deklaratë e sekretarit të Shtetit, Blinken në Shtëpinë e Bardhë, më 9 janar 2022.

³⁰ Deklarata e Sekretares së Jashtme të MB, Liz Truss dhe Shefit të Inteligjencës së Mbrojtjes së Mbretërisë së Bashkuar, gjenerallejtënant Sir Jim Hockenhull, më 19 shkurt 2022.

operacioneve psikologjike dhe dezinformacionit ka ndryshuar edhe konceptin e përdorimit të informacionit.

3. Suksesi i parashikimit të inteligjencës po aq edhe dështimi duhen vënë përballë, krahasuar dhe analizuar për të përgatitur mësimet e nxjerra.
4. “Paralajmërimi strategjik” i suksesshëm na ndihmon të përgatitemi për krizat e ardhshme, madje edhe luftërat e ardhshme, sepse ato do të ndodhin, herët a vonë.
5. Gjetja e përgjigjes “kur do të ndodhë sulmi?” do të vazhdojë të mbetet misioni i zbulimit strategjik ushtarak edhe në të ardhmen, për aq kohë sa rreziqet dhe kërcënimet e jashtme do të ekzistojnë.
6. Komponenti (I) i fuqisë kombëtare³¹, pas 24 shkurtit 2022, ka diktuar ndryshim të raportit të burimeve mediatike, krahasuar me burimet e fshehta (HUMINT, SIGINT, IMINT, COMINT, TELINT³² etj.).
7. Ne duhet të ndjekim me vëmendje situatën e sigurisë në rajonin tonë, pasi Rusia po e kërcënon realisht Shqipërinë³³ dhe rajonin³⁴, si me baza ushtarake ruse në Serbi³⁵, ashtu edhe me armë dhe metoda hibride në Kosovë³⁶.

Bibliografia

1. H.J. Davies, Brunel University, Qendra për inteligjencë dhe studime të sigurisë.
2. Doktrina e NATO-s AJP 2-0; Instrumentet e fuqisë kombëtare: plomacy, Intelligence, Military, Economy (DIME).
3. Dr. Neveen Shaaban Abdalla, “Analiza e inteligjencës paralajmëruese në Ukrainë”, 6 maj 2022.
4. Dr. Dan Lomas, “Sa larg do të shkojë Rusia”.

³¹ Komponentët e fuqisë kombëtare: diplomaci, informacion, ushtri, ekonomi, financë, inteligjencë, zbatim i ligjit.

³² Inteligjenca me agjenturë, sinjalore, satelitore, komunikimeve dhe telemetrike.

³³ Svetlana Timofoeva 33 vjeç dhe Mikhail Zorin 23 vjeç, me pasaportë ruse, arrestohen për grumbullim në fshehtësi të informacionit sekret ushtarak në uzinën e armëve në Gramsh dhe përdorim të lëndëve nerv-paralizuuese kundër rojeve tona ushtarake, më datë 19 gusht 2022.

³⁴ Deklaratë e ministres së jashtme britanike Liz Truss “Ballkani dhe Kosova janë objektivat e ardhshëm të Rusisë, pas Ukrainës” më 18 prill 2022.

³⁵ Deklaratë e ambasadorit rus në Beograd Aleksander Bocan Harceko, më 2 gusht 2022 tek “Kosova Press”.

³⁶ Më 7 gusht 2022, agjencia “Rojters”, referuar ministrit të brendshëm Svelca, shkruan se gazetarja ruse Daria Aslamova, që punon për Komsomolskaja Pravda, u ndalua për aktivitet spiunazhi rus në kufirin verior në Kosovë.

5. Deklaratë e sekretarit të Shtetit amerikan, Antony Blinken me datë 24 prill 2022
6. Gazeta "The Guardian" më 9 maj 2022
7. Matthew Ford the telegraf 19 dhjetor 2021
8. Erik Dahl, "Suksesi dhe dështimi i inteligjencës", <http://press.georgetown.edu/book/georgetown/intelligence-and-surprise-attack> , 2013.
9. Douglas Nicoll, "The telegraf" 29 shkurt 2022
10. Gazeta "Washington Post", 21 dhjetor 2021.
11. Gazeta "Der Spiegel", 26 shkurt 2022.
12. Deklaratë e këshilltarit të sigurisë kombëtare të Shtëpisë së Bardhë Jake Sullivan, 21 dhjetor 2021.

KONCEPTI STRATEGJIK DHE SFIDAT E NATO-s, MADRID 2022 VLERËSIME DHE REFLEKTIVE

Kolonel Msc. David Rroku
Nënkolonel (R) Msc. Kanan Himaj
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Koncepti i ri strategjik i NATO-s, Madrid 2022 dhe sfidat e sigurisë nuk janë çështje të zakonshme. Ne po jetojmë në momente të vështira, kur kërcënimet janë ngritur në nivelin e sfidave të mëdha. Thelbi i konceptit lidhet me sfidat e Aleancës në një perspektivë afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë. Koncepti Strategjik i Aleancës është dokument referues për Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s (NDPP), i cili përcjell formën, përmbajtjen, axhendën, kapacitetet dhe qëndrimet themelore të strategjisë së sigurisë kolektive (NATO, BE, etj.).*

Objektivi i Konceptit Strategjik të Aleancës është të pengojë kundërshtarët e saj dhe, nëse është e nevojshme, të mbrojë aleatët kundër çdo kërcënimi. Ky mision nuk ka ndryshuar, por ajo çka ka ndryshuar është mjedisi strategjik me të cilin përballlet Aleanca, me shumë sfida që vijnë nga drejtimet strategjike dhe operacionale. Kjo është arsyeja pse koncepti nënkupton një vizion të ri të integruar me dimensione të gjera sipas shfaqjeve të kërcënimeve dhe sfidave të sigurisë.

Koncepti i ri strategjik i NATO-s është dëshmi e vendosmërisë së aleatëve për të ruajtur paqen, ripohon parandalimin dhe mbrojtjen kolektive si detyrë thelbësore e NATO-s, përkushtimin për menaxhimin e krizave, si dhe bashkëpunimin brenda kontekstit të mjedisit strategjik.

Fjalët kyçe: koncept strategjik, sfidë, aleancë, mbrojtje kolektive, NATO

Hyrje

Tashmë, është qartësisht e dukshme që koncepti i Aleancës tregon mënyrën që NATO do të jetë në gjendje t'i përgjigjet në koherencë me mjedisin e sigurisë rajonale dhe globale, e cila ka dhe përgjegjësinë e ndërtimit të institucioneve më të forta të sigurisë dhe mbrojtjes.

Koncepti i ri i NATO-s, në përmbajtjen e tij dallon se nuk është misioni që ka ndryshuar, por mjedisi strategjik me të cilin përballet Aleanca, me kërcënime dhe sfida që vijnë nga shumë drejtime strategjike dhe ndikojnë në pesë fushat operacionale: tokësore, detare, ajrore, kibernetike dhe hapësinore.

Urgjenca është *tipari përcaktues* i këtij koncepti strategjik, duke pasur parasysh natyrën dhe shtrirjen e sfidave ndaj vlerave të Aleancës, krahasuar konceptin e vitit 2010. Nisur nga bashkëpunimi midis Evropës dhe Amerikës së Veriut, Aleanca është rritur, duke zgjeruar zonën e lirisë. Aleatët e saj kanë rritur kontributet, duke ndarë angazhimin e qëndrueshëm të Aleancës për paqen dhe sigurinë kolektive.

Nisur nga përmbajtja, koncepti është vizion politik-strategjik, i cili bazohet në fuqinë efektive ushtarake. Prandaj, fokusi i tij kryesor është identifikimi i parimeve, parametrave dhe udhëzimeve të nevojshme për zhvillimin e politikave të duhura, planifikimin strategjik-operacional, strukturën e forcës dhe aftësitë e saj. Kjo përfshin përmirësimin e ndarjes së barrës transatlantike dhe krijimin e një aleance më të ekuilibruar, me synimin për të marrë më shumë përgjegjësi për mbrojtjen kolektive, dhe për të qenë reagues e të besueshëm në raste të krizave dhe emergjencave.

Koncepti Strategjik 2022 bazohet në axhendën e NATO-s, - 2030, e cila do të jetë efektive në kohezionin politik; gatishmërinë, aftësitë dhe kapacitetin e përmirësuar të forcave; qëndrueshmërinë e rritur; ndarjen më të drejtë të barrës financiare; në përforcimin dhe balancimin e marrëdhënieve NATO-BE dhe me vendet partnere.

Gatishmëria më e mirë e NATO-s për të përballuar kërcënimet që vijnë nga teknologjitë në zhvillim është gjithashtu thelbësore për Konceptin Strategjik 2022.

2. Thelbi dhe sfidat e NATO-s, qëndrueshmëria e aleancës

Koncepti strategjik 2022 në thelb ka: ruajtjen e paqes, mbrojtjen e njerëzve, i cili përmban tre synime kryesore: të jetë mjaftueshëm e fortë ushtarakisht, më e bashkuar politikisht dhe të adoptojë një qasje më të gjerë globale ndaj sigurisë dhe mbrojtjes. Misioni i këtij koncepti strategjik është të mbrojë territoret, popullsinë, vlerat dhe forcat e Aleancës. Koncepti Strategjik NATO - 2022 ka pesë elemente thelbësore: (1) mbrojtjen e vlerave tona, (2) forcimin e fuqisë ushtarake të NATO-s, (3) forcimin e shoqërive të Aleancës, (4) miratimin e një pikëpamjeje globale dhe (5) ruajtjen e Aleancës si lidhje institucionale jetike midis Evropës dhe Amerikës së Veriut.

Pas gati 20 vitesh, operacionet ushtarake të udhëhequra nga NATO në Afganistan janë mbyllur në mënyrë të papritur, duke ngritur pikëpyetje rreth kohezionit dhe besueshmërisë së Aleancës. Rrjedhimisht, ka disa mësimë që Aleanca ka marrë nga fushata e gjatë në Afganistan, të cilat të gjitha janë në përputhje me Konceptin Strategjik 2022. Këto përfshijnë vendosjen e objektivave realiste politike; nevojën për qëndrim strategjik; rolin e Aleancës në promovimin e qeverisjes më të mirë, sundimit të ligjit dhe zhvillimit ekonomik në një mjedis të paqëndrueshëm; riformatim të përmirësuar të fushatës; kohezion më të fortë politiko-ushtarak; nevojën për rregulla të angazhimit të qëndrueshëm e të përshtatshëm; stabilizim e rindërtim të qëndrueshëm, partneritet me institucionet e tjera dhe kombet partnere; krijimin e një grupi të përshtatshëm për progresin e mbrojtjes; mbi të gjitha, unitetin e qëndrueshëm të përpjekjeve dhe qëllimit të aleatëve.

Në zemër të Aleancës janë vlerat e përbashkëta të një komuniteti unik. Parathënia e Traktatit të Uashingtonit deklaron se Aleanca është "themeluar mbi parimet e demokracisë, lirisë individuale dhe shtetit të së drejtës". Koncepti Strategjik 2022 bazohet në këto vlera, parime e tradita, si dhe në shtatë konceptet e mëparshme strategjike për t'u përgatitur më mirë për një epokë të re, në të cilën këto parime kërcënohen nga shtetet që kanë sisteme qeverisjeje që nuk janë në përputhje me këto vlera dhe që kërkojnë të dëmtojnë demokracinë dhe ata që aspirojnë lirinë.

Mbajtja e rendit e bazuar në rregulla do të sigurohet duke përforcuar paktin transatlantik midis Amerikës së Veriut dhe Evropës. Kjo do të sigurojë që Aleanca të jetë mjaft e fortë politikisht për të përballuar situatat. Kohezioni politik do të përforcohet më tej nga një kulturë e rinovuar e realizmit strategjik në nivelet më të larta, me një njohje të qartë në kohë krize, ku Aleanca duhet të veprojë me shpejtësinë e duhur.

NATO mbetet forumi unik, thelbësor dhe i domosdoshëm transatlantik për

konsultime dhe veprime të përbashkëta për të gjitha çështjet që lidhen me sigurinë individuale dhe kolektive të aleatëve, siç përcaktohet në nenin 4 të Traktatit të Uashingtonit. Çdo çështje sigurie me interes për çdo aleat mund të vihet në vëmendjen e Aleancës për të ndarë informacione, për të shkëmbyer pikëpamje dhe, kur është e përshtatshme, për të krijuar qasje të përbashkëta.

Aleanca përballat me një sërë kërcënimesh që po zhvillohen me shpejtësi. Rusia mbetet kërcënimi i rendit të parë, por terrorizmi dhe paqëndrueshmëria rreth Mesdheut, Lindjes së Mesme dhe Afrikës së Veriut duhet të konsiderohen si kërcënime të vazhdueshme për sigurinë e Aleancës në tërësi. Megjithatë, ndryshimi më i madh midis 2010 dhe 2022 ka qenë ngritja e Kinës si një superfuqi ushtarake dhe konkurrenca e ripërtërirë si pasojë e fuqive të mëdha, e cila është një sfidë për të gjithë komunitetin transatlantik, sigurinë evropiane dhe pjesën më të madhe të vendeve të lira. Marrëdhëniet e ngushta të Kinës me Rusinë shtojnë kompleksitetin strategjik me të cilin duhet të përballat Aleanca. Ajo duhet të përballat gjithashtu me sfida të tjera, të tilla si: teknologjitë në zhvillim, pandemitë e ardhshme dhe ndryshimet klimatike, të cilat të gjitha janë katalizatorë potencialë për konkurrencën dhe paqëndrueshmërinë gjithnjë e më të rrezikshme.

Koncepti thekson se deri në vitin 2030, aleatët evropianë dhe Kanada do të ofrojnë të paktën gjysmën e aftësive të përgjithshme ushtarake të Aleancës, bazuar në kërkesat minimale ushtarake të vendosura nga autoritetet ushtarake të NATO-s. Kjo siguron që barra e mbrojtjes kolektive të ndahet në mënyrë të barabartë me Shtetet e Bashkuara, ndërkohë që me kalimin e kohës do t'iu mundësojë aleatëve evropianë të marrin përgjegjësinë kryesore për menaxhimin e krizave brenda dhe përreth Evropës. Besueshmëria e Aleancës është ndërtuar mbi fuqinë luftarake proporcionale dhe legjitime. Ruajtja e një besueshmërie në një botë në ndryshim kërkon përgjegjësi më të madhe strategjike evropiane dhe aftësi të mjaftueshme për të kryer operacione të nivelit të lartë të menaxhimit të krizave në fqinjësinë strategjike të Evropës. Prania ushtarake e SHBA-së në Evropë do të mbetet e fortë dhe e përforcuar nga forcat e dislokuara dhe stoqet e paravendosura.

Aleatët mbeten të përkushtuar për të përmbushur Premtimin e Investimeve të Mbrojtjes 2014 dhe objektivat për përmirësimin më tej të gatishmërisë së forcave aleate dhe modernizimit të strukturës së forcave të NATO-s, si dhe për të përmbushur nevojat aktuale e të ardhshme të mbrojtjes. NATO do të mbajë një përzierje të përshtatshme të aftësive të mbrojtjes konvencionale, bërthamore dhe raketore për qëllime të parandalimit dhe mbrojtjes, duke përshtatur aftësitë dhe taktikat e Aleancës për operacione në fusha të tjera, si hapësira kibernetike.

3. Mjedisi strategjik i NATO-s

Ndasitë, përçarjet dhe shkatërrimi po shihen si rreziku, sfida dhe kërcënimi me të cilin Aleanca duhet të përballet përmes një mbrojtjeje, parandalimi dhe angazhimi. NATO do të ruajë ose rivendosë integritetin dhe sigurinë e zonës euroatlantike në të gjitha rrethanat, duke përdorur forca dhe burime që të jenë të nevojshme si pjesë e reagimit fleksibël dhe praninë e tyre. Ajo do t'i përshtatet më tej karakterit dhe sjelljes së luftës që ndryshon me shpejtësi, e cila tani shtrihet në një mozaik të luftës së informacionit, luftës kibernetike, asaj "konvencionale" gjithnjë e më e shpejtë dhe luftës bërthamore. Megjithatë, edhe me një rritje të dukshme të aftësive dhe kapaciteteve ushtarake, forcat dhe burimet do të jenë gjithmonë të kufizuara në shtrirje, duke pasur parasysh shkallën e sfidave të nënkuptuara në spektrin e plotë të misionit të NATO-s. Duhet të arrihet një ekuilibër midis ruajtjes së parandalimit dhe mbrojtjes së besueshme në krahun verior dhe lindor të Aleancës; angazhim për sigurinë në Mesdhe, Lindjen e Mesme dhe Afrikës Veriore; sigurisë së Atlantikut të Veriut dhe atë globale, të cilat janë jetike për funksionimin strategjik të saj.

Aleanca do të vazhdojë të kërkojë dialogun me Rusinë dhe të respektojë Aktin Themelues NATO-Rusi, edhe pse Rusia vazhdon të shkelë vlerat, parimet, besimin dhe angazhimet e përshkruara në dokumente të tjera të dakordësuara që mbështesin marrëdhëniet NATO-Rusi. Veprimet agresive të Rusisë dhe sjellja gjithnjë e më sfiduese e Bjellorusisë – e përforcuar nga aftësia ushtarake në rritje e Moskës – vazhdojnë të përbëjnë kërcënimin për sigurinë dhe mbrojtjen e aleatëve. Pushtimi i paligjshëm i Krimesë, destabilizimi dhe agresioni ndaj Ukrainës, mbështetja për separatistët dhe mohimi i aspiratës legjitime të Ukrainës për të zgjedhur aleancat e saj janë pjesë e një politike më të gjerë të detyrimit kompleks strategjik me të cilin Aleanca duhet të përballet. Prania ushtarake në rritje e Rusisë në Bjellorusi dhe nxitja e mijëra emigrantëve të dëshpëruar drejt Polonisë tregojnë për një politikë të sjelljes rreth kufijve të Rusisë, të drejtuar nga Kremli, e krijuar për të minuar sigurinë dhe stabilitetin e aleatëve në rajon.

Modeli agresiv i Rusisë përforcohet nga rritja e forcave të armatosura, të cilat janë krijuar për të kërcënuar krahun lindor të NATO-s dhe rajonin e Detit të Zi. Lufta në Ukrainë dhe stërvitjet e kombinuara me presionin e vazhdueshëm ushtarak në kufijtë lindorë dhe veriorë të Ukrainës tregojnë se Moska tashmë është e përfshirë në një konflikt me synimin për të shtrirë në pjesën më të madhe të Evropës Lindore. Ajo është e angazhuar në kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e municioneve të avancuara, të cilat synojnë të krijojnë një avantazh të qartë ndaj NATO-s në zonat që Moska i konsideron jetike për interesat e saj dhe në një kohë që forcat ruse mund të sjellin fuqi të mëdha. Deti Arktik, Svalbard, Kepi i Veriut dhe Finmark, shtetet baltike, Bjellorusia, Ukraina dhe

rajoni i Detit të Zi janë të gjitha zona ku Rusia është aktive. Për NATO-n kjo është sfidë të cilës duhet t'i përgjigjet.

Terrorizmi sfidon rendin ndërkombëtar të bazuar në rregulla, duke kërkuar të minojë demokracinë dhe stabilitetin në mbarë botën. Rrjedhimisht, terrorizmi duhet parë si një kërcënim parësor për Aleancën. Ai është faktor kryesor në emigracionin masiv në zonën euroatlantike, së bashku me trafikimin e qenieve njerëzore dhe krimin e organizuar, të cilët tani veprojnë në Evropë. NATO duhet t'iu përshtatet kërcënimeve të tilla dhe të kuptojë më mirë shkallën e shtrirjes, ndërveprimin midis tyre dhe ku ajo mund të ndihmojë në trajtimin e tyre si pjesë e përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar.

Rritja e Kinës si superfuqi ushtarake, ekonomike dhe politike do të jetë faktori përcaktues i ndryshimit në dekadën e ardhshme, me implikime të thella për Aleancën. Ndërsa NATO kërkon të mbajë një dialog konstruktiv me Kinën, ndikimi në rritje, fuqia ushtarake dhe ekonomike paraqesin sfida që duhet t'i trajtojë, t'i vlerësojë dhe rivlerësojë. Shpejtësia dhe rritja e madhe e aftësive ushtarake kineze përgjatë mozaikut të hibridit, kibernetikës është shqetësim për Aleancën. Kina paraqet sfida të tjera si: ndërlikimet ushtarako-civile, spiunazhi industrial i sponsorizuar nga shteti, përpjekjet e subvencionuara nga shteti për të monopolizuar tregjet kryesore, kontrolli i monopoleve dhe zinxhirit të furnizimit, investimet e huaja të synuara për të fituar teknologji të ndjeshme, infrastruktura kritike, përpjekjet për të dominuar rrjetet 5G dhe zhvillimin e standardeve në sektorët kritikë të teknologjisë.

Politika gjithëpërfshirëse hapësinore e NATO-s do të sigurojë akses të sigurt të aleatëve në shërbimet, produktet dhe aftësitë hapësinore që do të jenë gjithnjë e më thelbësore për kryerjen e operacioneve, misioneve dhe aktiviteteve të Aleancës. NATO konsideron se sulmet brenda hapësirës përfaqësojnë një sfidë për sigurinë, ndikimi i së cilës mund të kërcënojë prosperitetin, sigurinë, stabilitetin kombëtar dhe euroatlantik. Sulme të tilla madje mund të çojnë në nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit, megjithëse çdo vendim i tillë do të merrej nga Këshilli i Atlantikut të Veriut rast pas rasti. Puna do të përshpejtohet për të thelluar dhe zgjeruar përdorimin e hapësirës, duke përfshirë përmes Qendrës Hapësinore të NATO-s në Gjermani dhe Qendrës Hapësinore të Ekselencës në Francë. Aleanca do të forcojë më tej ndërgjegjësimin e fushës së hapësirës dhe do të integrojë më mirë hapësirën në aktivitetet aleate, duke përfshirë trajnime dhe ushtrime, elasticitet dhe përpjekje për inovacion. Prania e aleatëve do të jetë plotësisht në përputhje me ligjin ndërkombëtar dhe NATO do të ofrojë mbështetje të plotë për përpjekjet ndërkombëtare për të promovuar sjellje të përgjegjshme në hapësirë.

Aleanca do të luftojë ndaj veprimtarive armiqësore të informacionit,

përdorimit keqdashës i teknologjive të sofistikuar, spiunazhit dhe sulmeve të synuara, të cilat kanë për qëllim minimin e besimit në leadershipin legjitim për sigurinë dhe mbrojtjen. Ajo do të zhvillojë mjete për të përballuar konfliktin e "zonës gri" midis paqes dhe luftës. Qëllimi kryesor i konfliktit të "zonës gri" është të shfrytëzojë tensionet politike midis aleatëve dhe tensionet sociale brenda tyre. Kina dhe Rusia përdorin një sërë instrumentesh luftarake ekonomike, politike dhe informacioni kundër aleatëve, të tilla si: kërcënimet ndaj furnizimeve me energji, sulmet kibernetike ndaj infrastrukturës dhe sistemeve kritike, propaganda ndaj segmenteve të cënueshme të shoqërisë, lufta për përmbysje politike dhe kërcënim i fuqisë ushtarake, si pjesë e grupit të shtrëngimit strategjik.

4. Forcimi dhe ribalancimi i marrëdhënieve

a. Ndarje e barabartë e barrës

NATO është komponenti jetik në politikat e sigurisë globale e cila do të rritet për shkak të sfidave e reja. Ajo do të vazhdojë të udhëheqë operacionet e mbrojtjes kolektive në Evropë deri në vitin 2030 me një ndarje të drejtë e barrës së Aleancës, e ndërtuar mbi parimin e rrezeve, përgjegjësisë dhe kostove të përbashkëta. Kanadaja dhe aleatët evropianë do të ofrojnë më shumë forca dhe aftësi të nivelit të lartë për të plotësuar forcat amerikane në të gjithë zonën euroatlantike. Të gjithë anëtarët e Aleancës do të vazhdojnë të ndajnë përgjegjësinë për qëllimet dhe misionet e NATO-s.

Që nga samiti i NATO-s në Uells të vitit 2014, aleatët evropianë kanë bërë përpjekje për të rritur shpenzimet e mbrojtjes, disa vende përmbushin objektivin prej 2 për qind të PBB-së, nga të cilat 20 për qind në vit duhet të shpenzohen për pajisje të reja.

b. Përgjegjësia strategjike evropiane

Realizimi i përgjegjësisë strategjike evropiane do të jetë jetik për ribalancimin më efektiv të roleve ushtarake, duke lehtësuar shqetësimet legjitime të SHBA-së për ndarjen e barrës transatlantike. Rritja e përgjegjësisë strategjike evropiane nuk është vetëm një parakusht për përmirësimin e ndarjes së barrës transatlantike, por ajo promovon konsultime për çështjet politiko-strategjike, duke siguruar që aleatët evropianë të kenë rol më të madh në Aleancë. Një përforsim i aftësive evropiane do t'i japë evropianëve mundësinë për të marrë më shumë përgjegjësi për menaxhimin e krizave brenda kornizës së Politikës së Përbashkët të Sigurisë dhe Mbrojtjes të BE-së ose përmes koalicioneve dhe jashtë kuadrit të BE-së. Qëllimi është që aleatët evropianë të bëhen reagues efektivë në krizat e mundshme në Lindjen e Mesme dhe Afrikën e Veriut dhe të marrin drejtimin për misionet bashkëpunuese, të tilla si ato të trajnimit në

Detin e Zi ose Ballkanin Perëndimor.

Duke njohur identitetet e veçanta strategjike të dy institucioneve, do të nxitet një partneritet strategjik midis NATO-s dhe BE-së, duke ndërtuar një partneritet të privilegjuar. BE-ja mbetet një partner unik dhe thelbësor për Aleancën për suksesin e të dy institucioneve në një mjedis kompleks të sigurisë. Marrëveshjet e tilla do të jenë të shpejta dhe t'u përgjigjen nevojave të BE-së në këmbim të përfshirjes të ashtuquajturave vende të treta në planifikimin dhe kryerjen e operacioneve të BE-së. Vetëm atëherë aleatët e NATO-s do të angazhojnë forca dhe burime për të gjithë spektrin e operacioneve civilo-ushtarake të BE-së për menaxhimin e krizave.

5. Detyrat dhe përgjegjësitë themelore të NATO-s

Koncepti Strategjik 2022 ripohon tre detyrat thelbësore: mbrojtja kolektive, menaxhimi i krizave dhe siguria e bashkëpunimit dhe vendos më tej prioritetet e reja të qëndrueshmërisë për të përballuar sfidat që vijnë nga mjedisi në ndryshim i sigurisë. Koncepti Strategjik 2022 ribаланcon qëllimet, mënyrat, mjetet e sigurisë dhe mbrojtjes aleate, plotëson më mirë kërkesat për qëndrueshmëri të shtuar dhe ndarje më të drejtë të kostove dhe rreziqeve.

- **Mbrojtja kolektive:** Aleanca do të vazhdojë të udhëheqë mbrojtjen kolektive dhe të riafirmojë angazhimin e vendosur dhe detyrues për të ndihmuar gjithmonë njëri-tjetrin, në përputhje me nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit. NATO ripohon vendosmërinë e saj për të penguar dhe mbrojtur ndaj çdo agresioni kur kërcënohet siguria e aleatëve ose e Aleancës në tërësi.

- **Menaxhimi i krizave:** Aleanca do të vazhdojë të aplikojë dhe përshtatë forcën e saj, aftësitë politike dhe ushtarake për të adresuar spektrin e plotë të krizave, gjatë dhe pas konflikteve. Një përzierje e përshtatur e mjeteve politike dhe ushtarake të Aleancës për të ndihmuar në menaxhimin e krizave do të ofrohet më mirë në partneritetet strategjik.

- **Siguria e bashkëpunimit:** Aleanca vazhdon të pranojë se mund të ndikojë në zhvillimet politike dhe të sigurisë përtej kufijve të saj. Ajo do të angazhohet për të rritur sigurinë ndërkombëtare, nëpërmjet partneritetit me vendet përkatëse dhe organizata të tjera ndërkombëtare; të kontribuojë në kontrollin e armëve, mospërhapjen dhe çarmatimin; dhe të mbajë derën e hapur për anëtarësimin në Aleancë.

Për të përforcuar detyrat kryesore, qëndrueshmëria e shtuar do të jetë një përparësi. Parimi i elasticitetit është në nenin 3 të Traktatit të Uashingtonit. Duke vendosur Angazhimin e Forcuar të Qëndrueshmërisë dhe kërkesat bazë, ajo ka ripohuar se qëndrueshmëria kombëtare dhe kolektive është një komponent jetik i parandalimit dhe mbrojtjes së besueshme, përmbushjes

efektive të detyrave thelbësore. Sulmet kibernetike dhe lufta e informacionit mbi infrastrukturën kritike civile dhe ushtarake konsiderohen si rreziqe të qarta dhe të pranishme. Ata do të forcojnë përpjekjet për të reduktuar cenueshmërinë e tyre ndaj kërcënimeve të tilla dhe do të punojnë ngushtë me BE-në. Një bashkëpunim i tillë do të ndihmojë në sigurinë, pavarësisht nga natyra dhe shkalla e një sulmi ose ngjarjeve të tjera, vazhdimësia e qeverisjes, shërbimet thelbësore për popullsinë, mbështetja civile për ushtrinë do të ruhen në të gjitha rrethanat, duke forcuar kështu më tej parandalimin.

a. Modernizimi i strukturës së NATO-s

Aleanca do të angazhohet për forcimin dhe modernizimin e mëtejshëm të strukturës së forcave të NATO-s për të përmbushur nevojat aktuale dhe të ardhshme të parandalimit dhe mbrojtjes. Kjo do të sigurojë një arkitekturë fleksibël, të shkathët dhe të qëndrueshme, e krijuar për të siguruar forcën e duhur, në vendin dhe kohën e duhur. Komanda dhe kontrolli do të modernizohen dhe do të përshtaten më mirë për të mbështetur qëndrimin e NATO-s, menaxhimin dinamik të forcës, sistemin e përmirësuar të reagimit dhe planifikimin më të shpejtë. Rrjedhimisht, theksi i shtuar do t'i vihet ndërvlerësishë së gjeografisë dhe gatishmërisë. Gatishmëria do të jetë e rëndësishme dhe aleatët janë plotësisht të përkushtuar për të përmirësimin e gatishmërisë dhe në këtë mënyrë aftësinë për reagim të shpejtë të saj.

Aleanca dhe aleatët do të investojnë më tej për aftësi të avancuara në mënyrë që të përballen me sfida të reja në të gjitha fushat operacionale. Qëllimi është që NATO të jetë në gjendje të ofrojë një sërë aftësish, duke përfshirë forcat dhe aftësitë më të avancuara dhe të mbështetura në gjendjen e kërkuar të gatishmërisë në kapacitet të mjaftueshëm për të qenë në mënyrë efektive për kohëzgjatjen e çdo krize. Aleanca do të vazhdojë të përmirësojë qëndrueshmërinë, vendosjen dhe ndërveprueshmërinë e aftësive për mjedisin e ri strategjik, veçanërisht për kryerjen e operacioneve të nivelit të lartë. Planet kombëtare të zhvillimit të aftësive do të mbështesin gjenerimin e plotë dhe në kohë të këtyre aftësive, në përputhje me Procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s.

Ruajtja e avantazhit teknologjik të Aleancës do të jetë jetike. Si përshpejtuesi i Inovacionit të Mbrojtjes për NATO-n (DIANA), ashtu edhe Fondi i Inovacionit të NATO-s janë hapa të rëndësishëm në përmbushjen e sfidës dhe zhvillimin e teknologjive. Një nga prioritetet strategjike të Aleancës duhet të jetë konkurrenca me sukses me shtetet autoritare që kërkojnë të arrijnë qëllime, të tilla si: inteligjenca artificiale, raketat hipersonike, sistemet autonome të dronëve, kompjuteri kuantik, robotika, analitika e të dhënave të mëdha, nanoteknologjitë, bioteknologjitë dhe bioinxhinieria. NATO do të veprojë si një institucion koordinues për shkëmbimin e informacionit dhe

bashkëpunimin midis aleatëve.

b. Komanda e Forcave Mobile të Operacioneve Aleate

Për të siguruar që Aleanca të përmbushë angazhimet e saj thelbësore deri në vitin 2030, aleatët kanadezë dhe evropianë do të krijojnë një Forcë të Rëndë Lëvizëse Operative të Komandës Aleate të NATO-s (AMHF). Ajo do të konsolidojë më shumë Forcat Aleate të Reagimit të Shpejtë në një grup të vetëm forcash të mbështetur nga struktura e nevojshme. AMHF do të veprojë si një forcë e ardhshme aleate e nivelit të lartë, reaguese e parë, e aftë për të vepruar nga bazat detare dhe në të gjitha fushat e ajrit, detit, tokës, kibernetikës, hapësirës dhe informacionit. AMHF do të mbahet në një nivel të mjaftueshëm gatishmërie për të përballuar të gjitha kërcënimet në zonën euroatlantike, me kapacitet të mjaftueshëm për të mbështetur ato vende të vijës së parë që përballen me kërcënime transnacionale. AMHF do të ndërtohet mbi bazën e Task Forcës së Përbashkët të Gatishmërisë Shumë të Lartë, Forcën e Reagimit të zgjeruar të NATO-s, si dhe ato forca të gatishmërisë shumë të lartë që do të dalin nga Nisma e Gatishmërisë së NATO-s.

AMHF do t'i mundësojë NATO-s që të shfrytëzojë më mirë teknologjitë dhe të mbajë një shkallë të lartë ndërveprueshmërie me forcat amerikane. AMHF do të veprojë si një mjet për futjen në Urdhrin Aleat të Betejës së inteligjencës artificiale, kompjuterit super/kuantik, të dhënave, grumbullimit të dronëve dhe aftësive autonome (për shembull, grupimi me pilot/pa pilot, stafetë dhe sisteme autonome në rrjet), sisteme të armëve hipersonike për të mundësuar një aftësi aleate.

AMHF do të ndihmojë për t'i dhënë formë dhe kuptim përgjegjësisë më të madhe strategjike evropiane. Një përgjegjësi dhe autonomi që ajo nxit do të jetë në funksion të aftësive dhe kapaciteteve relative ushtarake. Me mundësimin e mbështetjes luftarake dhe mbështetjen e shërbimit luftarak, ajo do të vendoset në disa forma dhe nën më shumë se një flamur, duke përfshirë si koalicion evropian të mundësuar nga NATO (si aleatët dhe partnerët e BE-së) ose si një kornizë për koalicionet dhe në gjendje.

Për të siguruar që AMHF të ngrihet në kohën e duhur, aleatët evropianë, së bashku me Kanadanë, deri në vitin 2030, do të investojnë burime të mjaftueshme për të siguruar që ata të plotësojnë të paktën 50 për qind të kërkesave të NATO-s të identifikuar nga komandantët strategjikë, duke përfshirë forcat e përdorshme për mbulimin e të gjithë spektrit të operacioneve dhe misionëve. Operacione të tilla do të kryhen së bashku me forcat amerikane brenda dhe jashtë zonës së përgjegjësisë së SACEUR, si dhe në mënyrë autonome kur bien dakord. NATO është dhe do të mbetet ofruesi kryesor i sigurisë ushtarake në Evropë. Ministrat e Mbrojtjes do të vendosin detajet e nevojshme në

Udhëzimin e tyre Politik për Planifikimin e Mbrojtjes në vitin 2023. Një grup i tillë kontingjentesh forcash të afta, të ofruara nga aleatët evropianë, do të sigurojë një grupim forcash që mund të nxirren për misione dhe operacione autonome të reagimit ndaj krizave brenda BE-së.

c. Pajisja e NATO-s për të ardhmen

Aleanca do të kryejë një vlerësim të përbashkët të sistemeve të nevojshme për të përgatitur si forcat aleate ashtu edhe asetet kombëtare joushtarake kritike për misionin për një fushë të gjerë të paparashikuara, siç janë sulmet ndaj infrastrukturave kritike kombëtare, sulmet kibernetike dhe kërcënime të tjera më ekzotike. Aleanca do të drejttojë procesin për të forcuar ndërlidhjen midis planifikuesve të mbrojtjes dhe komunitetit më të gjerë teknologjik, duke inkurajuar partnerët industrialë të mbrojtjes që të marrin në konsideratë më tej aplikimet novatore të teknologjive me përdorim të dyfishtë, si dhe partneritetet e reja shumëkombëshe.

Aleanca pranon se industritë e mbrojtjes janë element i rëndësishëm i zhvillimit ekonomik kombëtar dhe inovacionit teknologjik të cilat ofrojnë vende pune me kualifikim të lartë në vendet aleate. Rrjedhimisht, Aleanca do të sigurohet që çdo proces përshtatjeje të bazohet në konkurrencë të ndershme, marrëveshje reciproke dhe të hapur për partnerë përtej bazave tradicionale të mbrojtjes, teknologjisë dhe industrisë. Ajo pranon se integrimi i teknologjisë në forcat aleate nuk duhet të bëhet në kurriz të përbashkës, logjistikës, trajnimit dhe ushtrimeve, të cilat do të mbeten jetike.

Mbetet jetike që NATO të ruajë avantazhin teknologjik dhe ta rifitojë atë aty ku e ka humbur. Prandaj, aleatët evropianë do të sigurojnë që industria e mbrojtjes e Evropës të bëhet më inovative dhe konkurruese, partner i fortë për bashkëpunimin transatlantik. Koncepti Strategjik 2022 nënkupton disa partneritete të reja, me një fokus të veçantë në zhvillimin dhe aplikimin e teknologjive. Kostoja e prokurimit duhet të reduktohet ndjeshëm dhe ritmi i cikleve të prokurimit duhet të përshpejtohet për të përmbushur objektivat e investimeve të nënkuptuara në këtë Koncept Strategjik. Aleatët evropianë përballen me një sfidë në kryerjen e kërkimit dhe teknologjisë bashkëpunuese (R&T). Ata do të rrisin shpenzimet bashkëpunuese për R&T. Përveç përmbushjes së objektivave të aftësisë, aleatët evropianë angazhohen gjithashtu të dyfishojnë investimet kombëtare dhe kolektive në R&T deri në vitin 2030.

Realizimi i ndryshimeve do të kërkojë reforma të rëndësishme në Bazën e Mbrojtjes, Teknologjisë dhe Industriale (DTIB). Prandaj, Aleanca do të ndërmarrë një vlerësim urgjent të përbashkët të DTIB-së në partneritet me anëtarët e NATO-s. Kërkesat realiste të së ardhmes do të përcaktohen në termat e aftësive operacionale, me tepër sesa në termat e ndonjë kapaciteti specifik.

d. Menaxhimi efektiv i krizës

NATO është Aleancë e ndërtuar mbi vullnetin politik, aftësinë ushtarake dhe kapacitetin e sigurisë; ruajtja, përshtatja dhe zhvillimi i së cilës do të jenë jetike në të ardhmen. Ndërsa NATO luajti një rol jetik në luftën kundër terrorizmit, një Afganistan stabël nuk u arrit. Prandaj, planifikimi dhe drejtimi i fushatave të ardhshme do t'u kërkojë aleatëve që kolektivisht dhe vazhdimisht të vlerësojnë interesat e tyre strategjike dhe të përputhen me ambiciet me qëllime realiste, të arritshme që kontribuojnë në mënyrë aktive për sigurinë, stabilitetin dhe, në fund të fundit, paqen.

Misionet e NATO-s për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar, do të përqafojnë dhe kuptojnë më mirë normat politike dhe kulturore të vendit pritës, aftësinë e çdo shoqërie dhe të institucioneve të saj të sigurisë, mbrojtjes për të përvetësuar në mënyrë efektive ndërtimin dhe trajnimin e kapaciteteve. Aleanca do të sigurojë vendosjen e mekanizmave efektivë për të nxitur ndërveprueshmërinë ushtarake dhe dialogun politik të kërkuar nga bashkëpunimi me partnerët operacionalë. Aleatët do të përmirësojnë mekanizmat për të forcuar rëndësinë e raportimit nga terreni dhe për të promovuar më shumë diskutime interaktive në kohë reale në nivelet më të larta.

e. Kontrolli i armëve, çarmatimi dhe mospërhapja

Kontrolli i armëve është gur themeli i rendit ndërkombëtar të bazuar në rregulla, por efektiviteti i tij po gërryhet ngadalë nga shtete të fuqishme, si Rusia, të cilat qëllimisht shpërfillin kushtet e traktatit për një avantazh, si në rastin e Forcave Bërthamore të Ndërmjetme të 1987-ës, tashmë të shfuqizuara. Aleatët do të ndihmojnë në zhvillimin e një strategjie për kontrollin e ardhshëm të armëve bërthamore, duke u mbështetur në Traktatin e Ri START, për të përfshirë armët bërthamore jostrategjike, raketat ruse me rreze të mesme të vendosura rishtazi dhe sistemet e reja të shpërndarjes destabilizuese, si raketat hipersonike me majë bërthamore dhe raketat e avancuara të lundrimit. NATO mbështet përpjekjet drejt reduktimit të rrezikut strategjik, i cili mund të japë kontribute të rëndësishme për sigurinë rajonale dhe ndërkombëtare. Në veçanti, transparenca dhe dialogu mund të ndihmojnë në shmangien e keqkuptimeve dhe llogaritjeve të gabuara.

Traktati për Mospërhapjen e Armëve Bërthamore (NPT) mbetet mburoja thelbësore kundër përhapjes së armëve bërthamore, gurthemeli i arkitekturës globale të mospërhapjes dhe çarmatimit bërthamor, kuadri për bashkëpunimin ndërkombëtar në ndarjen e përfitimeve paqësore të energjisë bërthamore, shkencës dhe teknologjisë. Aleatët mbeten fuqimisht të përkushtuar ndaj zbatimit të plotë të NPT-së në të gjitha aspektet e saj, si një platformë e pazëvendësueshme, dhe forcimit në tre shtyllat e saj përforcuese reciproke.

Aleanca ripohon gjithashtu vendosmërinë e saj për të kërkuar një botë më të sigurt për të gjithë dhe për të ndërmarrë hapa të mëtijshëm për të krijuar kushtet për negociata të mëtijshme të çarmatimit bërthamor. Aleatët mbështesin plotësisht qëllimin përfundimtar të një bote pa armë bërthamore në përputhje të plotë me të gjitha dispozitat e NPT-së, përfshirë Nenin VI, në një mënyrë të verifikueshme për të promovuar stabilitetin ndërkombëtar, bazuar në parimin e sigurisë për të gjithë. Shtetet e NATO-s me armë bërthamore kanë theksuar në mënyrë të përsëritur angazhimin për të përmbushur detyrimet përkatëse kombëtare sipas NPT-së për aq sa lejojnë kushtet ndërkombëtare. NATO vazhdon të favorizojë zgjidhjet e negociuara për të ulur tensionet, forcat bërthamore dhe konvencionale në Evropë, por Aleanca e ka bërë të qartë se nuk do të pranojë propozime apo ultimatumë të paverifikueshme, të pabalancuara dhe destabilizuese.

Aleanca mbetet e përkushtuar ndaj kontrollit të armëve konvencionale si themel i një arkitekture të qëndrueshme të sigurisë euro-atlantike, ajo do të kërkojë të ruajë, forcojë dhe modernizojë kontrollin e armëve konvencionale në Evropë bazuar në parimet dhe angazhimet kryesore, duke përfshirë reciprocitetin, transparencën dhe pëlqimi i kombit pritës. Qëndrimi agresiv i Rusisë, refuzimi për të përmbushur plotësisht detyrimet e saj sipas Traktatit të Qiejve të Hapur, zbatimi i vazhdueshëm selektiv i Dokumentit të Vjenës dhe dështimi i gjatë për të zbatuar Traktatin për Forcat e Armatosura Konvencionale në Evropë vazhdojnë të minojnë sigurinë dhe stabilitet në të gjithë Evropën.

Aleanca nënvizon rëndësinë e modernizimit të Dokumentit të Vjenës, mirëpret mbështetjen e gjerë për paketën gjithëpërfshirëse të modernizimit dhe pret diskutime të intensifikuara në Forumin për Bashkëpunimin e Sigurisë me besimin se kjo do të çojë në konsensus mbi një Dokument të përditësuar. Për të ringjallur traktatin mbi Qiejt e Hapur, është thelbësore që të gjitha palët të zbatojnë plotësisht dispozitat e tij. NATO do të vazhdojë të mbështesë diskutimet në OSBE, duke përfshirë edhe dialogun e strukturuar.

f. Partneritetet dhe politika e dyerve të hapura

Partneriteti është rrugë drejt anëtarësimit përfundimtar përmes politikës së dyerve të hapura të Aleancës. Aleanca do të përforcojë Politikën dhe Programin e Ndërtimit të Integritetit në mbështetje të partnerëve. Korrupsioni dhe qeverisja e dobët minojnë demokracinë, shtetin e së drejtës dhe zhvillimin ekonomik, në këtë mënyrë përbëjnë sfida për sigurinë. Zbatimi i masave për të përmirësuar ndërtimin e integritetit, për të nxitur luftën kundër korrupsionit dhe për të nxitur qeverisjen e mirë do të jetë me rëndësi të vazhdueshme, si dëshmi e përkushtimit ndaj vlerave të përbashkëta të anëtarësimit eventual.

Me Arktikun dhe Evropën Veriore, Finlanda dhe Suedia janë partnerë të

besuar në sigurimin e integritetit të zonës euroatlantike. Kanadaja është një fuqi e Arktikut dhe ndikohet drejtpërdrejt nga ndikimet e kombinuara të ndryshimeve klimatike dhe prania në rritje kineze dhe ruse. Kanadaja do të krijojë një Qendër të Përsosmërisë së NATO-s për Klimën dhe Sigurinë, për të kuptuar më mirë ndërveprimin midis të dyjave. Aleanca do të mbështesë plotësisht Kanadanë dhe Norvegjinë në përpjekjet e tyre përkatëse për të siguruar që Arktiku të mbetet një rajon paqeje dhe eksplorimi, por do t'i rezistojë çdo përpjekjeje për militarizimin e detit ose çdo pretendimi që shkon përtej marrëveshjeve aktuale për demarkacionin.

Aleanca ripohon mbështetjen për integritetin territorial dhe sovranitetin e Ukrainës, Gjeorgjisë dhe Moldavisë brenda kufijve të njohur ndërkombëtarisht dhe i bën thirrje Rusisë të tërheqë të gjitha forcat që ka vendosur në territoret e vendeve pa pëlqimin e tyre. Aleanca nuk do ta njohë kurrë aneksimin e paligjshëm të Krimesë nga Rusia. Gjithashtu, dera mbetet e hapur për anëtarësimin në NATO, si për Gjeorgjinë ashtu edhe për Ukrainën. NATO do të vazhdojë t'i mbështesë dy shtetet për të përmirësuar qëndrueshmërinë e forcave të tyre dhe për të ndihmuar në parandalimin e çdo agresioni. Përpjekje do të bëhen për të forcuar Partneritetet e Mundësive të Zgjeruara, e cila është pjesë e Iniciativës së Ndërveprueshmërisë së Partneritetit të nisur në Samitin e NATO-s në Uells. Australia, Finlanda, Gjeorgjia, Jordania, Suedia dhe Ukraina secila kanë krijuar partneritete me NATO-n për ndërveprim efektiv midis forcave të armatosura përkatëse dhe atyre të Aleancës. Partneritetet e krijuara me Finlandën dhe Suedinë janë të rëndësishme për Aleancën dhe janë modele për partneritetet më të afërta pa anëtarësim.

Në funksion të agresionit të vazhdueshëm nga Rusia dhe forcat e udhëhequra nga Rusia në Ukrainën lindore, Aleanca do të nisë një Iniciativë për Parandalimin e Ukrainës (UDI) si një zgjatje e programit të partneritetit të zgjeruara të Aleancës. Nën UDI, aleatët do të bëjnë gjithçka që munden për të ndihmuar Ukrainën dhe të rrisin ndikimin e Kievit në ndjekjen e një zgjidhjeje politike të konfliktit në Donbas. UDI do të përfshijë sigurimin e pajisjeve ushtarake dhe trajnimit, si dhe përpjekjet për të rritur qëndrueshmërinë e Ukrainës kundër sulmeve kibernetike, dezinformimit, luftës ekonomike dhe përmbysjes politike. UDI do të krijojë formë partneriteti të drejtuar nga funksioni, duke e bërë atë një përgjegjësi formale të Aleancës për të ndihmuar në trajnimin e FA ukrainase dhe për të lehtësuar blerjen e armëve moderne të mbështetura nga financimi i përbashkët.

Përpjekjet për ndërtimin e kapaciteteve të mbrojtjes, të tilla si misioni i NATO-s në Irak, janë veçanërisht të rëndësishme për Aleancën në luftën kundër terrorizmit si pjesë e përpjekjeve të përbashkëta me partnerët për të ndihmuar në stabilizimin e zonës euroatlantike dhe më gjerë. Dialogu

Mesdhetar promovon konsultimet politike dhe bashkëpunimin praktik dypalësh dhe shumëpalësh që përfshin vendet rreth Detit Mesdhe. Iniciativa e Bashkëpunimit të Stambollit promovon bashkëpunimin praktik në baza dypalëshe në një zonë të gjerë të Lindjes së Mesme.

Aleanca do të mbështesë ruajtjen e paqes demokratike në mbarë botën. Partneritete do të krijohen me demokracitë e tjera në rajonin Indo-Paqësor, si: Australia, India, Japonia, Zelanda e Re dhe Koreja e Jugut. Aleanca do të kërkojë paralelisht edhe konsultime me Kinën, ndoshta përmes krijimit të një këshilli NATO-Kinë.

g. Gratë, paqja dhe siguria

Politika dhe Plani i Veprimit i NATO-s për Gratë, Paqen dhe Sigurinë do ta përgatisin më mirë Aleancën për të adresuar sfidat e së sotmes dhe së nesërme. Në përputhje me vlerat e saj, Aleanca njeh plotësisht rëndësinë kritike të pjesëmarrjes së plotë, të barabartë dhe kuptimplotë të grave në të gjitha aspektet e paqes dhe sigurisë, si dhe ndikimin që konflikti ka tek gratë dhe vajzat, duke përfshirë dhunën. Aleanca është plotësisht e përkushtuar për zbatimin e plotë të Axhendës së Grave, Paqes dhe Sigurisë nga Këshilli i Sigurimit i OKB-së.

Politika e vitit 2019 për Parandalimin dhe Reagimin ndaj Shfrytëzimit dhe Abuzimit Seksual do ta mbajë Aleancën me standardet më të larta të sjelljes. Duke punuar së bashku me partnerët, organizatat ndërkombëtare dhe shoqërinë civile, axhenda e NATO-s 2030 do të avancojë barazinë gjinore, do të sigurojë mundësi të barabarta në FA, do të integrojë perspektivat gjinore dhe do të nxisë parimet e axhendës së grave, paqes dhe sigurisë.

f. Migrimi i pakontrolluar

Aleanca do të vazhdojë të ndihmojë aleatët në përballimin e sfidës së migrimit të pakontrolluar. Në përputhje me ligjin ndërkombëtar, të gjitha anijet që lundrojnë, duke përfshirë anijet e NATO-s, kërkohet të shpëtojnë njerëzit në fatkeqësi në det. Anijet aleate do të vazhdojnë të përmbushin përgjegjësitë kombëtare përkatëse për të përmbushur detyrimet për të ndihmuar në lehtësimin e vuajtjeve të njerëzve të dëshpëruar të zhvendosur nga konflikti dhe për të parandaluar terroristët që të shfrytëzojnë gjendjen e tyre.

h. Siguria e energjisë

Aleanca do të luajë rolin e saj në forcimin e sigurisë energjetike me Qendrën e Ekselencës për Sigurinë Energjetike të NATO-s (ENSEC COE) duke vazhduar të ofrojë këshilla të kualifikuara dhe të përshtatshme ekspertësh për çështje që lidhen me sigurinë e energjisë. ENSEC COE do të ndihmojë Komandat Strategjike, organet e tjera të NATO-s, aleatët, partnerët dhe subjektet civile dhe ushtarake duke ofruar udhëzime për procesin e zhvillimit të aftësive,

efektivitetin e misionit dhe ndërveprueshmërinë në terma të afërt, afatmesëm dhe afatgjatë, si dhe duke ofruar ekspertizë gjithëpërfshirëse në kohë mbi të gjitha aspektet e sigurisë së energjisë.

i. Siguria njerëzore

Aleanca e ka njohur prej kohësh rëndësinë e sigurisë njerëzore, e cila përqendrohet në rreziqet dhe kërcënimet ndaj popullatave në zonat e konfliktit ose krizës, si dhe mënyrën e zbutjes dhe reagimit ndaj tyre. Aleanca mbetet e përkushtuar për të siguruar të gjitha përpjekjet për të shmangur, minimizuar dhe zbutur çdo efekt negativ mbi civilët që rrjedhin nga misionet ose operacionet aleate. Këto synime nënvizohen në Politikën për Mbrojtjen e Civilëve dhe Politikën për Parandalimin dhe Përgjigjen ndaj Dhunës Seksuale të Lidhur me Konfliktin, e cila shkakton trauma afatgjata tek individët dhe familjet. Aleanca do të vazhdojë të punojë për të zbutur ndikimin e konfliktit te fëmijët, si pjesë e Mbrojtjes së Fëmijëve në Konfliktet e Armatosura dhe të Pasurive Kulturore.

j. Ndryshimet klimatike

Ndryshimi i klimës është një nga sfidat përcaktuese të kësaj epoke. Nëpërmjet Planit të Veprimit të NATO-s për ndryshimet klimatike dhe sigurinë, Aleanca synon të bëhet organizata ndërkombëtare e sigurisë, kur bëhet fjalë për të kuptuar dhe përshtatur ndikimin e ndryshimeve klimatike në siguri. NATO do të përfshijë konsideratat e ndryshimeve klimatike në spektrin e saj të plotë të punës, duke filluar nga planifikimi i mbrojtjes dhe zhvillimi i aftësive, deri te gatishmëria civile. Këto masa mund të kontribuojnë në formulimin e qëllimeve vullnetare për të reduktuar emetimet e tilla. NATO do të forcojë gjithashtu shkëmbimet me vendet partnere, si dhe me organizatat ndërkombëtare dhe rajonale që janë aktive për ndryshimet klimatike dhe çështjet e sigurisë.

6. Forcat e Aleancës në vitet 2030

a. Koncepti i Forcës së Aleancës

Fuqia e aleancës në fund të fundit është fuqi luftuese. Në vazhden e Luftës së Ftohtë, "dividendi i paqes" gërryen fuqinë ushtarake aleate me kalimin e kohës. Dhjetë vitet e ardhshme mund të shohin ekuivalentin e 70 viteve të zhvillimit teknologjik ushtarak të kaluar. Rrjedhimisht, ky Koncept Strategjik ripohon rolin e qëndrueshëm ushtarak të Aleancës dhe detyrat e saj themelore ushtarake në dritën e natyrës së ndryshimit të shpejtë të rreziqeve dhe kërcënimeve bashkëkohore dhe të ardhshme.

Aleanca po shkon drejt një strategjie të re ushtarake, nëpërmjet zbatimit të dy koncepteve të rëndësishme ushtarake. Koncepti për Parandalimin dhe Mbrojtjen e zonës euroatlantike ofron një kornizë të vetme koherente për të

sfiduar, penguar dhe mbrojtur kundër kërcënimeve kryesore të Aleancës në një mjedis me shumë fusha dhe në këtë mënyrë për të forcuar gatishmërinë e NATO-s për të trajtuar paqëndrueshmërinë e përhapur dhe goditjet strategjike. *Koncepti i prandalimit dhe mbrojtjes* do të drejtojë një planifikim të zgjeruar paraprak për t'iu përgjigjur krizave dhe konflikteve të mundshme, si dhe do të përmirësojë më tej përdorimin, organizimin e forcave dhe aftësive aleate në të gjitha fushat operationale dhe do të sigurojë komandim dhe kontroll më efektiv. *Koncepti i luftimit* ofron vizionin afatgjatë për ruajtjen dhe zhvillimin e avantazhit vendimtar ushtarak të NATO-s. Nëpërmjet zbatimit të këtij koncepti, Aleanca do të sigurojë që ajo të zhvillojë vazhdimisht avantazhin e saj ushtarak dhe teknologjik, ndërsa karakteri i konfliktit evoluon.

Struktura e Forcave të NATO-s (NFS) është një kornizë gjithëpërfshirëse për gjenerimin e forcës, planifikimin ushtarak, komandën dhe kontrollin operacional që trajton si aktivitetet e parandalimit ushtarak në kohë paqeje, ashtu edhe veprimet e mbrojtjes në krizë dhe konflikt. Kjo përfshin vendosjen e shpejtë dhe efektive në periferinë e NATO-s aty ku nevojitet në një krizë, si dhe për operationet e mbrojtjes kolektive. Aleanca do të forcojë dhe modernizojë NFS-në në mënyrë që të veprojë gjithmonë si një arkitekturë e qëndrueshme, e shkathët dhe elastike e forcës me shumë domene, duke siguruar që forcat e duhura të jenë në vendin e duhur në kohën e duhur. Kjo do të forcojë komandën dhe kontrollin modern të përshtatur për të mbështetur qëndrimin e NATO-s, menaxhimin dinamik të forcës, sistemin e përmirësuar të reagimit dhe planifikimin e forcës. Planifikimi dhe sinergjitë e mëtejshme operationale do të identifikohen për të përballuar kërcënimin nga Rusia ndaj zonës euroatlantike dhe kërcënimin terrorist si brenda dhe jashtë, së bashku me BE-në dhe partnerët e tjerë. NFS do të përshtatet më tej për të shfrytëzuar më mirë teknologjitë e hapësirës së ardhshme të betejës, si dhe për të përdorur ushtrime sintetike dhe simulime. Aleanca do të adresojë dhe përditësojë vazhdimisht shkallën e kërcënimeve, si dhe do të optimizojë reagimin dhe gatishmërinë.

Aleanca do të sigurojë që Struktura e Komandës së NATO-s (NCS) të mbetet e fuqishme, elastike dhe e gatshme për të ndërmarrë të gjithë elementët e komandës dhe kontrollit efektiv, në rast të sfidave të njëkohshme në të gjitha fushat dhe në të gjithë spektrin e plotë të misioneve, duke përfshirë operatione në shkallë të gjerë për mbrojtjen kolektive. Kontributet e aleatëve për komandimin dhe kontrollin përmes NFS do të përfshijnë ofrimin e mbështetjes së forcave të vendit pritës.

Koncepti i Mbrojtjes dhe Parandalimit është ndërtuar mbi konceptin e mbrojtjes së drejtpërdrejtë, e krijuar për të mposhtur agresorin, duke përfshirë zonën gri midis paqes dhe luftës. Një aftësi e tillë e drejtpërdrejtë e mbrojtjes në çdo rast është një pengesë, sepse ajo ose mund të mposhtë ose të imponojë

kosto agresorit. Koncepti i mbrojtjes së drejtpërdrejtë përfshin përdorimin e të gjitha aftësive të disponueshme siç mund të autorizohen, të planifikuara paraprakisht ose rast pas rasti.

c. Forcat bërthamore të Aleancës

Qëllimi themelor i aftësisë bërthamore aleate është ruajtja e paqes, parandalimi i detyrimit dhe frenimi i agresionit. Për sa kohë që ekzistojnë armët bërthamore, NATO do të mbetet një Aleancë bërthamore. Duke pasur parasysh mjedisin e përkeqësuar të sigurisë në Evropë, një Aleancë bërthamore e besueshme dhe e bashkuar është thelbësore. Armët bërthamore janë gjithashtu unike dhe rrethanat në të cilat ato do të përdoren mbeten jashtëzakonisht të largëta. Megjithatë, NATO rithekson se çdo përdorim i armëve bërthamore kundër aleatëve do të ndryshonte rrënjësisht natyrën e një konflikti. Aleanca ka aftësitë dhe vendosmërinë për të imponuar kosto ndaj një kundërshtari që do të ishte e papranueshme dhe do të ishte shumë më e madhe se përfitimet që çdo kundërshtar mund të shpresonte të arrinte, duke përfshirë përdorimin e parë të armëve bërthamore.

Forcat strategjike të Aleancës, veçanërisht ato të Shteteve të Bashkuara, janë garancia supreme e sigurisë së aleatëve. Forcat e pavarura strategjike bërthamore të Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës kanë një rol parandalues dhe kontribuojnë ndjeshëm në sigurinë e përgjithshme të Aleancës. Qendrat e veçanta të vendimmarrjes së këtyre tre aleatëve kontribuojnë më tej në parandalimin duke komplikuar llogaritjet e kundërshtarëve të mundshëm. Qëndrimi i parandalimit bërthamor i NATO-s mbështetet gjithashtu në armët bërthamore të SHBA-së të vendosura përpara në Evropë, si dhe në aftësitë dhe infrastrukturën e Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës. Në përgjigje të mjedisit më sfidues të sigurisë, po ndërmerren gjithashtu hapa për të siguruar që forcat bërthamore të Mbretërisë së Bashkuar, franceze dhe amerikane të mbeten të sigurta dhe efektive.

Kontributet kombëtare të avionëve me aftësi të dyfishta në misionin e parandalimit bërthamor të Aleancës mbeten jetike. Megjithatë, aftësi të tilla do të përforcohen dhe përmirësohen për të mbetur të besueshme përballë sistemeve të mbrojtjes ajrore që po zhvillohen me shpejtësi. Aleanca ripohon domosdoshmërinë për të siguruar pjesëmarrjen më të gjerë të mundshme nga aleatët e interesuar në marrëveshjet e dakordësuara për ndarjen bërthamore, në mënyrë që të demonstrohet uniteti dhe vendosmëria e Aleancës. Aleatët gjithashtu do të vazhdojnë të sigurojnë koherencë më të madhe midis komponentëve konvencionalë dhe bërthamorë dhe të rrisin efektivitetin e stërvitjeve aleate për të ruajtur dhe demonstruar vazhdimisht përkushtimin e qëndrueshëm të NATO-s për parandalim të besueshëm.

d. Mbrojtja ajrore dhe raketore

Mbrojtja nga raketat mund të plotësojë rolin e armëve bërthamore në parandalim, por nuk mund t'i zëvendësojë ato. Sfida për mbrojtje raketore do të rritet me vendosjen e sistemeve raketore hipersonike dhe mjeteve të rihyrjes së manovrueshme (si balistike ashtu edhe me rrëshqitje). Prandaj Aleanca do të vazhdojë të zhvillojë dhe forcojë aftësinë e integruar të mbrojtjes ajrore dhe raketore si një element integral i mbrojtjes kolektive të Aleancës. Qëllimi përfundimtar është të sigurojë mbulim dhe mbrojtje të plotë për të gjitha popullsitë, territoret, infrastrukturën kritike dhe forcat evropiane të NATO-s kundër kërcënimit në rritje që vjen nga përhapja e raketave të avancuara balistike dhe të lundrimit.

e. Mbrojtja kibernetike

Politika Gjithëpërfshirëse e Mbrojtjes Kibernetike e NATO-s pranon se në rrethana të caktuara ndikimi i aktiviteteve të rëndësishme të akumuluarat keqdashëse kibernetike mund të konsiderohet si një sulm i armatosur i rëndësishëm në nenit 5. Çdo vendim se kur një sulm kibernetikë konsiderohet mjaft i rëndë për të garantuar thirrjen e nenit 5 do të merret nga Këshilli i Atlantikut të Veriut rast pas rasti.

f. Qëndrimi i forcës së Aleancës

Për të mbrojtur territoret dhe vendet aleate dhe për të ruajtur përdorimin e lirë të detit, hapësirës ajrore, kibernetike, hapësirës së përbashkët globale, Aleanca do të zhvillojë një pozicion fleksibël parandalues konvencional. NATO do të vendosë gjithmonë forca të mjaftueshme për luftim dhe të balancuara si: tokësore, ajrore dhe detare. Veprime të tilla do të ndërmerren së bashku me vendosjen e shpejtë të selisë së komponentëve dhe logistikës, identifikimin e hershëm të shkallës së çdo agresioni në të drejtimin tokësor, detar, ajror, hapësirës, kibernetike dhe informacionit për të parandaluar një agresor që të kapë ose të mbajë çdo pjesë të zonës euroatlantike. Nëse një agresor mbetet i vendosur për një qëllim agresiv, NATO do t'i përballë ata me një rezistencë të tillë që ata do të detyrohen të tërhiqen ose të rrezikojnë përshtatshëm e mëtejshëm i cili, nëse është e nevojshme, mund të përfshijë përdorimin e kontrolluar të armëve të avancuara konvencionale, kibernetike dhe/ose bërthamore.

Aleanca do të mbajë një arsenal të besueshëm të kapaciteteve konvencionale, kibernetike dhe bërthamore, sipas nevojës, për të arritur objektivat dhe për t'i komunikuar një agresori se në rast të ndonjë humbjeje të territorit aleat, asnjë fakt i kryer nuk do të pranohet kurrë dhe se Aleanca do të angazhojë të gjitha mjetet e nevojshme për të rimarrë territorin e pushtuar. NATO do të kërkojë

gjithashtu të identifikojë qëllimet dhe mjetet e tyre, qëllimet e tyre specifike dhe shkatërrojë forcat e tyre.

Prezenca e Përparuar e Përmirësuar dhe e Përshtatur do të shkrihet në prezencë të vazhdueshme (CFP) dhe do të pajiset me forcat e nevojshme të mjaftueshme tokësore, detare, ajrore dhe dixhitale.

Nisma e Gatishmërisë së NATO-s 2018 (NRI) i angazhoi aleatët të kishin 30 batalione, 30 skuadronë ajrore dhe 30 anije luftarake detare të gatshme për t'u përdorur brenda 30 ditëve. Përpjekje të vazhdueshme janë duke u zhvilluar për të përmbushur ambicien politike të NRI-së, duke përfshirë një sistem raportimi të gatishmërisë SACEUR për të mundësuar vlerësime të sakta të forcave të disponueshme.

g. Aleanca dhe lufta e ardhshme

Hiperlufta është një luftë super e shpejtë e aktivizuar me makinë. Deri në vitin 2030, hiperlufta do të jetë realitet dhe Aleanca duhet të përgatitet. Duke pasur parasysh shpejtësinë me të cilën një armik mund të ndërmarë një sulm, strukturat komanduese dhe kontrolluese politike dhe ushtarake të Aleancës do të kenë nevojë për një aftësi në kohë reale për të vlerësuar vazhdimisht aftësitë e armikut dhe treguesit e sulmit, të mbështetur nga intelijenca artificiale.

Prandaj, *elementi kritik në modernizimin e strukturave të komandës dhe forcave të NATO-s do të jenë makineritë vendimmarrëse të afta për të vepruar me shpejtësinë e rëndësishme.* Çdo kapacitet i tillë do të jetë veçanërisht i rëndësishëm në lidhje me shpalljen e masave të alarmit, duke përfshirë transferimin nga Këshilli i Atlantikut të Veriut të autoritetit komandues për komandantët e lartë, caktimin e forcave dhe burimeve, përdorimin e aftësive të përkohshme ofensive dixhitale dhe ushtarake konvencionale gjatë vendimeve.

Strategjia e Inteligjencës Artificiale e NATO-s ka katër synime: të vendosë një bazë për zhvillimin dhe përdorimin e AI për mbrojtjen dhe sigurinë, për të përshpejtuar dhe futur në rrjedhën kryesore të adoptimit të AI në zhvillimin e aftësive, për të adresuar konsideratat e politikës së sigurisë të lidhura me AI, dhe për t'u mbrojtur kundër kërcënimeve nga përdorimi me qëllim të keq të AI. Të gjitha aplikacionet e AI do të zhvillohen dhe përdoren në përputhje me ligjin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke përfshirë të drejtën ndërkombëtare humanitare dhe ligjin për të drejtat e njeriut.

Strategjia do të përfshijë mekanizma verifikimi, vlerësimi në nivel të Aleancës ose në nivel kombëtar. Aplikacionet e AI do të kenë përdorime të qarta, të mirëpërcaktuara me sigurinë, dhe qëndrueshmërinë e aftësive të tilla që i nënshtrohen testimit dhe sigurimit gjatë gjithë ciklit jetësor, duke

përfshirë përmes procedurave të përcaktuara të NATO-s dhe/ose kombëtare të certifikimit. Do të ndërmerren hapa proaktivë për të minimizuar çdo paragjykim të paqëllimshëm në zhvillimin dhe përdorimin e aplikacioneve të AI dhe në grupet e të dhënave.

Do të kërkohen partneritete më të thella me sektorin privat me qëllim të identifikimit të boshllëqeve në bashkëpunimin kolektiv të mbrojtjes në fusha të tilla si strategjitë, normat, kërkimi dhe zhvillimi i AI lidhur me sigurinë, si dhe për të mbrojtur kundër përdorimit malinj dhe agresiv të Inteligjencia artificiale, llogaritja kuantike, raketat hipersonike dhe teknologjitë e dronëve, sistemet të automatizuara, pasi sjellja dhe karakteri i ndryshimeve të luftës dhe teknologji të tilla përshejtojnë shpejtësinë e luftës. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me aleatët do të krijohet një strategji kryesore, e mbështetur nga Grupi Këshillimor Industrial i NATO-s.

Thelbi i Konceptit Strategjik 2022: Ruajtja e paqes, mbrojtja e njerëzve

Në përfundim të Samitit por edhe të Konceptit Strategjik të NATO-2022 janë riafirmuar vlerat dhe parimet për sigurinë dhe mbrojtjen. Aty theksohet që Aleanca do të ketë burimet e nevojshme financiare, ushtarake dhe njerëzore për të përmbushur misionet e saj si dhe ajo mbetet e përkushtuar për të ruajtur efektivitetin e saj më të suksesshme politiko-ushtarake në botë.

Aleanca do të jetë si burim shprese, sepse bazohet në vlerat e përbashkëta të lirisë individuale, demokracisë, të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës, sepse qëllimi i saj i përbashkët, thelbësor dhe i qëndrueshëm është të ruajë lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të saj. Në fund theksohet se këto vlera dhe objektiva janë universale dhe të përhershme për të qenë të vendosur t'i mbrojë përmes unitetit, solidaritetit, forcës dhe vendosmërisë.

Në referencë të Konceptit Strategjik të NATO-s, lidërshipi të vlerësojë tërë procesin dinamik të transformimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura duke mbajtur frymën që përcjell ky samit, me synimin për të rivlerësuar ambicien e politikës sonë, rishikimin e dokumenteve madhore të sigurisë dhe mbrojtjes (SSK, SU), vizionin perspektiv të zhvillimit të FA-2030, si dhe çështje të planëzimit të mbrojtjes, sigurisë, mbështetjes dhe modernizimit.

Tërë procesi i studimit akademik, kërkues dhe shkencor të mbështetet te vlerësimet dhe reflektimet e Koncepti Strategjik i NATO-s, çështjet e së cilës të studiohen mirë për të kuptuar rrugën që duhet të bëjmë në kuadrin e procesit të planifikimit të NATO-s, si dhe reflektimit në dokumentet e Procesit të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes së vendit.

Bibliografia:

1. Samitet e NATO-s 2014-2021.
2. Samiti i NATO-s, Madrid 2022.
3. Koncepti Strategjik i NATO-s, Lisbonë 2010.
4. Koncepti Strategjik i NATO-s, Madrid 2022.
5. Faqja zyrtare e NATO-s, <https://www.nato.int/>
6. Asgjencia Evropiane e Mbrojtjes, <https://eda.europa.eu/>
7. Kolegji i Mbrojtjes NATO (NDC) Rome <https://www.ndc.nato.int/#>

LIDHJA E KRIMIT TË ORGANIZUAR DHE TERRORIZMIT- RREZIK PËR SIGURINË

Msc. Ekleva Baxhaku

Akademia e Forcave të Armatosura

Nënkolonel (R) Alqi Nikolla

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Marrëdhënia në zhvillim midis krimit të organizuar dhe terrorizmit paraqet sfida dhe kërcënime të rëndësishme për komunitetin ndërkombëtar. Në shumë zona/vende të botës, marrëdhënia ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit është shndërruar në një lidhje të ngushtë, e cila është bërë gjithnjë e më e vështirë për të nxjerrë një dallim kuptimplotë. Aktivitetet e terroristëve dhe të kriminelëve të organizuar shpesh përforcojnë njëri-tjetrin, ku terroristët angazhohen drejtpërdrejt ose tërthorazi në aktivitete të krimit të organizuar, ndërsa grupet e krimit të organizuar mund të përdorin taktika terroriste, përfshirë përdorimin strategjik të dhunës. Terrorizmi dhe krimi i organizuar janë dy forma të ndryshme të veprimtarisë kriminale dhe kërcënim i njëjtë për sigurinë.

Ky material shtjellon lidhjen e krimit të organizuar me terrorizmin duke theksuar ngjashmëritë dhe dallimet midis tyre si dhe kompleksitetin e kësaj lidhje. Po kështu, jepet një përshkrim i kësaj veprimtarie në Ballkanin Perëndimor dhe masat që duhet të merren për parandalimin dhe luftimin e këtyre veprimtarive.

Fjalët kyçe: krimi i organizuar, terrorizmi, globalizim, siguri, Bashkimi Evropian, NATO, luftë globale.

Hyrje

Historia e njerëzimit ka qenë gjithmonë e shoqëruar nga dhuna. Krimi ka ekzistuar që kur njerëzit u organizuan për herë të parë në një formë institucionale shtetërore. Fillimisht, ai u shfaq si grup i aktiviteteve dhe i sjelljeve që sulmuan dhe rrezikuan vlerat njerëzore, liritë e të drejtat themelore, pronën dhe sigurinë. Krimi dhe terrorizmi janë zhvilluar me evoluimin e shoqërisë dhe ndryshime të rëndësishme kanë ndodhur në drejtim të organizimit të tyre. Gjatë periudhës së Luftës së Ftohtë, krimi i organizuar dhe terrorizmi u konsideruan si fenomene të veçanta, të cilat nuk përbënin kërcënim për rendin botëror. Pas kësaj periudhe, situata ndryshoi në mënyrë rrënjësore dhe dolën prirje të reja globale, të cilat ndikuan në natyrën e këtyre fenomeneve. Globalizimi, i cili ka pasur zgjerim pas rënies së “Perdes së Hekurt” dhe hapjes së kufijve, solli zhvillimin e shumë sferave të jetës shoqërore. Zhvillimi i shoqërisë mbartte me vete si zhvillimin e vlerave pozitive edhe të atyre negative.

Pas 11 shtatorit 2001, Shtetet e Bashkuara të Amerikës luajtën një rol dominues në luftën kundër terrorizmit, duke shpallur “luftën kundër terrorit”, e cila përfshinte ngrirjen e asetëve dhe bllokimin e transaksioneve financiare për individët, organizatat bamirëse dhe shoqatat terroriste. Ndërsa aktivitetet e tyre për mbledhjen e fondeve u kufizuan ndjeshëm, grupet terroriste u detyruan të zhvilloheshin dhe të gjenin mënyra të reja financimi të aktiviteteve të tyre, si: përfshirje në trafikimin e drogave, aktivitete të tjera të paligjshme dhe forma të krimit të organizuar. Nga ana tjetër, organizatat kriminale iu përshtatën rrethanave të reja, duke u shndërruar në organizata hibride të fuqishme kriminale, me një sistem të brendshëm financimi, që u mundësoi atyre të angazhohen në aktivitete terroriste me qëllim rritjen e fitimeve të tyre.

Terrorizmi dhe krimi i organizuar janë ndër kërcënimet kryesore globale të kohës sonë. Lidhja midis terrorizmit dhe krimit të organizuar në përgjithësi ka evoluar në mënyrë të konsiderueshme gjatë 15-20 viteve të fundit. “Terrorizmi dhe krimi i organizuar transnacional, të konsideruar tradicionalisht si dy kërcënime globale me objektiva dhe interesa të ndryshme, kanë parë konvergencë operationale në rritje, duke çuar në bashkëpunimin dhe bashkëjetesën e tyre, pasi secili ka mësuar dhe përfutur nga mënyrat dhe metodat e tjetrit. Disa grupe

terroriste po transformohen në grupe të organizuara kriminale, dhe anasjelltas, kufiri ndërmjet tyre është shpesh i paqartë”¹.

Marrëdhënia në zhvillim, midis krimit dhe terrorizmit, paraqet sfida të rëndësishme dhe është një kërcënim për mbarë botën. Nuk ka asnjë vend në botë që mund të jetë i mbrojtur prej problemeve që rrjedhin nga krimi i organizuar dhe terrorizmi. Krimi i organizuar dhe terrorizmi mund të rrezikojnë sigurinë e vendit si nga jashtë, ashtu dhe nga brenda. Krimi i organizuar, si një formë e rrezikut për sigurinë e brendshme të një vendi, përhapet edhe në vendet fqinje, duke u bërë një kërcënim për to e vendet e tjera. Terrorizmi si një dorë e zgjatur e krimit të organizuar, duke qenë i motivuar politikisht, është një realitet që ne të gjithë e jetojmë. Lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit, apo siç përshkruhet nga disa autorë: “...si martesë e përkohshme e lehtësirave; takimi i njëanshëm ose partneriteti afatgjatë”², është komplekse dhe e sofistikuar dhe mund të shihet nga drejtime të ndryshme. Kur kjo lidhje shihet në nivel global, duket se është një kërcënim i madh në pjesë të ndryshme të botës, në veçanti, në Evropë, ku terroristët dhe kriminelët tani rekrutohen nga i njëjti mjedis. Kjo lidhje ndikon drejtpërdrejt në sigurinë e vendit dhe paraqet një kërcënim serioz si në nivel kombëtar, dhe në atë ndërkombëtar.

1. Lidhja ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit

Koncepti i lidhjes së krimit me terrorizmin nuk është i ri. Ai u shfaq në fillim të viteve 1990 pas rënies së Bashkimit Sovjetik dhe lindjes së epokës së informacionit. Mes ndryshimeve të mëdha që ndodhën, aktorët jo shtetërorë përshtatën modelet e operimit kriminale për të çuar përpara qëllimet e tyre. Lidhja midis krimit të organizuar dhe terrorizmit është, nga natyra, komplekse dhe dinamike. Aty ku ekzistojnë lidhje ndërmjet krimit dhe terrorizmit, shihet se ka një ndikim të drejtpërdrejtë negativ në siguri, duke kontribuar në erozionin e stabilitetit dhe zhvillimit politik, ekonomik dhe social. Kjo marrëdhënie shfaqet në mënyra të ndryshme në varësi të faktit nëse lidhet me një organizatë, ose një transaksion midis dy grupeve të pavarura (d.m.th. një grup kriminal dhe një celulë ose grup terrorist). Sidoqoftë, në nivelin e tij më themelor, lidhja i përket ndërveprimit midis dy elementeve të krimit të organizuar dhe terrorizmit.

Vitet e fundit, komuniteti ndërkombëtar është fokusuar gjithnjë e më shumë në ekzistencën e lidhjeve midis krimit të organizuar dhe terrorizmit. Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara ka miratuar rezoluta të ndryshme për këtë

¹ Council of Europe Committee on Counter-Terrorism (CDCT); Guidelines on the links between terrorism and transnational organised crime. https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=0900001680a19655

² Crime and Terror in Europe: Where the Nexus Is Alive and Well by Colin P. Clarke. <https://www.rand.org/blog/2016/12/crime-and-terror-in-europe-where-the-nexus-is-alive.html>

çështje. Kjo tregon se çdo lidhje e krimit të organizuar dhe terrorizmit do të përfaqësonte një kërcënim të rëndësishëm për sigurinë ndërkombëtare³. Në mesin e viteve 1990, grupet e krimit të organizuar dhe organizatat terroriste ishin qartësisht të dallueshme, të lidhura në disa mënyra, por të ndara në mënyra të tjera më të rëndësishme⁴. Edhe pse krimi dhe terrorizmi shiheshin tradicionalisht si dy dukuri të ndara, shtimi i aktiviteteve transnacionale të krimit të organizuar dhe fakti që terrorizmi si fenomen po ndryshonte, shtoi mjegullimin e kufijve midis dhunës kriminale dhe asaj politike dhe çoi në rritje të ngjashmërive organizative dhe operacionale. Një pjesë e grupeve xhihadiste aktive në dekadën e parë të këtij shekulli, jo vetëm që kishin të kaluar kriminale, por kishin vazhduar aktivitete kriminale për të mbështetur kauzën xhihadiste. Për më tepër, talebanët shpesh herë janë varur nga prodhimi i heroinës në Afganistan; Hezbollahu ka investuar në industrinë e paligjshme të narkotikëve të Amerikës së Jugut që nga vitet 1980 dhe se grupe si Ushtria Republikane Irlandeze (IRA) janë përfshirë në kontrabandën e karburanteve, cigareve dhe falsifikimit të mallrave të konsumit⁵.

Megjithatë, ekziston një ndryshim thelbësor midis organizatave kriminale dhe organizatave terroriste: e para do të vazhdojë të synojë t'i shpëtojë ndjekjes penale dhe thjesht të fitojë para, ndërsa e dyta synon të formësojë ose të ndryshojë mjedisin politik. Por, ky dallim nuk e përjashton bashkëpunimin ndërmjet këtyre rrjeteve. Këto organizata kanë një pragmatizëm profesional që mund dhe i kapërcen dallimet ideologjike. Për më tepër, shpesh ka lidhje personale midis njerëzve brenda këtyre rrjeteve që janë mjaft të forta për të kapërcyer çdo pengesë të mundshme për bashkëpunim⁶.

Lidhja krim-terror lidhet kryesisht me tiparet e përbashkëta që mund të ndajnë krimi i organizuar dhe grupet terroriste. Pra, pavarësisht mosmarrëveshjeve mbi përkufizimet, lidhja ose i referohet disa veçorive të organizatave terroriste të përshtatura nga krimi i organizuar për përdorimin e tyre, ose organizatave terroriste që kryejnë aktivitete tipike të krimit të organizuar. Kjo 'konvergjencë' mund të përshkruhet si 'miratimi' i aktiviteteve që janë specifike për një grup kriminal ose terrorist. Përndryshe, lidhja konsiderohet si një hibrid që bashkeekziston brenda të njëjtave grupe, që janë "politike ditën" dhe "kriminale gjatë natës"⁷.

³ Burimi elektronik: https://www.unodc.org/documents/e4j/FINAL_Module_16_Linkages_between_Organized_Crime_andTerrorism_14_Mar_2019.pdf - fq.3.

⁴ Revisiting the Relationship between International Terrorism and Transnational Organised Crime 22 Years Later - Author: Alex P. Schmid. fq.1.

⁵ Rajan Basra, Peter R. Neumann, and Claudia Brunner - Criminal Pasts, Terrorist Futures: European Jihadists and the New Crime-Terror Nexus, fq.11. ICSR - www.icsr.info

⁶ The Crime-Terrorism Nexus - Renske van der Veer <https://www.clingendael.org/pub/2018/strategic-monitor-2018-2019/the-crime-terrorism-nexus/>

⁷ Dr. Louise I. Shelley, John T. Picarelli, Allison Irby, Douglas M. Hart, Patricia A. Craig-Hart, Dr. Phil Williams, Steven Simon, Nabi Abdullaev, Bartosz Stanislawski, Laura Covill Methods and Motives:

Për më tepër, lidhja mund t'i referohet formave të bashkëpunimit midis grupeve me qëllime të ndryshme.

Një parakusht thelbësor për të kuptuar lidhjen ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit është të kuptojmë ato veç e veç. Terrorizmi dhe krimi i organizuar janë dy forma të ndryshme të veprimtarisë kriminale dhe një kërcënim i barabartë për sigurinë njerëzore. Pavarësisht shumë ngjashmërive operacionale dhe organizative, ato janë ende fenomene të ndara dhe shqyrtimi i karakteristikave, ngjashmërive dhe dallimeve të tyre, është hapi i parë në luftimin e tyre. Është e rëndësishme që të zhvillojmë detajet e dallimeve në mes të këtyre aktiviteteve kriminale, si dhe analizojmë ngjashmëritë. Duke bërë sistematikisht ndarjen ndërmjet ngjashmërive dhe dallimeve midis terroristëve dhe kriminelëve, mund të nxjerrim një vlerësim më të mirë se kush janë, çfarë bëjnë, si veprojnë dhe pse i bëjnë.....

1.1. Ngjashmëritë

a) **Narkoterrorizmi** ishte identifikimi i parë i lidhjes ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit. Ky term u përcaktua në vitin 1983 nga presidenti i Perusë *Fernando Belaunde Terry*⁸, kur forcat e tij policore po përballeshin me sulmet e llojit terrorist të trafikantëve të drogës. Trafikantët përdornin taktika terroriste për të rritur fitimet, ndërsa terroristët përdornin drogën për të financuar organizimin dhe operacionet e tyre.

b) Një karakteristikë tjetër e përbashkët janë **burimet financiare**, ku më fitimprurëse janë trafikimi i qenieve njerëzore, drogës, armëve, materialeve të rrezikshme, agentëve kimikë dhe biologjikë, prostitucioni, pastrimi i parave, mashtrimet financiare etj. Kështu, aktivitetet kriminale të disa organizatave terroriste financohen nga krimi i organizuar, ndërsa nga ana tjetër, disa organizata kriminale që kanë fituar pushtet financiar, shfaqin ambiciet politike me ndihmën e terrorizmit.

c) Po kështu ato kanë një **profil të ngjashëm** të personalitetit të anëtarëve të tyre. Të dyja këto grupe i rekrutojnë anëtarët e tyre nga grupe shoqërore të dobëta (të lëna pas dore) të ekspozuara dhe të ngarkuara nga frustrimet shoqërore apo politike. Burgjet janë bazë e rëndësishme e takimit të terroristëve me krimin e organizuar dhe u mundësojnë terroristëve të rekrutojnë individë për qëllimet e tyre. Terroristët që koordinuan dhe kryen sulmet e Parisit të janarit 2015, duke vrarë 17 njerëz, ishin kriminelë që u rekrutuan në burg nga terroristët⁹.

Exploring Links between Transnational Organized Crime & International Terrorism. fq.18.

⁸ Burimi elektronik: <https://www.123helpme.com/essay/Realism-Theory-and-Narcoterrorism-10553>

⁹ The Crime-Terrorism Nexus - Renske van der Veer <https://www.clingendael.org/pub/2018/strategic-monitor-2018-2019/the-crime-terrorism-nexus/>

d) **Planifikimi** i hollësishëm dhe përgatitja e aktiviteteve të paligjshme të tyre. Të dy grupet kriminale shfaqin respekt e disiplinë të përpiktë, ku përfshihen rregullat e sjelljes dhe një sistem i brendshëm ndëshkimi. Ato përdorin taktika të ngjashme (megjithëse jo tërësisht të mbivendosura): rrëmbime, vrasje, zhvatje, kontrabandën ndërkufitare, pastrimin e parave, falsifikimin, grabitjen e bankave apo lloje të ndryshme të dhunës.

e) **Fshehtësia dhe besueshmëria** e aktiviteteve të tyre dhe **përdorimi i dhunës** për të arritur qëllime ose interesa të caktuara. Të dy përdorin rrëmbimin, grabitjen, kërcënimin, dhunën dhe vrasjet kundër objektivëve, kryesisht, atyre civilë. Si organizatat terroriste ashtu edhe grupet e krimit të organizuar veprojnë fshehurazi dhe të dyja kanë nevojë për mbështetje (parti politike, kazino) rrjete të njëjtë të korrupsionit (ose të ngjashme) për aktivitetet e tyre.

f) Ato kanë një **“armik” të përbashkët - shtetin**. Të dyja janë të kriminalizuara nga regjimi në pushtet. Që të dyja qëndrojnë në kundërshtim me shtetin (përveç rasteve kur ka bashkëpunim shtetëror apo edhe përfshirje aktive).

g) **Teknologjia** është një element kyç i terrorizmit dhe i veprimtarive kriminale e cila u ofron elasticitet, shpejtësi dhe efikasitet. Interneti dhe hapësira kibernetike përdoren intensivisht nga grupet e krimit të organizuar dhe rrjetet terroriste. Ato shfrytëzojnë mjetet e internetit për rekrutimin, propagandën, planifikimin, logjistikën, mbledhjen e fondeve dhe pastrimin e parave. Gjithashtu, interneti ka ndikuar në krimet kibernetike, si: vjedhja e identitetit, pirateria, mashtrimi me karta krediti etj. Interneti përdoret gjerësisht për të planifikuar sulme terroriste, duke përfshirë objektiva dhe udhëzime për sulmet/grabitjet, ndërtimin e bombave artizanale dhe operacione të ndryshme.

h) **Globalizimi** gjithashtu ka lehtësuar transfertat dhe lëvizjen ndërshtetërore. Emigrimi i popullsisë në vendet e zhvilluara është një bazë e mirë dhe një mbështetje për grupet dhe rrjetet kriminale në vendet e zhvilluara. Shumë terroristë që përdorin migracionin depërtojnë në një shoqëri dhe bëhen bazë dhe mjet për veprimet dhe aktivitetet kriminale të organizatës terroriste. Disa nga rrugët e emigranteve janë të njëjta me ato të trafikut të drogës, gjë që na jep një tablo më të qartë për lidhjen ndërmjet migrimit, krimit të organizuar dhe terrorizmit.

1.2. Ndryshimet

a) **Motivimi dhe objektivat**. Grupet terroriste zakonisht janë shumë të motivuara ideologjikisht, në krahasim me grupet e krimit të organizuar. Terroristët veprojnë për qëllime idealiste dhe synojnë reformimin e realitetit shoqëror, ndërsa nga ana tjetër, anëtarët e krimit të organizuar kanë për qëllim përfitimin personal. Pra, qëllimi (politik/ideologjik) i tyre përbën dallimin kryesor midis terroristit dhe kriminelit.

b) Një tjetër pikë ku ata ndryshojnë, është **mënyra e paraqitjes së aktiviteteve** të tyre. Grupet terroriste, zakonisht, kërkojnë vëmendjen e mediave, deklarojnë qëllimet e tyre haptazi; marrin përgjegjësinë për sulme terroriste dhe e bëjnë këtë në mënyrë që të fitojnë mbështetje nga grupe të caktuara të njerëzve, në mënyrë që vendosmëria e tyre në përmbushjen e qëllimit, të bëhet e qartë për të gjithë. Ndërsa grupet e krimit të organizuar nuk kërkojnë vëmendjen e mediave; nuk i zbulojnë qëllimet e tyre publikisht; kurrë nuk tregojnë aspiratat e tyre politike hapur, por i mbajnë aktivitetet e tyre në fshehtësi; nuk marrin asnjë përgjegjësi për veprat e tyre kriminale.

c) **Rekrutimi i elementëve**, ka veçori dalluese në aktivitetin kriminal të ndjekur nga grupe të ndryshme terroriste për sa u përket faktorëve “historikë dhe kulturorë”¹⁰. Terroristët radikalë islamikë kërkojnë individë me nivel të ulët për të kryer aktet terroriste, duke i rekrutuar më shumë për lidhjet e tyre me komunitetet lokale sesa për aftësitë kriminale. Në anën tjetër, grupet kriminale, në përgjithësi, rekrutojnë individë posaçërisht për aftësitë e tyre kriminale¹¹.

d) Edhe pse mendohet që terrorizmi dhe krimi i organizuar kanë të njëjtin armik, “shtetin”, **marrëdhënia e tyre me shtetin** është një tjetër veçori dalluese. Terrorizmi karakterizohet nga konfrontimi i vazhdueshëm dhe përpjekja për të ndryshuar qeverinë, ndërsa krimi i organizuar është i njohur për infiltrimin e tij, korrupsionin, ryshfetin e zyrtarëve shtetërorë në nivele të caktuara të qeverisjes.

e) Terrorizmi dhe organizatat kriminale në aktivitetin e tyre, shpesh, varen nga furnizues të njëjtë, (mjetet e transportit, infrastruktura, burimi i të ardhurave) që çojnë në konkurrencë, nga e cila mund të rezultojë **mosmarrëveshje apo përplasje** e armatosur midis tyre. Gjobat e përdorura nga terroristët për prodhuesit e drogës (si një shembull i lidhjeve midis drogës dhe terrorizmit), në të vërtetë nuk janë një shembull bashkëpunimi, por një shembull i një marrëdhënieje klienteliste. Grupet e krimit të organizuar në një territor të caktuar shpesh luftojnë me njëri-tjetrin në luftëra bandash por, kjo është më pak e zakonshme me grupet rivale terroriste.

2. Kompleksiteti i lidhjes

Rritja e krimit të organizuar, si dhe lidhjet e tij me terrorizmin, konsiderohen ndër shqetësimet më të ngutshme të sigurisë kombëtare dhe globale. Si një nga shprehjet më të mprehta të këtij zhvillimi, “lidhja krim-terror” e karakterizuar

¹⁰ Mark S. Hamm, Crimes Committed by Terrorist Groups: Theory, Research, and Prevention, Washington, D.C.: U.S. Department of Justice, Office of Justice Programs, <http://www.ncjrs.gov/pdffiles1/nij/grants/211203.pdf>

¹¹ Po aty.

nga ndërveprimi midis krimit të organizuar transnacional dhe organizatave terroriste, tregon se kryqëzime të tilla krijojnë një fushë komplekse të ndërhyrjeve të sigurisë¹². Terrorizmi dhe krimi i organizuar internacional nuk mund të studiohen të ndara nga njëri-tjetri. Për një dekadë, ato u dukën se ishin të nxitura nga motive të ndryshme: terroristët u perceptuan se kishin qëllime politike, ideologjike, fetare ose etnike; ndërsa kriminelët e organizuar, kryesisht, qëllime ekonomike. Terrorizmi nuk shihej si veprim kriminal, por si një formë e dhunës politike. Sot, shumica e terroristëve janë të angazhuar në një formë të krimit të organizuar dhe një numër, gjithnjë e në rritje, i karteleve të krimit të organizuar, po angazhohen në dhunë politike. Trafikimi i drogave është akti më i zakonshëm kriminal që bashkon kriminelët e organizuar me terroristët. Këto grupe janë duke u etiketuar nga zyrtarët e zbatimit të ligjit në terma të tillë të rinj, si: “narkoterroristë”, “narkoguerilas” dhe “narkofundamentalistë”¹³.

Në një prezantim nga Leif Villadsen, zëvendësdyrëtor i Institutit të Kërkimeve Ndërajonale të Kombeve të Bashkuara për Krimin dhe Drejtësinë në tetor 2021 me temë “Rritja e lidhjeve midis trafikut të drogës, korrupsionit dhe formave të tjera të krimit të organizuar, duke përfshirë trafikimin e personave, armëve të zjarrit, krimit kibernetik dhe pastrimit të parave dhe, në disa raste, terrorizmit, duke përfshirë pastrimin e parave në lidhje me financimin”, theksohet se:

Së pari, tregtia e drogës vazhdon të sigurojë një burim financimi strategjik për grupet më të mëdha, më tradicionale terroriste që varen nga siguri i burimeve të rëndësishme financiare për të financuar zhvillimin dhe aktivitetet organizative. Fakti që këto grupe mund të vazhdojnë të përfitojnë nga trafiku i drogës nënkupton një lloj destabiliteti të vazhdueshëm, korrupsion dhe kontroll të dobët të qeverisë; dhe, si e tillë, droga në këto zona gjeografike do të vazhdojë të sigurojë fonde për grupet terroriste të strukturuar në mënyrë më hierarkike. *Së dyti*, tendenca në zhvillim është e një lidhjeje më të lokalizuar krim-terrorizëm/drogë-terrorizëm. Ky ka qenë veçanërisht rasti në Evropë, me tregtimin e drogës (ndër krimet e tjera) të identifikuar si një nga burimet më të zakonshme të financimit për celulat militante islamike që komplotojnë sulme, gjithnjë e më shumë gjatë dekadës së fundit. Një numër rastesh riafirmojnë një model në zhvillim të kriminelëve që përfshihen në terrorizëm, një prirje që është identifikuar kohët e fundit në shumë analiza akademike. *Së treti*, përfshirja në drogë mund të çojë në burg. Ne e dimë se disa burgje kanë vepruar si inkubatorë për radikalizimin, dhe rrjedhimisht për rekrutim në celula terroriste. Pra, është radikalizimi dhe rekrutimi në burgje

¹² Perspectives on Terrorism Volume 15, Issue 4 Frictional Security Governance: Policing the Crime-Terror Nexus in Denmark by Mette-Louise E. Johansen, Anna Bræmer Warburg, and Maya Mynster Christensen 2021, fq.111.

¹³ West Sands Advisory LLP Project lead: Dr. Tamara Makarenko - Europe's Crime-Terror Nexus: Links between terrorist and organised crime groups in the European Union.

që përbën trendin e tretë që po shohim në lidhje me lidhjen krim-terror dhe drogën. **Së fundi**, disa nga kriminelët e radikalizuar në fakt përbënin një përqindje të konsiderueshme të luftëtarëve të huaj të njohur, që udhëtuan nga Evropa në Irak dhe Siri. Studimet tregojnë se një numër disproporcional i këtyre militantëve kishin lidhje me kriminalitetin, veçanërisht me drogën. Lidhja e dikurshme e këtyre individëve në rrjetet kriminale ose, në përgjithësi, prejardhja e tyre kriminale, ka shërbyer gjithashtu si “faktor shtytës” duke u mundësuar atyre të arrijnë në destinacionet përfundimtare plotësisht të pazbuluar, duke përfshirë infiltrimin e rrugëve të emigrantëve të paligjshëm dhe përdorimin e dokumenteve të falsifikuara.

Shtimi i veprimtarisë së krimit dhe terrorit i bën ata më të fuqishëm: terroristët përfitojnë nga të ardhurat e aktiviteteve kriminale dhe kriminelët e organizuar përdorin taktika terroriste për të fituar pushtet politik. Në disa raste, grupet kriminale kanë miratuar ideologjinë e grupeve terroriste ose janë shumë mbështetës për motivet e tyre, veçanërisht në rajonet me rritje tensionesh etnike dhe fetare. Të dy grupet po shfaqin veprime të ngjashme operacionale dhe organizative dhe ndajnë përvojën e tyre të kaluar. Në lidhjen ndërmjet krimit dhe terrorit kanë ndikuar katër zhvillime kryesore: **globalizimi**, me flukset e tregtisë së lirë dhe reduktimit të pengesave tregtare, si dhe mjeteve të udhëtimit global, ka mundësuar që krimi dhe terrori të mund të kryhen në të gjitha anët/skajet e globit, gjatë gjithë kohës; **fundi i Luftës së Ftohtë** reduktoi mundësitë e financimit të shtetit për lëvizjet terroriste, të cilat detyruan terroristët të ndërmarrin aktivitete kriminale për të rritur të ardhurat e tyre; **revolucionin i komunikimit përmes internetit** krijoi kushte që grupet terroriste dhe ato të krimit të organizuar të shfrytëzojnë internetin për rekrutimin, planifikimin, operacionet psikologjike, logjistikën dhe mbledhjen e fondeve, piraterinë e videove, mashtrimet me kartë krediti, shitjen e drogës, grabitjet, pastrimin e parave dhe pornografinë dhe **lufta globale ndaj terrorit** ka bërë që ato të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën.

Rritja e lidhjes së terrorizmit me krimin e organizuar ka përkeqësuar përpjekjet kundër luftës dhe arritjes së paqes në vende si Iraku, Afganistani apo Afrika Perëndimore, të cilët janë bërë qendra të rrezikshme të trafikimit, duke bërë bashkë terroristët dhe kartelet e krimit të organizuar në një hapësirë të gjerë të globit. Ajo po sfidon sigurinë kombëtare dhe ndërkombëtare, duke dobësuar institucionet demokratike, kompromentuar institucionet qeveritare, dëmtuar besueshmërinë e institucioneve financiare, infiltruar ekonominë formale, çuar në rritjen e krimeve dhe sfidave të sigurisë njerëzore. Rëndësia e shqyrtimit të lidhjes midis këtyre dy fenomeneve përkon me rëndësinë e luftës kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar. Veprimet antiterroriste dhe antikriminale në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar varen në masë të madhe

nga kuptimi i secilit problem veç e veç, si dhe nga kuptimi i lidhjeve reciproke të tyre të gjithanshme. Në të kundërt, ekziston rreziku i bashkimit teorik të njërit problem me tjetrin, që mund të çojë në probleme për luftimin e këtyre krimeve në praktikë.

Marrëdhënia në zhvillim midis terrorizmit dhe krimit të organizuar përbën një sfidë të rëndësishme për bashkësinë ndërkombëtare. Forcimi i lidhjes, nga një bashkëjetesë e thjeshtë drejt një marrëdhënieje reciproke të dobishme, si dhe linjat mes këtyre veprimtarive që tani po bëhen gjithnjë e më të paqarta, po e bëjnë të vështirë dallimin midis grupeve terroriste “të pastër” dhe homologëve të tyre kriminalë apo diçka në mes tyre. Lidhja konceptuale mes terrorizmit dhe krimit të organizuar është bërë më e qartë nga veprimet e mëtijshme ndërkombëtare. Duke e njohur këtë prirje, bashkësia ndërkombëtare e ka identifikuar lidhjen midis organizatave kriminale dhe terrorizmit në një numër instrumentesh dhe veprimesh. Në vitin 2001, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 1373¹⁴, duke kërkuar që të gjitha shtetet anëtare të trajtojnë me përgjegjësi lidhjet e mundshme midis terrorizmit dhe krimit të organizuar. Në vitin 2014, Këshilli i Sigurimit i OKB-së miratoi Rezolutën 2195, “Kërcënimet ndaj paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”¹⁵, duke u bërë thirrje shteteve që të kuptojnë më mirë dhe të adresojnë lidhjen mes krimit të organizuar dhe terrorizmit, si një kërcënim për sigurinë dhe zhvillimin e vendeve. Po kështu miratoi edhe Deklaratën e Këshillit të Sigurimit 13325 të datës 8 maj 2018, “Kërcënime për paqen dhe sigurinë ndërkombëtare”¹⁶.

Pavarësisht nga qëllimet dhe modalitetet/mënyrat e tyre, “krimi i organizuar dhe terrorizmi janë identikë për atë që ato paraqesin sfida serioze ndaj legjitimitetit të shteteve, paqes dhe sigurisë ndërkombëtare”¹⁷. Në të vërtetë, ekziston një dallim i theksuar ndërmjet situatës në Evropë dhe në vendet e tjera më të zhvilluara dhe rajoneve që vuajnë deri diku nga konfliktet dhe sfidat më të gjera të zhvillimit, veçanërisht, aty ku ka mungesë të mekanizmave të sundimit të ligjit dhe institucioneve shtetërore. Në realitet, dinamika e grupeve nxitet nga mjedisi lokal, burimet, politikat e shtetit, si dhe ndryshimet në situatën mbizotëruese rajonale dhe ndërkombëtare. Secili grup (si terrorist, ashtu edhe kriminal) është unik dhe si pasojë, edhe marrëdhëniet ndërmjet tyre. Shumë shpesh, organizatat terroriste dhe grupet kriminale shihen si entitete/shoqata

¹⁴ Resolution 1373 (2001) Adopted by the Security Council at its 4385th meeting, on 28 September 2001 https://www.unodc.org/pdf/crime/terrorism/res_1373_english.pdf

¹⁵ Resolution 2195 Threats to international peace and security <http://unscr.com/en/resolutions/2195>

¹⁶ Threats to international peace and security <https://www.un.org/securitycouncil/content/statements-made-president-security-council-2018> https://www.un.org/securitycouncil/sites/www.un.org/securitycouncil/files/part_i_2018_threats_to_ips.pdf

¹⁷ Burimi elektronik: <https://www.ipinst.org/wp-content/uploads/2014/11/IEF-Meeting-Note-TOC-and-Peacebuilding.pdf>

monolite, homogjene dhe jo si rrjete komplekse dhe shumëdimensionale. Ndërsa janë vendosur linjat e lidhjeve midis grupeve terroriste dhe krimit të organizuar, natyra, shtrirja dhe thellësia e lidhjeve të tilla është shumë e debatuar. Ndërveprimi mes grupeve terroriste dhe organizatave kriminale nuk është i drejtpërdrejtë; secili rast është specifik dhe vazhdimisht evoluon.

Një nga aspektet më shqetësuese të lidhjes së re krim-terror është potenciali që 'aftësitë' kriminale t'u transferohen terroristëve. Grupet terroriste mund të kërkojnë të kompensojnë mungesën e aftësive të brendshme duke bashkëpunuar me krimin e organizuar. Përfshirja e ish-kriminelëve mund të ketë vlerë për grupet terroriste dhe se bashkimi i mjediseve kriminale dhe terroriste rrit kapacitetin e grupeve terroriste për të kryer më shumë sulme - dhe më vdekjeprurëse. Në të vërtetë, ka shumë aftësi që mund të ketë zhvilluar një terrorist me të kaluar kriminale: kriminelët kanë përvojë në trajtimin e zbatimit të ligjit dhe më e rëndësishmja, mund të jenë të njohur me kufijtë e kompetencave të policisë. Kriminelët janë gjithashtu novatorë dhe shpesh kanë një aftësi për të kontrolluar nervat dhe për të trajtuar presionin. Individët me të kaluar kriminale priren të kenë hyrje më të lehtë në armët; së dyti, ata janë të aftë të qëndrojnë 'nën radar' dhe të planifikojnë logjistikë diskrete; dhe së treti, përvoja dhe njohja e tyre me dhunën ul pragon e tyre (psikologjik) për t'u përfshirë në akte terroriste¹⁸.

Grupet kriminale dhe terroriste kanë filluar të rekrutojnë nga të njëjtët grupe njerëzish, duke krijuar sinergji (shpesh të paqëllimshme) dhe mbivendosje që kanë pasojë për mënyrën se si individët radikalizohen dhe veprojnë. Kjo është ajo që ne e quajmë lidhja e re krim-terror¹⁹. Lidhja krim i organizuar me terrorizmin shfaqet në nivele të ndryshme. Grupet e krimit të organizuar dhe terroristët mund të bashkohen, në mënyrë të përhershme ose oportuniste (që nisen nga interesa të ngushta të çastit). Për shembull, grupet terroriste si Partia e Punëtorëve të Kurdistanit (PKK) tatojnë dhe zhvatin trafikantët e drogës që veprojnë brenda territorit që ata kontrollojnë; Camorra napolitane u zbulua se furnizonin me armë të rënda grupin separatist ETA në këmbim të dërgesave të drogës. Për më tepër, përdorimi i taktikave kriminale nga terroristët për të çuar më tej aktivitetet e tyre financiarisht dhe operacionalisht është një fenomen i përsëritur, duke filluar nga përfshirja e IRA-s në shantazhe deri te tregtia e drogës nga anëtarët e celulave terroriste evropiane²⁰. Këta shembuj nxisin reflektimin mbi natyrën e lidhjeve ndërmjet krimit të organizuar dhe terrorizmit. Edhe pse përgjithësisht janë menduar si kërcënime të veçanta, ndërveprimi ndërmjet terrorizmit dhe krimit të organizuar po evoluon dhe

¹⁸ Rajan Basra, Peter R. Neumann, and Claudia Brunner - Criminal Pasts, Terrorist Futures: European Jihadists and the New Crime-Terror Nexus, fq.35. ICSR - www.icsr.info

¹⁹ Po aty, fq.3. ICSR - www.icsr.info

²⁰ Burimi elektronik: http://www.sussex.ac.uk/lps/research/networks/sussex_terrorism_extremism_research_net_~work

aktivitetet e tyre kanë efektin e përforcimit të njëri-tjetrit, duke e shndërruar marrëdhënien e tyre në një simbiozë, në të cilën është gjithnjë e më e vështirë të bëhet dallimi kuptimplotë midis të dyjave.

Si rezultat, lidhja e krimit të organizuar me terrorizmin mbetet një subjekt i shqetësimit të vazhdueshëm për politikëbërësit dhe agjencitë e zbatimit të ligjit. Megjithatë, zhvillimi i politikave të bazuara në prova është i ndërlikuar nga sfidat e kërkimit të aktiviteteve të rrjeteve kriminale dhe terroriste. Kjo është veçanërisht e vërtetë në një epokë të drejtuar nga teknologjia, me mundësitë që interneti dhe hapësira kibernetike u ofron terroristëve dhe kriminelëve. Nëse lidhja nuk kuptohet në mënyrë metodike dhe specifike, mund të ekzistojë rreziku i ngatërimit të krimit dhe terrorizmit në një çështje të vetme, ose bashkimi i aktiviteteve dhe lidhjeve të krimit dhe terrorizmit. Megjithatë, duke marrë parasysh veçoritë e lidhjes është e mundur të izohet dy grupe lidhjesh midis krimit dhe terrorizmit apo lidhjet midis entiteteve dhe aktiviteteve. Kuptimi i kësaj hollësie ka një ndikim në strategjitë kundër krimit dhe terrorizmit.

3. Një këndvështrim për Ballkanin

Krimi i organizuar dhe grupet terroriste përbëjnë një kërcënim edhe për vendet e Ballkanit Perëndimor. Një nga faktorët kryesorë që favorizon praninë dhe zhvillimin e krimit të rëndë dhe të organizuar në Ballkanin Perëndimor është pozicioni gjeografik i rajonit në udhëkryqin midis Evropës dhe Lindjes së Mesme. Për më tepër, ato janë të vendosura në kufijtë e jashtëm të zonës Shengen dhe janë pjesërisht të rrethuar nga shtetet anëtare të BE-së. Aspekti transnacional i krimit të organizuar në rajon është shumë i zhvilluar: Ballkani Perëndimor është një qendër për trafikimin e shumë mallrave të paligjshme dhe një qendër gjeografike për kontrabandimin e migrantëve që përpiqen të hyjnë në Evropën Perëndimore²¹. Historikisht, gadishulli i Ballkanit ka shërbyer si një zonë tranziti për trafikimin dhe kontrabandën e njerëzve dhe mallrave nga grupet kriminale nga Azia në Evropën Perëndimore²².

Faktorët socialë, ekonomikë dhe politikë në dekadat e fundit luajtën një rol të rëndësishëm në rritjen e krimit të organizuar në rajon. Kombinimi i institucioneve të brishta dhe kërkesave perëndimore për mallra të paligjshme e bënë Ballkanin rrugën e rezistencës më të vogël për grupet e organizuara kriminale. Për më tepër, vendndodhja e saj gjeografike përgjatë rrugëve kryesore të trafikut të drogës dhe migrimit në skaj të Evropës Perëndimore ofron një mundësi ideale për kriminelët dhe zyrtarët e korruptuar dhe zgjerimin e organizatave kriminale.

²¹ Global Initiative Against Transnational Organised Crime, SPOT PRICES Analysing flows of people, drugs and money in the Western Balkans, May 2021, Available on: <https://globalinitiative.net/analysis/western-balkans-crime-hotspots-3/>

²² Kole Krasniqi, Organized Crime in the Balkans. European Scientific Journal, 12(19), 204-220

Kontrollet e pamjaftueshme kufitare dhe lehtësia e marrjes së pasaportave mundësojnë kalimin transit të kriminelëve dhe figurave terroriste në Evropën Perëndimore. Efektet gërryese të krimit të organizuar dhe korrupsionit në institucionet shtetërore janë një çështje shqetësuese në të gjitha vendet dhe territoret e Ballkanit Perëndimor²³. Korrupsioni ka krijuar kushte dhe ka lehtësuar krimin e organizuar si dhe është një faktor kryesor që shpjegon mos efikasitetin e ndërhyrjeve të politikave.

Krimi i organizuar vazhdimisht zhvillon manifestime të reja dhe përshtatet me kushtet dhe rrethanat e reja shoqërore. Disa lloje të krimit të organizuar po bëhen gjithnjë e më komplekse si rezultat i lidhjeve më të mëdha rajonale dhe ndërkombëtare midis grupeve të krimit të organizuar dhe ato po karakterizohen gjithnjë e më shumë nga një strukturë heterogjene dhe një nivel i lartë fleksibiliteti. Teknologjitë moderne të informacionit dhe mjetet e komunikimit ndikojnë në ruajtjen dhe krijimin e marrëdhënieve të reja të ndërsjella të anëtarëve të grupeve të krimit të organizuar. Teknologjitë e reja të informacionit, mediat sociale, aplikacionet e internetit për komunikim do të vazhdojnë të jenë mjetet kryesore të komunikimit mes grupeve të krimit të organizuar, por edhe një nga mënyrat kryesore për të rekrutuar anëtarë të rinj të grupeve të krimit të organizuar. Përdorimi i rrjeteve sociale dhe aplikacioneve të tjera të internetit mundëson kontakt më të shpejtë dhe më të sigurt ndërmjet anëtarëve të grupeve kriminale dhe në këtë mënyrë ndikon negativisht në sigurimin e provave. Ato përdorin platforma online për të tregtuar mallra dhe shërbime nëpërmjet përdorimit të rrjetit të errët²⁴.

Strukturat e grupeve kriminale shpesh varen nga aktiviteti i spikatur kriminal në të cilin ata janë të përfshirë. Grupet e kontrabandës së migrantëve janë të lidhur lirshëm me një bos ose një hierarki të thjeshtë dhe mënyra të sofistikuar bashkëpunimi midis grupeve. Grupet e trafikut të drogës janë më elastikë dhe më pak hierarkikë në strukturë, me grupime të specializuara në shërbime të caktuara (p.sh., me shumicë, pakicë) dhe me lidhje të kufizuara ndërmjet tyre (përgjithësisht nëpërmjet një personi kontaktues). Grupet e përfshira në trafikimin e qenieve njerëzore nuk janë rrjete kohezive, por të rregulluar me grupime të vogla si në vendndodhjet e origjinës ashtu edhe në destinacionin, ku këto të fundit janë vendi në të cilin ata përfshihen në shfrytëzimin e viktimave²⁵.

²³ Balkans in Europe Policy Advisory Group (BiEPAG) (2019). Strengthening the Rule of Law in the Western Balkans: Call for a Revolution against Particularism. Policy Study. <http://biepag.eu/wp-content/uploads/2019/03/Strengthening-theRule-of-Law.pdf>

²⁴ Ministry of Interior, Serious and Organised Crime Threat Assessment, Mid-term Review 2019, Ministry of Interior, 2019, p. 12.

²⁵ UNITED NATIONS OFFICE ON DRUGS AND CRIME, MEASURING ORGANISED CRIME IN THE WESTERN BALKANS, 2020, Available on: <https://www.unodc.org/unodc/en/frontpage/2020/December/unodc-launches-comprehensive-regional-report-on-organized-crime-in-the-western-balkans.html>

Prodhimi dhe kontrabanda e drogës në Ballkanin Perëndimor përfaqëson llojin më dominues dhe më fitimprurës të krimit të organizuar, në të cilin përfshihet numri më i madh i tyre. Për sa i përket kontrabandës së drogës, vendet e Ballkanit Perëndimor janë vende transit. Sasi të caktuara mbeten në territoret e tyre për qëllime konsumi ose ruajtjeje dhe marihuana dhe droga sintetike prodhohen ilegalisht për nevojat e tregut vendas. Tregu i drogës është dinamik si rezultat i faktit se shumica e rrugëve të përdorura nga organizatat kriminale përdoren edhe për kontrabandën e llojeve të tjera të produkteve (mallra me akcizë, cigare, etj.). Organizatat kriminale të Ballkanit Perëndimor marrin pjesë në kontrabandën e kokainës nga Amerika e Jugut dhe kjo tendencë e identifikuar do të vazhdojë të rritet ndërkohë që metodat e kontrabandës do të ndryshojnë vazhdimisht dhe përfshijnë metoda të sofistikuar të fshehjes dhe përdorimin e teknologjive moderne të informacionit në komunikim²⁶.

Trafikimi i armëve të zjarrit në Ballkanin Perëndimor është kryesisht brenda rajonit, megjithëse çmimi i lartë i armëve në tregjet jashtë rajonit shkakton gjithashtu trafikun e armëve të zjarrit nga Ballkani Perëndimor në pjesë të tjera të Evropës, Azisë Perëndimore dhe Amerikës së Veriut. Shpesh grupet kriminale të organizuara trafikojnë armë zjarri brenda rajonit për të zbatuar disiplinën/rregullin, për të frikësuar grupet rivale ose për të siguruar mbrojtjen e aktiviteteve dhe anëtarëve të një grupi²⁷.

Kërcënimet asimetrike të sigurisë për vendet e rajonit ndajnë shumë sfida të përbashkëta të sigurisë që mund të ndikojnë në sigurinë integrale në rajon. Në kohën e sotme, krimi i organizuar dhe terrorizmi vlerësohet si një rrezik real për sigurinë e çdo vendi, por në mënyrë të veçantë, për sigurinë e vendeve me shtete e demokraci të brishta, që s'kanë as traditën, as përvojën e duhur për t'u përballur me efikasitet me të. Në këtë këndvështrim, ky fenomen vlerësohet si rrezik kryesor për sigurinë e secilit vend me grupin e vet unik të problemeve dhe sfidave dhe në përgjithësi, të gjithë rajonit. Me gjithë progresin e arritur për të ndërtuar një të ardhme të re nëpërmjet procesit të integritetit në Bashkimin Evropian, në sytë e ndërkombëtarëve rajoni ynë ende vlerësohet mjaft i brishtë dhe sfidues. E vërteta është se në 20-25 vitet e fundit, në Ballkan ka lulëzuar një "industri e re", që punon me kapacitet të plotë - "industria e krimit të organizuar". Kjo ka bërë që edhe këndvështrimi i vlerësimit gjeostrategjik të pësojë një ndryshim të madh. Rëndësia strategjike e Ballkanit shihet lidhur me rreziqet që ai mund të eksportojë. Krimi i organizuar shihet si një ndër rreziqet

²⁶ OSCE Mission in Serbia, REGIONAL SERIOUS AND ORGANISED CRIME THREAT ASSESSMENT Report: <https://polis.osce.org/regional-serious-and-organized-crime-threat-assessment>

²⁷ UNITED NATIONS OFFICE ON DRUGS AND CRIME, MEASURING ORGANISED CRIME IN THE WESTERN BALKANS, 2020, Available on: <https://www.unodc.org/unodc/en/frontpage/2020/December/unodc-launches-comprehensive-regional-report-on-organized-crime-in-the-western-balkans.html>

kryesore. Për këtë arsye, lufta ndaj tij ka qenë një ndër drejtimet kryesore të kontributit ndërkombëtar për fuqizimin e institucioneve në vendet e rajonit, por në të njëjtën kohë, edhe një ndër kushtet bazë që duhet të plotësojnë qeveritë e vendeve për realizimin e aspiratës së integritimit në BE dhe në NATO.

Krimi i organizuar përfshihet në kërcënimet kryesore të kohës së sotme për sigurinë dhe shihet si një burim që i ushqen drejtpërsëdrejti këto kërcënime, qoftë konfliktet rajonale dhe ndëretnike, si dhe terrorizmin. Si veprimtari antiligjor, e cila ka në themel fitimin e paligjshëm, krimi i organizuar kërcënon stabilitetin e sundimit të ligjit dhe sfidon e kërcënon pareshtur themelet ekonomike e ligjore të shtetit. Fuqizimi i grupeve kriminale dhe tendenca e gjetjes së një partneri të mundshëm si terrorizmi, është i rrezikshëm, dhe përbën kërcënim ndaj institucioneve shtetërore.

Për sa i përket terrorizmit, si kërcënimi më i rrezikshëm asimetrik, duhet të theksohet se mundësia e sulmeve terroriste në rajon nuk mund të shpërfilllet. Pavarësisht humbjes së territorit dhe rënies së të ashtuquajturit “Kalifat” (ISIS), kërcënimi i terrorizmit është ende i pranishëm dhe i kushtëzuar nga ndryshimet në format dhe metodat e veprimtarisë terroriste. Domethënë, ideja e mbijetesës së Kalifatit është shndërruar nga një Kalifat territorial në një “Kalifat Virtual”, duke frymëzuar dhe inkurajuar ekzekutimin e aktiviteteve terroriste. Rajoni i Ballkanit Perëndimor nuk ka mbetur imun ndaj fenomeneve të terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm që çuan në aktivitete terroriste. Aktivitetet e grupeve dhe individëve ekstremë kriminalë dhe radikalë janë dokumentuar në rajon, si dhe persona që kanë marrë pjesë aktive në luftime në rajonet e krizës.

Rajoni mbetet një bazë e rëndësishme logjistike dhe një rrugë transiti për terroristët dhe ekstremistët në Evropën Qendrore e në zonat e krizës, me qëllim kryerjen e akteve terroriste ose rekrutimin e luftëtarëve dhe gjithashtu, shërben si strehë e tyre. Përfshirja e luftëtarëve nga Ballkani në zonat e konfliktit mund të shihet edhe si një shkelje e sigurisë në rajon. Ekstremizmi, fetar apo nacionalist, është ende aktiv në rajon, në formën e grupeve apo lëvizjeve separatiste. Dallimet politike në disa vende janë faktorë për vazhdimin e aktiviteteve ekstremiste. Këto grupe janë të vendosura të imponojnë besime radikale fetare dhe ideologjike dhe si të tilla, paraqesin rrezik për sigurinë e vendeve të caktuara.

Lëvizja e emigrantëve nga Lindja e Mesme, pjesë të Afrikës së Veriut dhe Azisë, vazhdon të ndikojë në rajonin e Ballkanit. Ekziston rreziku i rritjes së infiltrimit të militantëve dhe kriminelëve nga vendet e rajonit, gjë që kërcënon sigurinë e tij në të ardhmen. Bashkëpunimi i terroristëve islamikë me krimin e organizuar krijon një kërcënim të madh për sigurinë e rajonit. Krimi i organizuar dhe terrorizmi veprojnë në nivel global dhe nuk njohin

kombësi dhe kufij. “Rruga e Ballkanit” u shërben aktiviteteve të paligjshme të dy grupeve të lartpërmendura. Dihet gjithashtu se krimi i organizuar dhe terrorizmi zakonisht krijojnë lidhje dhe ndërvarësi që rrisin nivelin e kërcënimit asimetrik. Interesat e krimit të organizuar mund të lidhen me qëllimet e terroristëve.

Disa “spote” në Ballkan përdoren në mënyrë operative si pika të rëndësishme të dërgesës për trafikim të paligjshëm, për shkak të flukseve të larta të trafikut rrugor rajonal, që favorizojnë dërgesat e paligjshme për të lëvizur, pa u zbuluar nga autoritetet e zbatimit të ligjit. Këto aktivitete ndihmohen nga rritja e flukseve të migracionit ilegal. Në shumë raste, rrjetet e kontrabandës së emigrantëve veprojnë si struktura ligjore të biznesit, si agjenci udhëtimi, për të prodhuar dokumente mashtruese që u mundësojnë emigrantëve të parregullt të marrin lejet e punës. Këto metoda kanë rezultuar shumë të suksesshme për rrjetet e përfshira dhe përdorimi i tyre mund të rritet më tej në të ardhmen. Rrjedhimisht, rrugët migruese që kalojnë nëpër Evropë, dhe në veçanti përmes Ballkanit Perëndimor, po bëhen më të ndryshueshme, dinamike dhe të rrezikshme. Gjithashtu, më shumë emigrantë tani kanë gjasa të kalojnë pa u zbuluar. Ballkani Perëndimor nuk konsiderohet vetëm si rajon transit, por gjithashtu, si një burim i rëndësishëm i tregtisë së armëve të zjarrit në tregun ndërkombëtar të armëve dhe të drogës. Rrjetet e transportit në Ballkan përdoren edhe nga grupe militante islamike për mbështetje logjistike.

Niveli i bashkëpunimit ndërmjet terroristëve dhe krimit të organizuar përcaktohet në shumë raste nga natyra gjeografike e rajonit. Historikisht, siguria e dobët e kufirit, zbatimi i dobët i ligjit, zyrtarët e korruptuar publikë dhe rrjetet e krijuara të kontrabandës kanë lehtësuar shfaqjen e grupeve hibride që kërkojnë, në të njëjtën kohë, synimet politike dhe maksimizimin e fitimit. Ekstremizmi, krimi i organizuar dhe migrimi ilegal në rajon janë kërcënime të sigurisë që mund të ndikojnë në mjedisin e sigurisë. Vitet e luftës në ish-Jugosllavi radikalizuan shumë lëvizje islamike në rajonin e Ballkanit. Kjo hapi rrugën për krijimin e lidhjeve të reja të ngushta dhe hapësirën për bashkëpunim të mëtejshëm ndërmjet organizatave terroriste të Ballkanit dhe organizatave të ndryshme terroriste në Lindjen e Mesme. Instalimi dhe zgjerimi i fundamentalizmit islamik, kryesisht në Bosnjë, Kosovë, Maqedoni, Shqipëri, Turqi dhe Bullgari, ishte një produkt i zhvillimeve të reja kërcënuese në rajon. Në këtë kontekst, është e nevojshme të theksohet se kjo është organizuar në një mënyrë specifike dhe me intensitet të ndryshëm në të gjitha pjesët e Ballkanit. Emëruesi i përbashkët për Ballkanin është se shërben si një portë e hapur, si një urë për transferimin e kërcënimeve të reja të sigurisë nga Lindja e Mesme në Evropë.

Sot, krimi i organizuar është një kërcënim për stabilitetin në Ballkan. Lidhja

e etnisë, ekstremizmit dhe kriminalitetit janë edhe më të rrezikshëm. Kjo kërkon masa më të forta e qasje më të bashkuar për të reaguar, si dhe për rritjen e rrjeteve për të forcuar qëndrueshmërinë ndaj këtyre kërcënimeve. Lufta kundër krimit të organizuar apo terrorizmit në Ballkan nuk duhet parë apo kuptuar vetëm si detyrë apo përgjegjësi e një shteti. Suksesi i luftës kundër krimit të organizuar në Ballkan varet edhe nga bashkëpunimi dhe rrjetëzimi ndërmjet aktorëve të ndryshëm kombëtarë dhe ndërkombëtarë. Vendet e Ballkanit janë të vetëdijshme për rreziqet që paraqet krimi i organizuar dhe terrorizmi dhe kanë marrë një sërë masash të nevojshme duke ndërtuar një bazë të fortë ligjore, duke riorganizuar dhe reformuar institucionet shtetërore dhe duke përmirësuar vazhdimisht bashkëpunimin ndërmjet institucioneve kombëtare dhe ndërkombëtare për të lehtësuar zhvillimin e një lufte më të suksesshme kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit.

3.1. Nisma “Ballkani i Hapur”

Nisja e nismës së Ballkanit të Hapur në verën e vitit 2021, e cila në një periudhë afatshkurtër bëri që tre vende të Ballkanit Perëndimor²⁸ të nënshkruan një memorandum që do të sigurojë ndihmë reciproke në kohë fatkeqësish natyrore, akses të lirë në tregjet e punës dhe lëvizje të lirë të mallrave. Plani afatgjatë është që të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor t'i bashkohen kësaj nisme që përfundimisht do të shohë krijimin e një mini-zone Shengen. Kjo nuk është pa rreziqe²⁹. Vendet e Ballkanit Perëndimor po përballen me fenomenin e luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer së fundmi nga fushat e betejës në Irak dhe Siri. Ato kanë ndarë shumë informacione për këta të kthyer; megjithatë, ekspertët besojnë se hapja e kufijve dhe qarkullimi i lirë i njerëzve pa regjistrim dhe kontroll, mund të çojë në dobësi dhe lëshime, veçanërisht në fushën e identifikimit pasi kufijtë e hapur do të kufizojnë më tej gjurmimin e tyre të mëtejshëm.

Nisma e Ballkanit të Hapur do të kontribuojë në ngritjen e institucioneve rajonale përgjegjësie e të cilave do të jetë lufta kundër krimit të organizuar dhe terrorizmit (të ngjashme me Europolin), të cilat do të duhet të përfshijnë oficerë ndërlidhës, ekipe të përbashkëta hetimore, ekipe strategjike, taktike dhe operacionale, analiza etj. Gjithashtu, sugjerohet që të ketë një bazë të dhënash të përbashkët të inteligjencës me institucionet në rajon për të garantuar ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit. Zbatimi i kësaj nisme do të thellojë bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet Financial Intelligence Unit (FIU). Duke marrë në konsideratë se cilat modele të bashkëpunimit dypalësh ose rajonal do të duhet të zhvillohen për të përshpejtuar shkëmbimin e informacionit, ekipet e përbashkëta, etj.

²⁸ Albania, North Macedonia and Serbia

²⁹ <https://cep.org.rs/en/blogs/open-balkan-initiative/>

Përfundime

Mjedisi bashkëkohor ndërkombëtar i sigurisë krijon mundësi për të zhvilluar lidhjet midis krimit të organizuar dhe terrorizmit. Nëse kufijtë midis terrorizmit dhe krimit të organizuar mbivendosen gjithmonë, ata tani janë bërë gjithnjë e më të padallueshëm. Rritja e të dy llojeve të organizatave ka të bëjë me faktorët strukturorë si: vështirësitë ekonomike, pabarazitë në shoqëritë tona, presionet e popullsisë dhe migracionit, shtypja nga regjimet autoritare për të ruajtur statusin e tyre të privilegjuar, si dhe ekzistenca e hapësirave të paqeverisura si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale, poroziteti më i madh i kufijve, udhëtimet më të lira ndërshtetërore, rritja e diasporave të huaja dhe veçoritë specifike të globalizimit si liberalizimi i tregjeve financiare, bankave dhe më e rëndësishmja, përdorimi dhe abuzimi me internetin.

Lidhja midis këtyre të këqijave të mëdha është e fortë dhe do të ndikojë jo vetëm te vende të veçanta, por edhe në ato globale; një çështje, e cila kërkon rregulla të qëndrueshme dhe të unifikuara, veprime vendimtare dhe të vendosura për parandalimin e tyre. Nuk ka asnjë vend të vetëm që do të mund në mënyrë individuale të mbrojë veten dhe të garantojë sigurinë e qytetarëve të saj. Këto janë çështje globale të sigurisë, të cilat nuk duhet të merren parasysht në mënyrë të izoluar; të gjitha aspektet duhet të merren në konsideratë. Lufta kundër tyre në nivel global duhet të jetë vendimtare dhe në frymën e përmirësimit të vazhdueshëm dhe zhvillimit.

Rritja e njohurive, ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit e mënyrave në të cilat terrorizmi dhe krimi i organizuar janë të lidhur duhet të jetë një prioritet në mënyrë që të zbulojmë në mënyrë të shpejtë fenomenin. Është e rëndësishme që të fokusohemi në konsideratat ligjore, këshilla praktike në terren, kërkimin dhe shkëmbimin e informacionit, forcimin e sigurisë kufitare, angazhimin lokal dhe ngritjen e kapaciteteve, dhe zbatimin e ligjit. Instrumentet e reja të zbulimit si analiza e të dhënave të mëdha dhe intelijenca artificiale mund të bëhen mjete të fuqishme në monitorimin e zhvillimeve të dëmshme shoqërore.

Si përfundim, hulumtimi, të dhënat dhe mësimet e nxjerra na tregojnë qartë se manifestimet e lidhjes duhet të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse. Më shumë bashkëpunim në nivel kombëtar dhe rajonal është thelbësor nëse duam të çmontojmë lidhjen në mbarë botën.

Bibliografia

1. Countries Human Security in the Western Balkans (HUMSEC): The Impact of Transnational Terrorism and Organized Crime on the Peace-Building Process.
2. Report 2 -Western Balkans 6 - Countering the Financing of Terrorism and Organised Crime in the Western Balkans.
3. Global Initiative against Transnational Organized Crime Crooked Kaleidoscope Organized Crime in the Balkans 2017.
4. The European Union (EU) Serious and Organised Crime Threat Assessment (SOCTA) 2021.
5. Angel Rabasa, Christopher M. Schnaubelt, Peter Chalk, Douglas Farah, Gregory Midgette, Howard J. Shatz Countering the Expansion of Transnational Criminal Networks.
6. Policy Toolkit on The Hague Good Practices on the Nexus between Transnational Organized Crime and Terrorism - March 2019
7. Michael R. Ronczkowski Terrorism and organized hate crime Third Edition Intelligence Gathering, Analysis, and Investigations.
8. Florence Gaub and Julia Lisiecka, The crime-terrorism nexus, European Union Institute for Security Studies (EUISS) April 2017
9. https://www.state.gov/wp-content/uploads/2021/07/Country_Reports_on_Terrorism_2020.pdf
10. <https://globalinitiative.net/analysis/transnational-tentacles-wb6/>
11. <https://globalinitiative.net/analysis/oc-western-balkans/> https://search.coe.int/cm/pages/result_details.aspx?objectid=0900001680a19655
12. <https://europeanwesternbalkans.com/2021/07/29/transnational-cooperation-necessary-in-the-fight-against-organized-crime-and-terrorism/>
13. <https://www.unodc.org/documents/data-and-analysis/OC/Measuring-OC-in-WB.pdf>
14. <https://icct.nl/app/uploads/2017/04/OC-Terror-Nexus-Final.pdf>

SKENARËT GJEOPOLITIKË DHE GJEOSTRATEGJIKË PËR MJEDISIN E SIGURISË NË RAJON, BAZË E DOKUMENTEVE STRATEGJIKE TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Nënkolonel Msc. Eduart Pllaha

Qendra e Kontroll-Raportimit, Forca Ajrore

Trajesë e shkurtuar. *Rajoni ynë në dy shekujt e fundit ka vijuar të jetë një vatër e nxehtë e konflikteve etnike, fetare, politike, ideologjike dhe ushtarake. Ai është perceptuar në vazhdimësi si një zonë gri ku përplasen influenca të fuqive të ndryshme me synimin për ta parë këtë rajon si një dritare apo mundësi për të riafirmuar statusin e fuqisë, pasi ishte lëkundur në konflikte të tjera. Ngjarjet e fundit, kryesisht sulmi rus mbi Ukrainë ka ndryshuar përfundimisht rendin e sigurisë globale, i cili kishte marrë formë pas përfundimit të Luftës së Ftohtë. Ky rend i ri do të kërkojë konfigurime dhe marrëveshje të reja për sigurinë rajonale, si në rastin e fuqizimit të influencës së Perëndimit, duke përfshirë rajonin plotësisht nën ombrellën e institucioneve të sigurisë së saj (BE-së dhe NATO-s) apo do të njihet dhe si një rajon i influencës të vendeve të tjera (p.sh., Rusi, Kinë). Në të dyja rastet do të kërkoreshin rregullime të ndryshme ndaj vendeve të cilat do të duhet të integrohen në këto sfera influence. Kjo do të realizohej nën termin diplomatik "të rregullimit të marrëdhënieve", me qëllim ndarjen nga njëra zonë dhe përafrimin te tjetra. Këto dy hipoteza do t'i eksplorojmë/zhvillojmë nëpërmjet skenarëve, me qëllim që të shohim implikimet e tyre mbi sigurinë e RSH për të cilat dokumentet e Strategjisë të Sigurisë dhe Mbrojtjes duhet t'i marrin në konsideratë për t'i zvogëluar apo asnjënjësuar këta skenarë të cilët në vetvete janë dhe kërcënime për sigurinë kombëtare.*

Fjalët kyçe: rendi i ri i sigurisë, skenar gjeopolitik dhe gjeostrategjik, zonë influence, rregullim i marrëdhënieve, siguria kombëtare, kërcënime.

*“Predictions” lead to preparation. Preparation shapes actual future,
making conflicts we predict less likely...*

*“Parashikimet” çojnë në përgatitje. Përgatitja formon të ardhmen e afërt,
duke i bërë konfliktet që ne i parashikojmë më pak të mundshme...*

Hyrje

Rajoni ynë pas viteve 1990, në lidhje me sigurinë rajonale kaloi disa ngjarje kryesore, të cilat në këndvështrimin e sigurisë mund të quhen plotësisht si “gur kilometrik”. Këto ngjarje rivijëzuan plotësisht rendin e sigurisë rajonale pas rënies së Perdes të Hekurt. Vendet evropiane, të cilat ishin pjesë e sferës së influencës të ish-Bashkimit Sovjetik, do të përfshiheshin në dy shtyllat e sigurisë evropiane, atë të BE-së dhe NATO-s. Menjëherë filluan luftërat etnike në ish-Jugosllavi (Sllovenia, Kroacia dhe më pas Bosnjë-Hercegovina). Më pas u vazhdua me kryengritjen dhe çlirimin e Kosovës nga shtypja e forcave të sigurisë së Serbisë dhe këto luftëra u mbyllën me kryengritjen e faktorit shqiptar në Maqedoninë e Veriut për fitimin e të drejtave kushtetuese në këtë Republikë. Ngjarja e tretë, është pranimi i shteteve të rajonit në NATO. E katërta, është aneksimi i Gadishullit të Krimesë nga Rusia në vitin 2014. Ngjarjet që i paraprinë sulmit të Krimesë janë dhe riintensifikimi i politikës ruse për Evropën dhe kërkesa e saj për njohjen e “Sferave të Influencës” në vitin 2008¹ dhe mos zgjerimi i BE-së në Lindje për ta përfshirë atë në Zonën e saj të Influencës². Sulmi i Rusisë ndaj Ukrainës në vitin 2022 ndryshoi përfundimisht rendin e sigurisë në Evropë. Ky ndryshim i rendit të sigurisë në Rajon do të kërkojë dhe rregullime të ndryshme në Ballkanin Perëndimor për të rigjetur përsëri balancën e fuqisë.

1. Tronditja e vazhdueshme e rendit rajonal të sigurisë në këndvështrimin historik (skenarë të paracaktuar)

Është fakt se rajoni historikisht ka pasur mungesë stabiliteti dhe kriza të

¹ Kramer, Andrew E. “Russia Claims Its Sphere of Influence in the World”. The New York Times, USA, 2021.

² <https://www.britannica.com/topic/sphere-of-influence> “a country or area in which another country has power to affect developments...” or “In the field of international relations, a sphere of influence (SOI) is a spatial region or concept division over which a state or organization has a level of cultural, economic, military, or political exclusivity”

vazhdueshme, të cilat kanë pasur një intensitet të madh në shekujt XIX dhe XX, për të vazhduar më tej në shekullin XXI. Kryesisht në shekullin XX, një sërë konfliktesh, si: luftërat ballkanike, Lufta I Botërore, Lufta II Botërore, Lufta Civile, luftërat etnike në ish-Jugosllavi krijuan ndryshime të vazhdueshme të hartës së formacioneve politike pjesëmarrëse në këtë rajon. Konfliktet lanë një trashëgimi të vazhdueshme për këto vende për të gjetur zgjidhje apo mënyra për t'i zgjidhur ato, nëpërmjet bashkëpunimit më njëra-tjetrën apo edhe duke u përfshirë në aleanca rajonale dhe kontinentale, si dhe me fuqi evropiane. Vende si: Rusia, Franca, Anglia, Italia, etj., nëpërmjet shteteve ballkanike, kërkonin të projektonin forcën e tyre në rajon apo dhe më gjerë. Shumë iniciativa për sigurinë janë shfaqur nëpër dekada (aleanca, konferenca për paqe, traktate bashkëpunimi etj.) por nuk kanë arritur të realizojnë një stabilitet, pasi në këtë rajon ndërthuren shumë influenca dhe probleme qoftë etnike, fetare etj. Rajoni në shekuj është parë si një zonë gri në të cilën janë përplasur influenca të ndryshme qoftë të ardhura nga Perëndimi apo dhe Lindja, për të arritur objektivat e tyre, pasi pozicioni gjeografik i tij, midis Lindjes e Perëndimit, si dhe me Detin Mesdhe e realizon më së miri këtë gjë.

Shekulli XIX hapi portën për luftërat gjatë shekullit XX në rajon. Së pari, nëpërmjet Kongresit të Vjenës i cili vendosi bashkëpunimin e fuqive/vendeve evropiane dhe shmangien e konflikteve midis tyre. Nëpërmjet kësaj iniciative për sigurinë e tyre hapi mundësinë për të projektuar influencën e tyre në Ballkan, ku Perandoria Osmane nuk ishte pjesë e kësaj iniciative. Pa harruar dobësinë për zgjedhjen e problematikave, modernizimin, përqafimin e reformave të kohës për të bërë një vend modern në të cilin popujt e Ballkanit të ndiheshin pjesë e kësaj perandorie. Në dobësimin e kësaj ndikuan pak a shumë të gjitha fuqitë e kohës. Por produkti i kësaj politike agresive të fuqive evropiane ndaj Perandorisë Osmane ishte aneksimi i territoreve të ndryshme nga ajo, si p.sh., marrja e Bosnjës nga Austro-Hungaria, Qiproja nga Anglia, Krimea dhe Dobruxha nga Rusia, etj. Pas luftës së Krimesë (1856) dhe viteve 1887 me Kongresin e Berlinit, fuqitë perëndimore ranë dakord që etnitë në rajonin e Ballkanit të krijonin shtete të reja të pavarura e jo të pushtoheshin nga ndonjë fuqi tjetër si p.sh.: Rusia (përfshirë nën rasti i Greqisë e cila ishte një marrëveshje e fuqive Rusi-Francë-Angli). Ndaj dhe nën këtë politikë pas fitores së Rusisë (shpeshherë nën petkun e pan-sllavizmit) ndaj Turqisë u formuan shtetet e pavarura të Serbisë, Malit të Zi, Rumanisë, Bullgarisë. Por këto vende të cilat u formuan nën mbështetjen e fuqive mund të themi u bënë pothuajse plotësisht një vegël në duart e tyre për të projektuar influencën në rajon. Madje u formuan dhe formacione politike shtetërore si ish-Jugosllavia nga Franca më qëllim mbështetjen e politikës së tyre në kontinent duke bashkuar Rajone pa lidhje historike, politike, etnike dhe fetare. Për të arritur objektivat e tyre, vendet e këtij rajoni ndryshuan shumë herë aleancat apo dhe kahet në

pjesëmarrjen në teatrin e konflikteve rajonale dhe kontinentale. Trashëgimia e konflikteve të ndryshme mbeti një nga problematikat e vazhdueshme midis vendeve.

Një faktor tjetër i cili ndikoi shumë në rajon në shekujt XIX-XX ishte ardhja e ideve Iluministe me idenë kryesore, atë të shtetit komb, pas revolucionit francez. Kjo ide futi në rebelim dhe pakënaqësi shtetasit e etnive të ndryshme në rajon ndaj Perandorisë Turke, Austro-Hungareze dhe Angleze për arritjen e këtij ideali. Kjo dëshirë e etnive u mbështet fuqishëm nga perandoritë pasi ishin në konkurrencë me njëra-tjetrën për të bërë zonë të influencës së tyre ekonomike, sociale, fetare, kulturore etj.

Interesi i fuqive mbi Ballkanin ishte i ndryshëm por një aspekt i këtij interesi ishte mundësia për të parë këtë Rajon si një dritare apo mundësi për të riafirmuar statusin e fuqisë, pasi ishte lëkundur në konflikte të tjera. Rusia, pas humbjes poshtëruese në konfliktin e vitit 1905 me Japoninë, investoi shumë në resurse politike/etnike (pan sllavizmi), fetare (pan ortodoksia), njerëzore në Ballkan, për të riafirmuar fuqinë e saj apo dhe për ta përfshirë këtë rajon në sferën e saj të influencës. Gjithashtu, për marrjen e territoreve dhe daljes në detin Adriatik për të rivalizuar Austro-Hungarinë në Ballkan dhe Anglinë në Mesdhe. Por suksesi i saj në Ballkan gjatë shek. XIX dhe fillim shek. XX ishte minimal pasi ai ishte nën influencën e Austro-Hungarisë, Gjermanisë, Anglisë, por ajo kontribuoi në nisjen e L.IB. Gjithashtu, Austro-Hungaria, pasi humbi konfliktin me Prusinë (1866) dhe zonën e influencës mbi shtetet e tjera gjermanike, iu drejtua Ballkanit për të projektuar fuqinë e saj perandorake. Ndikimi ishte i shumanshëm, në fushën fetare, ekonomike, politike (deri në vitin 1905 Serbia ishte nën influencën e Habsburge³). Gjatë dekadës së parë dhe të dytë ajo pati një rol kryesor në frenimin e influencës ruse në Ballkan, të daljes së Serbisë në detin Adriatik, si dhe në formimin e Shqipërisë.

Pas përfundimit të L.IB. në rajon, rol parësor mori Franca, e cila për të realizuar politikën e saj evropiane kundër Gjermanisë, formoi shtetin e Jugosllavisë. Më pas me mbështetjen e Anglisë për të ruajtur *status quo*-në e vendosur nga Konferenca e Versajës, si dhe për të minimizuar Italinë në Mesdhe formoi “Antantën e Vogël” në vitin 1934 me vendet Ballkanike: Jugosllavi, Turqi, Rumani dhe Greqi. Në këtë iniciativë për sigurinë rajonale nuk u ftua Bullgaria dhe Shqipëria, e nga ky veprim i politikës së fuqive del qartë se rajoni ynë ishte ndarë në zona influence. Me fuqizimin e Gjermanisë dhe afrimin e konfliktit në Evropë, Shqipëria u pushtua nga Italia. Pushtimi i saj nuk u kundërshtua nga Franca dhe Anglia si një veprim flagrant i prishjes së sigurisë rajonale në shkëmbim të pasjes së Italinë në krahun e tyre.

³ K. Jirecek “Historia e Serbeve, Pjesa e dytë” Botuesi Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2010, f. 256.

Lufta II Botërore në Ballkan formoi dy zona të influencës, atë italiane dhe gjermane. Nën ndikimin e tyre u tentua rregullimi i konflikteve midis shteteve duke shkëmbyer apo aneksuar territore. Por pas humbjes së forcave të boshtit në Lindje dhe me ardhjen e trupave ruse në rajon, shtetet u çliruan nga ushtria e Kuqe (përveç Shqipërisë). Me trupat në terren, BS vazhdoi politikën për ta përfshirë komplet rajonin nën influencën e tij. Kjo gjë u njoh nëpërmjet marrëveshjes midis fuqive në Konferencën e Katërt të Moskës në vitin 1944, në të cilën Ballkani u nda në dy Zona Influence midis Perëndimit dhe Rusesë⁴ me qëllim legjitimimin e interesave të fuqive në rajon.

Pas përfundimit të L.II.B., vendet e rajonit u bënë pjesë e Luftë së Ftohtë të organizuar nga fuqitë jo evropiane, SHBA dhe BS, për të projektuar fuqitë e tyre pas L.II.B. Menjëherë nisi lufta civile në Greqi e cila ndodhi për arsye të konsolidimit të Zonave të Influencës. Ndërkohë në Shqipëri, Perëndimi nën drejtimin e Anglisë në fillim dhe më pas të SHBA-së, filloi inkursionet për të rrëzuar qeverinë e Tiranës. Tensioni u përshkallëzua më shumë me krijimin e blloqeve ushtarake të NATO-s dhe Traktatit të Varshavës. Vendi ynë pas largimit nga Traktati i Varshavës në vitin 1968 kontribuoi në formimin e të ashtuquajturës formati i sigurisë “2-2-2” (Turqi-Greqi me Perëndimin, Bullgari dhe Rumani me Lindjen dhe Shqipëri dhe Jugosllavi të paangazhuar). Nëpërmjet këtij formati u arrit një balancë e rendit të sigurisë rajonale.

Pas rënies të Perdes së Hekurt, vendet evropiane të cilat ishin pjesë e sferës së influencës të ish-Bashkimit Sovjetik do të përfshiheshin në dy shtyllat e sigurisë evropiane, atë të BE-së dhe NATO-s. Pjesë e kësaj politike ishin një sërë iniciativash rajonale, tryezash dhe formate sigurie për të formalizuar në këto vende influencën perëndimore, si dhe për të kodifikuar këtë ndarje të re të rajonit. Në vitin 1997, NATO dhe Rusia nënshkruan “Paktin e Marrëdhënieve të Përbashkëta, Bashkëpunimeve dhe Sigurisë”, me qëllim krijimin e hapësirës së Evropës, një hapësirë të sigurtë dhe të qëndrueshme pa ndarje në linja të Influencës...”. Gjatë luftërave etnike në ish-Jugosllavi, rajoni ishte nën ekskluzivitetin e NATO-s. Ndërsa BE nisi “procesin e Stabilizim - Asociimit” për vendet e rajonit, me qëllim afrimin e tyre me politikën e saj dhe me objektiv përfundimtar integrimin e plotë në Bashkimin Evropian. Këto veprime të BE-së u mbështetën edhe nga SHBA, e cila vazhdoi të luajë rolin kryesor në aspektin e sigurisë rajonale, duke investuar për të mbyllur luftërat etnike në Bonje-Hercegovinë, Kosovë dhe Maqedoni. Gjithashtu, NATO filloi zgjerimin duke pranuar në gjirin e saj vendet e rajonit.

Pas viteve 2000, në rajon filluan të kristalizohen influenca të tjera të vendeve si: Kina, Turqia dhe Rusia. Kjo e fundit nuk e kishte harruar Ballkanin si një

⁴ Weinberg, Gerhard (2005). A World In Arms A Global History of World War II. Cambridge: Cambridge University Press. f.167.

rajon ku mund të kundërshtonte Perëndimin si zonë të influencës së saj⁵. Lufta kundër terrorizmit dhe kriza ekonomike devijoi vëmendjen e SHBA-së ndaj rajonit. Ndërsa BE në rajon nuk pati sukses të madh në integrimin e tyre sidomos ndaj vatrave të tensionit në Kosovë dhe Bosnje-Hercegovinë. Ajo nuk u dha një perspektivë të qartë këtyre vendeve për integrimin e tyre në BE, duke e bërë këtë rajon përsëri një rajon gri të influencave të ndryshme dhe riaktivizimin e qarqeve nacionaliste.

2. Hipotezat e sigurisë në rajon

Ndryshimi i formatit të sigurisë rajonale filloi me Krizën Botërore të Ekonomisë (2008) dhe pas pushtimit të Krimesë nga forcat ruse në vitin 2014, perëndimi nën udhëheqjen e SHBA-së, ishte shumë i fokusuar në problemet e ekonomisë, ndërsa SHBA me konfliktet në Afganistan, Lindjen e Mesme dhe në Azi. Ndryshimi kryekëput i rendit të sigurisë globale ndodhi me sulmin e Federatës Ruse ndaj Ukrainës dhe pasojat e saj u ndjenë dhe do të ndihen në vitet e ardhshme, pasi vendet e rajonit do të rishikojnë të gjithë aspektin e sigurisë së tyre tashmë nën këndvështrimin e “Real Politikës”⁶. Këto ndryshime shkundën përfundimisht politikën e sigurisë euroatlantike dhe parashikimet optimiste pas Luftës së Ftohtë, e së bashku me atë dhe nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit: *“Palët bien dakord se një sulm i armatosur kundër një apo më shumë prej tyre në Evropë apo në Amerikën e Veriut do të quhet si sulm kundër të gjithë atyre...”*. Gjithashtu nën situatën e re gjeopolitike dhe gjeostrategjike u rizgjua neni 3 *“...do të ruajnë dhe zhvillojnë aftësinë e tyre individuale dhe kolektive për t’i bërë ballë sulmit të armatosur...”*. Për të reflektuar këto ndryshime nën dritën e re të rendit të sigurisë rajonale dhe globale, NATO u angazhua me Konceptin e ri Strategjik të miratuar në Madrid. Ndërsa vende joanëtare të NATO-s apo dhe nismave të tjera rajonale të sigurisë shprehën një gatishmëri për të arritur objektivat e tyre nëpërmjet intensifikimit të politikës, madje edhe nëpërmjet instrumenteve ushtarake duke cenuar hapur rendin e sigurisë rajonale. Pjesë e këtij diskursi të sigurisë është dhe riarmatimi i këtyre vendeve me armë dhe sisteme.

Nën dritën e ndryshimeve të sigurisë rajonale, duke marrë në konsideratë aspektin historik të rajonit i cili sipas fakteve të sipërcituara, mund të themi se është fakt që ai portretizohet si rajon i paqëndrueshëm, rajon i projektimit të fuqisë apo si zonë e kontestimit të influencave. Gjithashtu fuqitë përfshihen në këtë rajon pasi ka mundësi marrëveshje shkëmbimi të tij për një rajon tjetër midis tyre. Vendet e Ballkanit Perëndimor nuk kanë bërë asnjë përparim për

⁵ John Radcliffe “To Maintain Spheres of Influence, U.S. Must Engage”, 2016; <https://mwi.usma.edu/maintain-spheres-influence-u-s-must-engage>

⁶ “Politics based on practical and material factors rather than on theoretical or ethical objectives” <https://www.merriam-webster.com/dictionary/realpolitik>

përfshirje në institucionet e BE-së madje janë në stacion dhe pa udhërrëfyes. Në bazë të këtyre fakteve do të formulojmë dy hipoteza të mundshme, me qëllim perifrazimin e skenarëve (nën këto hipoteza) për sigurinë e RSH-së:

a. Largimi i Perëndimit (SHBA/BE) nga rajoni dhe njohja e influencave të vendeve të tjera dhe pasojat që do të sillte kjo njohje ndaj arritjeve të kombit shqiptar.

b. Rajoni do të jetë plotësisht nën influencën e Perëndimit, nëpërmjet marrëveshjeve politike do të kompensohen vende të cilat do të detyrohen të largohen nga influencat e tjera si Serbia.

3. Skenarët e sigurisë

3.1. Largimi i Perëndimit (SHBA/BE) nga rajoni dhe njohja e influencave të vendeve të tjera dhe pasojat që do të sillte kjo njohje ndaj arritjeve të kombit shqiptar.

Sa më sipër, rajoni ynë vazhdon të dominohet nga problematika të ndryshme politike, fetare, ekonomike dhe të influencave nga fuqi të ndryshme. Rajoni kaloi destabilitet të vazhdueshëm të sigurisë dhe u bë pjesë e luftërave botërore dhe atyre etnike. Pas L. II B. ndikimi i Rosisë u arrit në sajë të marrëveshjes në të cilën kryesisht u njoh Ballkani si zonë e Influençës ruse. Rënia e Perdes së Hekurt e cila u realizua me marrëveshje për bashkimin e Gjermanisë dhe shpërbërjen e Traktatit të Varshavës (1991) solli një përfshirje të Perëndimit nën drejtimin e SHBA-së për integrimin e këtyre vendeve në dy shtyllat e sigurisë evropiane (NATO dhe BE) për rregullimin përsëri të balancës së sigurisë. Perëndimi nëpërmjet mjeteve diplomatike, ekonomike dhe ushtarake (Bosnje-Hercegovinë dhe Kosovë) krijoi influencën e tij mbi këtë rajon pothuaj të padiskutueshme. Pas vitit 2001, SHBA u përqendrua në luftën kundër terrorizmit, më pas në Lindjen e Mesme dhe në Azi. Ndërsa BE-ja, e cila kishte ambicie për afirmim si fuqi, krijoi udhërrëfyes politikë për përfshirjen e vendeve të rajonit në union (Samiti i Selanikut 2003⁷), por nuk ia arriti ta realizojë këtë qëllim. Pas krizës ekonomike botërore (vendet perëndimore e ndjenë më shumë) në rajon u rikthyen idetë e vjetra, të influencimit të fuqive të tjera si: Rusia, Kina dhe Turqia.

Perëndimi tregoi dobësi në aspektin e sigurisë dhe shtoi burokracinë për afrimin e tyre në BE. Madje u arrit të diskutohej tërheqja e trupave paqeruajtës nga Bosnje-Hercegovina dhe Kosova. Në këtë të fundit impakt pati ideja e diskutuar nga administrata e SHBA-së gjatë presidencës së D. Trump⁸ për

⁷ <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku> ; “miratoi procesin e Stabilizim-Asociimit, duke konfirmuar kështu perspektivën e anëtarësimit në BE të vendeve të Ballkanit Perëndimor”

⁸ <https://www.botasot.info/aktuale-lajme/1250951/djali-i-donald-trump-ben-thirrje-per-terheqjen-e-trupave-amerikane-kosova/>

tërheqjen e trupave ushtarake, e më pas këtë ide e morën dhe vende të tjera për tërheqjen nga Kosova. Ky diskutim (tërheqja nga Kosova) dhe tërheqja e shpejtë e pakoordinuar e SHBA-së dhe aleatëve të tjerë nga Afganistani solli një entuziazëm në qarqe nacionaliste në Serbi se kjo do të ndodhte edhe në Kosovë⁹. Vende të tjera të interesuara drejtpërdrejt në arritjen e objektivave të tyre, si dhe kontestimin e fuqisë së Perëndimit në këtë rajon vazhduan të influenconin në dy vatrat e nxehta, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë për destabilizim.

Gjatë viteve të fundit, vendet e Ballkani Perëndimor nuk ka bërë asnjë hap drejt afrimit me BE-në, kryesisht për shkak të politikës bllokuese të disa vendeve të BE-së, madje Kosovës i është kërkuar të bëjë marrëveshje me Serbinë nëpërmjet të cilës do të humbasë shumë nga sovraniteti i saj; Maqedonisë së Veriut marrëveshje në fillim me Greqinë dhe më pas me Bullgarinë, ndërsa Serbia intensifikoi politikën e saj ndaj Rajonit, duke investuar në destabilizimin apo dhe mbajtjen hapur të tensioneve etnike dhe fetare në Bosnje, Mal të Zi dhe Kosovë. Pjesë e intensifikimit të politikës provokuese të Serbisë është dhe modernizimi i ushtrisë serbe me pajisje moderne, si: sisteme kundërajrore dhe UAV nga Kina, tanke, autobлиндë, avionë Mig 29 nga Rusia, helikopterë sulmi nga Gjermania, raketa kundërajrore nga Franca dhe në javët e fundit dhe diskutimin për blerjen e avionëve reaktivë (12 copë) të tipit “Rafaele”, po nga ky shtet. Theksojmë se forcimi i arsenalit të ushtrisë serbe po realizohet në mungesë të plotë të ndonjë kërcënimi. Këto kontrata blerje, mesa duket kanë për qëllim marrjen dhe mbështetjen politike të vendeve prodhuese të këtyre sistemeve ndaj çështjeve politike të hapura për të cilat Serbia po investohet politikisht në Ballkanin Perëndimor kryesisht ndaj Kosovës. E nuk është për të habitur se Kosova nuk ka përparuar në afrimin me BE-në apo dhe liberalizimin e vizave. Gjithashtu, nëpërmjet modernizimit të ushtrisë dhe reklamimit masivisht të tyre në media dhe përdorimit të një diskursi kërcënues duke mobilizuar ushtrinë në kufi¹⁰ ndaj Kosovës, Serbia ka për qëllim dhe cenimin e mbështetjes popullore ndaj qeverive dhe elitave drejtuese¹¹ të vendeve të Ballkanit Perëndimor. Ndërsa Perëndimi nuk ka arritur ta pengojë këtë politikë destabilizuese të Serbisë.

Ngjarjet e fundit të sigurisë globale, kryesisht ato në Ukrainë, të cilat ndryshuan rendin e sigurisë globale, në Serbi dhe në qarqe të tjera pro-ruse në rajon u morën si një tendencë e pakthyeshme e rënies dhe dobësimit të

⁹ <https://www.dw.com/sq/fantazi-serbe-p%C3%ABr-largimin-e-shba-nga-kosova/a-59060495/>; “Tërheqja e menjëhershme e SHBA nga Afganistani ka bërë që madje disa politikanë qeveritarë të fantazojnë për një tërheqje të mundshme të fuqisë së padëshiruar botërore edhe nga Kosova”

¹⁰ Daniel Serwer “Serbia mund të provojë të kopjojë librin e lojës ruse në Kosovë”, 05.06.2022

¹¹ Ch. Brose “The Kill Chain: Defending America in the Future of High-Tech Warfare” USA, 2020, fq 55.

SHBA-së dhe BE-së, si dhe fuqizimit të influencës ruse në rajon dhe në botë. SHBA aktualisht është duke ridimensionuar politikën e saj botërore nga njëpolare¹² nën ndikimin e saj shumëpolare, pasi nuk mund të mbajë një zonë influence të pa kontestuar në rajon dhe në botë. Këtë tërheqje nga rajoni ynë me shumë gjasa do ta plotësojnë Rusia dhe vende të tjera të interesuara. Në kushte hipotetike, Rusia do të vazhdojë zgjerimin e influencës (dhe ajo do të ishte me intensitet të madh nëse do të kishte fituar në Ukrainë pa kosto të madhe politike, ushtarake, strategjike) duke mos respektuar dhe rregullat ndërkombëtare (Traktati i Vefalisë për mosndërrhyrje në punën e brendshme të shteteve dhe njohjen e sovranitetit të vendeve përkatëse). Rajoni ynë do të ishte i ekspozuar drejtpërdrejt nga kjo ndërhyrje. SHBA do të ishte e fokusuar në Azi ku të gjithë tendencat tregojnë një fokusim më të madh për t'u përqendruar në atë Rajon. Nën dështimet e vazhdueshme të BE-së dhe nevoja për të ekonomizuar resurset do të kishte pak gjasa të vazhdonte të investohej për ruajtjen e sferës së influencës të pakontestueshme në dy kontinente¹³, kundër një Rusie e cila do ishte fuqizuar shumë me fitoren/paqen mbi Ukrainën, si dhe nëpërmjet aleancës me Kinën. Një mosmarrje e përgjegjësive të vendeve evropiane për gjithë kontinentin për shkak të ndarjeve të politikës së tyre do sillte një marrëveshje midis SHBA-s dhe Rusisë me qëllim zvogëlimin e mbështetjes së kësaj të fundit ndaj Kinës në Azi, si dhe për mosavancimin e saj ndaj vendeve të tjera të Evropës si p.sh., Moldavi, Baltik, Finlandë etj. Kjo politikë pragmatiste e fuqive nuk do të ishte gjë e re pasi kemi shembuj nga historia si p.sh., Anglia me Rusinë pas L. II B.¹⁴, SHBA me Kinën në vitet 1970, tërheqja nga Afganistani pas një marrëveshjeje të SHBA-së me talebanët, etj. Në SHBA, ithtarë me profil të rëndësishëm politik mbështesin një marrëveshjeje me Rusinë me qëllim përqendrimin e vëmendjes dhe resurseve të saj ndaj Kinës, si p.sh., ish-sekretari i shtetit H. Kissinger i cili shprehet për dorëzim territori nga Ukraina për Rusinë¹⁵. E kjo gjë si një mënyrë kompensimi të kësaj të fundit për humbjen në Ukrainë apo dhe në Evropën Lindore. Po këta ithtarë janë shprehur më parë dhe kundër ndërhyrjes të NATO-s në Kosovë¹⁶ dhe për njohjen e sovranitetit të Serbisë në Kosovë. Gjithashtu edhe në Gjermani do të

¹² John Radcliffe "To Maintain Spheres of Influence, U.S. Must Engage" 2016 "The U.S. cannot view the world over as its own sphere-of-influence. Today, the U.S. seeks UN approval; without it, American politicians seek NATO support"

¹³ Po aty "U.S. military barely possesses the capability to pivot to the Pacific while maintaining an effective presence in the Middle East. Adding major new requirements in Europe will stretch the American military past its limits to a breaking point".

¹⁴ Weinberg, Gerhard (2005). "A World In Arms A Global History of World War II". Cambridge: Cambridge University Press. f.167

¹⁵ Gazeta Washington Post, 2022 <https://www.washingtonpost.com/world/2022/05/24/henry-kissinger-ukraine-russia-territory>

¹⁶ Henry Kissinger "Does America need Foreign Policy" Simon&Schuster, New York 2001.

ketë një rishikim të politikës së jashtme në përgjithësi dhe kundrejt Ballkanit Perëndimor pas largimit të kancelares Merkel¹⁷, e cila ndikoi për rreth 15 vjet në politikën e Gjermanisë dhe BE-së ndaj rajonit dhe Rusisë.

Pas një analize të gjithanshme mund të themi se do të shkohej drejt një marrëveshje për një ndarje të re gjeostrategjike të rajonit në dy *Zona Influence*, të Rusisë dhe atë të Perëndimit. Ballkani Perëndimor me aksin kryesor Sarajevë - Prishtinë do të përfshihej nën influencën ruse dhe kjo e fundit do njihte influencën e SHBA-së në pjesën tjetër të rajonit e të Evropës. Ndërsa një BE e lidhur fort në interesat e saj ekonomike dhe e varur nga energjia ruse dhe e dobët në aspektin e instrumenteve të unifikuara të sigurisë, do të shkonte drejt një marrëveshjeje me Rusinë për të ruajtur anëtarët e rinj të Bashkimit Evropian: Kroaci, Rumani dhe Bullgari. Madje dhe formatet e reja të propozuara nga politika franceze për afrimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor, shumëkush nga njohësit e politikës ndërkombëtare e quajnë si një njohje të interesave ruse në rajon (me apo dhe pa marrëveshje).

Diapazoni i marrëveshjes në terma maksimalë supozojmë do të ishte: një Ballkan Perëndimor nën influencën ruse (pa Shqipërinë). Rusia do ta forconte këtë influencë duke krijuar Federatën e Serbisë me anëtarë Malin e Zi dhe Kosovën. Serbia do të arrinte ëndrrën e saj historike për dalje në det nën krijimin e Federatës së re. Pjesë e kësaj do të ishte edhe largimi i KFOR-it nga Kosova pas një marrëveshje Kosovë-Serbi në emër të ashtuquajturës “Normalizim i Marrëdhënieve”. Ndërsa vendet si Bosnje-Hercegovina dhe Maqedonia e Veriut do të ishin nën influencën ruse por jashtë kësaj Federate. Kjo gjë do të kërkohej nga Kroacia dhe Greqia me qëllim krijimin e një zone “sfungjer” midis tyre dhe Serbisë. Kjo kërkesë e Greqisë dhe Kroacisë do të mbështetej nga Perëndimi për krijimin e kësaj hapësire “sfungjer” midis BE-së dhe influencës ruse në rajon.

Gjithashtu Rusia do të ndërtonte një bazë detare në Adriatik. Kjo marrëveshje do të ishte e ngjashme nga historia me të ashtuquajturën “Vija e Teodosit”, në të cilën Evropa u nda në dy pjesë në kufirin Gjiri i Kotorrit (Mali i Zi) në Budapest (Hungari). Ndërsa në terma minimalë supozojmë se aksi Sarajevë - Prishtinë - Beograd nën influencën ruse. Por do të kishte dhe rregullime të tjera për të shpërblyer Serbinë si aleatja e Rusisë në rajon. Vendet e tjera të Ballkanit do të vazhdonin të ishin nën orbitën e Perëndimit¹⁸.

¹⁷ Europeans may have begun to lose their long-held aversion to what German Chancellor Angela Merkel calls “old thinking about spheres of influence”. https://ecfr.eu/article/commentary_spheres_of_influence_eu_external_security/

¹⁸ Në aspektin e këtij skenari: NATO ekziston dhe nuk do të zgjerohet më shumë ose Mali i Zi do të tërhiqej me kërkesë të saj.

3.2. Rajoni do të jetë plotësisht nën influencën e Perëndimit, por nëpërmjet marrëveshjeve politike do të kompensohen vende të cilat do të detyrohen të largohen nga influencat e tjera si p.sh. (Serbia).

Pas sulmit të Rusisë ndaj Ukrainës, rendi i sigurisë globale ndryshoi plotësisht dhe nën këtë fakt vendet e Perëndimit u rreshtuan në krahun e Ukrainës duke e ndihmuar atë për t'i rezistuar dhe për të vazhduar luftën ndaj agresionit. Ky sulm alarmoi qarqet e Perëndimit tashmë nën shqetësimin për sigurinë evropiane, të cilat duket se lanë mënjanë kundërshtitë dhe filluan të marrin hapa për unifikimin e qëndrimit për këto çështje. Në një kohë të shkurtër vendet të cilat hezitonin të përfshiheshin në këtë aleancë, si: Finlanda dhe Suedia kërkuan të përfshihen në NATO, nën shqetësimet për sigurinë e tyre. Gjithashtu, Gjermania e cila hezitonte të shtonte kontributin financiar dhe të merrte përgjegjësi për sigurinë evropiane ndryshoi qëndrim dhe sipas fakteve që kemi në dispozicion do të bëhet kontribuuesja kryesore e sigurisë në Evropë (bashkë me Francën). Ajo do të ushtrojë ndikim në unifikimin e një zëri për çështjet e politikës së jashtme dhe të sigurisë evropiane. E njëjta gjë ndodh dhe me vendet e tjera të BE-së dhe NATO-s të cilat rritën dhe do të rrisin shpenzimet ushtarake, si dhe do të anashkalojnë ndasitë midis tyre. Rusia e cila pas humbjes në Ukrainë do të ndryshonte politikën e jashtme dhe të sigurisë ndaj Evropës, do të pranonte një marrëveshje e cila do ta mbante larg influencën dhe instrumentet e tjera të saj nga Evropa. Rajoni ynë do të avanconte drejt integritetit të BE-së, SHBA do të vazhdonte të mbante një prezencë relativisht të konsiderueshme ushtarake për të ruajtur influencën e saj në rajon. Kjo tërheqje e Rusisë nga kontinenti ka ndodhur dhe në periudha të tjera si p.sh., pas L.IB. dhe pas viteve 1990 me përfundimin e Luftës së Ftohtë.

Pas këtyre ngjarjeve politike mund të themi se rajoni do të ishte nën influencën e Perëndimit. Por kjo influencë do të ofronte “terma marrëveshjeje” për vendet të cilat kanë mbajtur marrëdhënie të afërta me Rusinë në aspektin e sigurisë dhe të politikës. Këto vende (kryesisht Serbia) me qëllim braktisjen e politikës së tyre aktuale dhe mosafrimin me ndonjë fuqi tjetër të interesuar për të kontestuar apo për ta pasur një rajonin gri të influencave, do të kompensoheshin nëpërmjet përpjekjeve diplomatike të Perëndimit në aspekte të tjera me qëllim përafrimin e politikës së tyre me të BE-së. Në Perëndim do të kishte ithtarë për këtë marrëveshje kompensimi me qëllim përafrimin dhe integrimin e Serbisë në institucionet e Evropës. Vendi më i gatshëm për ta mbështetur këtë lloj marrëveshjeje do të ishte Franca e cila historikisht e ka mbështetur atë. E kjo mbështetje do të vinte dhe nëpërmjet lobimit të korporatave të cilat kanë apo do të kenë marrëveshje të mira në fushën e sigurisë (blerja e raketave kundërajrore dhe avionëve Rafaele, etj.) në Serbi. Formatet e propozuara apo dhe të kërkuara nga qarqe në Evropë dhe në SHBA

do të ishin kryesisht një afrim apo dhe një integrim në mënyrë të ndryshme drejt BE-së dhe NATO-s por ajo më kryesorja do të ishte se fuqi të tjera nuk do të kishin mundësi të influencenin apo ta shikonin si një zonë kontestimi rajonin e Ballkanit Perëndimor.

Marrëveshja për një ndarje të re gjeostrategjike dhe gjeopolitike në Ballkanin Perëndimor me shumë gjasa do të ishte në aksin kryesor “Sarajevë - Prishtinë”. Ky aks i cili nuk është stabilizuar plotësisht, do të ofronte mundësi të mira për të arritur marrëveshje kompensimi ndaj Serbisë më qëllim heqjen dorë nga politika e afërt ekonomike, politike dhe ushtarake me Rusinë apo me fuqi të tjera. Diapazoni i marrëveshjes në terma maksimale supozojmë do të ishte: një Ballkan Perëndimor i integruar në NATO dhe në BE nën influencën e Perëndimit. Serbia do të kompensohej në Bonjë-Hercegovinë dhe në Kosovë në emër të “Normalizimit të Marrëdhënieve”. Ky kompensim mund të ofrohej nëpërmjet modeleve të “Asosacioneve” apo dhe të njohjes së sovranitetit mbi zonat e banuara me serbë. Pjesë e diskutimeve mund të ishte dhe rregullimi i kufijve me formën e shkëmbimit apo aneksimit. Kjo marrëveshje do të reklamohej në terma diplomatikë me qëllim neutralizimin e elementeve radikale dhe ndryshimit të kushtetutës në Serbi. Pjesë e “Normalizimit të Marrëdhënieve” do të ishte dhe largimi i KFOR-it nga Kosova, pas një marrëveshjeje Kosovë-Serbi. E kjo e fundit ndoshta nuk do të ndodhte në një distancë të afërt kohore. Ndërsa në terma minimale supozojmë se aksi Sarajevë - Prishtinë do të ishte plotësisht nën influencën e Perëndimit e cila politikisht do të neutralizonte faktorët irredentistë dhe nacionalistë në rajon. Serbia do të kompensohej politikisht në formimin e një “Asosacioni i Komunave Serbe” në Kosovë por me kompetenca ekzekutive.

Përfundime

Sipas këtyre skenarëve, kombi shqiptar do të ishte i pari i cili do të humbiste më shumë nga arritjet e tij historike në dekadat e fundit me pavarësinë e Kosovës, fitoren e popullatës shqiptare në Maqedoninë e Veriut si faktor shtetformues dhe të drejtave në Malin e Zi, të kësaj popullsie. Mëkëmbësja e politikës së Rusisë në rajon do të ishte përfituesja e parë e cila ka mbajtur marrëdhënie të afërta me atë, pasi do të ishte normale në termat e politikës realiste që përveç arritjes së objektivave të saj, Rusia do të mbështesë edhe objektivat e Serbisë në Kosovë dhe në rajon. Gjithashtu, në skenarin e dytë me orientimin e saj të plotë ndaj Perëndimit dhe shkëputjes nga politika bashkëpunuese me Rusinë, do t'i ofroheshin terma lëshimi për atë në boshtin “Sarajevë - Prishtinë”. Në konsideratë duhet të kemi edhe skenarin më të keq atë të largimit të SHBA-së, mosfuqizimit të BE-së në aspektin e sigurisë, largimin e KFOR-it, si dhe kërkesën e Serbisë për të hyrë me trupa në Kosovë sipas rezolutës 1244 të OKB-së. Në qarqet në Serbi pas largimit të KFOR-it nga Kosova ose dhe në

rastet kur ajo do të ishte minimale, nën pretekstin e gjenocidit të popullsisë serbe në Kosovë do të bënte mobilizimin e ushtrisë dhe ndërhyrjen në Veri të Kosovës duke marrë shembull sulmin e Rusisë në Ukrainë.

Këta skenarë në të cilët do të kishte terma koncesioni ndaj Serbisë në kurriz të Kosovës do të ishte një vdekje politike e shtetit të Kosovës, pasi ai do të bëhej një shtet jofunksional dhe do të ishte një vatër e hapur e konflikteve fetare, etnike në rajon dhe e kërcënimit të rendit të sigurisë së rajonit. Këto shqetësime të sigurisë të dala nga këta skenarë duhet të përfshihen në hartimin e dokumenteve të sigurisë kombëtare të shtetit Shqiptar dhe atij të Kosovës. Nëpërmjet adresimit të këtyre shqetësimeve do të kishte mundësi të merreshin masa nëpërmjet fuqisë kombëtare për adresimin e tyre dhe mosinkurajimin e faktorëve të tjerë rajonalë apo edhe fuqive për realizimin e këtyre skenarëve.

Bibliografia

1. Kramer, Andrew E. "Russia Claims Its Sphere of Influence in the World". New York Times, SHBA, 2021.
2. K. Jirecek, " Historia e serbëve", pjesa e dytë, Shtëpia Botuese 55, Tiranë, 2010.
3. W. Gerhard, "A World In Arms A Global History of World War II", Cambridge Press, UK, 2005.
4. Radcliffe, John, "To Maintain Spheres of Influence, U.S. Must Engage", 2016.
5. Ch. Brose, " The Kill Chain: Defending America in the Future of High-Tech Warfare" SHBA, 2020.
6. Kissinger, Henry, "Does America need Foreign Policy "Simon&Schuster, New York 2001.
7. Serwer, Daniel, "Serbia mund të provojë të kopjojë librin e lojës ruse në Kosovë", Gazeta Tema, 05.06.2022. <https://www.gazetatema.net/rajoni/serbia-mund-te-provoje-te-kopjoje-librin-e-lojes-ruse-ne-kosove-i341592>
8. <http://integrimi-ne-be.punetegashtme.gov.al/anetaresimi-ne-be/historiku/>
9. <https://www.botasot.info/aktuale-lajme/1250951/djali-i-donald-trump-ben-thirrje-per-terheqjen-e-trupave-amerikane-nga-kosova-koha-qe-ushtaret-te-kthehen-ne-shtepi/>
10. <https://www.dw.com/sq/fantazi-serbe-p%C3%ABr-largimin-e-shba-nga-kosova/a-59060495>
11. https://ecfr.eu/article/commentary_spheres_of_influence_eu_external_security/
12. <https://www.washingtonpost.com/world/2022/05/24/henry-kissinger-ukraine>

REFLEKTIME DHE DALLIME MIDIS KONCEPTIT STRATEGJIK TË NATO-s, MADRID 2022 DHE ATIJ NË LISBONË 2010

Gjeneral Brigade (R) Msc. Muhamet Buçpapa
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Trendi dhe qasja e konceptit strategjik të NATO-s fokusohet në zhvillimet më të reja që ky koncept po përballlet ndaj ndryshimeve dhe dinamikës së mjedisit të ri të sigurisë në zonën euroatlantike në nivel global. Ndryshimet, të cilat shoqërojnë gjithë kontekstin e konceptit të ri të aleancës 2022 që nga synimi dhe parimet, detyrat themelore, siguria bashkëpunuese, analiza e natyrës së re të rreziqeve, kërcënimeve veçanërisht atyre hibride, zhvillimeve teknologjike dhe deri te ndryshimet klimaterike, do të përbëjnë një axhendë të ngarkuar dhe plot sfida për të, në një të ardhme të afërt e më gjatë.

Kohezioni, bashkëpunimi, ndërveprimi me njëri-tjetrin i të gjithë aktoreve me rëndësi duhet të prevalojnë zhvillimet, angazhimet dhe reagimet e duhura dhe efektive parandaluese, shkurajuese dhe mbrojtëse të Aleancës në interes të paqes dhe sigurisë euroatlantike. Karakteri i saj mbrojtës mbetet shtyllë kryesore e miratuar në Madrid këtë vit. Koncepti pasqyron vizionin dhe direktivën se ku duhet të shkojë Aleanca 2030.

Në thelb, koncepti strategjik i NATO-s rithekson angazhimin për mbrojtjen kolektive, prosperitetin e vendeve anëtare në veçanti, duke u mbështetur në parimin se cenimi i sigurisë së sovranitetit apo integritetit të njërit prej anëtarëve të saj është i barasvlershëm për të gjithë.

Fjalë kyçe: koncept strategjik, samit, aleancë, NATO, siguri, sfida.

Hyrje

Ky punim sjell në vëmendje të rejat që ofron “Koncepti Strategjik i NATO-s, Madrid 2022” në ndryshimet, përshtatjet apo qasjet e reja të aleancës mbi një analizë të thelluar të rreziqeve, kërcënimeve hibride, ruajtjen e avantazheve teknologjike në vorbullën e një konkurrence strategjike të fuqive kryesore, e sidomos asaj ruse-kineze dhe aleatëve të tyre, terrorizmit, luftës kibernetike, dimensionit të ri të mjedisit të sigurisë, atij hapësinor, ngrohjes globale, sigurisë njerëzore, mbrojtjes së grave, pakicave etj.

Shkrimi konsiston në disa trajtesa të përmbledhura e të shqyrtuara me kujdes si çështje me prioritet duke filluar me një vështrim të shkurtër historik të zhvillimit të koncepteve të NATO-s në situata të ndryshme të cilat në tërësi kanë pasur njëfarë përngjashmërie por jo rrallë me ndryshime të dukshme.

Në këtë këndvështrim, mendoj se koncepti i NATO-s, pavarësisht ndryshimeve, rritjes zhvillimit dhe modernizimit në tërësi të organizatës, i ka ruajtur vazhdimisht parimet dhe normat thelbësore të saj, si një organizëm politiko-ushtarak me karakter mbrojtës të paqes, sigurisë dhe prosperitetit të shoqërive dhe shteteve demokratike anëtare të saj. Vizioni e saj mbrojtës dhe bashkëpunues ka si shtyllë kurrizore Artikullin 5 të Traktatit të Atlantikut të Veriut, Uashington 4 prill 1949.¹

Duke analizuar disa karakteristika të përafërta të mjedisit të sigurisë dhe njëkohësisht një metodologji që lehtëson njohjen dhe studimin e zhvillimit të Aleancës së Atlantikut të Veriut për një periudhë rreth 73-vjeçare mund të dalim në përfundimin se ajo ka kaluar nëpër katër etapa kryesore zhvillimi dhe transformimi.

Më në brendësi trajtohen prurjet, qëndrimet apo të rejat e Konceptit të ri të NATO-s 2022, i cili dallon nga koncepti i mëparshëm i Lisbonës 2010, pasi vlerësohen në një qasje ndryshe koncepti i rrezikut të një sulmi konvencional, përcaktimi i Rusisë si një kërcënim i rëndësishëm dhe i drejtpërdrejtë për aleancën, dalja në pah dhe ngritja e Kinës si fuqi e madhe, sfidat në fushën teknologjike, si një dimension i ri i mjedisit të sigurisë.

¹ Artikulli 5 të Traktatit i Atlantikut Veriut , Uashington 4 prill 1949

Së fundmi por jo nga rëndësia, mbetet qasja jonë pro aktive për të avancuar me tej angazhimin tonë kombëtar në kuadër të kontributit real në përafrimin, përshtatjen dhe përqasjen me konceptin e ri të NATO-s 2022, në procesin e sigurisë dhe mbrojtjes, reformimin, rritjen, zhvillimin dhe angazhimin e kapaciteteve tona ushtarake dhe jo vetëm, për realizimin e detyrimeve kombëtare dhe atyre në kuadër të Aleancës së Atlantikut të Veriut.

1. Një vështrim i shkurtër historik i zhvillimit të konceptit strategjik të NATO-s nga viti i krijimit 1949 deri në samitin e Madridit 2022

Aleanca e Atlantikut të Veriut (NATO) që nga themelimi në prill të vitit 1949 e deri në ditët e sotme ka kaluar nëpërmjet sfidash të shumta e të ndërlikuara të imponuara nga ndryshimet dinamike dhe shpesh të paparashikuara të mjedisit të sigurisë, përmes një procesi të vazhdueshëm reformues, transformues e modernizues duke u rritur e zgjeruar në përshtatje me realitetin e ri të zhvillimeve shoqërore shumëdimensionale.

Pavarësisht ndryshimeve, rritjes, zhvillimit dhe modernizimit në tërësi të organizatës ajo vazhdimisht ruajti synimet parimet dhe normat përmbajtësose thelbësore të saj si një organizëm politiko-ushtarak me karakter mbrojtës të paqes, sigurisë dhe prosperitetit të shoqërive dhe shteteve demokratike anëtarë të saj. Vizioni mbrojtës dhe bashkëpunues ka si shtyllë kurrizore Artikullin 5 të Traktatit të Uashingtonit, prill 1949 që siguron në thelb mbrojtjen kolektive të vendeve anëtare të Aleancës.

Duke u përpjekur të sjellim karakteristikat kryesore të etapave nëpërmjet të cilave është transformuar zhvilluar e përshtatur NATO si një organizëm politiko-ushtarak i qenësishëm dhe gjithëpërfshirës duhet të analizojmë rrethanat dhe mjedisin e sigurisë ku ajo u krijua u rrit dhe u transformua.

Zhvillimet në NATO janë diktuar nga varësia e ndryshimeve dhe sfidave që ka imponuar mjedisi rajonal dhe ai global për mbrojtjen dhe sigurinë, ndryshimet gjeopolitike dhe zhvillimet e brendshme apo të jashtme të vendeve anëtare të saj. Aktualisht konkurrenca strategjike e fuqive të rendit të parë apo siç mund ti vlerësojmë ndryshe fuqitë kryesore globale, të ushqyera e ndërthurura jo rrallë me konfliktet e tjera të karakterit lokal e rajonale nga aktorë shtetëror por edhe jo shtetërorë që kanë ardhur duke u theksuar vitet e fundit dhe që kulmoi me sulmin e paprovokuar dhe pajustificuar rus mbi shtetin e pavarur dhe sovran të Ukrainës.

Ndryshimeve gjeopolitike të mjedisit të sigurisë mund t'u shtojmë sot edhe ndryshimet klimaterike, zhvillimet teknologjike, terrorizmin kibernetik, rrezikun nga armët e dëmtimit në masë, deri te mungesat apo kufizimet e burimeve jetësore si: uji, energjia apo ndërprerja e zinxhirit të furnizimit

ushqimor. Këto pasoja katastrofike po shihen sidomos në këtë kohë kur Rusia po përdor furnizimin me energji si armë për presion ndaj vendeve perëndimore dhe bllokimin e importeve të drithërave ukrainase, drejt vendeve të tjera dhe veçmas atyre afrikane, ku nevojat janë me të domosdoshme. Duke analizuar aktorët kryesorë që kanë ndikuar në mjedisin e sigurisë këto 73 vitet e fundit, do të përpiqemi që të analizojmë këtë proces transformimi, rritje e modernizimi, nisur nga disa karakteristika specifike që mendoj se ka kaluar në katër etapa kryesore:

- Etapa e parë, gjatë Luftës së Ftohtë.
- Etapa e dytë, pas rënies së murit të Berlinit.
- Etapa e tretë, pas sulmeve të 11 shtatorit 2001 ndaj SHBA-së.
- Etapa e katërt, pas agresionit rus ndaj Ukrainës.

Etapa parë, përfshin zhvillimet në epokën e Luftës së Ftohtë. Koncepti strategjik gjatë kësaj periudhe trajtohej më tepër nga fryma ushtarake, mbi rregulla strikte dhe të mbyllura, për shkak se mjedisi i sigurisë formësohej nga dy blloqe kryesore: ai komunist apo lindor, i përfaqësuar nga ish-Bashkimi Sovjetik dhe ai Perëndimor i udhëhequr nga SHBA. Një epokë e karakterizuar nga konkurrenca e ashpër në shumë fusha, por kryesisht e implikuar nga ballafaqimi ushtarak dhe gara e shfrenuar e armatimit, duke shtuar kështu tensione të vazhdueshme mes Lindjes e Perëndimit. Nga ana tjetër, ky ballafaqim shërbeu edhe si një mekanizëm për ruajtjen e balancës e të sigurisë, për një paqe më të gjatë e të qëndrueshme në kontinentin Evropian e më gjerë.

Etapa e dytë, përfshin zhvillimet pas rënies së murit të Berlinit dhe shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik deri në sulmet terroriste të 11 shtatorit në SHBA. Kjo periudhë u karakterizua nga një farë shtensionimi të marrëdhënieve dhe të një fryme të re bashkëpunimi, midis lindjes dhe perëndimit e veçmas me Federatën Ruse, por edhe me Kinën dhe fuqitë e tjera të rendit të parë apo ato rajonale. Njëkohësisht kjo periudhë paqe dhe qetësie u shoqërua edhe me procesin e zgjerimit të NATO-s drejt lindjes, kryesisht me vende nga ish-bloku socialist. Ku proces nxori në pah rolin kryesor të SHBA-së në drejtimin e menaxhimit të problemeve të mprehta të paqes dhe të sigurisë në nivel botëror dhe orientoi botën drejt sistemit njëpolar të arkitekturës së sigurisë me rolin e padiskutueshëm të SHBA-së për ruajtjen e paqes dhe sigurisë.

Etapa e tretë, përfshin periudhën nga sulmet terroriste të Al Kaedës në SHBA më 11 shtator 2001 deri në shkurt 2022, kur filloi agresioni rus mbi Ukrainë. Kjo periudhë nxori në skenë terrorizmin si rrezikun më serioz në sigurinë euroatlantike dhe një kërcënim ndërkombëtar e mbarë botëror. Angazhimi në luftën kundër terrorit dhe më vonë shtetit islamik zbehu me kalimin e kohës arkitekturën njëpolare të sistemit të sigurisë globale. Ndërhyrjet në Afganistan,

Irak, pranvera arabe, konflikti sirian nxjerrin në skenë shtetet islamike, pushtimin Rus të Krimesë e deri të tërheqja e trupave të NATO-s. Angazhimet evropiane, ruse, turke, përkrah SHBA-së në Siri dhe luftës kundër ISIS-it janë të mjaftueshme për të qartësuar këto zhvillime të reja në aspektin e përpjekjeve për të shtuar dominimin në menaxhimin e punëve të përbotshme nga disa aktorë të rinj globalë.

Kësaj shtohet rritja dhe presioni ekonomiko-financiar i Kinës në ekonominë botërore, zhvillimet teknologjike, ekspansioni në fushat e tjera të zhvillimit. Aneksimi rus i Krimesë dhe ndërhyrja ushtarake në Ukrainë i dha një dimension të ri konkurrencës së fuqive tjera rajonale dhe atyre globale, duke qartësuar më shumë qëndrimet dhe angazhimet e këtyre të fundit pro apo kundër ndërhyrjes ushtarake ruse në Ukrainë.

Kina me qëndrimin e saj ndaj pushtimit rus të Ukrainës dhe mbështetjes që po i ofron (shto këtu edhe ambiciet e saj për dominim në rajonin e indo-paqësor) shton edhe më shumë tymnajën rreth rolit amerikan si dominues në sistemin aktual global të sigurisë sot. Kërcënimi terrorist në rritje si faktor ndërkombëtar me rrezikshmëri të parashikueshme për paqen e sigurinë është dhe mbetet aktual dhe kërkon përqasje globale të aktorëve kryesorë gjeopolitikë, pasi askush nuk mund të fitojë betejën krejtësisht i vetëm. Gjithashtu, përdorimi apo përhapja e armëve bërthamore janë kërcënime serioze dhe që karakterizojnë këtë periudhë gjeopolitike të mjedisit të sigurisë. Agresioni ushtarak rus në Ukrainë po sjell ethet e përdorimit të armëve bërthamore, si masa paralajmëruese ndaj vendeve anëtare të aleancës dhe si një kërcënim real për sigurinë kombëtare nën pretekstin se po ndërhyjnë drejtpërsëdrejti në këtë konflikt, nëpërmjet furnizimit me armë e pajisje të tjera luftarake në mbështetje të Ukrainës. Kjo periudhë shtoi paqartësitë dhe ndezi diskutimet për qasjen e NATO-s ndaj të panjohurave që aktualisht parashtron mjedisi gjeopolitik i sigurisë sot dhe në të ardhmen e afërt dhe shoqëroi me polemika e debate angazhimin perëndimor ndaj Rusisë me rastin e pushtimit të Krimesë, si dhe ngjarjet e fundit që përkojnë me tërheqjen e diskutueshme të perëndimit nga Afganistani.

Etapa e katërt, mund të quajmë periudhën pas operacioneve ushtarake në shkallë të gjerë, për pushtimin rus të Ukrainës. Rritja e kërcënimit ushtarak nga Federata Ruse për vendet të tjera fqinje e kryesisht anëtare të NATO-s, mundësia e shtrirjes së konfliktit në Ballkanin Perëndimor, si dhe shkëputja e zinxhirit të furnizimit është duke shkaktuar krizë me pasoja negative për sigurinë dhe paqen në nivel botëror. Kjo situatë kërkon unison në mendime, veprime, qëndrueshmëri dhe kohezion politik nga komuniteti demokratik euroatlantik i vendeve mike dhe aleate nga gjitha drejtimitet.

Bashkimi Evropian dhe NATO janë aktorët më aktivë që duhet të përballen dhe të ndikojnë me çdo mjet dhe mundësi, në rrafshin diplomatik, ekonomik, ushtarak, për menaxhimin e pasojave që rrjedhin nga aktiviteti i aktorëve kërcënues e veçmas atij rus ndaj mjedisit të sigurisë në zonën euroatlantike. Sot bota ka ndryshuar. Duke iu referuar këtij mjedisi disi më diversiv dhe më me shumë të panjohura, presidenti i SHBA Biden, në konferencën për shtyp në takimin e Madridit më 30 qershor 2022, theksoi: “Për herë të fundit NATO përpiloi dokumentin e misionit të ri para 12 vitesh. Në atë kohë, ai vlerësonte Rusinë si një partner dhe madje ai nuk përmendte fare Kinën. Bota ka ndryshuar, një ndryshim i madh që atëherë. NATO është duke ndryshuar gjithashtu.”² Tashmë është koha për një qasje të re dhe gjithëpërfshirës për të analizuar, parashikuar dhe marr masa të gjithanshme dhe shumëplanëshe për ruajtjen e sigurisë, paqes, lirisë dhe të drejtave njerëzore nga çdo natyrë kërcënimi, nga çdo drejtim që mund t’i vijë komunitetit tonë euroatlantik.

2. Disa përcaktime të rëndësishme në samitin e NATO-s Madrid 2022, në raport me samitin e Lisbonës 2010

Sipas një tradite, Aleanca e Atlantikut të Veriut (NATO) mblidhet në takime të veçanta samiti, çdo 10 vjet, për të rishikuar Konceptin Strategjik i NATO-s (KSN). Ai është dokumenti thelbësor që paraqet parimet bazë dhe angazhimet konkrete të organizatës për periudhën në vazhdim. Në këtë shkrim do të përpiqemi të analizojmë disa ndryshime të dukshme midis koncepteve strategjike të miratuara e shpallura nga dy samitet e fundit të mbajtura në Lisbonë në vitin 2010 dhe atij në Madrid gjatë vitit 2022.

Për një njohje më të detajuar të asaj se cilat janë risitë që kanë shoqëruar qasjen e NATO-s në raport me zhvillimet, dinamizmin dhe ndryshimet e mjedisit të sigurisë gjatë këtyre 10-12 viteve të fundit, po paraqesim disa mendime rreth kësaj çështje me rëndësi jetike që njëkohësisht pasqyrojnë diferencat apo ndryshimet që kanë shoqëruar KSN nga takimi i Lisbonës, tek ai i Madridit.

Dokumenti kryesor, Koncepti Strategjik i NATO-s (KSN) i samitit të Madridit 2022 thekson ndryshe nga sa më parë se vihet në pikëpyetje paqja dhe siguria globale dhe rajonale duke shtuar rrezikun e zgjerimit të konfliktit në Evropë e deri në një konfrontim të hapur të NATO-s, duke tërhequr në të njëjtën kohë në konflikt edhe SHBA-në. Në artikullin 5 të Traktatit të Uashingtonit 1949 theksohet se: “Një sulm ndaj një shteti anëtar të NATO-s vlerësohet si sulm ndaj gjithë Aleancës”. Për të përforcuar më shumë rëndësinë dhe situatën në të cilën po kalon mjedisi i sigurisë, mund t’i referohemi deklaratës së samitit të Madridit të shpallur nga kryetarët e shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare

² www.whitehouse.gov/; Remarks by President Biden in Press Conference Madrid Spain, 30 June 2022.

të NATO-s ku në pikën 1 të saj ndër të tjera theksohet se: “Ne po përballemi me një kohë kritike për sigurinë tonë dhe paqen e stabilitetin ndërkombëtar. Ne qëndrojmë së bashku në solidaritet dhe riafirmojmë qëndrueshmërinë e lidhjes transatlantike të lidhjes mes kombeve tona.”³

Studimi i thelluar dhe i hollësishëm i dokumenteve nxjerr në pah një sërë dallimesh në përqasjen e Aleancës së Atlantikut të Veriut në samitin e Madridit, në raport me qëndrimet e shprehura gjatë samitit të Lisbonës 2010. Në këtë kontekst, më poshtë mund të evidentojmë disa gjetje thelbësore që bëjnë diferencën në aspektin e adresimit të sfidave, rreziqeve apo kërcënimeve të mjedisit të sigurisë:

KSN-2010 në Lisbonë, kërcënimet ndaj Aleancës si shkak i një rreziku të një sulmi konvencional e vlerëson të ulët, por nuk e injoruan kurrësi.

KSN-2022 në Madrid, e vlerëson si kërcënim të drejtpërdrejtë dhe real një sulm konvencional. Ky qëndrim përforcohet veçmas pas agresionit rus mbi Ukrainë dhe retorikave të shtuara mes Kinës dhe Taivanit në lidhje me sovranitetin e këtij të fundit. Duke u thelluar më tej në këtë analizë, nuk përjashtohet mundësia e një sulmi bërthamor në nivel taktik që mund të vijë nga ana e Rusisë për të arritur objektivat e saj ushtarake në Ukrainë. Njëkohësisht shqetësim i madh mbetet mundësia e rrezikut të angazhimeve ushtarake në rajonin lindor të Aleancës dhe vendeve të tjera anëtare të saj, duke tërhequr direkt apo indirekt në një konflikt të armatosur konvencional e pse jo edhe bërthamor në tërësi Aleancën e Atlantikut të Veriut.

KSN -2010 në Lisbonë, parashikonte ose pretendonte për një botë pa armë nukleare, ndërkohë që KSN-2022 në Madrid, kërcënimin nga armët bërthamore e vlerësonte si një realitet, si një masë parandaluese apo mjet për të arritur objektivat e operacionit ushtarak siç mund të ndodhë në rastin e përshkallëzimit të konfliktit në Ukrainë.

Koncepti Strategjik i NATO-s në samitin e Lisbonës 2010 thekson: “Forcat strategjike bërthamore të aleancës, konkretisht ato të SHBA-ve, janë garancia supreme për sigurinë e Aleancës. Forcat strategjike të pavarura të Mbretërisë së Bashkuar dhe Francës kanë një rol dekurajues në vetvete dhe japin një kontribut të rëndësishëm për sigurinë e përgjithshme të Aleancës.”⁴

Përpyjekjet e vazhdueshme të Rusisë për të avancuar më tej zhvillimin dhe modernizimin e arsenalit të saj shprehin gatishmërinë për një konfrontim në rrafshin bërthamor. “Federata Ruse është duke modernizuar forcat e saj bërthamore dhe është duke zgjeruar sistemin e tij te retorikës përçarëse me

³ Madrid Summit Declaration 1, issued on 29 June 2022.

⁴ “Strategic Concept For the Defence and Security of The Members of the North Atlantic Treaty Organisation”, Lisbonë 2010, p. 18.

kapacitete dyfish shpërndarje, duke përdorur sinjale shtrënguese bërthamore.”⁵ Këtij shqetësimi iu shtua edhe deklarata e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Antonio Guterres mbajtur në “Konferencën e 50-vjetorit të Rishikimit të Traktatit të Mospërhapjes së Armëve Bërthamore”, ku thekson se: “Bota ndodhet një hap nga asgjësimi bërthamor”.⁶ Ky deklarim mbart me vete shqetësimin e mjaft aktorëve të tjerë me peshë globale, në lidhje me rreziqet që dominojnë në mjedisin e sigurisë së Aleancës së Atlantikut të Veriut, të cilat janë kërcënim real dhe me pasoja të parikuperueshme për njerëzimin.

Situata të tilla nën një kërcënim të vazhdueshëm për sigurinë rrezikojnë të degradojnë në një kalim të mundshëm të këtij konflikti në përballje ushtarake midis Federatës Ruse dhe NATO-s në tërësi apo edhe vendeve të saj anëtare e mike në veçanti. Përplasja e mëtejshme e mjedisit të sigurisë mund të na çojë drejt një lufte bërthamore me pasoja katastrofike të pariparueshme për njerëzimin dhe ekzistencën e tij në përgjithësi.

Vlerësimi për Federatën Ruse në KSN-2010 në Lisbonë ishte mjaft miqësor dhe e konsideronte si vend partner strategjik të Aleancës. Ndërsa KSN-2022 në Madrid e vlerëson atë si një kërcënim të rëndësishëm, real dhe të drejtpërdrejtë ndaj NATO-s, jo vetëm për shkak të agresionit të pajustificuar dhe të paprovokuar ndaj një shteti sovran si Ukraina, por edhe për shkak të kërcënimit ndaj vendeve të tjera fqinjë, e për më tepër anëtare të Aleancës. Qasjen e saj të papranueshme e bëjnë më shumë prezente disa veprime diplomatike mjaft agresive të Rusisë kohët e fundit, nëpërmjet të cilave ka shpallur një sërë vendesh anëtare të Aleancës si vende jo miqësore, duke përfshirë në këtë klasifikim edhe vendin tonë, Republikën e Shqipërisë.

Një gjetje tjetër në KSN-2022, janë konsideratat rreth Kinës, e cila në ditët e sotme vlerësohet si një fuqi në rritje dhe po aq konkurruese në sferën globale të mjedisit të sigurisë dhe agjendën e avancuar teknologjike e hapësinore, ndërkohë që në KSN-2010, Kina nuk ka qenë subjekt diskutimi as vlerësimi. Kina për më tepër mund të vlerësohet nga tërësia e ndryshimeve, spektrit të përfshirjes dinamike, intensitetit të zhvillimit dhe ambicieve të saj të gjithanshme, si surpriza e këtij shekulli në zhvillimet gjeopolitike në nivel global. Në këtë vijë qëndrimi, mund të vlerësojmë thirrjen e ish-kryeministrit të Mbretërisë së Bashkuar pasqyruar nga shtypi britanik ku theksohet se: “Toni Blair u kërkon fuqive perëndimore t’i kundërvihen Kinës.”⁷

Një nga vlerësimet e reja mund të konsiderojmë ndryshimet klimaterike që

⁵ NATO 2022 STRATEGIC CONCEPT, p.8.

⁶ Deklarata e Sekretarit të përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara Antonio Guterres, në konferencën e 50-vjetorit të rishikimit të traktatit të mos përhapjes së armëve bërthamore, 2 gusht 2022.

⁷ <https://www.theguardian.com>; 16 July 2022.

janë tashmë një sfidë përcaktuese e zhvillimeve në tërësi të jetës tonë social-ekonomike dhe që thellojnë ndikimin mbi mjedisin e sigurisë në tërësi. Këto përbëjnë një kërcënim shumëdimensional dhe që mundë të shoqërohen me kriza të zgjatura dhe të shumëllojshme, si në fushën e energjetike, prodhimeve bujqësore, migrimit apo emigrimit masiv, përhapjen e pandemive, katastrofat natyrore etj. Në këtë kontekst ndikimi në mënyrën e operimit të forcave të armatosura do të jetë i pallogaritshëm dhe me ndikim shumëpalësh.

3. Përshtatja dhe përqasja pro aktive e detyrimeve të konceptit strategjik të NATO-s 2022 me sfidat e reja të mjedisit të sigurisë

Në kontekstin e mjedisit të sigurisë shohim një dallim esencial nga vlerësimet e tij në ekstremet e dhjetëvjeçarit të fundit nga samiti i Lisbonës 2010, në atë të Madridit 2022. Ai vlerësohet nga i qetë në jo të qetë duke bërë disa vlerësime të rëndësishme ndryshe, që zënë fill me pushtimin e Krimesë.

Mjedisi i hapësirës kibernetike që mbetet i kontestuar nga pala ruse, i kombinuar me zhvillimin e sistemeve reaktore, mbështetja dhe bashkëpunimi me aleatët e saj si: Kina, Koreja e Veriut dhe Irani, i kombinuar me aktorët joshitetërorë, terrorizmin, sulmet kibernetike, ndryshimet klimaterike, zhvillimet teknologjike, fatkeqësitë natyrore, përhapja e pandemive etj., amplifikojnë kërcënimet rreth mjedisit aktual të sigurisë. Gjithashtu, degradimi i arkitekturës së kontrollit dhe mospërhapjes së armëve të dëmtimit në masë ka një impakt më të rritur negativ mbi mjedisin e sigurisë.

Këto dhe ndryshimet e tjera në mjedisin e sigurisë dhe shtimi i oreksit të fuqive rajonale për më shumë hegjemoni, duke ruajtur si qendër të rëndësës bashkëpunimin e ngushtë të kohëve të fundit midis Kinës dhe Rusisë dhe integrimin ushtarak me Bjellorusinë dhe gatishmërinë për t'i afruar kësaj të fundit asete bërthamore, janë një mundësi e shtuar për t'iu kundërvënë rolit udhëheqës perëndimor në çështjet botërore dhe të zbehin ndikimin e Amerikës si dominuese në arkitekturën e rendit botëror.

KSN-2010 në Lisbonë shprehet qartësisht për “dyert e hapura” për vendet që ndajnë vlera të përbashkëta dhe marrin përgjegjësi, si dhe ndajnë barrën e përgjegjësisë për sigurinë.

KSN-2022 në Madrid hapi dritën jeshile për afrimin si anëtare të Aleancës për dy vendet me status neutral, Suedinë dhe Finlandën, gjë e cila u formësua pas pajtimit të Turqisë për këtë çështje. Nga ana tjetër, Ukraina, Gjeorgjia, Bosnje-Hercegovina u diskutuan vetëm në kuadër të partneritetit, por u la pa përgjigje kërkesa e Kosovës rreth kësaj çështje. Subjekt i agjendës ishin edhe rajonet të tjera të ndjeshme si: Lindja e Mesme, vendet e Magrebit, Afrika Veriore dhe Rajoni Sahel, probleme të cilat shihen shumë më ndryshe në rajonin e trazuar

të eurozonës, në krahasim më vlerësimet para një dekade.

Ndërsa çështja e Ballkanit Perëndimor diskutohet e ndërlidhur me rajonin e Detit të Zi, si subjekt me rëndësi të veçantë për aleancën, në lidhje me sfidat aktuale për të ardhmen e mjedisit të sigurisë si dhe domosdoshmërinë e integritetit sa më të shpejtë në institucionet perëndimore euroatlantike. Rëndësinë e këtyre rajoneve po e evidenton gjithnjë e më shumë situata e ndjerë në Ukrainë dhe rreziku i përhapjes së shkëndijave të një konflikti tjetër në këto rajone e veçmas për rajonin tonë disi të trazuar të Ballkanit Perëndimor. Vlerësimi të samitit të Madridit po i shtohet edhe angazhimi i instrumenteve të tjera të sigurisë dhe përfshirja e të dërguarve specialë nga Evropa, Britania e Madhe, SHBA e deri te kontributi i Turqisë për të paraprirë me masa adekuate çdo tendencë përkeqësimi të mjedisit të sigurisë.

Në të njëjtin drejtim ishin edhe vizitat e fundit të përfaqësuesve evropianë Lajçak e atij amerikan Eskobar, si dhe të sekretari të përgjithshëm të NATO-s Stoltenberg për dhënien fund dhe gjetjen e një zgjidhjeje për krizën të shkaktuar nga reagimi i serbëve përkundër masave të reciprocitetit të ndërmarra nga qeveria e Kosovës për dokumentet e identitetit të lëshuara nga të dyja palët, e cila tashmë ka marrë zgjidhje, ndërsa çështja për targarat e lëshuara nga Serbia për popullatën serbe të Kosovës mbetet në tendencë për një marrëveshje në të ardhmen.

Një gjetje e re mjaft e rëndësishme që paraqet një reagim, përshtatje dhe qasje me të shpejtë efikase dhe gjithëpërfshirëse përkundrejt situatës aktuale të sigurisë, është angazhimi për shtimin e kapaciteteve ushtarake të një force për detyrë të gatishmërisë së lartë të reagimit të menjëhershëm, zgjerimin e saj me anëtarë cilësorë si Finlanda dhe Suedia, rritjen e buxheteve për mbrojtjen, shtimin e masave parandaluese ndaj kërcënimeve aktuale e një sërë angazhimesh të tjera në nivel kombëtar dhe të NATO-s.

Një angazhim të tillë e deklaroi në konferencë për shtyp pas samitit të Madridit, sekretari i Përgjithshëm Stoltenberg, pasqyruar kjo në shkrimin e analistit Samuel Petrequin në AP⁸: “NATO do të forcojë forcën e reagimit të shpejtë dhe do të mbështesë ushtarakisht Ukrainën”, duke nënvizuar se: “forcat e gatishmërisë së lartë të reagimit të menjëhershëm nga 40 mijë do të shkojnë në 300 mijë me një rritje prej afro 8 fish”.

Një rëndësi të veçantë ka angazhimi i vendeve anëtare dhe veçanërisht i NATO-s për mbështetjen e menjëhershme dhe pa kushte që iu ofrua vendit tonë për të tejkaluar situatën e vështirë të krijuar nga “sulmi kibernetik kompleks

⁸ Petrequin, Samuel, “NATO to boost rapid reaction force Ukraine military support”; AP 27 June 2022.

dhe me shkallë të gjerë ndaj Shqipërisë⁹. Rezultat i kësaj mbështetjeje ishte jo vetëm eliminimi në kohë i pasojave të këtij sulmi armiqësor ndaj vendit tonë, por edhe zbulimi dhe ndëshkimi i agresorëve.

Koncepti Strategjik ndikon në promovimin, inovacionin dhe rritjen e investimeve tona në teknologjitë e reja, duke e vendosur këtë objektiv si detyrën kryesore të mbrojtjes kolektive.

Arritjet në planin kombëtar dhe ato të mbrojtjes kolektive kërkojnë angazhimin e burimeve më të spikatura jo vetëm njerëzore por edhe ato materiale dhe financiare, si dhe kombinimin me ndërthurjen e ideve elitare dhe inovative për menaxhimin e kontributeve të përbashkëta mbi përparësitë smart, sidomos në adresimin e problematikave rreth mbrojtjes kibernetike dhe hapësinore për një përjasje sa më efektive, për parandalimin e rreziqeve dhe kërcënimeve dhe ruajtjen optimale të elementeve jetësore të mjedisit të sigurisë në çdo aspekt dhe nivel të hapësirës gjeopolitike euroatlantike.

Përfundime

Në përfundim të samitit, në Konceptin Strategjik të NATO-s 2022 u theksuan edhe një herë vlerat, parimet dhe objektivat, duke shprehur domosdoshmërinë e NATO-s për të garantuar paqen, lirinë, prosperitetin e komunitetit të gjerë demokratik të vendeve anëtare dhe vazhdimësinë për të qëndruar të bashkuar për të mbrojtur sigurinë, vlerat dhe mënyrën demokratike të organizimit tonë shoqëror.

Aleanca do të sigurojë burimet dhe kapacitetet e nevojshme financiare, ushtarake, njerëzore e teknologjike për të përmbushur misionet e saj, si dhe përkushtimin për të ruajtur efektivitetin dhe epërsinë e saj më të suksesshme politiko-ushtarake e teknologjike në nivel botëror.

Aleanca mbetet burim shprese sepse bazohet në vlerat e përbashkëta të lirisë individuale, demokracisë, të të drejtave të njeriut. Prioriteti i saj është të ruajë lirinë dhe sigurinë e anëtarëve të saj. Gjithashtu theksohet se këto vlera dhe objektiva janë universale dhe të përhershme për të qenë të vendosur t'i mbrojnë përmes unitetit, solidaritetit, forcës dhe vendosmërisë.

Kina mund të vlerësohet nga tërësia e ndryshimeve, spektri i përfshirjes, dinamizmi dhe intensiteti i tyre, si surpriza e këtij shekulli në zhvillimet gjeopolitike në nivel global.

Bazuar në frymën e Konceptit Strategjik të NATO-s Madrid 2022, lidhshipi vlerëson tërë procesin dinamik të transformimit dhe modernizimit të Forcave të Armatosura duke mbajtur frymën që përcjell ky samit, me synimin për të

⁹ <https://www.aa.com.tr>ballkani>s...>

rivlerësuar ambicien e politikës tonë, rishikimin e dokumenteve madhore të sigurisë dhe mbrojtjes (SSK, SU, DM, PAZH, RSM), vizionin perspektiv të zhvillimit të FA-2030, si dhe çështje të planëzimit të mbrojtjes, sigurisë, mbështetjes dhe modernizimit dhe rritjes cilësore të kapaciteteve ushtarake në veçanti.

Tërë procesi i angazhimit të mendimit intelektual, kërkues dhe shkencor të fokusohet te njohja studimi, analiza, vlerësimet që përmban në thelb Koncepti Strategjik i NATO-s 2022, çështjet e së cilës jo vetëm të kuptohen qartësisht deri në detaje, por të shërbejnë rrugës që duhet të ndjekim dhe angazhimit konkret në kuadrin e Procesit të Planifikimit Strategjik të Mbrojtjes së vendit në kohezion e duke reflektuar principet, prioritetet dhe objektivat e tij.

Bibliografia

1. “Strategic Concept For the Defence and Security of The Members of the North Atlantic Treaty Organisation”, samiti i Madridit, 29 qershor 2022.
2. “Strategic Concept For the Defence and Security of The Members of the North Atlantic Treaty Organisation”, Lisbonë 2010.

FAKTORËT KËRCËNUES NDAJ SIGURISË KOMBËTARE TË SHTETEVE TË BALLKANIT PERËNDIMOR

Nënkolonel Msc. Bajazit Muceku

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Trajtesë e shkurtuar. *Mjedisi ndërkombëtar i sigurisë është nën një presion të vazhdueshëm të kërcënimeve komplekse, shumëdimensionale dhe subjekt i ndryshimeve të papritura. Këto kërcënime dhe rreziqe, në mënyrë të paparashikuar, po ndryshojnë ndjeshëm natyrën, intensitetin dhe ndikimin ndaj sigurisë globale. Kërcënimet jokonvencionale të sigurisë, që shqetësojnë sot vendet e rajonit, janë ato të lidhura me krimin e organizuar dhe korrupsionin, lëvizjet ekstremiste, trafikimin ilegal, ndikimin negativ të medias sociale në dezinformimin e shoqërisë, sulmet kibernetike, kërcënimet hibride, etj. Rajoni po përballët me sfida edhe si rezultat i shtrirjes së ndikimit të jashtëm dhe gjeopolitikës së aktorëve shtetërorë me interesa rajonale dhe globale, të cilët, duke shfrytëzuar mbështetjen dhe marrëdhëniet e ngushta historike me shtete të caktuara të rajonit, duan të pengojnë ecurinë e integritetit euroatlantik të rajonit.*

Kërcënimet dhe rreziqet ndaj sigurisë kombëtare kanë evoluar në mënyra që po vënë në dyshim shenjë e ndryshimit të natyrës së brezit të ri të kërcënimeve. Teknologjia, media sociale, ndikimi i tyre në shoqëri, si dhe instrumentet e reja të natyrës hibride, të cilat përcaktojnë përçarje të mëdha në shoqëritë demokratike, po krijojnë një mjedis të ri dhe kategori të reja kërcënimesh që nuk janë shfaqur kurrë më parë. Për më tepër, këto lloj ndryshimesh kanë ndikim të jashtëzakonshëm në elasticitetin dhe kohezionin e shoqërive demokratike, në mbështetjen e publikut për shpenzime në fushën e sigurisë dhe në perceptimin e kërcënimeve, përfshirë edhe ato të natyrës konvencionale.

Fjalë kyçe: kërcënim, siguri kombëtare, ndikimi rus, media sociale, populizëm, kohezion

Hyrje

Siguria, liria dhe mirëqenia ekonomike janë elemente thelbësore të shoqërive të civilizuar dhe përfaqësojnë themelet, mbi të cilat mbështetet zhvillimi dhe progresi i kombit. Shqyrtimi i mjedisit strategjik, nxjerr në pah se rreziqet dhe kërcënimet ndaj sigurisë kombëtare nuk janë të izoluara nga njëra-tjetra, por të lidhura dhe të ndërvarura. Siguria jonë ndikohet nga një ndërthurje e rreziqeve tradicionale dhe jotradicionale, që burojnë nga faktorë të brendshëm dhe të jashtëm. Sfidat bashkëkohore ndaj mjedisit të sigurisë sa vijnë dhe shtohen dhe bëhen edhe më komplekse.

Mjedisi bashkëkohor i sigurisë karakterizohet nga një nivel i lartë kompleksiteti, i cili vjen si pasojë e ekzistencës së aktorëve të ndryshëm, shfaqjes së fenomeneve të reja, të cilat bëjnë kërcënim për shoqërinë; ndërveprimet në nivele të ndryshme; globalizimit, tendencave integruese dhe intensifikimit të marrëdhënieve midis aktorëve; zhvillimeve teknologjike dhe paparashikueshmërisë. Në këtë mjedis sigurie shfaqen kërcënime tradicionale dhe jotradicionale, të cilat sfidojnë dhe kërcënojnë sigurinë kombëtare të shteteve të rajonit. Kërcënimet hibride, sulmet kibernetike, ndikimi negativ i mediave sociale janë disa nga kërcënimet në rritje ndaj sigurisë kombëtare të vendeve të rajonit.

Shtetet e rajonit të Ballkanit Perëndimor janë të orientuara drejt vlerave dhe aspiratave evropiane dhe euroatlantike, pavarësisht dinamikës së brendshme komplekse politike dhe nacionaliste. Ato janë të angazhuara në garantimin e të drejtave të grupeve të ndryshme etnike dhe pakicave fetare, por mungesa e zhvillimit social-ekonomik, polarizimi politik, rritja e ndjenjave nacionaliste dhe mungesa e besimit të ndërsjellë mund të nxisin tensione dhe dhunë ndëretnike, me pasojë për rajonin dhe më gjerë.¹ Bashkëpunimi rajonal, forcimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë, pjesëmarrja aktive në organizatat kryesore të sigurisë, vazhdimi dhe kryerja e reformave në fushën e drejtësisë dhe sundimit të ligjit, respektimi i standardeve demokratike dhe të drejtave e lirive të individit dhe rritja e mirëqenies së qytetarëve janë drejtimitet e duhura për të sfiduar kërcënimet ndaj sigurisë të vendeve të rajonit.

¹ Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes, 2019, kreu II, faqe 3

1. Ndikimi i Rusisë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, një kërcënim serioz dhe permanent

Në këtë çështje do të trajtojmë dy aspekte kryesore. **Së pari**, politika e Rusisë në rajon realizohet nga një rrjet i aktorëve rusë shtetërorë dhe joshtetërorë që po mjegullojnë linjat tradicionale midis fushave publike dhe private. **Së dyti**, Rusia ka rritur koston e integritit të Ballkanit Perëndimor në BE dhe NATO duke shfrytëzuar dobësitë politike dhe ekonomike të rajonit. Theksojmë që, megjithëse Rusia ishte në gjendje të ngadalësonte procesin, ajo deri më tani nuk ka arritur të ndryshojë shkallën e qëndrueshme të rajonit drejt organizmave perëndimorë. Një mori veprimesh destabilizuese në Ballkanin Perëndimor kanë krijuar një përshtypje se Rusia ka bërë një sukses të madh gjatë “rikthimit” të saj në rajon. Megjithatë, perceptimi që Rusia post-sovjetike u largua ndonjëherë nga rajoni është i rremë. Që nga fillimi i viteve 1990, Rusia ka mbajtur një prani të vazhdueshme në Ballkanin Perëndimor. Objektivat e saj dhe mënyra se si fuqia e projektuar dhe e sofistikuar ka ndryshuar vazhdimisht, sidoqoftë kanë qenë kryesisht për shkak të ndërveprimit të katër faktorëve: kufizime dhe mundësi që rrjedhin nga lufta dhe dinamika e paqes në Ballkanin Perëndimor, marrëdhëniet me Evropën dhe SHBA, vetë-perceptimi i Rusisë dhe baza e burimeve të saj të energjisë.² I shkatërruar nga luftërat në vitet 1990, Ballkani Perëndimor siguroi disa mundësi ligjore të biznesit për të huajt. Ashtu si fuqitë e tjera kryesore, politika e Rusisë në rajon u përqendrua kryesisht në menaxhimin e konflikteve. Edhe nëse Kremlinin përpiquej me kohë të ndërtonte një prani ekonomike dhe të përdorë kontratat e furnizimit me gaz të trashëguar nga koha sovjetike, ajo kryesisht mbështetej në mjetet diplomatike dhe fuqinë e saj ushtarake. Rusia bëri presion ndaj palëve ndërluftuese, mbështeti sanksione ndërkombëtare, u bashkua me formatet e zgjidhjes së konflikteve dhe propozoi e pengoi zgjidhje diplomatike. Në të njëjtën kohë, Rusia vendosi paqeruajtësit dhe inkurajoi rrjedhën e vazhdueshme të luftëtarëve rusë që u nisën për në Ballkan. Në përgjithësi, projeksioni i energjisë i Rusisë në rajon u përpoq të shndërronte kapitalin politik të fituar përmes menaxhimit të konflikteve, në ndikim dhe statusin e një ndërmjetësi të energjisë.

Në fushën e vështirë të sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Rusia vendosi heshtje për unipolaritet. Moska hoqi dorë nga përgjegjësia për policimin e rajonit ndaj NATO-s dhe BE-së dhe paqeruajtësit e fundit rusë u larguan nga Kosova dhe Bosnja në 2003. Por, ndërsa Rusia përfundoi tërheqjen e saj ushtarake, gjigantët e saj të energjisë, duke vepruar në një marrëveshje me një numër sipërmarrësish në hije, u dyndën në rajon. Infiltrimi i kapitalit rus u lehtësua nga një interesim i pjesshëm nga ana e fuqive të tjera për të investuar në një zonë me infrastrukturë të shkatërruar të epokës socialiste, qeverisje të

² Stanislav Secieru, “Russia in the Uestern Balkans”, EUISS, 2019, f.2

dobët, një varësi nga furnizimi i gazit nga Gazprom i Rusisë (në Serbi dhe Bosnje e Hercegovinë) dhe konflikte të pazgjidhura dhe kriza globale financiare e vitit 2008.³ Ndërsa Rusia nuk u bë partneri ose investitori kryesor tregtar i Ballkanit Perëndimor (me përjashtim të Malit të Zi), bizneset ruse gjithsesi bënë blerje të rëndësishme në sektorët strategjikë si: energjia, industria e rëndë, minierat dhe bankat. Për shembull, kompania ruse e naftës Zarubezneft kontrollon të dy rafineritë e naftës në Bosnje dhe Hercegovinë, duke i dhënë asaj një monopol pothuajse në tregun e produkteve me bazë naftë. Përkundër këtij depërtimi mbresëlënës në treg, disa nga investimet kryesore të Rusisë dëshmuuan se ishin ushtrime për humbjen e parave. Zarubezneft ka raportuar humbje të konsiderueshme financiare në Bosnje dhe Hercegovinë, për shembull, por në të njëjtën kohë nuk ka sinjalizuar asnjë qëllim për t'u larguar.⁴ Ajo që zbulon kjo dhe raste të tjera të ngjashme është se fitimi i të ardhurave ishte shpesh me rëndësi dytësore. Lëvizja merkantiliste kërkonte të krijonte varësi dhe t'i dhuronte shtetit rus ndikim politik në rajon. Me fjalë të tjera, merkantilizmi po maskonte objektivat gjeopolitikë të Rusisë. Qasja pohuese e Rusisë në Ballkanin Perëndimor në vitet 2010 shpesh shoqërohet me bllokimin politik dhe diplomatik me Evropën, e shkaktuar nga aneksimi i paligjshëm i Krimesë dhe anulimi i tubacionit të gazit të Rrjetit Jugor të mbështetur nga Rusia. Sidoqoftë, këto çështje përshpejtuan sesa filluan ndryshimin e politikës së Rusisë në rajon. Në vitet 2010, Kremlini vazhdoi të inkurajojë bizneset ruse të investojnë në sektorë strategjikë. Sidoqoftë, ngadalë, zgjerimi ekonomik i dha vendit një qëndrim të hapur gjeopolitik dhe pohues dhe një aktivitet më të madh në fushën e sigurisë. Për më tepër se 50 vjet pasi Bashkimi Sovjetik humbi bazën e vetme detare në rajon, Bazën e Pashalimanit, Deti Adriatik është rishfaqur në radarët e Rusisë. Në vitin 2013, Rusia raportohet se iu drejtua qeverisë malazeze me një kërkesë për hyrje të rregullt në portet e Barit dhe të Kotorrit për luftanijet e saj. Pak a shumë në të njëjtën kohë, ajo nxiti përhapjen e organizatave nacionaliste përçarëse në Bosnje dhe Hercegovinë, duke zgjeruar infrastrukturën “në hije” për të cilën mund të mbështetet në rast nevojë. Ky trend gjithashtu u intensifikua ndjeshëm nga viti 2014 e në vazhdim. Nuk është hera e parë që Federata Ruse ose paraardhësit e saj kanë përdorur taktika përçarëse në rajon: Bashkimi Sovjetik u përpoq të kufizojë autonominë e drejtuesve rajonalë, të dobësojë pozitën e tyre të brendshme dhe pastaj madje u përpoq t'i heqë ata nga pushteti në Jugosllavi (1947 -1958) dhe në Shqipëri (1960-69) duke përdorur luftë politike dhe ekonomike.⁵ Megjithatë, megjithëse qasja e tanishme e Rusisë po kujton një lloj “deja vu”, ekzistojnë disa veçori që e dallojnë të tashmen nga e kaluara.

³ Stanislav Secieru, “Rusia in the Uestern Balkans”, EUISS, 2019, f.3

⁴ Po aty.

⁵ Po aty, f.5.

Në ditët e sotme, Rusia mbështetet në një grup shumë më të gjerë aktorësh sesa më parë: oficerët e inteligjencës, operativët politikë, oligarkët, organizatat ultranacionaliste, kompanitë shtetërore, hakerët, ndërmarrjet private të paligjshme ushtarake, media në pronësi të shtetit, kriminelët dhe “peshkuesit” e internetit, tani të gjithë ndihmojnë Kremlinin në objektivat e tij. Me gjithë këtë amalgamë hibride të aktorëve, ajo që është e qartë është se veprimet e tyre në rajon, përveç avancimit të qëllimeve të ngushta private, gjerësisht përputhen me axhendën e shtetit rus. Një mënyrë që Rusia të mohojë përgjegjësinë për veprimet e këtyre aktorëve është të pretendojë se ata nuk kanë asnjë lidhje me shtetin rus. Për dallim nga vitet 1950 dhe 1960, vendet e Ballkanit Perëndimor sot kanë sisteme shumë më të hapura politike dhe ekonomike. Kjo i ofron Rusisë më shumë mundësi, jo vetëm të depërtojë në strukturat shtetërore, por edhe të kryejë në mënyrë paradoksale veprime subversive krahas veprimeve të joshjes. Për dallim nga Bashkimi Sovjetik, Rusia, pra, ka mundësinë që të ndërtojë njëherazi aleanca me politikanë të korruptuar, të marrë asete dhe ta shndërrojë këtë prani ekonomike në ndikimin politik, të përfshihet në projekte me shikueshmëri të lartë dhe gjenerim të prestigjit (p.sh. Gazprom është sponsori zyrtar i klubit të futbollit të Yllit të Kuq të Beogradit) dhe formëson mendimet e njerëzve përmes mediave masive të sponsorizuara nga shteti rus⁶. Megjithëse Bashkimi Sovjetik praktikoi zyrtarisht ateizmin shtetëror, ai mori maksimumin nga përdorimi i “urtësisë” të Kishës Ortodokse, për qëllime të politikës së brendshme dhe të jashtme. Në vitet 1990, politika e Rusisë në rajon, rimori një dimension fetar, duke u kthyer në traditën cariste të përdorimit të kishës ortodokse në politikën e saj në Ballkanin Perëndimor. Më pas, besimi rus në diplomacinë fetare u zgjerua shumë në vitet 2010. Rusia është e vendosur mirë për të shfrytëzuar këto lidhje fetare të vërteta dhe të perceptuara: ka bashkësi të konsiderueshme ortodokse në Ballkanin Perëndimor (Serbia 88%, Mali i Zi 72%, Maqedonia e Veriut 65%, Bosnja dhe Hercegovina 31%) dhe feja luan një rol vendimtar te njerëzit, te jeta private dhe përcaktimet e tyre të identitetit kombëtar. Mediat ruse shpesh kornizojnë rivalitetet rajonale në aspektin fetar, diçka e krijuar për të përkeqësuar tensionet tashmë ekzistuese: për shembull, Sputnik i Rusisë portretizon armiqësinë midis serbëve dhe shqiptarëve kryesisht si përplasje mes të krishterëve ortodoksë dhe muslimanëve. Rusia përdor fenë për të forcuar fuqinë e saj të butë. Në përgjithësi, rrjetet e spiunazhit shtetëror rus kanë arritur disa suksese taktike të cilat deri më tani nuk kanë ndryshuar drejtimin strategjik të Ballkanit Perëndimor. Por Rusia nuk mund të kreditohet ekskluzivisht për këto fitore të vogla: pa tokë pjellore politike (në formën e qeverisjes së dobët, korrupsionit, mosmarrëveshjeve të pazgjidhura) dhe pushtetarëve të Ballkanit Perëndimor që përdorin Rusinë në lojërat e tyre të lokalizuara të pushtetit, Kremli nuk do të kishte mundësi të

⁶ Stanislav Secieru, “Russia in the Uestern Balkans”, EUISS, 2019, f.7.

përkeqësonte dukshëm polarizimin ose ndezjen e tensioneve të mëtejshme⁷. Në vitet e ardhshme, strategjia e BE ndaj rajonit do të kërkojë jo vetëm reagime kundër veprimeve armiqësore të Rusisë, por përpjekje më të guximshme për inkurajimin dhe mbajtjen e reformave të thella në këto vende. Për dallim nga Rusia, BE-ja ka një model tërheqës për të ofruar dhe fuqinë financiare për të pasur sukses; por vendosmëria e qëndrueshme politike për të funksionalizuar këto avantazhe është ende një domosdoshmëri.

2. Kërcënimet hibride

Në zonën gri mes luftës dhe paqes, në teorinë moderne të luftës ka evoluar koncepti i luftës hibride, që nënkupton angazhimin e kapaciteteve ushtarake dhe jo ushtarake me qëllim të arritjes së objektivave politik. Kur flasim për këtë zonë gri, lufta hibride merr formën që qëndron jashtë formave tipike konvencionale dhe jokonvencionale të luftës, duke përjashtuar elementin e dhunës në veprimet për arritjen e objektivave shtetërorë në shumicën e rasteve. Lufta hibride tashmë konsiderohet si normë natyrore e kombinimit të disa aspekteve strategjike në një të vetëm dhe shtetet po krijojnë dhe po avancojnë mekanizmat e brendshëm dhe ato të jashtëm në kuadër të mbrojtjes kolektive për t'ju përgjigjur kërcënimeve potenciale. Kërcënimet hibride në zonën gri, mbeten vazhdim i politikës me mjete të tjera, duke mënjанuar përdorimin e dhunës dhe pa arritur kufirin e minimumit të luftës, por që japin rezultate në favor të përmbushjes së objektivit politik. Ato janë luftë e pakufizuar që shkojnë përtej kuptimit tradicional të limiteve ndaj luftës duke përdorur të gjitha mjetet në dispozicion për të arritur objektivat politik dhe strategjik. Kësisoj në vend se të përdorim termin luftë hibride, meqë vetë lufta nënkupton përdorimin e makinerisë ushtarake dhe dhunës, në vazhdim do të përdorim termin kërcënime hibride duke nënkuptuar përdorimin e formave jo të armatosura kundër objektivit. Kërcënimet hibride, përmes përdorimit të teknologjisë së informacionit, operacioneve klandestine të inteligjencës, diplomacisë, kërcënimit mbi përdorimin e forcës ushtarake, mjeteve ekonomike dhe financiare e madje edhe dobësive në infrastrukturën ligjore të një vendi apo në rendin juridik ndërkombëtar, synojnë të influencojnë aspekte të politikës, informacionit dhe aspekte njohëse përbrenda një shoqërie⁸. Tashmë ndërhyrja dhe influencimi në zgjedhjet e brendshme në vende të caktuara, siç është rasti i SHBA (2016) dhe Francës (2017), përbën një shembull tipik të kërcënimeve hibride.

Në terma të përgjithshëm, kërcënimet hibride karakterizohen nga:

- kombinimi i konvencionale dhe jokonvencionale, ushtarake dhe joushtarake, veprime të fshehta dhe jo të fshehta;

⁷ Stanislav Secrieru, "Rusia in the Uestern Balkans", EUISS, 2019, f.11.

⁸ Jan Joel Andersson, Thierry Tardy, "Hybrid operations: Lessons from the past", EUISS, 2015, f.2

- qëllimi i krijimit të paqartësisë dhe konfuzionit mbi natyrën, origjinën dhe objektivin e kërcënimit;

- aftësia për të identifikuar dhe shfrytëzuar dobësitë e objektivave;

- aftësia për të mbajtur nivelin e armiqësisë nën "pragun" e luftës konvencionale.

Për një kërcënim të një natyre 'hibride', ai duhet të jetë produkt i mënyrave të shumëfishta për të kërcënuar ose sulmuar objektivin e synuar të tij - aq sa një specie hibride prodhohet duke kombinuar raca ose varietete të ndryshme. Prandaj është përzierja e metodave të ndryshme - konvencionale dhe jokonvencionale, ushtarake dhe joushtarake - që e bën një kërcënim hibrid. Në këtë kuptim, jo të gjitha kërcënimet bashkëkohore janë hibride. Për shembull, një grup terrorist i cili kryesisht ndërton bomba ose përdor taktika të bombave vetëvrasëse, në vetvete, nuk përbën një kërcënim hibrid. Është vetëm nëse kur një mënyrë e tillë kombinon taktika të tilla me, p.sh., fillimin e fushatave ushtarake, përhapjen sistematike të dezinformimit ose drejtimin e veprimtarive kriminale, kërcënimi shndërrohet në një hibrid.⁹ Terrorizmi, krimi në internet, trafikimi nuk janë vetë hibride në natyrë; ato mund të bëhen të tilla në varësi të mënyrës dhe në çfarë mase ata ndiqen duke përdorur taktika të shumëfishta njëkohësisht. Madje mund të jetë rasti që disa kërcënime që vijnë nga një organizatë ose shtet i caktuar janë hibride ndërsa të tjerët që vijnë nga i njëjti agjent nuk janë. Vlerësimi i kërcënimeve duhet të rishikohet vazhdimisht në dritën e zhvillimeve të reja. Përdorimi i polarizimit politik brenda një vendi është mjet tipik i llojit rus të kërcënimeve hibride, që e kemi parë më herët në Ballkan, siç është rasti i Malit të Zi¹⁰ në momentet kur vendi po synonte të bëhej anëtar i NATO-s. Sidoqoftë ky është vetëm një aspekt i kërcënimeve hibride ruse, të ravijëzuara në të ashtuquajturën Doktrina e Gerasimovit. Sipas kësaj doktrine, vetë natyra e luftës ka ndryshuar, kësaj përdorimi i mjeteve jo ushtarake për arritjen e objektivave politikë dhe strategjik shpesh arrin rezultate më të larta dhe më efektive sesa përdorimi i forcës. Lloji i aktiviteteve që përkufizon kërcënimet hibride nuk është i ri, më parë është quajtur me shumë terma si luftë speciale apo luftë indirekte, sidoqoftë arritja e rezultateve në përdorimin e këtyre metodave ka ndryshuar, duke kaluar prej niveleve taktike e ndonjëherë edhe operacionale në të kaluarën, në nivele strategjike në të sotmen.

Rasti i Kosovës mund të shihet si terren i favorshëm për Doktrinën e Gerasimovit. Një kalim nga efektet në nivelin taktik në atë strategjik mund ta ilustrojmë përmes një shembulli të thjeshtë në Kosovë në historinë e pasluftës. Deri në shthurjen e organeve paralele të Serbisë në Kosovë, Serbia përmes

⁹ Jan Joel Andersson, Thierry Tardy, "Hybrid operations: Lessons from the past", EUISS, 2015, f.5

¹⁰ Raporti i Komitetit për Marrëdhënie me Jashtë të Senatit të SHBA, 2019, f. 48

përdorimit të këtyre mekanizmave ilegale ka arritur vetëm objektiva në nivelin taktik, ku më së shumti këto objektiva kanë qenë të mbajnë popullsinë serbe të Kosovës të painkuadruar në shoqërinë kosovare. Me shpërbërjen e institucioneve paralele serbe dhe hyrjen e Listës Serbe në Kuvendin e Kosovës, Serbia ka instrumentalizuar përfaqësuesit serbë duke provuar të influencojë agjendat, të bllokojë ato dhe të krijojë potencial për destabilitet politik dhe institucional. Përmes përfaqësuesve politikë të komunitetit serb nëpër organet shtetërore, Serbia krijon potencial për të arritur objektiva strategjikë, përderisa objektivat e nivelit taktik ua ka lënë grupeve kriminale që veprojnë në veri të Kosovës. Një shembull i suksesshëm i kësaj metode ka rezultuar në Bosnje si pasojë e sistemit juridik atje, mirëpo rezultate të njëjta janë vështirë të arrihen në Kosovë për shkak të rrethanave të ndryshme. Serbia shfrytëzon sistemin legal të Kosovës dhe të drejtat që sistemi kushtetues kosovar ua jep minoriteteve, polarizimin politik që shpesh e faktorizon Listën Serbe, përbërjen etnike ku përmes organizatave kriminale që veprojnë në veri e dikton vullnetin e saj në terren të qytetarët kosovarë të etnisë serbe, përmes Kishës Ortodokse Serbe që proklamon vijën nacionaliste në raport me Kosovën e influencën krijimin e opinionit të serbët e Kosovës përmes ligjërimit fetar, si dhe shfrytëzon pozicionin problematik të Kosovës në rrafshin ndërkombëtar si pasojë e mosnjohjes, ku shpesh kemi qenë dëshmitarë të veprimeve dhe retorikës që do të ishte e patolerueshme në marrëdhëniet mes shteteve.

Interesat serbe dhe ruse në këtë rast duhet të asimilohen me njëra-tjetrën, përderisa e para synon mosfunksionalizimin e shtetit të Kosovës, projekt i mbështetur nga vendet perëndimore dhe e dyta synon luftimin e dominimit perëndimor në rajonin e Ballkanit dhe shtrirjen e dominimit të saj. Këto interesa kanë të përbashkëtat e tyre jo vetëm në rrafshin konceptual, por edhe në atë praktik. Duke shfrytëzuar minoritetet serbe në Ballkan, Serbia synon të shtrijë hegemoninë e saj dhe të ndikojë jetën politike në vendet fqinje, përderisa Rusia përmes shfrytëzimit të të njëjtave komunitete synon pengimin e arritjeve të objektivave të shteteve perëndimore në këto vende. Shembull i këtij bashkëpunimi është edhe ndërtimi i qendrës humanitare ruse në Nish, e cila është interpretuar si fasadë e një qendre të koordinimit të aktiviteteve të spiunazhit dhe aktiviteteve tjera armiqësore, me qëllim që të shërbejë si kundërpeshë ndaj dominimit perëndimor në Ballkan dhe shtytjes para të interesave ruse pikërisht përmes kërcënimeve hibride.

Faktorë të tjerë që e bëjnë Kosovën terren të favorshëm për veprime armiqësore kundër shtetësisë së saj janë lehtë të identifikueshëm. Korrupsioni, mungesa e sundimit të ligjit, përhapja e radikalizmit fetar, mungesa e mekanizmave që parandalojnë përhapjen e propagandës, mungesa e mekanizmave të luftimit të sulmeve kibernetike, gjendja social-ekonomike, polarizimi i thellë politik, e të

gjitha këto e bëjnë Kosovën vulnerable ndaj kërcënimeve hibride. Në anën tjetër, në proceset që Kosova pritet të kalojë deri në një marrëveshje përfundimtare me Serbinë, duhet të pritet që aktivitetet e fenomenit të trajtuar do të mund të shtohen dukshëm me qëllim të dobësimit të pozicionit të Kosovës në tavolinat e negociatave. Edhe pse aktivitetet e aplikueshme në Kosovë fatmirësisht kanë një kufizim të caktuar, si pasojë e pranisë së trupave amerikane dhe atyre të KFOR që shërbejnë si parandalues ndaj formave më agresive të kërcënimeve hibride, krijimi i një strategjie për t'i kundërpërgjigjur këtyre kërcënimeve duhet të konsiderohet i domosdoshëm. Duhet të jemi të vetëdijshëm për luftën hibride si kërcënim serioz. Rruga më e mirë e përballjes ndaj kësaj është vazhdimi i modernizimit të institucioneve të sigurisë, si në sistemet e pajisjeve dhe komunikimit, po ashtu edhe në programet kombëtare për ngritje të kapaciteteve të specializuara dhe vetëdijesimit publik. Modernizimi është përgjigja më e mirë e përbashkët ndaj kërcënimeve hibride. Ngritja e kapaciteteve, rritja e vetëdijesimit dhe përballja me luftën informative është domosdoshmëria për të garantuar sigurinë kombëtare në “epokën hibride”.

3. Ndikimi negativ i medias sociale në sigurinë kombëtare

Të gjithë jemi dëshmitarë të evolucionit dhe përdorimit të medias sociale në formimin e shoqërisë. Nga revolucioni i Twitter në Republikën e Moldavisë, në prill 2009, deri në “pranverën arabe”, aftësia e mobilizimit ishte e madhe, kur aksionet dhe ndikimi kalojnë një prag të caktuar të impulsit emocional. Të paktën po aq e rëndësishme sa lufta e informacionit është ndikimi i medias sociale si një instrument në sigurinë kombëtare. Përdorimi i gjerë i medias sociale dëshmon për të përcaktuar ndryshime të rëndësishme në sjelljen individuale të njeriut, në zhvillimin e shoqërisë dhe evolucionin e shpirtit të komunitetit, si dhe ndikimin e tij në demokracinë liberale si një sistem politik.¹¹ Edhe një herë, nuk është instrumenti i keq, përkundrazi, është një vlerë e shtuar për demokracinë, rrjedha e lirë e ideve, inkurajimi i njerëzve dhe dëgjimi i mendimeve të tyre. Por mënyra se si përdoret ky instrument mund të krijojë efekte anësore të shoqërisë që, të paktën, duhet të njohim dhe hulumtojmë në thellësi. Vetë interneti fillimisht ka krijuar një efekt anësor në shndërrimin e njerëzve që hyjnë në realitetin virtual në një grup shumë më soditës dhe pasiv, duke reaguar me një klikim përpara një kompjuteri sesa dalja në rrugë duke protestuar dhe pretenduar të drejtat e tyre në realitetin fizik. Media sociale ka avantazhin e arritjes së audiencës të synuar, njerëz të vendosur në vendndodhje të përcaktuara gjeografike dhe individë të larmishëm në të gjithë botën me preferenca specifike në politikë, shoqëri, besime fetare. Ajo përbën

¹¹ Iulian Chifu, Oazu Nantoi, Information warfare. The pattern of aggression, The Publishing House of the Institute of Political Sciences and International Relations “Ion I. C. Brătianu” of the Romanian Academy, 2016. f.34

një instrument që ka një pjesë të rëndësishme të ndikimit në ndryshimet në shoqëri dhe preferencat individuale. Për më tepër, është një mjet që mund t'i lejojë të gjithë të arrijnë gjithçka, përtej kufijve dhe barrierave të çdo lloji.

Ekzistojnë disa mënyra se si media sociale po ndikon në shoqëritë demokratike. Ajo ka një ndikim në sigurinë shoqërore përmes aftësive dhe efekteve anësore në fragmentimin e përgjithshëm të shoqërisë, në ndikimin e pjesëmarrjes në disa ngjarje, në aftësinë e tij të mobilizimit, në modifikimin e sjelljes njerëzore dhe sociale në disa mënyra. Me një lloj ndikimi të dyfishtë, ajo gjithashtu i referohet në mënyra të ndryshme llojit të ndryshëm të njerëzve - aktivë ose pasivë, sositës ose të prirur për veprim.¹² Ajo ka një ndikim të madh psikologjik tek individët dhe, si pasojë, në shoqëri përmes ndikimit dhe përhapjes së emocioneve kolektive, adresimit të pragmatizmit, theksimit të ndjeshmërive dhe shqisave dhe, në të njëjtën kohë, privimit të ndjeshmërive nga disa ngjarje humanizmi dhe realitete faktike. Krijon gjithashtu ndarje të mëdha midis perceptimeve dhe realiteteve me “fluska” që promovojnë ide jokritike dhe izolim nga idetë e tjera dhe debati i vërtetë. Krijon mjedise shumë miqësore me secilin nga mendimet, por kjo qasje krijon perceptime më të forta dhe të pazbardhura për të vërtetën dhe realitetin që nuk përballet me argumente të tjera dhe kurrë nuk i verifikon ato perceptime me realitetin dhe të vërtetën përreth nesh.¹³ Ajo favorizon idetë që tërheqin turmën dhe ato privilegjojnë deklarata nacionaliste dhe ekstreme, besime antisistem dhe mendimet e opinionet e mbështetura mirë dhe që përhapen përmes teorive të komplotit.¹⁴ Kështu që mediat sociale po promovojnë, me një shpejtësi të madhe, ide ekstreme dhe tronditëse, madje edhe ato pa ndonjë lidhje me të vërtetën ose realitetin, ndjesitë, emocionet dhe mendimet personale në vend të informacionit të verifikuar, analizave të ekspertëve, gazetarisë tradicionale me rregullat e saj të kontrollimit të fakteve. Prandaj, media sociale favorizon populizmin, nacionalizmin, ekstremizmin e çdo lloji, pasi ajo vë një theks të madh në emocione, perceptime në vend të realiteteve faktike. Media sociale ka një efekt anësor të copëzimit të shoqërisë. Fragmentimi i shoqërisë krijon një kërcënim të vërtetë për solidaritetin, bujarinë, frymën komunitare, pjesëmarrjen për qëllime të përbashkëta në bashkësitë lokale dhe përçarjet në shoqëri në tërësi. Krijon probleme të kohezionit në politikat e përbashkëta kombëtare dhe opsionet strategjike.

Ndikimi negativ i medias sociale është krijimi i identiteteve të forta, copëzimi i spektrit shoqëror dhe mungesa e dialogut dhe debatit, i cili është

¹² Julian Chifu, Oazu Nantoi, Information warfare. The pattern of aggression, The Publishing House of the Institute of Political Sciences and International Relations “Ion I. C. Brătianu” of the Romanian Academy, 2016, f.38.

¹³ Po aty, f.43.

¹⁴ Po aty.

një pjesë integrale e formimit të mendimeve dhe zhvillimit të një shoqërie demokratike. Përkundrazi, ne kemi thjesht individë me mendime të forta për tema të ndryshme, pa dëgjuar argumentet e të tjerëve. Ky është një kërcënim për sigurinë shoqërore. Në një pikë tjetër, media sociale po jep përgjigje të shkurtra, të dukshme, të ashpra dhe të rrepta për çdo lloj problemi. Në këtë mjedis, ne nuk kemi kohë për nuanca, përgjigje të përpunuara ose vlerësime komplekse, me pyetje të hapura dhe dilema të pazgjidhura. Kohezioni është i vështirë për t'u arritur dhe çdo vendim kritikohet ose mbështetet mbi emocione dhe jo në baza racionale.

Media sociale mbështet zhvillimin e populizmit, në nivele të ndryshme. Nuk ka të bëjë vetëm me ngacmimin e emocioneve dhe të fjalës së ashpër, me qëllim tërheqjen e shumë ndjekësve përmes saj. Është gjithashtu për të sfiduar elitat ekzistuese dhe promovimin e "njerëzve të thjeshtë" në ballë të publikut dhe institucioneve politike, duke i dhënë kënaqësi numrit të madh të njerëzve, pa ndonjë ambicie të vërtetë për të marrë ndonjëherë një detyrë publike. Dhe për këtë arsye, partitë tradicionale nuk mund të konkurrojnë me lëvizjet populiste për shkak të gjuhës së ekuilibruar, prirjes për të paraqitur detaje dhe nuanca në fjalime dhe në përpjekjen për të zgjidhur problemet reale, çështje që janë shumë më të ndërlikuara për t'u komunikuar grupeve të mëdha të ndjekësve sesa zgjidhje që duken të thjeshta, të sofistikuara, në mesazhet e qarta dhe të ashpra të drejtpërdrejta të populistëve. Ekzistojnë pesë elementë kryesorë të populizmit që zbatohen përmes përdorimit të mediave sociale: theksimi i sovranitetit të popullit, mbështetja për popullin, sulmi ndaj elitës, gërryerja e të tjerëve dhe evokimi i "traditës".¹⁵ Sovraniteti i njerëzve përkundrejt burokratëve, teknokratëve, ekspertëve, elitës në përgjithësi, është e thjeshtë për t'u kornizuar në teoritë e konspiracionit të përhapura nga populistët. Të pretendosh se populistët janë përfaqësuesit e vërtetë të njerëzve dhe institucionet ekzistuese, partitë, udhëheqësit janë të rremë - është e lehtë ta thuash në grupe të mbyllura në mediat sociale dhe në mjedisin e drejtuar nga mendimi i grupeve. Sulmi ndaj elitës është një detyrë e lehtë në median sociale ku emocionet dhe fjalët e ashpra kanë një shtrirje më të rëndësishme sesa gjuha e ekuilibruar dhe argumentet apo faktet racionale. Populistët janë shumë të mirë në gjetjen dhe përcaktimin e armiqve, dhe media sociale e bën më të lehtë krijimin e grupeve të prera, të qarta, ne dhe ata. Dhe thirrja e traditave, kohët e vjetra të mira, mënyra për të bërë gjëra në kohën tonë është më e lehtë në një mjedis emocional si ai i favorizuar nga media sociale. Ne mund të shtonim një përdorim të gjerë të fushatave specifike, për të përhapur mesazhe indikuese midis grupeve të ndjeshme të votuesve gjatë referendumeve si Brexit apo zgjedhjet presidenciale amerikane në 2016. Kjo taktikë do të ishte e pamundur

¹⁵ Iulian Chifu, Oazu Nantoi, Information warfare. The pattern of aggression, Bukuresht, 2016, f.45

para rrjeteve sociale. Populizmi është qasja e parë politike për të përfutur në median sociale. Nacionalizmi është një pikë tjetër e përcaktuar shumë mirë në mediat sociale, me ide shumë të qarta dhe deklarata koherente, të ashpra që krijojnë një numër të lartë ndjekësish. Mediat sociale gjithashtu kanë një ndikim të drejtpërdrejtë në identitetet. Dhe kjo ndryshon edhe peizazhin politik, duke ndikuar në sigurinë politike. Media sociale është një instrument i lehtë për t'u përdorur në krijimin e llojeve të reja të identiteteve dhe grupeve, me axhendat e ndryshme, në ndërtimin e grupeve të reja të kërkesave për kategori të reja të të drejtave ose avantazheve. Mbështetja për populizmin gjithashtu mund të vijë përmes promovimit në mediat sociale, të llojeve të reja të identiteteve.¹⁶ Krijimi i grupeve të reja mund të jetë një mënyrë për shpërndarjen e atyre të vjetra tradicionale, pasi në disa raste të tjera, media sociale dhe përdorimi i tepërt i internetit mund të dëmtojnë kohezionin shoqëror dhe të tjetërsojnë personin nga komuniteti dhe shoqëria. Efektet e mediave sociale që mbështesin dhe zhvillojnë populizmin dhe favorizojnë përhapjen e ideve populiste vijnë edhe nga sfidimi i udhëheqjes globale, luftimi i elitës, kundërshtimi i partive dhe institucioneve tradicionale. Ata përhapin ide të rishikimit të sigurisë globale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare, në vend se t'i ndryshonin, përshtatnin dhe reformonin ato.¹⁷

Siç e dimë, presioni i populizmit ka efektin e tij malinj në rendin botëror liberal dhe është shumë real. Populizmi do të thotë, përgjithësisht, qeverisja me një sy në media dhe tjetri në sondazhet. Dhe kjo çon në mediokraci dhe mediakraci. Ndikimi i mediave sociale në politikën tradicionale, ideologjitë dhe partitë gjithashtu ka një ndikim të rëndësishëm në hierarkitë e partive, përfshirë në partitë kryesore, ku liderët populistë favorizohen më shumë nga mediat sociale. Ata favorizojnë personalitete me më pak përgjegjësi dhe në gjendje të komunikojnë emocione, me fjalë të forta dhe forma ekstreme që po tërheqin publikun në vend të njerëzve me argumente dhe njohuri. Në një këndvështrim tjetër, media sociale ndihmon në promovimin e qasjeve ekstreme që dëmtojnë identitetet individuale dhe shoqërore.

Të gjitha këto kërcënime në aspektin shoqëror ndaj sigurisë kanë një ndikim të madh në mjedisin e ri të kërcënimeve, në çdo vlerësim aktual të tyre. Dhe të gjitha marginalizohen në çdo përpjekje aktuale dhe të ardhshme për të realizuar sigurinë dhe mbrojtjen e një kombi. Kjo është arsyeja pse të gjitha ato kërcënime jokonvencionale dhe jotradicionale që po dëmtojnë realitetin e pandryshueshëm të brendshëm i konsideronim si nevojë konstante dhe solide për t'u hulumtuar dhe njohur në një mënyrë shkencore dhe gjithëpërfshirëse

¹⁶ Francis Fukuyama, *Identity, Contemporary Identity Politics and the Struggle for Recognition*, London, 2018, f.126

¹⁷ Iulian Chifu, "Technology and Democracy. The Impact of the Evolution of Security and International Relations", National Defence University, Bukuresht, 2019, f.14

në mënyrë që të parandalojmë shfaqjen e llojeve të reja të konflikteve. Është e lehtë të kuptohet se ndikimi i zhvillimeve teknologjike në perceptimet e kërcënimeve individuale dhe shoqërore po ndikojnë në nivelin më të lartë të sigurisë kombëtare.¹⁸ Ndryshimi i raporteve shoqërore, copëzimi dhe tjetërsimi i individit, humbja e ndjenjës së shpirtit në bashkësi ose kohezionit shoqëror po ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë kombëtare. Për më tepër, dobësitë e reja mund të përdoren nga aktorët e jashtëm që mund të përfitojnë nga këto evolucione dhe mungesa e parandalimit.

Përfundime

Brezi aktual i kërcënimeve për sigurinë kombëtare ka një format shumë specifik, kjo është arsyeja pse ne priremi të supozojmë se mund të flasim për një ndryshim në vetë natyrën e kërcënimeve për sigurinë kombëtare. Kërcënimet jokonvencionale që kemi studiuar tashmë janë një tipologji hibride e kërcënimeve të zhvilluara mbi dobësitë e brendshme që kthehen në kërcënime. Është rasti i të gjitha karakteristikave të vlerave dhe parimeve të demokracisë, të cilat konsiderohen të cenueshme nga disa aktorë shtetërorë dhe joshtetërorë, që ndërtojnë instrumente me qëllim që të përfitojnë nga ato karakteristika, duke u bërë kërcënime reale me burime të jashtme kundër shoqërive demokratike, që vijnë nga spekulimet e vlerave dhe parimeve të sistemeve demokratike.

Një burim tjetër për ato kërcënime jokonvencionale gjenerohet nga spekulimet e dobësive të brendshme të shoqërive demokratike që vijnë nga evolucioni i teknologjisë dhe ndikimi i saj në shoqëri. Mbizotërimi i medias sociale dhe informacionit, dronët dhe armët hipersonike po formësojnë mjedisin e sigurisë së të ardhmes, me ndikim në qasjen dhe mënyrën e të menduarit për çështjet që lidhen me sigurinë. Dhe konkretisht, ndryshimi më i thellë vjen nga ndikimi i teknologjisë në vetë demokracinë. Teknologjia ka një ndikim të jashtëzakonshëm në demokraci dhe shoqëri përmes ndikimit të drejtpërdrejtë në kriteret dhe sjelljet që lidhen me kohezionin shoqëror - solidaritetin, ndjenjën e bashkësisë, tjetërsimin dhe copëzimin. Në një pikë tjetër, ndjenja e mungesës së privatësisë, identitetit të ndryshuar - individual dhe kolektiv, nevoja për dinjitet dhe respekt, të gjitha janë efektet e reja të teknologjisë në jetën tonë të përditshme që kanë një ndikim në shoqërinë tonë dhe pjesëmarrjen në proceset demokratike, si dhe mbi jetën e komunitetit, mbi përmbajtjen e demokracisë sonë. Këto procese specifike janë nënvizuar në një numër studimesh nga autorë të ndryshëm. Këto evolucione vetë po krijojnë dobësi për shoqërinë tonë me të cilën duhet të përballemi. Bazat e këtij reagimi duhet të jenë ndërtimi i elasticitetit (aftësisë ripërtëritëse) për shoqërinë tonë.

¹⁸ Iulian Chifu, "Technology and Democracy. The Impact of the Evolution of Security and International Relations", National Defence University, Bukuresht, 2019, f.16

Dhe kjo nuk është diçka e lehtë, pasi kjo aftësi ka nevojë për përfshirjen e shtetit, shoqërisë dhe individëve.

Bibliografia

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare, Tiranë, 2014.
2. Strategjia ushtarake, Tiranë, 2015.
3. RSM 2019.
4. Siguria e shteteve të vogla, Tiranë, 2013.
5. Regional security challenges – Role of Albania, Tiranë 2018.
6. Stanislav Secieru, “Russia in the Uestern Balkans”, EUISS, 2019.
7. Jan Joel Andersson, “Hybrid operations: Lessons from the past”, EUISS, 2015.
8. Barry Buzan, “People, States and Fear”, 1991.
9. Francis Fukuyama, Identity, Contemporary Identity Politics and the Struggle for Recongnition, London, 2018.
10. Iulian Chifu, “Technology and Democracy. The Impact of the Evolution of Security and International Relations”, National Defence University, Bukuresht, 2019
11. Eric Stern, Crisis Decision making. A Cognitive institutional approach, Swedish National Defence College, Stockholm, 2003.
12. Iulian Chifu, Oazu Nantoi, “Information warfare. The pattern of aggression”, Bukuresht, 2016.

UKRAINA, ORIGJINA E KONFLIKTIT

Msc. Roland Tashi

Alism, Ministria e Mbrojtjes

Trajtesë e shkurtuar. Historia tregon se për të analizuar origjinën e një konflikti, fillesat e një lufte apo kryengritje, duhet studiuar dhe “gjurmuar” thellë në shekuj deri sa të kuptohen, qartësohen arsyet, rrethanat favorizuese, si dhe shkaku përfundimtar që është gjetur për të justifikuar nxitjen dhe fillimin e tyre. Kjo është e ngjashme me përcaktimin e individualitetit të një personi publik, që, për të kuptuar sa më shumë rreth tij, analizohet pema gjenetike dhe formimi, ndërsa për të kuptuar një komb, e vetmja mënyrë e besueshme është të hulumtosh në historinë e tij. Vetëm kështu mund të qartësohemi se kur flasim për luftën mes dy vendeve, historia ofron çelësin më të përshtatshëm për të kuptuar arsyet.

Lufta në Ukrainë tregon se Evropa jeton një të përditshme paqësore të veshur me traktate dhe parime të diktuar nga Bashkimi, por në vende të tjera jo shumë larg saj kjo nuk është e vërtetë, madje zhvillohet luftë, dëgjohen shpërthimet e predhave dhe raketave dhe mbizotëron trishtimi. Këtë panoramë, e cila na kujton ngjarjet e viteve 90-të gjatë konflikteve në rajonin e Ballkanit, po e shohim përsëri në Ukrainë.

Epoka moderne solli njëherësh me zhvillimin ekonomik edhe “kultivimin”, zgjimin e disa mosmarrëveshjeve të fjetura për shekuj, të tjera më të fshehta dhe gjithmonë të gatshme për t’u rindezur. Ukraina është sigurisht një nga këto raste ku mosmarrëveshjet ndërmjet saj dhe Rusisë kanë rrënjë të thella që datojnë të paktën në shekullin e tetëmbëdhjetë dhe ndoshta më herët. Një nga ngjarjet më esenciale që ndryshoi marrëdhëniet dhe ekuilibrin e forcës në Evropën Lindore, është padyshim edhe beteja e Poltavës në vitin 1709.

Për përgatitjen e këtij shkrimi është shfrytëzuar dhe punuar artikulli “Ukraina, origjina e konfliktit”. Artikulli është botuar në muajin prill 2022 në portalin e pavarur italian “Difesa Online”, specializuar në sektorin e mbrojtjes. Opinionet e trajtuara në shkrime shprehin vetëm mendimin dhe gjykimin e autorëve.

1. Suedia mbizotëruese dhe Rusia në rritje

Një nga udhëheqësit e shquar në histori, Gustavo Adolfo i Suedisë, luajti një rol kryesor në ngjarjet e mëdha të shekullit të shtatëmbëdhjetë. Nën sundimin e tij, Suedia përparoi dhe u zhvillua në shumë drejtime, veçanërisht në fushën ushtarake. Përvoja e fituar në luftën 30-vjeçare u kthye në simbol trashëgimie për të gjithë mbretërit suedezë, sundimtarët e Stokholmit, të cilët zgjeruan territoret e tyre mbi popullsitë e ndryshme të Evropës Veriore. Danimarka, Polonia, Saksonia dhe Rusia u përpoqën të kundërshtonin ekspansionin suedez, por Karli XII¹ i mposhti kundërshtarët e tij në një seri betejash, në atë që kujtohet si Lufta e Madhe e Veriut. Në vitin 1705 mbreti i Suedisë e detyroi Poloninë për paqe pasi në vitin 1701 mori Rigën, në vitin 1703 pushtoi Pulutskin, në vitin 1705 Grodnonin dhe në vitin 1706 Saksoninë. Në radhën e fitoreve, më e rëndësishme mbetet ajo e vitit 1700 ndaj Pjetrit të Rusisë, kur Karli XII ishte vetëm 18 vjeç. Pas fitores së Narvës, ai e vlerësoi Rusinë si një kundërshtar të dobët ndaj së cilës duhej kushtuar pak vëmendje. Pjetri, ndryshe nga sundimtari suedez, ishte një figurë më e arrirë, më i pjekur politikisht, me kulturë të lartë, që ndiqte me vëmendje zhvillimet në Evropën Perëndimore. Pjetri synonte që Rusinë ta kthente nga një regjim gjysmëfeudal në një shtet të përparuar dhe të pasur, ku shtresat e larta fisnike të përfshiheshin në mënyrë aktive në jetën politike, në strukturat ekzekutive dhe ato ushtarake të kohës. Ushtria e Pjetrit të Madh u reformua, njësitë e vjetra u zëvendësuan nga regjimente moderne me oficerë këmbësorie. Ndër komandantët e tij më të vlefshëm kujtojmë princin Aleksandër Menshikov (1673-1729), i cili kishte shërbyer në ushtrinë e vogël të Pjetrit dhe Kontit Sheremetiev, një admirues i reformizmit të Carit.

Midis dy pretendentëve, aktorëve kryesorë sundues në rajon, Rusisë dhe Suedisë, ishte edhe një aktor i tretë, Ukraina ose e njohur ndryshe si toka e Kozakëve, ku Ivan Mazepa² mund të vepronte, vendoste një ekuilibër ndërmjet dy aktorëve kryesorë.

¹ Charles XII, lindi më 17.06.1682, Stockholm, ndërroi jetë më 30.11. 1718, në Norvegji. Mbret i Suedisë nga 1697–1718.

² Mazepa Ivan, lindi 30.03.1639 në Mazepyntsi, ndërroi jetë më 02.10.1709 në Bendery, Moldavi. Ishte Ataman, titull i lartë i udhëheqësve kozakë, studioi në kolegjin “Kyivan Mohyla” dhe “Jesuit College” në Varshavë.

Ivan Mazepa ishte një nga figurat më të diskutueshme të Evropës Lindore. Në vitin 1700, Mazepa ishte Hetman (Ataman, titull i lartë i ushtrisë kozake Zaporozhiane) dhe ushtronte pushtet absolut mbi pjesën lindore të Ukrainës. Marrëdhëniet etnike dhe territoriale tregonin një realitet të çorganizuar, ku popullsia ukrainase ishte e përshkueshme nga kultura të ndryshme. Për një kohë të gjatë kozakët e Ukrainës i shërbyen principatës moskovite por, kur shpërtheu lufta kundër Suedisë, Ivan Mazepa ndryshoi në mënyrë drastike kursin, duke zgjedhur të bashkohej me sundimtarin suedez. Ky ishte një veprim që do të linte gjurmë në histori: qëndrimi pro Suedisë u pasua jo vetëm me një “*damnatio memoriae*” për Mazepën, dënimin e kujtesës për figurën e tij, por ishte gjithashtu pararoja, fillimi i fatkeqësive të popullsisë kozake të Ukrainës. Tradhtia e Mazepës dhe ndryshimi i linjës politike shkaktuan një përçarje brenda kozakëve. Pjetri, kur u informua për qëndrimin, kthesën e tij, emëroi menjëherë një udhëheqës tjetër si Ataman, Ivan Skoropadsksin. Ardhja në fron e Pjetrit dhe ambiciet e tij perandorake zbehën përgjithmonë ëndrrat e Mazepës, i cili dëshironte të krijonte një Etamanat të madh Kozak me kufijtë e shtrirë drejt pjesës perëndimore të Ukrainës. Reformat e zbatuara nga Pjetri u përhapën në Ukrainë duke gërryer, dëmtuar dhe sabotuar fuqinë dhe prestigjin e Mazepës.

Në vitin 1708, kur tradhtia kishte dalë në dritë dhe ishte e qartë për të gjithë, Pjetri filloi ofensivën kundër tradhtarit duke pushtuar Baturyn, kryeqytetin e Mazepës. Kronikat ukrainase të kohës përshkruanin pushtimin e qytetit duke denoncuar masakrat e tmerrshme të kryera nga ushtria ruse. Pjetri arriti një fitore të rëndësishme jo vetëm ushtarake por edhe morale, duke synuar që nëpërmjet fitores së arritur të tërhiqte, grumbullonte rreth tij të gjithë kozakët e pavendosur.

Me aleancën e mbetur të Mazepës dhe shumicës së kalorësve kozakë, Karli XII hartoi një plan për të goditur me vendosmëri kundërshtarin. Mundësitë, variantet që duhet të përdorte për të sulmuar ishin të pakta: - të sulmonte nga veriu në drejtim të Shën Petersburgut, - të ndërhynte në drejtim të Moskës ose nga jugu i Ukrainës ku sundimtari suedez kishte si aleat Mazepën. Opsioni i parë ishte i rrezikshëm pasi do ta kthente një pjesë të territorit suedez në një fushëbetejë; plani më i mirë ishte të drejtohej nga Moska, nëpërmjet Smolenskut, e njëjta rrugë që ndoqi më pas Napoleoni në vitin 1812. Megjithatë, Pjetri ishte i bindur se ushtria suedeze do të përparonte drejt Shën Petersburgut, edhe pse Karli XII i besoi gjeneralit Lubecker ekzekutimin e manovrave diversioniste nga Finlanda.

2. Beteja e Poltavës

Ngjarjet që pasuan pushtimin e Polonisë dhe avancimin në Rusi e detyruan

Karlin XII të ndryshonte planet e tij. Faktori kryesor që ndikoi në ndryshimin e strategjisë së luftimit të mbretit suedez ishte taktika e "tokës së djegur" që po zbatonte ushtria ruse, e cila "kujdesej" që gjatë tërheqjes të mos i linte asgjë të shfrytëzueshme armikut. Pjetri e kuptoi se kundërshtari i tij nuk synonte të kërcënonte Shën Petersburgun, por të shkonte drejt Moskës duke kaluar përmes të ashtuquajturës "porta e lumit", midis rrjedhave të sipërme të Dvinës dhe Dnieperit dhe jo nëpërmjet vendeve Baltike. Sundimtari suedez, gjatë avancimit dhe fazave të luftimit, ndeshej vazhdimisht me vështirësi, të krijuara nga rezistenca e ushtrisë ruse si dhe nga natyra, kushtet jo të favorshme të terrenit, problemet me furnizimin në kohë me logjistikë dhe teknikë luftarake. Në këto kushte, situata kërkonte rishikimin dhe ndryshimin e planeve të luftimit.



“Drita në fund të tunelit” erdhi nga Ukraina, kur Ivan Mazepa u deklarua hapur në dispozicion të një aleance kundër Pjetrit. Ukraina ofronte gjithçka që i nevojitej ushtrisë suedeze, furnizime me ushqime si dhe mundësinë e strehimit, qëndrimit në ambiente, fushime dimërore për përballimin e kushteve të vështira të motit. Karli XII shpresonte gjithashtu të merrte përf forcime të konsiderueshme ushtarake jo vetëm nga ukrainasit, por edhe nga Polonia fqinje dhe Turqia. Më 11 tetor 1708 mbreti i Suedisë marshoi në drejtim të Ukrainës duke mposhtur rusët në Romny, Gadyach dhe Lokhvitsa, por dukej se ushtria e tij kishte rënë në “kurth”. Dimri i akullt i tokave ukrainase thajse kishte paralizuar ushtrinë suedeze e detyruar të shpërndahej për të gjetur strehim nëpër fshatra. Nga ana tjetër, kalorësia e Pjetrit e cila mbikëqyrte të gjitha lëvizjet e armikut, ndjeu dhe shfrytëzoi dëshpërimin e tyre duke qenë gjithmonë gati për të zmbarsur sulmet ndaj Kharkovit dhe Kurskut. Me

ardhjen e pranverës, ushtria e Karlit XII ishte në afërsi të Poltavës, duke pritur me anktë përforcime të mëtejshme nga Polonia. Ndërkohë, trupat ruse të princit Menshikov u përqendruan në Vorskla, pikërisht përballë dislokimit suedez.

Beteja filloi sipas një modeli klasik rrethimi: suedezët hapnin llogore përpara Vorsklas, ndërsa trupat e këmbësorisë së lehtë dhe të kavalerisë ruse vepronin në pararojë për të goditur, vonuar dhe bllokuar lëvizjen e trupave kundërshtarë. Në muajin qershor, në fushën e betejës mbërriti vetë Car Pjetri, i cili vendosi të sulmojë në drejtim të Poltavës duke pasur një epërsi të padyshimtë numerike. Beteja ishte një sukses i plotë për rusët që arritën një fitore dërrmuese kundër Karlit XII. Mazepa dhe kozakët e tij luftuan me të gjitha mjetet dhe forcat, megjithatë guximi i tyre nuk mjaftoi, në fund të luftës ata u përballën me tërbimin hakmarrës të Carit. Kozakët e mbijetuar, sipas një urdhri të prerë të Pjetrit duhej të silleshin para tij, që nënkuptonte vdekjen e sigurtë. Më 31 qershor 1709, rreth 20 000 ushtarë suedezë nga Ukraina u kapën robër dhe më pas u liruan në vitin 1721, vetëm pasi pretendentët nënshkruan Traktatin e Nystadt. Nga ana tjetër, Karli XII, pas disfatës në Poltava, u strehua nën mbrojtjen e turqve në qytetin Bender, qytet që në atë kohë ishte pjesë e Perandorisë Osmane ndërsa sot ndodhet në Moldavi. Me ndihmën e Tatarëve të Krimesë dhe Kozakëve Zaporizhzhya, ai filloi të përshkallëzojë situatën në kufirin jugor të Rusisë.

3. Mazepa i mallkuar

Fitorja në Poltava ndryshoi përgjithmonë ekuilibrin e fuqisë në Evropën Lindore, duke fshirë nga historia hegjemoninë suedeze që kishte zgjatur për gati një shekull në këto troje dhe duke sjellë në skenën gjeopolitike të kohës pushtetin e Pjetrit të Madh si fuqi mbizotëruese në të njëjtin nivel me fuqitë e tjera perëndimore.

Propaganda cariste bënte vazhdimisht presion që urrejtja ndaj Mazepës të mos binte kurrë në harresë, kozakët të shiheshin në armiqësi me kishën ortodokse duke e shtyrë Ukrainën në anën e katolicizmit polak. Jehona e pabesisë së Mazepës arriti edhe në vende të tjera ku censura cariste nuk ishte në gjendje të vinte veton. Ndër pikëpamjet e figurave të shquara të kohës mbi ngjarjet dhe sjelljen e Mazepës ishte ajo e Volterit, i cili në analizën e tij tregonte simpati për Karlin XII dhe Suedinë. Sipas Volter, Mazepa ishte një njeri "guximtar" që kishte qëndruar në krah të aleatit të tij deri në fund. Volteri gjithashtu deklaronte se Ukraina kishte kërkuar gjithmonë lirinë, larg ndikimit moskovit, polak dhe osman.

Ngjarjet e kohës flasin për një histori me linja të diskutueshme të "nacionalizmit". Aktualiteti i sotëm, teatri i veprimeve luftarake në Ukrainë tregojnë se ngjarjet

dhe kontradiktat i kanë rrënjët shumë të thella në histori. Në rast se skenari i luftimeve në kohën e Mazepës përgatitej nga Cari Pjetri i Madh, sot duket se skenarët dhe planet që pasohen me veprimet luftarake në Ukrainë, miratohen nga Car Putini.

Në epokën moderne, Ukraina ka shfaqur një ndjenjë të theksuar anti ruse me synimin për një autonomi të dëshiruar e cila shtyn drejt kërimit të aleatëve që mund ta garantojnë atë. Pyetja shtrohet: nëse aktorët politikë që veprojnë në skenën e kësaj krize ndërkombëtare, mundet të veprojnë si Karli XII, por pa shkaktuar një Poltava të dytë të rrezikshme.

RËNDËSIA E PËRGATITJES FIZIKE NË FORCAT E ARMATOSURA

Dr. Valbona Zekaj

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Ky shkrim trajton rëndësinë e veçantë që ka programi i përgatitjes fizike në Forcat e Armatosura dhe veçanërisht në Akademinë e FA, me qëllimin për të ndihmuar drejtuesit ushtarakë dhe specialistët e përgatitjes fizike të formulojnë dhe zbatojnë një politikë të stërvitjes fizike e ushtarake sa më efikase.

Materiali trajton me hollësi se si ushtrimet fizike kanë impakt të drejtpërdrejtë në shëndetin e njeriut, duke ndikuar pozitivisht në kontrollin e peshës, luftimin e sëmundjeve të ndryshme, përmirësimin e humorit, forcimin e qëndrueshmërisë, rritjen e energjisë etj. Në të njëjtën kohë shtjellohet dhe rreziku për personelin ushtarak, kur ai nuk ushtron në mënyrë të rregullt përgatitjen fizike.

Shkrimi mbyllet me disa përfundime dhe rekomandime me synim përmirësimin e programit të përgatitjes fizike, si dhe përballjen e trupës ushtarake me sfidat e fitnesit fizik.

Fjalët kyçe: përgatitje fizike, Forcat e Armatosura, stërvitje, fitnes, ushtrime, sëmundje.

1. Rëndësia e përgatitjes fizike

Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbështetur në misionin e tyre kushtetues, janë të angazhuar në ruajtjen e integritetit dhe sovranitetit të vendit, duke ushtruar në mënyrë të vazhdueshme përgatitje dhe stërvitje ushtarake, me qëllim mbajtjen në nivel sa më të lartë të operacionalitetit dhe të gatishmërisë. Krahas misionit themelor Forcat e Armatosura janë të angazhuara gjithashtu në kryerjen dhe mbështetjen e operacioneve të emergjencave civile, si dhe ne operacionet jashtë vendit në kuadër të angazhimit në Aleancën e Atlantikut. Baza e një fuqie sa më të plotë ushtarake është trekëndëshi i njohur për çdo ushtri të botës: forcë-moral-motivim. Kur flasim për komponentin e forcës duhet të theksojmë se krahas pajisjes me armatim dhe teknologji një vend të rëndësishëm zë përgatitja e personelit ushtarak dhe në veçanti përgatitja fizike.

Në përcaktimin e fuqisë luftarake ka pak rëndësi sa të përparuara janë platformat, armatimet ose pajisjet e njërive ushtarake, nëse njerëzit që i drejtojnë ato janë të pamotivuar, janë të pa stërvitur ose u mungon udhëheqja e duhur.¹ Sot, trupat ushtarake të Shqipërisë janë të angazhuara në mjaft detyra operacionale dhe për pasoje ato janë dislokuar në misione brenda vendit, ashtu edhe në misionet paqeruajtëse, ku për pasoje nuk gjejnë kohë të mjaftueshme për të bërë përgatitje fizike dhe stërvitje të programuara si në kohë normale. Kondicioni fizik, si komponent i performancës sportive, formohet nga veprimi i përbashkët me përparësi i proceseve energjetike të organizmit dhe muskulaturës, duke u shfaqur si aftësia e forcës, shpejtësisë, qëndrueshmërisë dhe lëvizshmërisë artikulare, në bashkërendim me cilësitë e domosdoshme psikike të këtyre aftësive.² Në këtë pikëpamje mundet të paraqitet si një rrezik i madh për personelin ushtarak, kondicionimi fizik, obeziteti apo sëmundje të tjera që lidhen me mos ushtrimin e rregullt fizik.

Ky rrezik është i njëjtë si për ata që kryejnë mision jashtë edhe për personelin ushtarak që vepron brenda vendit. Personeli komandues dhe drejtues në Forcat e Armatosura duhet të sensibilizojnë të gjitha nivelet e personelit që

¹ Doktrina e Forcave të Armatosura (DP-01), fq. 2-30.

² Rregullore testi ushtarak i përgatitjes fizike (TUPF), fq.7, viti 2013

merren me përgatitjen fizike dhe stërvitjen ushtarake për menaxhimin sa më të mirë të kohës së tyre për të siguruar që përgatitja fizike dhe stërvitja ushtarake të kryhen pavarësisht rrethanave. Ushtrimet e rregullta fizike dhe në këtë kontekst përfitimet e drejtpërdrejta që janë “përfitimet shëndetësore” nuk mund të injorohen, ndaj shtrohet si nevojë dhe përparësi përgatitja fizike për të gjithë personelin ushtarak.

Ushtrimet fizike që ushtrojnë ushtaraket në terrene sportive apo palestër, padyshim i bëjnë ata të aftë fizikisht dhe në të njëjtën kohë u nevojiten atyre për të kryer detyra sa më të vështira, si për shembull, marshimet në distanca të gjata gjatë operacioneve komplekse ose operimi në zona që nuk janë lehtësisht të lundrueshme. Drejtuesit në strukturat e FA, trupa pedagogjike në Akademi duhet të organizojnë fushata të trajnimit fizik për të promovuar aftësi të besueshme për trupat e tyre, në mënyrë që ata të mund të përballen me çdo lloj ngjarjeje, veçanërisht ato që ndodhin në mënyrë të papritur. Qëllimi i edukimit të drejtuesve për “Health and Fitness” (H&F) është të përgatisë liderët për të komunikuar, kuptuar, krijuar dhe mbështetur sistemin (H&F) brenda strukturave të tyre. Udhëheqësit duhet të kuptojnë rolin e tyre organizativ nga mbikëqyrja për trajnimin për burime. Qofshin në komandë apo jo, drejtuesit në strukturat e FA duhet të zotërojnë njohuritë e praktikave më të mira. Rezultati i këtij edukimi udhëheqës është përputhja e përmirësuar me programimin H&F, me shpërndarjen e burimeve duke bërë kështu një ulje të rasteve për sëmundje fizike dhe psikologjike. Këto rezultate ndodhin kur udhëheqësit kuptojnë

Ushtrimet dhe aktiviteti fizik, tashmë është vërtetuar shkencërisht se janë efektive sidomos në kontrollin e peshës.³ Përgatitja fizike ndihmon në djegien e kalorive dhe luftimin e obezitetit të ushtarakëve. Padyshim kjo është një përgjegjësi në radhë të parë e çdo ushtaraku në mënyrë individuale, por edhe e strukturave drejtuese të përgatitjes fizike në të gjithë piramidën e Forcave të Armatosura.

Ushtrimet fizike ndihmojnë trupin të luftojë sëmundjet. Bazuar në kërkimet fiziko-shëndetësore, ushtrimet e rregullta fizike rrisin në trupin e njeriut lipoproteinën me densitet të lartë (HDL), ose atë që quhet kolesterolin “e mirë” dhe ul trigliceridet, të cilat nuk janë të shëndetshme për shëndetin e njeriut dhe në të njëjtën kohë mbajnë gjakun tuaj të rrjedhë pa probleme, gjë që ul rrezikun e sëmundjeve kardiovaskulare.

Përfitimet janë shumë më të mëdha se sa kaq, në fakt, aktiviteti i rregullt fizik mund t’ju ndihmojë të parandaloni ose menaxhoni një gamë të gjerë problemesh dhe shqetësimesh shëndetësore, duke përfshirë goditjen në tru, sindromën

³ <http://www.nutritionstrategy.com/weightcontrol.html>

metabolike, diabetin e tipit 2, depresionin dhe disa lloje të kancerit, artritis etj.

Komandat e njësive ushtarake dhe drejtuesit e te gjitha niveleve duhet të ruajnë infrastrukturën e përgatitjes fizike dhe ndërkohë të ndërtojnë objekte të reja shtese te trajnimit fizik, në mënyrë që të inkurajojë sa me shume personelin ushtarak dhe civil në Forcat e Armatosura që të bëjnë sa më shumë përgatitje fizike duke ndikuar drejtpërdrejtë në përmirësimin e mirëqenies së tyre.

Përgatitja fizike ndikon ne përmirësimin e humorit. Është mjaft domethënëse kur themi se gjendja psikologjike dhe e humorit të personit ndikon në kryerjen me sukses ose jo te misionit te tyre. Është vërtetuar se ushtrimet fizike stimulojnë hormone të ndryshme të trurit që mund ta bëjnë një person më të lumtur dhe përfundimisht të relaksuar. Është detyre e te gjithë drejtuesve dhe stafeve pedagogjike të përgatitjes fizike në Akademinë e Forcave te Armatosura të shfrytëzojnë rastin për të ngritur moralin e trupave duke stimuluar dhe promovuar përgatitjen fizike në te gjithë strukturat e Forcave te Armatosura.

Rritja e energjisë. Individit që tregon kujdes dhe vlerëson bodybuilding-un, gëzon gjithmonë më shumë force dhe energji. Ushtrimi dhe aktiviteti fizik jep oksigjen dhe lëndë ushqyese në indet e trupit dhe ndihmon një sistem kardiovaskular për të punuar më shpejt. Gjithashtu, kur zemra e individit dhe mushkëritë punojnë në mënyrë më efikase, ai ka më shumë energji, e cila mund ta mbështesë atë të bëjë shumë aktivitete. Pra, është e domosdoshme dhe e nevojshme që personeli ushtarak kudo qe të jetë i dislokuar, në çdo kohë, duhet të ushtrojë më shumë veprimtari fizike, në mënyrë që t'i përgjigjet sa më mirë detyrave të tyre në përputhje me rrethanat.

Promovimi i gjumit më të mirë. Studime të ndryshme, nëpërmjet argumenteve të tyre kane dalë në përfundimin se aktiviteti i rregullt fizik mund t'i ndihmojë njerëzit të bëjnë një gjumë të thellë dhe të rehatshëm. Për këtë arsye, njerëzit që përfundojnë mungesë të gjumit efektiv, këshillohet të bëjnë sa me shume dhe rregullisht përgatitje fizike. Personeli ushtarak duhet të ushtrojë çdo ditë aktivitet fizik, në mënyrë që ai të pushojë lehtë pas stërvitjes së rëndë rutinë të përditshme.⁴ Gjithashtu, krahas një gjumi të mirë, përgatitja fizike e bën personin që e ushtron atë të ndihet energjik dhe të duket më mirë emocionalisht, gjë që mund të ketë një efekt mjaft pozitiv në jetën e tij/saj seksuale.⁵ Si përfundim, edukimi fizik duhet të vazhdojë të ofrohet dhe ushtrohet për përmirësimin e shëndetit të njeriut në të gjitha sferat e jetës.

2. Promovimi i përgatitjes fizike - nevojë e qenësishme për Forcat e Armatosura.

Mjedisi i sigurisë sot është i paparashikueshëm dhe i ndryshëm, ku ai

⁴ <http://www.nutritionstrategy.com/weightcontrol.html>

⁵ Mark Stibich, Ph.D "How Exercise Makes Sex Better"

përballat me sfida te shumta qe lidhen me rreziqe nga me te ndryshme qoftë ato me karakter global por edhe me ato të karakterit kombëtar. Sot, kur teknologjia ka avancuar jashtëzakonisht shume, kërkohet qe krahas kufizimit te personelit ushtarak t'i jepet rendësi kompensimit te këtij komponenti me përgatitjen profesionale.

Praktikisht, Forcat e Armatosura të RSH që në fillimet demokratike dhe me vone pas anëtarësimit ne NATO, në vitin 2009, ka ardhur duke u reduktuar në personelin ushtarak, por nga ana tjetër ka rritur fleksibilitetin nëpërmjet ngritjes profesionale dhe modernizimit të forcës nëpërmjet rritjes se teknologjisë. Pavarësisht se lufta po bëhet gjithnjë e më shumë teknike, kjo nuk do të thotë se aftësitë fizike të një luftëtari nuk janë më të rëndësishme. Kjo është vërtetuar nga përvoja e kontingjenteve të Forcave të Armatosura që kanë kryer misione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në kuadër të NATO-s, BE-se dhe OKB-se. Një trupë ushtarake e përgatitur fizikisht mund të përballojë me sukses në beteje një kundërshtar, pavarësisht teknikës dhe teknologjisë në epërsi qe mund te ketë ai. Në këtë pikëpamje është mjaft e rëndësishme që krahas modernizimit, zhvillimit teknologjik të Forcave të Armatosura, zhvillimit të stërvitjeve e trajnimeve për njohjen e armëve dhe pajisjeve moderne, drejtuesit duhet të kenë në qendër te vëmendjes që të sigurojnë aftësitë e duhura fizike për trupat e tyre. Ndaj del si detyrë parësore që në kohë paqe një rëndësi e madhe t'i kushtohet programit të përgatitjes fizike. Është e njohur shkencërisht që niveli i performancës dhe i aftësive fizike të trupave dhe luftëtarëve gjatë zhvillimit të krizave dhe operacioneve të ndryshme fillojnë të ulen, për shkak të kohës së pamjaftueshme për t'u rikuperuar fizikisht ose për të bërë ushtrime fizike gjatë operacioneve. Shëndeti dhe përgatitja fizike përben sistemin e gatishmërisë fizike të Forcave të Armatosura. Kjo arrihet nëpërmjet pesë elementeve të qëndrueshme siç janë: politikat, programi, personeli, pajisjet/burimet dhe edukimi i lidershipit.

Forcat e Armatosura duhet të trajnohen mirë për të ruajtur aftësinë e tyre fizike, për të lëvizur dhe për të përballuar kushtet e betejës në terrene që mund të jenë të mëdha dhe të vështira për t'u trajtuar. Sa më sipër, strukturat e FA-ve duhet të hartojnë, zhvillojnë dhe zbatojnë një politikë të trajnimit të vazhdueshëm për t'u mundësuar trupave të kenë vazhdimisht një nivel të lartë të performancës fizike përpara se ato të nisin misionet për kryerjen e operacioneve të ndryshme. Investimi i liderit është thelbësor për të promovuar, trajnuar dhe përmirësuar gatishmërinë e ushtarëve dhe njërive. Drejtuesit duhet të nxisin ndryshimin kulturor duke siguruar burimet për atë ndryshim. Suksesi apo dështimi i Sistemit të H&F (Health & Fitness) varet nga cilësia e udhëheqjes së tij. Udhëheqja është procesi i ndikimit tek ushtarët nga ofrimi i qëllimit, drejtimit dhe motivimit.⁶

⁶ FM 7-22 Holistic Health and Fitness, fq. 7-22

Drejtuesit e njësive janë përgjegjës për suksesin e Sistemit të H&F dhe janë përgjegjës për rezultatet e njësive të tyre, duke qenë të vetëdijshëm se ky sistem kërkon shumë më tepër sesa planifikimin dhe mbikëqyrjen e trajnimit. Përgatitja fizike siguron benefite shumë të vlefshme për shëndetin e njeriut, duke ndikuar pozitivisht në kontrollin e peshës, luftimin e sëmundjeve të ndryshme, përmirësimin e humorit, rritjen e energjisë, nxitjen e gjumit më të mirë, përmirësimin e performancës seksuale etj.

Përvoja e Forcave të Armatosura Shqiptare që kanë marrë nga skenarë të ndryshëm operacional, si brenda vendit ashtu edhe në misionet paqeruajtëse ndërkombëtare, kane dëshmuar se ushtrimet fizike nuk mund të anashkalohen sepse luajnë një rol shumë të jashtëzakonshëm në performancën e trupave si dhe të individëve luftëtarë. Ushtarakët e të gjitha kategorive duhet të bëjnë vazhdimisht përgatitje të rregullt fizike, në mënyrë që të jenë në gjendje të përballen me vështirësitë e hasura gjatë detyrave të tyre në mision duke siguruar aftësi psikologjike, mendore dhe fizike të qëndrueshme.

Nëse kjo realizohet në mënyrë të përsosur, trupat ushtarake mund të kenë sukses dhe të arrijnë elasticitetin në një kohë relativisht të shkurtër. Që të jemi në gjendje të përmirësojmë performancën e shërbimit të ushtarëve është thelbësore të dimë se cilët faktorë ndikojnë në të, pra të ekzaminojmë marrëdhënien midis performancës së shërbimit të ushtarëve dhe vëllimit të stërvitjes fizike gjatë një misioni të caktuar brenda ose atyre paqeruajtës ndërkombëtar.

Për të ilustruar se sa ndikim kanë ushtrimet fizike në rritjen e forcës mendore është marrë një shembull nga misioni norvegjez në Kosovë (KFOR). Janë përfshirë gjithsej 71 (shtatëdhjetë e një) ushtarë norvegjezë të këmbësisë, të cilët i ishin bashkuar një misioni 12-mujor në Forcën e Kosovës (KFOR). Çdo ushtar kishte detyrë të raportonte stërvitjen fizike ditore në një formular të caktuar. Ndërkohë oficeri epror maste performancën mujore të shërbimit të çdo ushtari nëpërmjet katër faktorëve të bazuar në të dhënat nga ushtarët e mëparshëm që kishin kryer mision në KFOR (rreth=1461 vete). Nga studimi rezultoi se ushtarët me forcë të lartë mendore kishin një vëllim mesatar të stërvitjes fizike 66% më të lartë se ushtarët me forcë të ulët mendore, ndërsa nuk u gjet asnjë lidhje midis aspekteve të tjera të performancës së shërbimit të ushtarëve dhe vëllimit të stërvitjes fizike. Si përfundim, ushtrimet fizike të ushtarëve lidhen me forcën mendore të ushtarëve, një aspekt shumë i rëndësishëm në situata të rënduara psikologjike.⁷

⁷ By AM Pensgaard, DG Barlaug and SM Dyrstad, In Original Research & Articles Issue Volume 18 No. 2 "Relationship between soldiers' service performance and physical training volume".

Personelit drejtues të përgatitjes fizike u bie për detyrë të trajnojnë trupat e tyre në mënyrë që ata të durojnë tendosjen fizike dhe mendore, duke i bere ata të jenë të afta për veprim dhe udhëheqje autonome tashmë në nivel skuadre. Përgatitja fizike e trupave është e domosdoshme për të siguruar qëndrueshmëri të trupës në çdo rrethanë, qoftë në kohë paqeje, krize apo në kohë lufte. Ushtrimet fizike e frymëzojnë personelin e Forcave të Armatosura që të kenë një mënyrë jetese fizikisht aktive gjatë gjithë jetës së tyre.

Ekspertë dhe studiues në fushën e trajnimit fizik këshillojnë që çdo njeri duhet të kalojë të paktën 30 minuta aktivitet fizik çdo ditë.⁸ Ndërkohë, nëse dikush dëshiron të humbasë peshë ose të arrijë qëllime specifike të fitnesit, ai/ajo mund të ketë nevojë të ushtrojë më shumë.

Rekomandime

Drejtuesit në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura duhet të vlerësojnë maksimalisht përfitimet e përgatitjes fizike. Përvoja e fituar nga misionet brenda vendit dhe ato paqeruajtëse ndërkombëtare tregojnë se në çdo nivel komandimi dhe performance, ushtarakët duhet të kenë një kapacitet të mirë fizik, psikologjik, etik dhe social.

Komandat e forcave, specialistët dhe trupa pedagogjike në Akademi duhet të rishikojnë dhe zbatojnë me rigorozitet politikën e stërvitjes fizike dhe aktivitetit të vazhdueshëm fizik, me qëllim ruajtjen e qëndrueshmërisë, mbajtjen e trupave në gatishmëri për t'iu përgjigjur në çdo kohë misionit sipas rrethanave të caktuara.

Personeli ushtarak dhe civil i mbrojtjes duhet të ushtrohet dhe të marrë pjesë në aktivitete të ndryshme fizike për të përmirësuar shëndetin e tyre dhe rritur operacionalitetin e trupës. Programi i ushtrimeve fizike të ushtrisë duhet të planifikohet me kujdes dhe duhet të mbështetet me burime të mjaftueshme.⁹

Strukturat përgjegjëse duhet t'i kushtojnë më shumë vëmendje infrastrukturës fizike, duke e shtuar dhe modernizuar atë, në mënyrë që të inkurajojë gjithëpërfshirjen e personelit ushtarak dhe civil, që të bëjnë sa më shumë ushtrime fizike, në sajë të mirëqenien e tyre shëndetësore.

Bibliografia

1. Doktrina e përbashkët e Forcave të Armatosura (DP-01), edicioni i dytë, 2017.

⁸ Laskowski Er (expert opinion), Mayo Clinic, Rochester, Minn June, 24, 2013

⁹ <http://www.litrary.com/military-fitness-requirements/army-fitness-programm>

2. FM 7-22 “Holistic health and fitness”, viti 2020
3. Rregullore “Testi ushtarak i përgatitjes fizike (TUPF)”, 2013
4. <http://www.quotegarden.com/exercise.html>
5. http://en.wikipedia.org/wiki/Military_education_and_training
6. <http://www.hsph.harvard.edu/nutritionsource/staying-active-full-story>
7. <http://www.nutristrategy.com/weightcontrol.html> (accessed 22 Sep 14)
8. <http://www.military.com/military-fitness/army-fitness-requirements/army-physical-fitness-program>
9. Laskowski, Edward R. (expert opinion). Mayo, Clinic, Rochester, Minn. June 24, 2013.

RUBRIKA E DYTË

Zhvillimi inovativ, sinergji e re në fushën e kapaciteteve ushtarake

Siguria kibernetike është një nga aspektet më të fundit të politikave të sigurisë kombëtare që po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në të gjithë sektorët e sigurisë të vendeve evropiane. Në dekadat e fundit, zhvillimi i shpejtë i internetit dhe ndryshimet inovative në teknologji kanë sjellë ndryshime rrënjësore dhe sfida në çdo shoqëri në mbarë botën. Përveç garantimit të sigurisë kombëtare, rrjetet e mbrojtura dhe të sigurta janë gjithashtu të rëndësishme për t'i dhënë hov ekonomisë kombëtare, si dhe për modernizimin e qeverisjes së sektorit publik në vendet e Evropës Juglindore.

Zhvillimet më të fundit në botë dhe rajon kanë treguar si domosdoshmëri nevojën për zhvillimin e inovacionit ushtarak në fushën e sigurisë kibernetike. Kjo është arsyeja pse shteti ynë dhe Forcat e Armatosura si anëtare të NATO-s duhet të vazhdojnë të zhvillojnë risi teknologjike për të mbrojtur thelbin e hapësirës sonë kibernetike. Është e rëndësishme që të zhvillohen të gjitha llojet e inovacionit për të pasur shanse më të mëdha të suksesit për t'u mbrojtur kundër sulmeve kibernetike.

Pikërisht këto çështje mjaft sensitive për kohën janë trajtuar në këtë rubrikë nga Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj dhe Msc. Elsa Koçi në shkrimin “Krijimi i ekosistemit të inovacionit, mjedis i favorshëm për hapësirën e sigurisë”, si dhe nga Major Edwin Nure me shkrimin “Rreziqet kibernetike ndaj sigurisë së RSH në vitet në vijim”.

KRIJIMI I EKOSISTEMIT TË INOVACIONIT, MJEDIS I FAVORSHËM PËR HAPËSIRËN E SIGURISË

Kolonel Msc. Ulsi Rexhaj

Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak, AFA

Msc. Elsa Koçi

Drejtorja e Shifrës, MM

Trajtesë e shkurtuar.

Punimi projektton rëndësinë e sigurisë kibernetike si politikë, ndërkohë që pasqyron nevojën për të përmirësuar vazhdimisht strategjinë, menaxhimin dhe operacionet kiber-dimensionale. Ekziston një nevojë e politikës për inovacion dhe sipërmarrje të vazhdueshme në siguri. Në një kohë sfidash strategjike dhe rekomandimesh politikash, prodhimi i këtij punimi është në kohën e duhur. Ky shkrim paraqet nevojën e domosdoshme për përmirësimin e inovacionit, propozon një kornizë strategjike të tij për operacionet në hapësirën kibernetike dhe tendencat e reja ku duhet të bazohet zhvillimi inovativ. Qëllimi, dizajni dhe vendosja e këtij punimi vlerëson në mënyrë eksplicite dhe metodologjike opsionet e inovacionit në siguri kibernetike. Ai na mundëson të kuptojmë më mirë nevojat globale dhe rajonale në kuadrin e mbrojtjes kibernetike aktuale dhe të ardhshme, duke kërkuar në të njëjtën kohë një qasje holistike ndaj inovacionit dhe sipërmarrjes, ndërkohë që shfaqen sfida të reja gjeostrategjike dhe gjeo-ekonomike.

Fjalët kyçe: Inovacion, forca ushtarake, siguri kibernetike, risi teknologjike, inteligjencë artificiale

1. Inovacioni ushtarak dhe ndryshimet teknologjike: përgatitja për gjeneratën e kërcënimeve kibernetike

Nisur nga zhvillimet më të fundit në botë dhe rajon, për të arritur mbrojtjen sa më efikase, është emergjente nevoja për zhvillimin e inovacionit ushtarak në fushën e sigurisë kibernetike. Zbulimi i mundësive më të mëdha të inovacionit ushtarak dhe se ku pritet të zhvillohen apo shfaqen vulnerabilitetet janë në qendër të garantimit që shteti ynë dhe jo vetëm të mos befaset nga një kundërshtar joliberal, i cili zbulon ide të reja të mëdha rreth operacioneve ushtarake përpara se ne ta bëjmë këtë, duke rrezikuar dështimin e parandalimit dhe humbjes në çdo luftë që mund të ndodhë.

Qëllimi është të shikojmë në të ardhmen duke nisur nga sot, për të vlerësuar zhvillimin teknologjik dhe për të planifikuar inovacionin e duhur. Meqenëse shumë sisteme të mbrojtjes kibernetike kërkojnë disa dekada për t'u zhvilluar, detyra jonë është të vlerësojmë kapacitetet aktuale dhe të planifikojmë zhvillimin e nevojshëm të teknologjisë ushtarake për vitet në vazhdim. Sipas një parashikimi të përgjithshëm, zhvillimi teknologjik i inovacionit ushtarak mund të jetë më i shpejtë dhe më i rëndësishëm në 20 vitet e ardhshme sesa është provuar gjatë 20 viteve të fundit, mundësi e cila po nxitet kryesisht në fushën e sigurisë kibernetike. Është plotësisht e mundur që ritmi i vazhdueshëm dhe i shpejtë i inovacionit kompjuterik mund t'i bëjë dy dekadat e ardhshme më revolucionare se dy të fundit. Dinamika në robotikë dhe në sigurinë kibernetike vetëm mund të përshpejtohet. Ato do të shtrihen në mënyra të rëndësishme edhe në fushën e Inteligjencës Artificiale (IA). Kjo është veçanërisht e vërtetë nga fakti se shumë vende (më së shumti Kina dhe Rusia) tani kanë burimet e nevojshme për të konkurruar me vendet perëndimore në inovacionin ushtarak në fushën e sigurisë kibernetike. Ndër të tjera, kjo ndërthurje faktorësh dhe dinamikash argumenton fuqishëm që vendi ynë, si shtet anëtar i NATO-s, duhet të përmirësojë inovacionin në fushën kibernetike në pritje të sulmeve të mundshme të ardhshme.

2. Një kornizë inovacioni për operacionet në hapësirën kibernetike

Inovacioni është kritik për përmirësimin e shoqërisë dhe është kyç për domenin kibernetik. Rritja e shpejtë e internetit ka bërë që mjetet për të

vepruar në hapësirën kibernetike të evoluojnë vazhdimisht. Në përgjithësi shtetet ushqehen me frymë inovative, ndërkohë qytetarët kanë përfituar nga rritja dhe përparimi që ka rezultuar nga risitë e shumta. Inovacioni ka luajtur një rol kritik në sukseset e kaluara të çdo ushtrie botërore. Risitë në luftën kibernetike janë si në operacionet sulmuese, ashtu edhe në fushën e mbrojtjes. Kur përdoret fjala "risi", shumica e njerëzve do të mendojnë për shpikjet dhe idetë që kanë ndikim në shoqëri. Megjithatë, këto lloj shpikjesh dhe idesh janë vetëm një pjesë e tablosë. Duke kuptuar se ekzistojnë dallime të qarta brenda "risisë", ne mund të zhvillojmë një strategji inovacioni për t'u përgatitur për konfliktin kibernetik të ardhshëm.

Për ta kuptuar më mirë, do të marrim në shqyrtim katër fusha të inovacionit që kontribuojnë në suksesin e një organizate: i qëndrueshëm, inkrementues, penetrues dhe shkatërrues¹. **Inovacionet e qëndrueshme** dhe **inkrementuese** prirën të gjenerojnë përmirësime brenda sistemeve ekzistuese, por zakonisht burojnë si përgjigje reaktive ndaj nevojave të tregut. **Inovacionet penetruese** dhe **shkatërruese** synojnë tregje të reja dhe mund të formësojnë në mënyrë proaktive mjedisin tonë. Duke aplikuar kornizën e inovacionit të këtyre katër llojeve, mund të vlerësohen boshllëqet dhe të identifikohen mundësitë për avantazh konkurrues. Ky punim kategorizon risitë në hapësirën kibernetike për të kuptuar më mirë aktivitetet që ndodhin në sferat mbrojtëse dhe sulmuese.

Në këtë punim, ne zbulojmë se pothuajse të gjitha mjetet sulmuese kibernetike, duke përfshirë shumicën e viruseve kompjuterike, krimbave² dhe malware³ të tjerë bien në fushën shkatërruese, lloji i inovacioneve që janë relativisht të lira për t'u prodhuar, më të shpejtë për t'u zbatuar dhe në thelb më fleksibël, sepse shfrytëzojnë asetet ekzistuese. Anasjelltas, shumica e aftësive kibernetike mbrojtëse, të tilla si: sistemet e parandalimit të ndërhyrjeve dhe sistemet e automatizuara të vetë-shërimit janë zakonisht inovacione të reja penetruese që janë të shtrenjta, teknologjikisht më komplekse dhe kërkojnë kërkime të gjera. Për të mbrojtur në mënyrë sistematike hapësirën kibernetike, nevojitet çdo lloj inovacioni për të siguruar një nivel të pranueshëm të sigurisë kibernetike.

Inovacionet e qëndrueshme dhe inkrementuese reagojnë ndaj nevojave ekzistuese të tregut dhe zakonisht janë llojet e inovacionit që mbështesin linjën përfundimtare të një kompanie. Inovacioni i suksesshëm fokusohet në përmirësimin e performancës dhe efikasitetit të një produkti të krijuar dhe

¹ E.Y. Wong and N.Sambaluk, "Disruptive Innovations to Help Protect against Future Threats." Proceedings of the 2016 CyCon U.S. Conference, Washington, District of Columbia, 2016.

² Lloj virusi, i cili ka aftësi të shumëfishojë veten e tij dhe të infektojë kompjuterë të tjerë.

³ Softuer i krijuar qëllimisht për të shkatërruar dëme në një kompjuter, server, klient ose rrjet kompjuterik.

përpiqet të zgjasë ciklin jetësor të fitimit të produktit për aq kohë sa të jetë e mundur. Për shembull, çdo vit kompanitë e automjeteve prezantojnë veçori të reja në makinat e tyre duke përmirësuar modelin e vitit të kaluar. Promovimi i masave të përmirësuar të performancës dhe atributet e reja synojnë që kompanitë e automjeteve të forcojnë një produkt tashmë të prodhuar. Inovacioni inkrementues është i ngjashëm me atë të qëndrueshëm në atë që tenton të reagojë ndaj nevojave ekzistuese të tregut, por është më evolucionar. Inovacioni inkrementues mund të mendohet si një cikël inovacioni, në të cilin një aktor del me një risi që mposht konkurrencën; konkurrenti më pas përgjigjet duke dalë me një risi edhe më të mirë për të ngritur nivelin e lojës brenda një kategorie ekzistuese. Evolucioni i telefonave inteligjentë për sa i përket veçorive të shtuara si: madhësia e ekranit, pikselat e kamerës dhe aplikacionet e integruara është një shembull i inovacionit inkrementues, ku që kompanitë konkurruese po shtojnë vazhdimisht veçori të reja për të rritur shitjet dhe për të ndarë tregun.

Ndërsa inovacionet e qëndrueshme dhe inkrementuese janë reaguese ndaj nevojave të tregut, inovacionet penetruese dhe përçarëse janë proaktive. Ato kërkojnë të ndryshojnë mjedisin, në vend që të përshtaten me mjedisin rreth tyre. Inovacionet penetruese janë të fundit dhe përfaqësojnë një përparim të rëndësishëm në kompleksitetin ose sofistikimin teknologjik, që kapërcen kurbën e produkteve dhe proceseve të mëparshme. Inovacioni penetruar prezanton një produkt të ri, shkakton zëvendësimin e produktit ose prezanton një mënyrë të re për të bërë gjëra që kërkojnë një bazë të re aftësish. Për shembull, sistemi i Pozicionimit Global (GPS) është një shembull i një novacioni penetruar që u zhvillua nga qeveria e Shteteve të Bashkuara për të ofruar aftësi gjeolokimi, i cili krijoi një treg të ri ushtarak, civil dhe komercial në mbarë botën. Ndërsa inovacionet penetruese priren të jenë të shtrenjta për t'u krijuar, ato përçarëse janë relativisht të lira dhe revolucionare. Inovacionet përçarëse apelojnë gjithashtu për një treg të ri ose të pashërbyer dhe përdorin asete që janë lehtësisht të disponueshme. Për shembull, fotokopjuesit personalë në shtëpi zvogëluan përdorimin e printerëve të mëdhenj të korporatave; printerët e mëdhenj u bënë aq të shtrenjtë dhe të personalizuar për përdorim të ekspertëve, sa që e lanë tregun shtëpiak dhe personal pa shërbim. Telefonat celularë janë një shembull tjetër i një inovacioni përçarës që i ofroi konsumatorëve akses në një produkt dhe shërbim komunikimi që ishte i kufizuar në disponueshmërinë e telefonit fikse.

Në përgjithësi, katër llojet e inovacionit mund të dallohen nga mënyra se si ato ndikojnë në një treg të synuar, krahasuar në kompleksitetin teknologjik dhe nëse janë proaktive apo reaktive. Siç u diskutua më lart, inovacionet e qëndrueshme dhe inkrementuese synojnë tregjet ekzistuese, ndërsa

inovacionet përçarëse dhe penetruese ndikojnë në tregjet e pashërbyera ose krijojnë tregje të reja. Inovacionet përçarëse dhe të qëndrueshme janë më pak komplekse, sepse ato mbështeten në sistemet dhe teknologjitë ekzistuese, ndërsa inovacionet penetruese dhe inkrementuese janë më komplekse sepse varen nga kërkimi dhe zhvillimi i teknologjive të reja.

Dy dimensione shtesë, shkalla e suksesit dhe potenciali i ndikimit mund të shtohen për të dalluar më tej katër llojet e inovacioneve dhe për të ofruar njohuri mbi rreziqet dhe përfitimet e mundshme të ndjekjes së secilit prej tyre. Inovacioni i qëndrueshëm dhe inkrementues kanë një probabilitet të lartë suksesi sepse ato mbështeten në një treg të vendosur. Inovacioni përçarës dhe penetrues kanë të kundërtën, sepse ata po ndjekin një territor të ri. Sidoqoftë, inovacionet përçarëse dhe penetruese kanë një potencial më të lartë ndikimi sesa ato të qëndrueshme dhe inkrementuese, sepse ato po krijojnë një treg të ri. Është thelbësore të kuptohen karakteristikat, rreziqet dhe përfitimet që lidhen me secilin lloj inovacioni për të zhvilluar strategjinë më të mirë të inovacionit për manovrimin e kundërshtarëve.

2.1. Kategorizimi i inovacionit kibernetik

Të kuptuarit më mirë të inovacionit kibernetik që po ndodh mund të ofrojë njohuri mbi atë që përfshin avantazhin konkurrues në hapësirën kibernetike dhe se si forcat ushtarake mund të forcojnë aftësitë e tyre kibernetike në të ardhmen. Gjatë gjithë historisë, ka pasur shembuj të inovacioneve kibernetike që përshtaten brenda katër kategorive të inovacionit dhe mund të konsiderohen si një mjet sulmues ose mbrojtës. Teknologjitë sulmuese kibernetike synojnë të depërtojnë, shfrytëzojnë ose sulmojnë infrastrukturën kibernetike.

Teknologjitë kibernetike mbrojtëse kërkojnë të mbrojnë sistemet nga çdo akses, veprim ose sulm i paautorizuar. Inovacionet penetruese kibernetike përfshijnë përparime të mëdha teknologjike komplekse që shpesh kërkojnë kohë dhe para të konsiderueshme për t'u zhvilluar. Shpikja e Protokollit të Kontrollit të Transmisionit/Protokollit të Internetit (TCP/IP) mund të konsiderohet një risi e re mbrojtëse. TCP/IP ndërlidhën pajisjet e rrjetit në internet dhe revolucionarizuan mënyrën se si kryheshin komunikimet e rrjetit, duke i kaluar ato nëpër katër shtresa të veçanta: aplikacioni, transporti, rrjeti dhe "data link". Kontrollat e sigurisë ekzistojnë në të katër shtresat e procesit, duke lejuar më shumë mbrojtje sesa disponohej më parë. Inovacionet penetruese janë më pak të zakonshme në aspektin sulmues, por krimbi Stuxnet⁴ shërben si shembull. Stuxnet ishte arma e parë digjitale e këtij lloji që

⁴ Stuxnet është një krimb kompjuterik me qëllim të keq i zbuluar për herë të parë në vitin 2010, por mendohet që ka qenë në zhvillim prej të paktën 2005. Stuxnet synon kontrollin mbikëqyrës dhe sistemet e grumbullimit të të dhënave dhe besohet se është përgjegjës për shkaktimin e dëmeve të konsiderueshme në programin bërthamor të Iranit.

u zhvillua për një objektiv specifik me qëllim të shkatërrimit fizik. Stuxnet ishte pjesë e një operacioni të fshehtë teknik dhe krijoi një treg të ri për zhvillimin dhe përdorimin e programeve kompjuterike, që mund të bënin më shumë sesa thjesht rrëmbim ose vjedhje informacioni.

Ritmi më i shpejtë dhe qasja unike e inovacionit përçarës për të shfrytëzuar asetet që tashmë ekzistojnë, mbështesin inovacionin më të përhapur në hapësirën kibernetike. Një nga shembujt më të mirë të një inovacioni përçarës të përdorur për mbrojtjen kibernetike është kur agjencia hapësinore amerikane NASA bllokoi të gjitha *email*et me bashkëngjitje përpara nisjes së anijes, për të shmangur hakerët të ndikojnë në mision. NASA përdori një zgjidhje të thjeshtë dhe me kosto të ulët për të adresuar një problem. Inovacionet përçarëse përdoren zakonisht në anën sulmuese të sigurisë kibernetike, ku *malware*-ët janë shembuj të spikatur. Shumica dërmuese e malware-ve kanë përfutur nga të metat ekzistuese brenda sistemeve ose softuerit për të arritur qëllimet e tyre keqdashëse.

Për shkak se inovacionet e qëndrueshme përmirësojnë një produkt që ka një vend në treg, përdorimi i antivirusit është një aplikim i zakonshëm mbrojtës i inovacionit të qëndrueshëm. Kompanitë e programeve antivirus lëshojnë përditësime dhe shpesh të reja të softuerit të tyre të sigurisë për të zgjidhur jetën e produkteve të tyre për konsumatorin e zakonshëm. Në anën sulmuese, një shembull i një inovacioni të qëndrueshëm është përdorimi i versioneve të mëvonshme të viruseve ose krimbave, që kanë provuar të shfrytëzojnë me sukses një sistem kompjuterik.

Në fushën e sigurisë kibernetike, inovacionet inkrementuese janë rezultat i drejtpërdrejtë i veprimeve të hakerëve dhe mbrojtësve që i përgjigjen njëri-tjetrit. Për shembull, krijimi i Ekipit të Reagimit ndaj Emergjencave Kompjuterike (CERT) është një shembull i inovacionit inkrementues mbrojtës. Në fushën sulmuese të inovacionit inkrementues, gabimet e softuerit ose të metat në programimin kompjuterik janë një shembull.

Me kalimin e kohës, inovacionet penetruese ose përçarëse mund të bëhen inovacione të qëndrueshme ose inkrementuese, ndërsa tregjet e zakonshme i adoptojnë gradualisht ato. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se disa risi nuk bien drejtpërdrejt në një kategori dhe mund të mbivendosen disa kategori kur ato zhvillohen fillimisht. Për shembull, virusi *Creaper* mund të konsiderohet si përçarës dhe penetruar. *Creaper* u zhvillua për të lëvizur midis kompjuterëve duke kopjuar veten dhe duke shfaqur mesazhin “**Unë jam Creaper: Më kap nëse mundesh!**”. Ky virus ishte një inovacion penetruar, sepse ishte i pari i këtij lloji dhe krijoi një treg të ri për zhvillimin dhe përdorimin e programeve kompjuterike që mund të kopjohen në mënyrë mashtruese. Megjithatë, ishte gjithashtu përçarës sepse nuk përdorte ndonjë shkencë

të re apo ndonjë pajisje të shtrenjtë. Virusi thjesht shfrytëzoi sistemet në të cilat funksiononte dhe ndryshoi mjedisin e sistemit për të kryer një funksion specifik. Siç tregon virusi *Creeper*, dallimet midis çdo lloji të inovacionit mund të ngatërrohen. Megjithatë, logjika e përgjithshme për të kategorizuar mjetet sulmuese dhe mbrojtëse është e dobishme për të kuptuar vendndodhjen e boshllëqeve të aftësive.

2.2. Inovacionet në aspektin mbrojtës për të luftuar sulmet kibernetike

Është e rëndësishme të theksohet nevoja e zhvillimit të mjeteve të mbrojtjes kibernetike, me qëllim fitimin e avantazhit ndaj kundërshtarëve të mundshëm. Me masa të ulëta sigurie në hyrje, një kundërshtar mund të përfitojë nga problemet dhe dobësitë që ekzistojnë brenda sistemeve duke përdorur malware që tashmë janë provuar dhe madje shiten në treg; prandaj, një kundërshtar mund të arrijë një efekt pa u shqetësuar për kompleksitetin e mjetit dhe kostoja është relativisht e ulët. Për shkak të uljes së kostos së automatizimit dhe aftësive të bazuara në “cloud”, një tregu në rritje të ndarjes së informacionit ndërmjet aktorëve të kërcënimit dhe sipërfaqes gjithnjë në rritje të sulmit, puna e sulmuesit po bëhet më e lirë dhe më e lehtë çdo ditë. Kjo pikëpamje sugjeron që mjedisi kibernetik po ndryshon kaq shpejt me malware shkatërrues, sa që nuk ka vend për asnjë lloj inovacioni, përveç atyre inkrementues për t'u përshtatur me shkeljet e sistemit. Tashmë sistemet tona duhet të zhvillojnë inovacione mbrojtëse që mund të ndryshojnë mjedisin me një ritëm të tillë që mjetet sulmuese si viruset kompjuterike, krimbat, “trojan horses”⁵ dhe malware të tjerë të mos mund të vazhdojnë më dhe kostoja për ta bërë këtë të bëhet penguese. Sistemet tona të mbrojtjes duhet të zhvillojnë një portofol më gjithëpërfshirës të inovacionit, që balancon aftësitë sulmuese dhe mbrojtëse të nevojshme për t'u përgatitur për konfliktin kibernetik të ardhshëm. Aftësi të tilla mund të zhvillohen duke përdorur dhe zgjeruar inovacionin aktual përçarës në komunitetin kibernetik, i cili është i përqendruar në rritjen e edukimit bazë kibernetik për publikun e gjerë, duke zhvilluar partneritete për shkëmbim më të mirë informacioni dhe të inteligjencës dhe duke shfrytëzuar potencialin e arkitekturës “cloud”.

Edukimi bazë kibernetik për punonjësit e fushës së sigurisë në administratë dhe sektorin privat, por edhe për publikun e gjerë është një shembull i inovacionit përçarës që ofron ekonomi të shkallëzuar, përdor një sistem që është tashmë i vendosur, nuk kërkon shpenzime të mëdha dhe synon një treg të pa shërbyer. Rëndësia e fillimit të një fushate ndërgjegjësimi dhe edukimi për të ndihmuar punonjësit dhe publikun të kuptojë nevojën dhe vlerën e sigurisë kibernetike nuk është një ide e re. Një fushatë e fortë ndërgjegjësimi mund të

⁵ Malware që mashtron përdoruesit për qëllimin e tij të vërtetë.

zvogëlojë dobësitë në rrjete që i atribuohen gabimeve njerëzore. Duke nxitur përpjekjet për edukimin kibernetik, forcat tona mund të ndihmojnë kombin të zhvillojë një aftësi mbrojtëse për të ulur shkallën e suksesit të kundërshtarëve, thjesht duke rritur ndërgjegjësimin për praktikën më të mira për sigurimin e rrjeteve të informacionit. Për t'u përgatitur për konfliktin e ardhshëm kibernetik, ushtria shqiptare po merr pjesë gjithashtu në fushatat dhe stërvitjet e edukimit kibernetik që po zhvillohen aktualisht nga NATO dhe në fund mund të zhvillojë një fushatë ndërgjegjësimi të vetën. Sugjerohet gjithashtu zhvillimi dhe financimi i programeve të ndërgjegjësimit kibernetik për grupet e ndryshme të shoqërisë. Ky është një shembull i një zgjidhjeje teknike me kosto të ulët, me potencial të lartë ndikimi dhe ofron një produkt për klientët jashtë tregut të shtrenjtë të penëtrimeve. Duke punuar për të krijuar një kulturë të ngjashme ndërgjegjësimi rreth sigurisë kibernetike për publikun e gjerë dhe audiencën e institucioneve dhe organizatave të mbrojtjes, ushtria mund të ndihmojë në forcimin e mbrojtjes kibernetike duke reduktuar gabimet njerëzore, duke e bërë sigurinë kibernetike bazë të lirë dhe të kudogjendur dhe duke edukuar një komunitet të ri të mbrojtësve kibernetikë që vetëm do të vazhdojë të rritet. Kjo aftësi mbrojtëse do të ishte njëkohësisht e qëndrueshme dhe shkatërruese.

Një tjetër rrugë për të rritur taktikat e mbrojtjes kibernetike është forcimi i partneriteteve me sektorin privat për të përmirësuar shkëmbimin e informacionit dhe të inteligjencës sepse "as qeveria dhe as sektori privat nuk mund të mbrojnë siç duhet sistemet dhe rrjetet përkatëse pa bashkëpunim të zgjeruar dhe të ngushtë"⁶. Një praktikë që ndiqet në SHBA është sponsorizimi i iniciativave, që kanë për qëllim ndarjen e informacioneve dhe vulnerabiliteteve që nuk janë diskutuar në domenin publik⁷. Njohuritë e marra përmes këtyre iniciativave bëhen më pas të zbatueshme dhe mund të nxisin zhvillimin e zgjidhjeve mbrojtëse. Përdorimi i platformave të tilla nuk është teknologjikisht komplekse ose e shtrenjtë. Me kalimin e kohës, ky partneritet mund të vendosë kritere të reja të performancës së tregut dhe norma bashkëpunimi midis qeverisë dhe sektorit privat.

Për të mbrojtur në mënyrë adekuate shoqëritë tona digjitale, është thelbësore të kuptojmë konkurrencën për të ecur përpara dhe jo vetëm të reagojmë ndaj kundërshtarëve. Shkëmbimi i inteligjencës përmes partneriteteve mund të ushqejë këtë mirëkuptim dhe t'i bëjë këto njohuri të aksesueshme për një audiencë më të gjerë të konsumatorëve që kanë nevojë të ndërtojnë mbrojtje kibernetike.

⁶ K.B. Alexander, J.N. Jaffer, and J.S. Brunet, "Clear Thinking About Protecting the Nation in the Cyber Domain," *The Cyber Defense Review*, 2, no.1, 2017, 29-36.

⁷ Byroja Federale e Hetimit (FBI) në SHBA sponsorizoi një iniciativë të quajtur *InfraGard*, një program që ka krijuar një kanal për bizneset, institucionet akademike, agjencitë shtetërore dhe lokale të zbatimit të ligjit dhe pjesëmarrësit e tjerë për të ndarë informacione rreth mbrojtjes kibernetike.

Duke bashkëpunuar me industrinë për të identifikuar pikat e dështimit dhe në shkëmbimin e informacionit dhe të inteligjencës të nivelit më të lartë rreth shkeljeve, sistemet tona mund të forcojnë aftësinë e tyre për t'u mbrojtur kundër konfliktit kibernetik duke krijuar një hapësirë të përbashkët për zhvillimin e teknikave, taktikave, procedurave dhe teknologjive më shkatërruese.

Përmirësimi i ndërgjegjësimit për situatën duke kuptuar më mirë rrjetin dhe sistemin e dikujt tjetër mund të jetë një mënyrë për të identifikuar dhe mbrojtur më shpejt nga sulmet kibernetike. Duke qenë se 55% e organizatave në të gjitha industritë në botë tani përdorin disa forma të “cloud computing”⁸ dhe agjencitë shtetërore në përgjithësi po shkojnë drejt tyre, ushtritë mund të përfitojnë nga e njëjta ulje në kosto që po përdorin kundërshtarët për shfrytëzime të lira dhe të lehta për të zhvilluar aftësi mbrojtëse kundër tyre. “Cloud computing”, i cili përfshin infrastrukturën, platformën, softuerin dhe sigurinë si shërbime, është një treg në zhvillim që krijon një terren të favorshëm për inovacione përçarëse. Duke zhvilluar programe softuerike të pajtueshme me arkitekturën “cloud”, sipërmarrësit mund të konkurrojnë me kompanitë e softuerëve për biznesin, sepse konsumatorët mund të shkarkojnë produkte shpejt dhe me çmim të ulët.

Këto shërbime kibernetike filluan si zgjidhje komplekse dhe të personalizuar të brendshme për sigurinë dhe ruajtjen për bankat e mëdha, korporatat industriale, kompanitë teknologjike dhe agjencitë e ndjeshme qeveritare. Sot, kompanitë po synojnë tregun e bizneseve të vogla dhe përdoruesve individualë me këto shërbime kibernetike si një zgjidhje e thjeshtë dhe me kosto të ulët për kontraktimin e sigurisë dhe ruajtjes midis shërbimeve të tjera. Duke kuptuar peizazhin dhe arkitekturën e tregut të “cloud computing”, agjencitë e mbrojtjes mund të nxisin kushte që mbështesin inovacionin përçarës. Ato gjithashtu duhet të bashkëpunojë me individë dhe subjekte që e bëjnë këtë për të zhvilluar teknika më të mira mbrojtëse dhe njohuri mbi dobësitë.

Forcat e Armatosura mund të eksperimentojnë gjithashtu me metodat aktuale të analizës së të dhënave të mëdha dhe modeleve, teknologjinë e disponueshme për një përgjigje të automatizuar dhe inteligjencën nga partnerët për të përcaktuar se cili kombinim i këtyre aftësive mund të sigurojë ndërgjegjësim më të fortë ndaj situatës dhe mekanizma më të mirë reagimi ndaj sulmit. Meqenëse teknika të ndryshme me kosto të ulët dhe të disponueshme përdoren për të eksploruar peizazhin e “cloud computing”, mund të ketë një shkallë të lartë dështimi, por sukcesi mund të ketë ndikim të madh duke ofruar aftësi mbrojtëse që mund të ndahen në gamën e ndryshme të përdoruesve të “cloud computing”.

⁸ P.M. Duggan, “Special Operations Forces in Cyberspace,” The Cyber Defence Review, 1, no. 2, 2016, 73-79.

3. Tendencat e inovacionit në siguri dhe hapësirën kibernetike

Aparati ushtarak global po përjeton transformime të rëndësishme dhe po përdor tendencat e teknologjisë për të forcuar aftësitë e tij në hapësirën kibernetike. Tendencat kryesore përfshijnë Inteligjencën Artificiale (IA), robotikën dhe “Internet of Things” për të optimizuar operacionet e mbrojtjes dhe për të rritur efikasitetin. Në ditët e sotme lufta konvencionale po zëvendësohet gjithnjë e më shumë nga qasje hibride, që kombinojnë luftën kibernetike dhe faktorë të tjerë. Tendencat e reja të teknologjisë ushtarake po ndryshojnë fushën e betejës në katër aspekte: ndërlidhjen, vdekshmërinë, autonominë dhe qëndrueshmërinë. Zgjidhjet e ndërlidhjes adresojnë shqetësimet sesi palët luftuese zbulojnë dhe lokalizojnë kundërshtarët e tyre, komunikojnë me njëri-tjetrin dhe drejojnë operacionet. Përparimet në teknologjitë e raketave dhe armëve rrisin vdekshmërinë, duke i bërë operacionet në fushëbetejë më efektive. Nga pikëpamja e autonomisë, përdoren robotika dhe IA⁹ për të ekzekutuar vendime me ndërhyrje minimale njerëzore ose pa ndërhyrje. Gjithashtu po përmirësohet qëndrueshmëria në industrinë e mbrojtjes me teknologji si prodhimi i aditivëve dhe elektrifikimi. Më poshtë paraqitet një përmbledhje e dhjetë trendeve dhe inovacioneve të Teknologjisë Ushtarake.¹⁰

3.1. Inteligjenca Artificiale (IA)

Përdorimi i IA në fushën e mbrojtjes kibernetike rrit arsyetimin ushtarak kompjuterik për misionet e inteligjencës, mbikëqyrjes dhe zbulimit. Vizioni i makinës mundëson menaxhimin e sigurisë së pajisjeve dhe fuqizon sistemet autonome të armëve, duke reduktuar kështu viktimat në forca ushtarake. Duke shfrytëzuar “machine learning”¹¹ dhe “digital twins”¹², prodhuesit e mallrave të mbrojtjes testojnë produktet e reja ushtarake dhe mundësojnë mirëmbajtjen parashikuese për asetet ushtarake. Gjithashtu kohët e fundit po zhvillohen sisteme inteligjente vetë-organizuese që bashkëpunojnë drejt një objektivit strategjik duke përdorur llogaritjen e tufës.

3.2. Pajisjet e Avancuara të Mbrojtjes

Ushtritë e shteteve të ndryshme po zhvillojnë pajisje mbrojtëse më të sofistikuar dhe të avancuara për t’iu kundërvënë kërcënimeve në zhvillim. Inovacionet variojnë nga fluturimet hipersonike dhe armët me energji të

⁹ Inteligjenca Artificiale, simulimi i proceseve të inteligjencës njerëzore nga makinat.

¹⁰ Studim i realizuar nga “StartUs Insights Discovery Platform”.

¹¹ Përdorimi dhe zhvillimi i sistemeve kompjuterike, që janë në gjendje të mësojnë dhe përshtaten pa ndjekur udhëzime të qarta, duke përdorur algoritme dhe modele statistikore për të analizuar dhe nxjerrë përfundime nga modelet e të dhënave.

¹² Paraqitja virtuale në kohë reale e një sistemi ose procesi fizik, që shërben si homologu digjital i padallueshëm i tij për qëllime praktike të tilla si simulimi i sistemit, integrimi, testimi, monitorimi dhe mirëmbajtja.

drejtuar deri te militarizimi i hapësirës. Investimet në teknikat e elektrifikimit të fushëbetejës përmes forcës shtytëse elektrike dhe karburanteve me hidrogjen për avionët ushtarakë lehtësojnë këtë tranzicion. Përveç kësaj, organizatat e mbrojtjes po avancojnë kërkimet në bioteknologji dhe nanoteknologji për krijimin e armaturës vetë-shëruese dhe pajisjeve të tjera inovative.

3.3. Sistemet robotike dhe autonome

Mbrojtja e forcave, rritja e ndërgjegjësimit për situatën, zvogëlimi i ngarkesës fizike dhe njohëse të ushtarëve si dhe lehtësimi i lëvizjes në terrene sfiduese janë disa objektiva vendimtarë për ushtarakët. Integrimi i teknologji të robotizmit dhe sistemeve autonome i lejon ushtarakët të arrijnë këto objektiva dhe të kontrollojnë terrenin, të sigurojnë popullsinë dhe të konsolidojnë përfitimet. Këto teknologji janë gjithnjë e më të rëndësishme për të siguruar lirinë e manovrimit dhe përmbushjen e misionit me rrezikun më të vogël të mundshëm për ushtarët. Përdorimi i dronëve mundëson gjithashtu marrjen e informacionit për situatën në fushëbetejë. Për më tepër, robotët me shumë misione lehtësojnë pastrimin e minave tokësore, operacionet e kërkim-shpëtimit, asgjësimin e mjeteve shpërthyes dhe mbështetjen logjistike.

3.4. Internet of Military Things (IoMT)¹³

Aplikimet e IoT në mbrojtje përfshijnë lidhjen e anijeve, avionëve, tankeve, dronëve, ushtarëve dhe bazave operative në një rrjet koheziv. Kjo rrit perceptimin, të kuptuarit në terren, ndërgjegjësimin e situatës dhe kohën e reagimit. “Edge computing¹⁴”, IA dhe 5G mbështesin rrjedhën e qetë dhe pa probleme të të dhënave në të gjitha degët e ushtrisë dhe kjo forcon strukturën e komandës dhe kontrollit. Në IoMT, pajisjet ndijuese dhe llogaritëse të veshura nga ushtarët dhe të ngulitura (embedded) në pajisjet e tyre mbledhin një sërë të dhënash biometrike statike dhe dinamike.

3.5. Lufta kibernetike

Sistemet ushtarake janë shpesh vulnerabël ndaj sulmeve kibernetike, të cilat potencialisht mund të çojnë në humbjen e informacionit të klasifikuar ushtarak dhe dëmtim të sistemeve ushtarake. Gjatë viteve të fundit, frekuenca dhe ashpërsia e sulmeve kibernetike janë rritur në mënyrë të vazhdueshme. Teknologjia parashikuese përdor sigurinë kibernetike, IA dhe automatizimin për të zbuluar kërcënimet e mundshme dhe për t'i ndaluar ato përpara se të ndikojnë në aftësitë mbrojtëse të luftës kibernetike. Siguria e pajisjeve të

¹³ Internet of Military Things, përfshin një gamë të gjerë pajisjesh që posedojnë aftësi inteligjente ndijuese, të të mësuarit dhe operimit, përmes ndërfaqeve virtual ose kibernetike që janë të integruara në sisteme.

¹⁴ Model i shpërndarë kompjuterik që afron llogaritjen dhe ruajtjen e të dhënave me burimet e të dhënave. Arkitekturë, që pritet të përmirësojë kohën e përgjigjes dhe të kursejë gjerësinë e brezit.

ndërlidhura ushtarake, mbrojtja kibernetike për institucionet kryesore si dhe siguria bërthamore janë fushat kryesore të fokusit. Ushtritë e vendeve të ndryshme po zhvillojnë gjithashtu aftësitë sulmuese të tyre duke filluar nga malware dhe ransomware¹⁵ deri te sulmet phishing¹⁶.

3.6. Teknologjitë gjithëpërfshirëse (Immersive)¹⁷

Këto teknologji e bëjnë të lehtë krijimin e përvojave të përsëritura dhe fleksibël, si p.sh. për trajnime fluturimi ose luftarake. Ato përdorin realitetin virtual për të ndërtuar mjedise sintetike trajnimi. Këto përvoja rrisin stërvitjen konvencionale dhe praktikimin e misioneve, duke përmirësuar gatishmërinë e ushtarëve dhe njësisë. Përtej mundësive të trajnimit, realiteti i shtuar i bën ushtarët në terren më efektivë në misionet e tyre. Syzet ose kufjet p.sh., u mundësojnë ushtarëve informacione hartografike, shënues të lëvizjes dhe të dhëna të tjera. Kjo përmirëson vendimmarrjen në kohë reale për forcat tokësore.

3.7. Prodhimi i Aditivëve

Ulja e peshës së pajisjeve mbrojtëse është thelbësore për përmirësimin e performancës në shpejtësi, kapacitet dhe konsum të karburantit. Printimi 3D mundëson prodhimin e komponentëve dhe pjesëve duke përdorur shumë më pak material sesa prodhimi tradicional. Ai redukton kostot e prodhimit, krijon mundësi të reja inxhinierike të projektimit dhe mundëson prodhim të lokalizuar sipas kërkesës, duke reduktuar ngarkesën logjistike. Për më tepër, ai lehtëson krijimin e kombinimeve të reja materiale për parzmore, veshje ushtarake vetë-ngrohëse dhe municione.

3.8. Të dhëna të mëdha dhe analizimi i tyre

E ardhmja e luftës mbështetet gjithnjë e më shumë në informacionin dhe aftësinë për të depërtuar në të. Ushtritë me aftësinë për të nxjerrë të dhënat më jetike, për t'i analizuar me saktësi dhe më pas për të shpërndarë me shpejtësi informacionin do të kenë një avantazh strategjik. Informatika kuantike gjen aplikacione në kriptanalizë dhe simulime ekzekutimi për vendimmarrje të informuar. Analitika mundëson gjithashtu interpretimin efikas të të dhënave të mbledhura nga infrastruktura IoMT. Për më tepër, analitika parashikuese frenon kërcënimet dhe përmirëson sigurinë dhe efikasitetin e detyrave të rrezikshme.

¹⁵ Lloj virusi nga kriptovirologjia, i cili enkripton skedarët në një pajisje, duke i bërë të papërdorshëm të gjithë skedarët dhe sistemet që mbështeten në to.

¹⁶ Një lloj sulmi i inxhinierisë sociale, ku një sulmues dërgon një mesazh mashtrues te viktima për të zbuluar informacione sensitive ose për të vendosur softuer me qëllim të keq në infrastrukturën e viktimës si ransomware.

¹⁷ Integrimi i përmbajtjes virtuale me mjedisin fizik në një mënyrë që lejon përdoruesit të përfshihen natyrshëm në realitetin e përzier.

3.9. Rrjetet 5G

Informacioni i duhur dhe në kohë është jashtëzakonisht i rëndësishëm për operacionet ushtarake. 5G, për shkak të shpejtësisë së tij, përshpejton marrjen e vendimeve në kohë reale në ushtri. Ai premton lidhje hiperkonvergjente dhe rrjete të sigurta të të dhënave. Kjo mundëson aplikacione të reja komandimi dhe kontrolli dhe riorganizon logjistikën. Më tej, rrjetet 5G lehtësojnë transferimin e sasive masive të të dhënave në sensorë dhe armë të largëta në rrjete të dendura dhe elastike të fushëbetejës. Kjo siguron ndërgjegjësimin e menjëhershëm të situatës, si dhe rrit aftësitë e trajnimit dhe të fushëbetejës.

3.10. Blockchain¹⁸

Blockchain garanton sigurinë e të dhënave ndërsa bën shpërndarjen e tyre me të gjitha palët e interesuara. Kjo është arsyeja pse sistemet e mbrojtjes në botë po ndërtojnë zgjidhje të bazuara në “blockchain” për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale ushtarake dhe kundër kërcënimeve kibernetike. Aplikime të tjera të teknologjisë blockchain në industri përfshijnë gjurmimin e pajisjeve, thjeshtimin e procesit të prokurimit dhe sigurinë e zinxhirit të furnizimit.

Sipas disa studimeve Inteligjenca Artificiale është një nga tendencat më të spikatura në fushën e mbrojtjes, pasi shumë shtete dhe kompani po shpenzojnë gjithnjë e më shumë në këtë drejtim. Në mënyrë të ngjashme, robotika dhe sistemet autonome të armëve përmirësojnë efektivitetin luftarak të ushtrisë, si dhe ndikojnë në tendencat e tjera të industrisë. Gjithashtu, ka një rritje të konsiderueshme në përdorimin e teknologjive IoT dhe 5G. Shpërndarja mbi impaktin e dhjetë tendencave më të fundit të teknologjive ushtarake për vitin 2022 është: IA - 20 %; pajisje të avancuara të mbrojtjes – 17 %; robotika dhe sistemet autonome – 14 %; IoT – 10 %; “cyber warfare” - 10 %; teknologjitë zhytëse – 9 %; prodhimi i aditivëve¹⁹ - 6 %; analiza e të dhënave – 6 %; 5G – 5%; “blockchain” – 3 %.

Përfundime

Në hapësirën kibernetike, milisekondat bëjnë ndryshim. Bota është aktualisht në një pikë kthese, ku shpejtësia e zotësisë dhe inovacionit kibernetik sulmues po tejkalon zhvillimin e aftësive kibernetike mbrojtëse edhe të ushtrive më të mira në botë. Për të qenë proaktiv në fushën kibernetike, ushtritë duhet të përqafojnë një mentalitet për inovacion përçarës që merr në konsideratë mënyra të thjeshta dhe të lira për të penguar kundërshtarët. Inovacionet

¹⁸ Teknologji e ruajtjes së të dhënave e krijuar për të bërë të pamundur hakimin e sistemit ose falsifikimin e të dhënave të ruajtura në të, duke e bërë atë të sigurt dhe të pandryshueshëm.

¹⁹ Prodhimi i shtresave shtesë është emri i prodhimit industrial për printimin 3D, një proces i kontrolluar nga kompjuteri që krijon objekte tre dimensionale duke depozituar material, zakonisht në shtresa.

përçarëse nuk janë risitë tradicionale që shumica e njerëzve mendojnë për sa i përket zgjidhjeve që janë të sofistikuara, komplekse dhe shumë teknike. Inovacioni përçarës ka të bëjë me shfrytëzimin e zgjuarsisë, imagjinatës dhe eksperimentimit për të shfrytëzuar sa më mirë burimet lehtësisht të disponueshme në mënyra të reja, që pasi të zbatohen mund të ekzekutohen dhe të përparojnë me një ritëm të shpejtë për të luftuar kundër kundërshtarëve kibernetikë. Idetë e tilla si rritja e ndërgjegjësimit përmes edukimit publik dhe forcimi i bashkëpunimit dhe shkëmbimit mes komunitetit kibernetik nuk janë ide të reja, por ato kanë një potencial të lartë ndikimi për të përmirësuar mbrojtjen kibernetike. Duke kërkuar dhe eksploruar ide, procese dhe teknologji të reja nga komuniteti kibernetik, ushtritë mund të fillojnë të zhvillojnë aftësitë më të mira të mbrojtjes kibernetike.

Është e rëndësishme të kuptohet se peizazhi i luftës po ndryshon me një ritëm eksponencial me teknologjitë e reja. Shtete të tilla si Kina dhe Rusia disponojnë burimet e nevojshme dhe janë në zhvillim të vazhdueshëm të inovacionit gjithëpërfshirës në hapësirën kibernetike. Armët autonome vdekjeprurëse, llogaritja kuantike, robotika, Inteligjenca Artificiale dhe lidhja hiperkonvergjente dhe e sigurt me 5G dhe “blockchain” janë disa nga tendencat më të spikatura, pasi përmirësojnë efektivitetin luftarak të ushtrisë, si dhe ndikojnë në tendencat e tjera të industrisë. Shumë shtete dhe kompani po shpenzojnë gjithnjë e më shumë në këtë drejtim.

Kjo është arsyeja pse shteti ynë dhe Forcat e Armatosura si anëtare të NATO-s duhet të vazhdojnë të zhvillojnë risi teknologjike për të mbrojtur thelbin e hapësirës sonë kibernetike. Është e rëndësishme që të zhvillohen të gjitha llojet e inovacionit për të pasur shanse më të mëdha të suksesit për t'u mbrojtur kundër sulmeve kibernetike. Inovacionet e qëndrueshme fokusohen në përmirësimin e asaj që kemi tashmë dhe inovacionet inkrementuese fokusohen në përshtatjen e teknologjisë sonë aktuale me botën në ndryshim. Inovacionet penetruese, ku duhet të fokusohemi, janë jetike sepse ato janë në ballë të së ardhmes dhe na sjellin ide dhe teknologji që ndryshojnë mjedisin aktual. Inovacionet përçarëse janë gjithashtu kritike sepse ato përdorin sistemet dhe proceset aktuale për të prodhuar produkte dhe rezultate të paimagjinueshme. Identifikimi, përdorimi dhe zbatimi i teknologjive në zhvillim ndikon në fitimin e një pozite superiore në fushën e mbrojtjes. Rreziku i mosdiversifikimit të përpjekjeve kërkimore dhe inovacionit shumëdimensional për t'u përgatitur për konfliktin e ardhshëm kibernetik mund t'u japë kundërshtarëve një avantazh konkurrues.

Bibliografia

1. "Defense 101: Understanding the Military of Today and Tomorrow" (Cornell University Press, 2021)
2. "A cyber-security framework for development, defense and innovation at NATO" (Journal of Innovation and Entrepreneurship, 2019)
3. "Thinking Outside-the-Box for Cyber Defense": Introducing an Innovation Framework for the 21st century" (Katherine Hutton, LTC Ernest Wong, Ryan Gagnon, 2018)
4. <https://www.startus-insights.com/innovators-guide/top-10-military-technology-trends-2022/>
5. <https://www.rand.org/blog/2021/04/how-the-military-might-expand-its-cyber-skills.html>
6. <https://innovation-entrepreneurship.springeropen.com/articles/10.1186/s13731-019-0105-z>
7. <https://www.brookings.edu/research/military-innovation-and-technological-change-preparing-for-the-next-generation-of-cyber-threats/>
8. <https://cyberdefensereview.army.mil/CDR-Content/Articles/Article-View/Article/1577721/thinking-outside-the-box-for-cyber-defense-introducing-an-innovation-framework/>

RREZIQET KIBERNETIKE NDAJ SIGURISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË VITET NË VIJIM

Major Edvin Nure
Drejtoria J6, SHPFA

Trajtesë e shkurtuar. Siguria kibernetike është një nga aspektet më të fundit të politikave të sigurisë kombëtare që po bëhet gjithnjë e më e rëndësishme në të gjithë sektorët e sigurisë të vendeve evropiane. Politikë-bërësit janë ende duke zënë hapin me ritmin e zhvillimeve teknologjike që shfrytëzohen nga një sërë aktorësh, miqësorë dhe armiqësorë. Kjo kërkon që kornizat e reja ligjore dhe të politikave të zhvillohen shpejt dhe në mënyrë gjithëpërfshirëse. Përveç garantimit të sigurisë kombëtare, rrjetet e mbrojtura dhe të sigurta janë gjithashtu të rëndësishme për t'i dhënë hov ekonomisë kombëtare, si dhe për modernizimin e qeverisjes së sektorit publik në vendet e Evropës Juglindore (konsideroni, për shembull, rëndësinë vendimtare që ka rrjeti i sigurt për funksionimin e mirë të shërbimeve të e-qeverisjes që futen në përdorim).

Një hapësirë e sigurtë kibernetike është gjithashtu e nevojshme për të garantuar që qytetarët mund të ushtrojnë të drejtat e tyre, siç janë qasja në informata dhe liria e shprehjes. Të qenit të vetëdijshëm për mundësitë, rreziqet dhe kërcënimet që i sjell hapësira kibernetike është me rëndësi vendimtare. Ne të gjithë jetojmë një jetë dixhitale, punojmë, mësojmë dhe luajmë online. Interneti është një burim i përbashkët dhe sigurimi i tij duhet të jetë gjithashtu një përgjegjësi e përbashkët. Për këtë arsye, siguria kibernetike fillon nga gjithsecili prej nesh, nga çdo punonjës në sektorin privat apo administratën shtetërore, një mësues apo një student, një bankier apo një polic, pasi të gjithë do të ndikohemi dhe do të ndikojmë në sigurinë e hapësirës kibernetike. Asnjë individ, biznes apo entitet qeverisjeje nuk është i vetëm përgjegjës për sigurinë në internet.

Fjalët kyçe: inovacion, siguri kibernetike, rrezik, informacion, teknologji etj.

Hyrje

Në dekadat e fundit, zhvillimi i internetit dhe ndryshimet inovative në teknologji kanë sjellë ndryshime rrënjësore dhe sfida në çdo shoqëri në mbarë botën. Jetët tona të përditshme, të drejtat e njeriut, ekonomitë dhe ndërveprimet shoqërore ndikohen thellësisht nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Një hapësirë e përbashkët dhe e lirë kibernetike promovon përfshirjen sociale dhe politike, thyen barrierat e komunikimit midis vendeve, komuniteteve dhe qytetarëve, siguron transparencë, duke lejuar ndërveprimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe ideve në kohë reale në të gjithë globin. Të gjitha zhvillimet dhe rritja e përdorimit të teknologjive të informacionit dhe komunikimit vijnë me përfitime të mëdha dhe në të njëjtën kohë sjellin kërcënime, prandaj mbrojtja kibernetike dhe siguria janë vendimtare.

Në hapësirën kibernetike ekzistojnë përpjekje të vazhdueshme nga individë dhe grupe të ndryshme me interesa keqdashës, të cilat ndikojnë në mbarëvajtjen dhe funksionimin e shteteve. Ndërhyrjet e privatësisë, vjedhjet e identitetit janë gjithashtu një problem në rritje dhe shumë shqetësues për të gjithë shoqërinë. Nga njëra anë, qeveria po investon gjithnjë e më shumë në infrastrukturën digjitale, për të ofruar shërbime digjitale për qytetarët. Nga ana tjetër, qytetarët po e përdorin internetin gjithnjë e më shumë për shkak të avantazheve që ofron. Shqipëria, si një vend në zhvillim, mbështetet, gjithashtu, në teknologjinë e informacionit, duke synuar rritjen e nivelit të jetesës dhe përmirësimin e shërbimeve publike. Krahas përfitimeve nga përdorimi i teknologjive të reja digjitale, përdorimi i internetit sjell problematikat e veta në lidhje me sigurinë kibernetike. Kërcënimet kibernetike, duke përfituar nga dobësitë teknologjike ose mungesa e njohurive në përdorimin e mirë të këtyre mjeteve, janë gjithnjë e më shumë në rritje, duke cenuar sigurinë e sistemeve të informacionit. Një prej sfidave aktuale dhe të vazhdueshme për të gjitha vendet është ndërtimi i një shoqërie të zhvilluar digjitale dhe të mbrojtur kibernetikisht, të pajisur me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, për të maksimizuar përfitimet dhe për të menaxhuar rreziqet. Aktualisht, Shqipëria është përmirësuar në Indeksin Global të Sigurisë Kibernetike krahasuar me vitin 2017, nga 89, në 62, në mbarë botën dhe 36 në nivel evropian. Pa dyshim, sulmet kibernetike janë ndër kërcënimet më të rëndësishme të sigurisë për botën moderne dhe për

këtë arsye, siguria kibernetike është bërë një pjesë e rëndësishme e sigurisë kombëtare.

1. Situata aktuale e sigurisë kibernetike në Shqipëri

Si një vend në zhvillim pa infrastrukturën e nevojshme ligjore për sigurinë kibernetike, kjo fushë është zhvilluar vetëm dy vitet e fundit, gjatë së cilave janë identifikuar infrastrukturat kritike dhe të rëndësishme të informacionit në sektorin publik dhe atë privat. Gjithashtu, janë hartuar masat minimale të sigurisë që duhet të zbatohen për rritjen e nivelit të sigurisë kibernetike në këto infrastruktura dhe është ndërtuar mekanizmi metodologjik për ngritjen dhe funksionimin e Ekipit të Reagimit ndaj Incidenteve të Sigurisë Kompjuterike (CSIRT) sektorialë në nivel kombëtar¹. Kuadri ligjor i lidhur me sigurinë e komunikimeve elektronike plotësohet me rregullimet ligjore për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, rrjetet e telekomunikacionit, të cilat janë pjesë e ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”², i ndryshuar, i cili ka përshtatur direktivat e BE-së për komunikimet elektronike. Korniza ligjore për sigurinë kibernetike ka përcaktuar, gjithashtu, Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike (AKCESK) si autoritet përgjegjës për mbikëqyrjen e zbatimit të ligjit. Përkatesisht, situata aktuale, lidhur me sigurinë në infrastrukturat kritike të informacionit, është përmirësuar krahasuar me dy vite më parë. Në këto infrastruktura, janë aplikuar masa sigurie të konsiderueshme, të cilat janë aprovuar nga AKCESK, si dhe janë ngritur CSIRT-et sektoriale, duke krijuar kështu një mjedis të sigurt kibernetik.

Në infrastrukturat qeveritare kritike të informacionit që përdoren nga institucionet publike, përkatesisht të alokuara pranë qendrës së të dhënave qeveritare dhe që menaxhohen nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), zbatohen të gjitha masat e sigurisë konform legjislacionit në fuqi dhe standardit ISO 27001.

AKSHI është CSIRT sektorial qeveritar dhe është certifikuar me këtë standard në vitin 2018 dhe mbi çdo infrastrukturë qeveritare nën administrim të AKSHI-t, aplikohen politikat e standardit ISO 27001.

Për sa i përket infrastrukturës digjitale dhe rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, duke marrë parasysh që pjesa më e madhe e kërcënimeve dhe sulmeve kibernetike vijnë përmes rrjeteve të komunikimeve elektronike, çështjet e sigurisë kibernetike në këtë sektor ndiqen dhe janë nën përgjegjësinë e Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare

¹ Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2020-2025, f. 8.

² Ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”

(AKEP). AKEP-i, bazuar në ligjin nr. 9918, datë 19.05.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, më specifikisht, neni 122 dhe në rregulloren nr. 37, datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike”, kërkon marrjen e masave të duhura teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe integritetin e rrjeteve dhe/ose të shërbimeve të komunikimeve elektronike nga ana e sipërmarrësve të komunikimeve elektronike që veprojnë nën Regjimin e Autorizimit të Përgjithshëm për të gjitha shërbimet, përfshirë këtu edhe shërbimin DNS që ata ofrojnë për pajtimtarët e tyre. AKEP-i ka kryer dhe kryen në vazhdimësi inspektime dhe audite pranë sipërmarrësve për të verifikuar implementimin dhe zbatimin e masave të duhura teknike dhe organizative të sigurisë dhe në bashkëpunim me AKCESK ndjek incidentet e sigurisë që raportohen nga sipërmarrësit e komunikimeve elektronike. AKEP-i është administrator i domain-it “.al” dhe ka autorizuar 8 subjekte si regjistrarë të akredituar për ofrimin e shërbimit të regjistrimit të domain name nën zonën .al (TLD name registries). Me përfshirjen e këtij shërbimi në listën e infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit, subjekt i zbatimit të përcaktimeve të rregullores nr. 37, datë 29.10.2015 “Mbi masat teknike dhe organizative për të garantuar sigurinë dhe/ose integritetin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike” do të jenë dhe regjistrarët e akredituar nga AKEP-i për ofrimin e shërbimit të regjistrimit të domain name nën zonën.al. Penetrimi i internetit në Shqipëri është ende në zhvillim dhe paraqitet në një nivel mesatar përdorimi. Rreth 67% e popullsisë si dhe rreth 40% e familjeve kanë pasur qasje në internet në vitin 2019.

2. Krimi kibernetik në Republikën e Shqipërisë

Shqipëria, ashtu dhe si shtetet e tjera, është në shumë raste viktimë e veprimtarisë keqdashëse kibernetike, të kryer nga aktorë kriminalë, duke përfshirë aktorët shtetërorë dhe jositetërorë, që mund të përdorin infrastrukturën e rrjetit në Shqipëri dhe jashtë saj. Së bashku me përmirësimin e internetit, Shqipëria ka parë, gjithashtu, shfaqjen e formave të ndryshme të krimit kibernetik. Format e zakonshme të krimit kibernetik që mbizotërojnë në Shqipëri përfshijnë mashtrimet që lidhen me Internet banking, të tilla si: phishing dhe spam. Edhe kur individët përgjegjës për veprimtaritë kriminale kibernetike kundër Republikës së Shqipërisë identifikohen, shpesh është e vështirë për agjencitë e zbatimit të ligjit në Republikën e Shqipërisë dhe organizatat ndërkombëtare, që t'i ndjekin ato kur janë në juridiksione të kufizuara. Aktualisht, vihet re se mungojnë mjetet e nevojshme për të marrë dhe krijuar inteligjencë kibernetike, duke përdorur burime njerëzore dhe logjistike të nevojshme për të ushtruar veprimtarinë ligjzbatuese. Rritja e

kapaciteteve për t'u përballur me sfidat kibernetike është thelbësore dhe si pasojë duhet të ndryshohen strukturat, qasja, kapacitetet teknike dhe logjistike etj. Një hap i rëndësishëm përpara në zhvillimin e legjislacionit dhe marrjen e masave kundër krimit kibernetik do të jetë edhe strategjia e parë kombëtare për krimin kibernetik, e cila do të përgatitet nga autoritetet respektive dhe do të vihet në jetë në një kohë relativisht të shkurtër. Ky dokument do të mund të përcaktojë rrugën për të luftuar veprimtaritë kriminale në fushën kibernetike, si dhe mundësimin e më shumë mjeteve të përshtatshme në shërbim të kësaj lufte.

3. Kuadri ligjor i sigurisë kibernetike

Një qasje gjithëpërfshirëse kombëtare e sigurisë kibernetike nuk mund të bëhet duke përdorur vetëm teknologjitë dhe shërbimet, por duhet të shoqërohet me një kornizë ligjore të mirë dhe aktuale, me fokus në natyrën dinamike të mjedisit të TIK-ut dhe natyrën evoluese të kërcënimeve kibernetike. Struktura të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare realizojnë fushata ndërgjegjësimi për grupe të ndryshme interesi, me qëllim mbrojtjen nga kërcënimet që vijnë nga krimi kibernetik dhe sulme të tjera të sigurisë në internet. Një kuadër ligjor dhe rregullator që mbron format e ndryshme të abuzimit dhe krimit elektronik është thelbësor për krijimin e një ambienti të besueshëm, për komunikimet dhe transaksionet elektronike. Ligjet kryesore që lidhen me sigurinë dhe krimin kibernetik janë: - ligji nr. 7895, datë 27.1.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; - ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”; - ligji nr. 9918, datë 19.5.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; - ligji nr. 9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar; - ligji nr. 8457, datë 11.2.1999 “Për informacionin e klasifikuar”, i ndryshuar; - ligji nr. 9880, datë 25.2.2008 “Për nënshkrimin elektronik”, i ndryshuar; - ligji nr. 107, datë 15.10.2015 “Për identifikimin elektronik dhe shërbimet e besuara”, i ndryshuar.

Lidhur me sa më sipër, është i nevojshëm harmonizimi i legjislacionit në fushën e sigurisë kibernetike me atë të BE-së, duke krijuar mekanizmin e plotë dhe të qartë të kodifikuar, për të adresuar saktë problematikat dhe për t'i zgjidhur ato. Gjithashtu është e nevojshme të realizohet, aty ku është e mundur, qasja, nënshkrimi, ratifikimi dhe zbatimi i instrumenteve ndërkombëtare të sigurisë në internet, duke përfshirë shpërndarjen e burimeve të mjaftueshme, sipas prioriteteve kombëtare, duke marrë në konsideratë zhvillimet teknologjike dhe duke zbatuar parimin e teknologjisë neutrale.

4. Interneti dhe përdorimi nga fëmijët

Përdorimi gjithnjë e në rritje i internetit nga fëmijët është problematika më e madhe për sa i përket sigurisë së tyre në mjedis online, jo vetëm në Shqipëri.

Siguria e fëmijëve në internet është një ndër prioritetet e Shqipërisë dhe e të gjitha institucioneve që e kanë në fokus të veprimtarisë së tyre. Në vitin 2018-2019 u realizua nga Unicef Albania, si partneri strategjik dhe kryesor i qeverisë në mbrojtjen dhe të drejtat e fëmijëve, një studim mbi “Eksperiencat e fëmijëve në përdorimin e internetit në Shqipëri”³, i cili anketoi 1000 fëmijë të moshave 9 - 18 vjeç dhe prindërit e tyre, rezultatet paraprake të të cilit janë si më poshtë: Mosha mesatare kur fëmijët e anketuar kanë aksesuar internetin për herë të parë është 9 vjeç, nga ku 37% pohojnë se kanë përdorur internetin nga mosha 8-vjeçare ose/dhe më herët. Ndërsa 51% e fëmijëve të anketuar kanë gjithnjë akses online (sa herë që ata dëshirojnë). Në përgjithësi, fëmijët e anketuar përdorin më shumë internetin dhe kanë më shumë aftësi teknologjike online se prindërit e tyre. Kjo përbën një pengesë që prindërit të shoqërojnë në mënyrë efektive eksperiencën e fëmijëve në internet, jo vetëm duke kontrolluar aksesin, por duke i ndihmuar fëmijët të zhvillojnë gjykim kritik mbi eksperiencat dhe përmbajtjet në internet. Nga studimi rezultoi se gjatë kohës së lundrimit të tyre në internet, fëmijët janë hasur me situata të padëshiruara. Më konkretisht, 14% e fëmijëve të anketuar kanë përjetuar online diçka që i ka mërzhitur, veçanërisht mosha 15 - 17 vjeç. 1(një) në 10(dhjetë) fëmijë (9%) ka pasur një përvojë seksuale të padëshiruar në internet. Statistikat nga ky hulumtim tregojnë se fëmijët janë të ekspozuar nga përmbajtje të dëmshme online si: imazhet e dhunës apo abuzimit (1 në 5 fëmijë), përmbajtje që flasin për dhunë fizike (17% e fëmijëve) apo përmbajtje që flasin për vetëvrasje (1 në 10 fëmijë). 1(një) në 5(pesë) fëmijë kanë qenë subjekt i mesazheve denigruese dhe të urrejtjes drejt tyre, që është gjithashtu një indikator i situatave të mundshme të bullizmit online. Ndërkohë, studimi tregon se fëmijët e kanë të vështirë të ndajnë situatat e vështira që përjetojnë dhe të kërkojnë ndihmë: 1 në 5 fëmijë nuk ia ka treguar askujt ndodhinë që e ka mërzhitur, ndërsa 75% e fëmijëve të anketuar e kërkojnë ndihmën dhe mbështetjen nga bashkëmoshatarët e tyre dhe jo nga të rriturit.

Më shumë se 20% e fëmijëve të anketuar pranojnë të gjitha kërkesat për shoqëri në rrjetet sociale, ndërsa 25% e fëmijëve pranojnë se kanë bashkëvepruar online me dikë, që nuk e njohin në jetën reale dhe 16% e tyre kanë takuar personalisht dikë, që e kanë njohur vetëm nëpërmjet internetit. Prindërit janë të informuar vetëm për 9% të rasteve të mësipërme. Fëmijët e anketuar pohojnë se nuk kanë asnjë kontroll ose supervizim nga prindërit, kur shohin video online (78%), vizitojnë rrjetet sociale (58%), përdorin aplikacionet e mesazheve (57%) apo përdorin kamerën e kompjuterit ose telefonit (56%). Siç vihet re nga studimi, përdorimi i internetit nga fëmijët në mënyrë të pakontrolluar është në tregues shumë të lartë. Kjo problematikë shoqërohet shpesh herë edhe me pasoja të rënda. Mungesa e informacionit të prindërit lidhur me rreziqet që paraqet

³ Studim i realizuar nga Unicef Albania, viti 2017, f. 10-11.

interneti i pasigurt, është në nivele të larta gjithashtu. Lidhur me kontrollin prindëror, edhe pse ofrohet si mundësi teknike nga disa operatorë të ofrimit të shërbimit të internetit, nuk zbatohet. Gjithashtu, nga studimi i situatës në shtatë rajone të vendit, i konstatuar nëpërmjet fushatave ndërgjegjësuese, në të cilën u përfshinë rreth 12.000 fëmijë të shkollave 9-vjeçare, në masë të madhe fëmijët konfirmojnë se prindërit e tyre nuk kanë informacion të qartë mbi rreziqet e përdorimit të internetit të pasigurt nga fëmijët. Studimi ka gjetur se, megjithëse legjislacioni shqiptar në tërësi përputhet me standardet ndërkombëtare përkatëse mbi abuzimin seksual të fëmijëve, ai është shpesh i fragmentuar dhe i mungojnë përkufizime shumë të rëndësishme lidhur me abuzimin seksual të fëmijëve, angazhimin dhe detyrimin e tyre në aktivitete seksuale dhe në aktivitete të tjera të pahijshme.

Një tjetër gjetje e rëndësishme lidhet me legjislacionin shqiptar që rregullon funksionimin e ofruesve të shërbimit të internetit, i cili është i paqartë për sa u përket ngarkimit të autoriteteve administrative me kompetencat e bllokimit ose fshirjes së materialeve të caktuara. Kjo i pengon këto autoritete që t'i kuptojnë qartë rolet dhe funksionet e tyre dhe që të kenë mekanizmat për ushtrimin e tyre. Në këtë fushë nevojitet legjislacion i qartë lidhur me kompetencat dhe procedurat ekzakte të autoriteteve administrative. Njësia për hetimin e krimit kibernetik pranë Policisë së Shtetit ka mungesë mundësish për kryerjen e mbikëqyrjes aktive online, duke cenuar aftësinë e tyre për të filluar hetimet ex officio dhe proaktive. Mungesa e reagimit të shpejtë nga ofruesit e shërbimit të internetit ndaj kërkesave të prokurorisë dhe vështirësitë në identifikimin e adresave IP të kundërvajtësve të pretenduar, ndikojnë në mënyrë shqetësuese në cilësinë dhe efikasitetin e përgjithshëm të hetimit dhe rrjedhimisht, edhe në mundësinë për t'i vënë autorët para përgjegjësisë. Studimi tregon se Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijës, por dhe profesionistë të tjerë që merren me mbrojtjen e fëmijëve në internet, kanë nevojë për ngritje kapacitetesh dhe mbështetje për adresimin e rasteve të abuzimit të fëmijëve në internet. Gjithashtu, nuk ka të dhëna specifike të mbledhura dhe të publikuara për abuzimin e fëmijëve në internet.

5. Vizioni i sigorisë kibernetike për të ardhmen

Garantimi i sigorisë kibernetike në Republikën e Shqipërisë duhet të realizohet nëpërmjet ngritjes dhe funksionimit të mekanizmave bashkëveprues institucionalë: instrumenteve ligjore dhe teknike, si element kritik i mbrojtjes në hapësirën kibernetike, për infrastrukturën digjitale, transaksionet dhe komunikimet elektronike; nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve profesionale, rritjes së vetëdijes mbarëkombëtare, si dhe forcimit të bashkëpunimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për një mjedis digjital të sigurt.

Me qëllim ndjekjen e realizimit të objektivave specifike, të përkthyer në

plan veprimi të detajuar, janë hartuar indikatorët bazë, të cilët do të shërbejnë si udhëzues për të monitoruar realizimin e Strategjisë. Indikatorët janë konceptuar të tillë që të jenë të kuptueshëm, të matshëm dhe lehtësisht të krahasueshëm, sipas periudhave të monitorimit. Për çdo objektiv specifik janë planifikuar dy indikatorë bazë, të cilët mund të jenë të thjeshtë apo të përbërë, në varësi të nënobjektivave që do të matin.

Për shkak të dinamikës dhe shpejtësisë me të cilën zhvillohet Teknologjia e Informacionit dhe Komunikimit (TIK) bashkëpunimi me sektorin privat duhet të forcohet. Vetëm nëpërmjet një bashkëpunimi të ngushtë mund të rritet siguria dhe zhvillimi i TIK-ut në administratën shtetërore, në koherencë me zhvillimet dhe trendin e teknologjisë. Rritja e bashkëpunimit dhe koordinimit ndërmjet institucioneve shtetërore do të forcohet për të garantuar ndërveprimin dhe koordinimin në forcimin e sigurisë dhe minimizimin e dëmeve nga sulmet kibernetike. Shqipëria mbështet dhe do të jetë pjesë e iniciativave ndërkombëtare, të cilat synojnë rritjen dhe forcimin e sigurisë. Në mënyrë të veçantë do të forcohet bashkëpunimi me NATO-n dhe BE-në, duke u bërë pjesë aktive e iniciativave të përbashkëta për sigurinë kibernetike. Anëtarësimi i Shqipërisë në organizmat dhe forumet e sigurisë kibernetike të njohura ndërkombëtare dhe rritja e bashkëpunimit është prioritet. Në cilësinë e vendit anëtar të NATO-s, Shqipëria njeh hapësirën kibernetike si domeni e pestë të luftës, së bashku me tokën, detin, ajrin dhe hapësirën. Hapësira kibernetike paraqet sfida dhe siguria në këtë hapësirë arrihet vetëm duke menduar në nivel global dhe duke punuar ngushtë në nivel ndërkombëtar.

Përfundime

Procesi i dixhitalizimit është sfidues jo vetëm në hartimin e ligjeve por më së shumti në zbatimin e kuadrit ligjor. Një hap pozitiv i shtetit shqiptar lidhet si me miratimet e ligjeve të ndryshme, si: Ligji për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për Komunikimet Elektronike apo ai për Tregtinë Elektronike, ashtu edhe me nënshkrimet e një sërë marrëveshesh dhe konventash ndërkombëtare siç është ratifikimi i Konventës Europiane mbi Krimin Kibernetik.

Nuk mund të realizohet dot harmonizimi i plotë i ligjit me atë europian, pasi ky proces duhet të jetë gradual dhe duhet të bazohet edhe në kontekstin shqiptar. Vështirësia me ligjin në fushën e sigurisë kibernetike qëndron dhe te fakti që është një legjislacion i ri dhe dinamik, pasi edhe fusha është e tillë, që ndryshon me shpejtësi.

Procesi i identifikimit të strukturave kritike është një metodë e re e futur në Shqipëri. Përditësimi i informacionit duhet të bëhet të paktën një herë në dy vjet dhe duhet që të raportohen incidentet për të gjitha strukturat kritike.

Edhe pse BE-ja ka një listë indikatorësh për këto struktura kritike, ato duhet të përshtaten me zhvillimin teknologjik dhe atë të institucioneve shqiptare. Kështu që disa nga këta indikatorë si, kërkimi hapësinor, mund të injorohet pasi nuk gjen zbatim në Shqipëri. Gjithashtu, indikatorë të rinj mund të krijohen siç është: siguria dhe rendi publik, që janë prioritarë në Shqipëri.

Forcimi i kapaciteteve njerëzore e teknike për të luftuar krimin kibernetik. Kapacitetet njerëzore në këtë drejtim janë të pakta dhe mungojnë. Fokusi duhet jo vetëm në trajnimet e ekspertëve të policisë, por edhe atyre të sistemit gjyqësor dhe prokurorëve, duke thelluar dhe bashkëpunimin mes institucioneve.

Rekomandohet që të trajnohen të paktën një gjyqtar dhe një prokuror për çdo rreth gjyqësor mbi sigurinë kibernetike dhe krimin kibernetik, në mënyrë që koordinimi i punës të jetë më i thjeshtë mes policisë dhe institucioneve të hetimit dhe gjyqimit në të gjithë vendin. E rëndësishme është që punonjësit e policisë dhe institucioneve të tjera të kenë njohuri mjaft të mira jo vetëm teknike dhe ekspertizë të lartë të fushës për të ditur si funksionon, por një domosdoshmëri shfaqet dhe niveli i lartë i njohjes së gjuhës angleze. Për këtë mund të realizohen trajnime brenda institucioneve të policisë, trajnimet me ekspertë të policive europiane apo ndërkombëtare si Europol apo Interpol, shkëmbim eksperiencash apo metodash se si të dallohet krimi kibernetik dhe si të hetohet ai. Kjo është e nevojshme edhe për gjyqtarët dhe prokurorët për të dhënë më pas të gjithë informacionin e nevojshëm.

Informimi dhe monitorimi për një internet më të sigurt. Mungon vëmendja ndaj këtij sektori, pak flitet dhe diskutohet kjo edhe për faktin e karakterit të tij specifik dhe teknik. Kërkohen më shumë fushata sensibilizimi dhe informimi mbi rrezikun kibernetik dhe si të mbrohem prej tij. Është i nevojshëm një proces i vazhdueshëm dhe periodik mbikëqyrjeje dhe monitorimi për sa i përket subjekteve dhe ngjarjeve kompjuterike dhe për këtë duhet edhe një regjistër i veçantë për të vendosur edhe incidentet kibernetike, edhe raportimet.

Rekomandime

Në përfundim, kam evidentuar disa rekomandime, me qëllim që Republika e Shqipërisë të garantojë siguri kibernetike në nivel kombëtar, nëpërmjet mbrojtjes së infrastrukturave të informacionit, duke fuqizuar mjetet teknologjike dhe juridike.

1. Përmirësimi i kuadrit ligjor që normon dhe rregullon fushën e sigurisë kibernetike në vend, si dhe harmonizimi i tij me direktivat dhe rregulloret e Bashkimit Evropian.
2. Përdorimi i zgjidhjeve hardware dhe software të avancuara për identifikimin, parandalimin dhe menaxhimin e incidenteve kibernetike.

Analizimi i infrastrukturave kritike dhe të rëndësishme të informacionit për vlerësimin e menaxhimit të riskut në to.

3. Përmirësimi i infrastrukturave të informacionit për të luftuar krimin kibernetik, radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm.
4. Hartimi i programeve të studimit në arsimin e lartë në fushën e sigurisë kibernetike, me qëllim krijimin e gjeneratës së re të ekspertëve të sigurisë kibernetike.
5. Rritja dhe mbështetja e kapaciteteve kërkimore dhe risive të biznesit nëpërmjet nxitjes së ngritjes së qendrave kërkimore shkencore në fushën e sigurisë kibernetike.
6. Rritja e kapaciteteve të CSIRT-eve në nivel kombëtar dhe nivelit ekzekutiv të administratës publike nëpërmjet trajnimeve dhe stërvitjeve kibernetike.
7. Organizimi i fushatave ndërgjegjësuese nga autoriteti përgjegjës për sigurinë kibernetike me grupe interesi të ndryshme, duke përdorur hapësirat e duhura për realizimin e tyre, përfshirë edhe mediat audiovizive apo edhe ato sociale.
8. Krijimi i një platforme edukative online, për sigurinë kibernetike, për të rritur ndërgjegjësimin në grup-mosha të ndryshme të shoqërisë për përdorimin e internetit të sigurt dhe të infrastrukturës digjitale.
9. Krijimi i mekanizmave të nevojshëm për sigurinë e fëmijëve në hapësirën kibernetike, duke përgatitur njëkohësisht brezin e ri të aftë për të përfituar nga përparësitë e teknologjisë së informacionit dhe për të përballuar sfidat e zhvillimit.
10. Ngritja e një strukture fleksibël me ekspertët më të mirë të sigurisë kibernetike në vend, me qëllim mbështetje në raste krizash kibernetike, testimi dhe vlerësimi të nivelit të sigurisë kibernetike në nivel kombëtar.

Bibliografia

LIGJE

1. Ligji nr.2/2017 "Për Sigurinë Kibernetike".
2. Ligji nr.107/2015, datë 1.1.2015 "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara" (i përditësuar)
3. Ligji nr. 9880/2008, datë 25.2.2008 "Për Nënshkrimin Elektronik"(i përditësuar).
4. Ligji nr.10273, datë 29.4.2010 "Për Dokumentin Elektronik" (i përditësuar)

VKM

1. VKM nr. 1084, datë 24.12.2020 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe Planit të veprimit 2020-2025".
2. VKM nr. 141, datë 22.2.2017 "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike".
3. VKM nr. 553, datë 15.07.2020 "Për miratimin e Listës së Infrastrukturave Kritike të Informacionit dhe të Listës së Infrastrukturave të Rëndësishme të Informacionit".
4. VKM nr. 495, datë 13.9.2017 "Për miratimin e rregullave të përfitimit të shërbimeve publike elektronike".
5. VKM nr. 69, datë 27.1.2016 "Për miratimin e rregullores "Për Identifikimin Elektronik dhe Shërbimet e Besuara".
6. VKM nr. 973, datë 2.12.2015 "Për miratimin e dokumentit të politikave për sigurinë kibernetike 2015 - 2017".
7. VKM nr. 503, datë 13.5.2009, "Për tarifatat e shërbimeve që ofrohen nga AKCE" (i përditësuar).

RUBRIKA E TRETË

Studime historike

Tashmë “Revista Ushtarake” e ka bërë traditë të saj trajtimin e temave historike, të lidhura me çështje të ndjeshme të historisë së popullit shqiptar e veçanërisht të ushtrisë shqiptare ndër vite, si dhe të problematikave të intensifikimit të arsimit ushtarak në vitet 1950-1970.

Në këtë rubrikë, autorët Dr. Eva Smaçi dhe Dr. Shpëtim Madani vijnë me shkrimin “Reformimi i Ushtrisë Popullore në kuadër të anëtarësimit në Traktatin e Varshavës (1955-1956). Ndikimi në politikën e brendshme”, i cili synon të analizojë një ndër momentet më kritike të reformimit të Ushtrisë Popullore në periudhën kohore 1955 - 1956. Në metodën analitike, punimi hedh dritë mbi shkak-pasojat e këtij reformimi të detyrueshëm, por gjithashtu sjell në vëmendje të lexuesit veçanërisht atij ushtarak, rrugëtimin që FA e Shqipërisë ka bërë për formësimin e identitetit të saj në kushtet e përfshirjes në një aleancë kolektive sigurie si Traktati i Varshavës.

Në shkrimin “Përpjekje për konsolidimin e shkollës ushtarake në vitet 1950-1970” Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi jep një informacion të hollësishëm rreth problematikave të intensifikimit të arsimit ushtarak në vitet 1950-1970. Kjo etapë e rëndësishme në shekullin e kaluar mund të etiketohet si faza e “tranzicionit”, e cila do të çonte në konsolidimin e shkollës ushtarake deri në marrjen e “statusit” të shkollës së lartë. Hapja e shkollave të reja ushtarake ishte domosdoshmëri e kohës dhe nevojë e ushtrisë, e cila tregonte dukshëm rritjen dhe forcimin e saj si dhe kompletimin me teknikën e kohës. Këto shkolla do të

plotësonin arsimimin për të gjitha llojet e armëve e shërbimeve me komandantë të zotë e specialistë të aftë, duke iu përgjigjur politikave të shtetit shqiptar dhe nevojave të ushtrisë.

Revista mbyllet me një tjetër shkrim historik nga ish-ushtaraku, tashmë në pension, Kolonel Sali Onuzi “Krijimi i ushtrisë kombëtare shqiptare nga qeveria e përkohshme e Vlorës (1912-1914)”. Nëpërmjet fakteve dhe dokumenteve të arkivuara, autori sjell në kujtesën e lexuesve një dëshmi të identitetit tradicional shqiptar me rëndësi të veçantë në planin kombëtar. Qeveria e përkohshme e Vlorës kishte krijuar ushtrinë e saj shqiptare, e cila ishte një forcë që kish luftuar në front për të ndalur përparimin e forcave sidomos atyre greke për të pushtuar Vlorën dhe territore të tjera shqiptare.

REFORMIMI I USHTRISË POPULLORE NË KUADËR TË ANËTARËSIMIT NË TRAKTATIN E VARSHAVËS (1955-1956). NDIKIMI NË POLITIKËN E BRENDSHME

Dr. Eva Smaçi

Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Dr. Shpëtim Madani

Qendra e Gjuhëve të Huaja, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Punimi synon të analizojë një ndër momentet më kritike të reformimit të Ushtrisë Popullore në periudhën kohore 1955 - 1956. Ky reformim nuk erdhi si rrjedhojë e nevojave të brendshme të politikave të mbrojtjes, por ishte pasojë e kushtëzimeve që iu vunë udhëheqjes politike shqiptare, pas anëtarësimit të Shqipërisë në Traktatin e Varshavës më 11 maj të vitit 1955.

Ushtria Popullore shqiptare kishte njohur reformime të pjesshme gjatë dhjetëvjeçarit të parë të pas luftës në vitet 1945, 1946 dhe 1947. Por bërja pjesë në një organizatë politiko-ushtarake që kishte si parim mbrojtjen kolektive, e vinte Komitetin Qendror të PPSH përpara një vendimmarrjeje të vështirë politike: reduktimi i një numri të lartë trupash.

Një akt i tillë kishte impakt të drejtpërdrejtë politik, prandaj edhe pjesa dërrmuese e dokumenteve të marra në shqyrtim në këtë punim i përkasin arkivit së Komitetit Qendror të Partisë së Punës. Debatet e zhvilluara në mbledhjen e Komitetit Qendror dhe Byronë Politike janë dëshmi se ky proces nuk ka qenë

aspak i lehtë. Presioni i udhëheqjes së Bashkimit Sovjetik për reduktimin e trupave të ushtrisë shqiptare së pari, lidhej me vështirësitë ekonomike të Shqipërisë. 50% e shpenzimeve ushtarake mbulohehin nga Bashkimi Sovjetik. Së dyti, viti 1955 shënoi një frymë të re në marrëdhëniet ndërkombëtare mes dy blloqeve dhe motoja e udhëheqësve të kampit socialist pas konferencës së Gjenevës ishte “bashkekzistenca paqësore”.

Për ta përmbyllur, bazuar në metodën analitike punimi hedh dritë mbi shkak-pasojat e këtij reformimi të detyrueshëm, por gjithashtu sjell në vëmendje të lexuesit veçanërisht atij ushtarak, rrugëtimin që FA e Shqipërisë ka bërë për formësimin e identitetit të saj në kushtet e përfshirjes në një aleancë kolektive sigurie si Traktati i Varshavës.

Fjalë kyçe: Ushtria Popullore, reformim, Bashkim Sovjetik, Komiteti Qendror, Traktati i Varshavës

Hyrje

Forca e Armatosur e krijuar më 10 korrik 1943, në kuadër të rezistencës antifashiste e formuar nga Partia Komuniste Shqiptare dhe që njihej si Ushtria Nacionalçlirimtare, ishte e vetmja forcë e armatosur përfaqësuese e shtetit të ri shqiptar në përfundim të pushtimit nazifashist të vendit në nëntor të vitit 1944. Me përfundimin e Luftës së Dytë Botërore dhe me legjitimimin e udhëheqjes komuniste si e vetmja force politike në vend, Forca e Armatosur do të ishte ndër strukturat e para që do t'i nënshtrohej reformimit. Më 9 korrik 1945 ajo do të merrte emrin “Ushtria Kombëtare”. Ndryshimet e tjera me karakter organizativ do të preknin së pari njësitë e mëdha ushtarake të krijuara gjatë fundit të vitit 1944. U suprimuan korparmata 1, 2, 3 si edhe divizioni i 7-të dhe i 8-të.

Një tjetër proces madhor në kuadër të reformimit ishte ai i çmobilizimit. Kalimi i partizanëve në jetën civile u pa i lidhur ngushtë me reduktimin e forcave aktive, një domosdoshmëri e kushteve ekonomike në vend. Çmobilizimi nuk ishte i menjëhershëm, por në disa faza. Në fund të vitit 1945, në radhët e ushtrisë numëroheshin 45000 vetë nga 70000 luftëtarë që morën pjesë në njësitë ushtarake të LANÇ. Në vitin 1946 u bë riorganizimi i dytë i FA duke pakësuar 10000 vetë. Pra, u reduktua numri i efektivëve në 35000 vetë. Organizimi i tretë u bë në vitin 1947. Konsolidimi i Ushtrisë Kombëtare u bë duke u mbështetur në detyrimet kushtetuese që shtroheshin para saj. “Ushtria Popullore është fuqia e armatosur e RPSH. Detyra e saj është të sigurojë dhe të mbrojë independencën e shtetit dhe lirinë e popullit. Ajo ruan që të mos cenohen kufijtë e shtetit dhe shërben për mbrojtjen e paqes dhe të sigurisë.”

Për organizimin dhe drejtimin e FA më 1 korrik 1945 u krijua Ministria e Luftës dhe Mbrojtjes Kombëtare. Në përbërje të saj ishte Komanda e Përgjithshme e Ushtrisë Kombëtare. Shtabi i Përgjithshëm ishte në vartësi të Komandantit Suprem. Komandanti Suprem ishte i ngarkuar me punët e luftës dhe mbrojtjes kombëtare. Përfundimi i luftës dhe reformimi i ushtrisë u shoqërua edhe me ndryshime të eksponentëve që kishin drejtuar organet kryesore të ushtrisë gjatë LANÇL. Gjeneralmajor Mehmet Shehu zëvendësoi gjeneralmajor Spiro Moisiun në detyrën e kryetarit të Shtatmadhorisë (detyrë

e mbajtur nga ky i fundit, që prej krijimit të Shtabit në korrik 1943). Vetë Enver Hoxha mbajti postin e Ministrit të Luftës. Enver Hoxha dha dorëheqjen nga ky funksion në 12 korrik 1954, nën presionin e vazhdueshëm të sovjetikëve, pasi kishte një numër të madh funksionesh.

Këto ishin disa nga momentet themelore të reformimit të Forcave të Armatosura të Republikës Popullore të Shqipërisë në 10-vjeçarin e parë, që nuk shënuan hapa cilësorë, së pari për shkak të izolimit dhe së dyti prej kushteve tepër të rënda ekonomike në vend. Ndryshimet cilësore që u shoqëruan me reduktime sasiore i përkasin periudhës 1955 - 1960, periudhë gjatë së cilës Shqipëria dhe FA të saj ishin pjesë e Traktatit të Varshavës (më tej TV), organizatë politike dhe ushtarake. Njoftimi i parë zyrtar se Shqipëria do t'i bashkohej Traktatit të Varshavës dhe ushtarakisht Komandës së Bashkuar të këtij traktati dokumentohet nga pikëpamja arkivore në Plenumin e KQ të PPSH, më 27 prill 1955. Enver Hoxha në përfundim të plenumit njoftoi anëtarët e tij se do t'u jepte një lajm të mirë e të gëzuar. Si përfundim i marrëveshjes së Moskës dhe konsultimeve të bëra kohët e fundit, do të firmosej traktati i Miqësisë, Bashkëpunimit dhe i Ndihmës Reciproke midis tetë vendeve që kishin marrë pjesë në konferencën e Moskës si dhe marrëveshja për krijimin e Komandës së Bashkuar.¹

Teza e anëtarësimit në TV për t'i bërë ballë sulmeve nga jashtë [nënkupto nën kujdesin e perëndimit E.S] ka mbizotëruar punimet historike të periudhës së komunizmit. Akuzat e liderit komunist Enver Hoxha që politikën amerikane e ka akuzuar si të angazhuar në zhdukjen e pavarësisë së Shqipërisë ngelen në rrafshin e luftës ideologjike. Në dokumentet amerikane ka një numër të madh rekordesh që dëshmojnë për të kundërtën. Qeveria amerikane tradicionalisht dhe në mënyrë konstante e ka afishuar veten në përkrahje të pavarësisë dhe integritetit territorial të Shqipërisë.² Projektet e Departamentit të Shtetit lidheshin me përmbysjen nga brenda të regjimit komunist të E. Hoxhës, si vend anëtar i bllokut komunist ku mungonin liritë demokratike dhe analizat mbi ushtrinë dhe fuqinë e saj mbrojtëse kanë qenë objekt studimi, sidomos pas përfshirjes në Traktatin e Varshavës.

Shqipëria tashmë kishte një traktat të Miqësisë, Bashkëpunimit dhe Ndihmës Reciproke dhe në planin ushtarak do të ishte pjesë e Komandës së Bashkuar të Forcave të Armatosura. Pra, Shqipëria kishte një protektor, që duhet ta

¹ Arkivi Qendror Shtetëror (më tej AQSH), Fondi 14 AP/ OU, V. 1955, D.1, fl 499. Procesverbal. Enver Hoxha jep komunikimin mbi marrëveshjen e arritur në Moskë për të përfunduar Traktatin e Miqësisë dhe Komandës së Bashkuar. Shih gjithashtu: Ana Lalaj, Shqipëri në Paktin e Varshavës, 1955- 1968”, në: *Studime Historike*, 2004, nr 1-2.

² Ana Lalaj, “Përse pranoi Enver Hoxha ta nënshkruante Traktatin e Varshavës”, në gazetën: *Panorama*, Nr.72, Tiranë, 12 shtator 2004, f. 12 -13.

mbronte, jo thjesht në aspektin ideologjik, por si një organizëm politik dhe ushtarak i legjitim. Po a do të shoqërohej anëtarësimi veç me përfitime apo do të kishte edhe kushtëzime të detyrueshme?

Urdhrat e parë nga Moska: Shkurtoni personelin e FA!

Vera e vitit 1955 do të shënonte ndryshime të detyruara jo vetëm në marrëdhëniet ndërkombëtare të Shqipërisë. Nga anëtarësimi i saj në TV do të buronin angazhimet e para në fushën ushtarake. Ato do të kishin një ndikim jo të pëlqyeshëm social. Një numër i ndjeshëm efektivësh do të shkurtoheshin. Ky do të ishte shkurtimi më i madh pas atij të vitit 1954³ dhe do e vinte qeverinë komuniste shqiptare përpara vështirësive që lidheshin me sistemimin e njerëzve të pakënaqur që do të largoheshin nga radhët e ushtrisë. Togfjalëshi “fryma e Gjenevës”^{*} do të ishte ndër më të përdorshmit në politikën e jashtme të BS në mesin e viteve 50-të. Forcimi i pozitës së Hrushovit në krye të BS u shoqërua edhe me tezën e bashkekzistencës paqësore. Vetëm një ditë pas nënshkrimit të TV, u nënshkrua traktati i paqes me Austrinë.^{*} Sipas këtij traktati, trupat e BS duhet të tërhiqeshin nga Hungaria dhe Rumania. Ky veprim ishte në funksion të uljes së tensionit. Por trupat ushtarake sovjetike në këto dy vende ishin tashmë si pjesë e trupave të Komandës së Bashkuar të TV. Neni i pestë i TV kishte legjitimuar praninë e trupave sovjetike aty. Megjithatë nismat për të ulur garën e armatimeve dhe demonstrimin e forcës ushtarake nuk munguan.

Në verën e vitit 1955, KQ i PPSH mori nga Moska një letër ku bëheshin propozime konkrete për pakësimin e FA të RPSH. Letra iu dorëzua kryeministrit të vendit M. Shehu nga ambasadori sovjetik në Shqipëri Leviçkin. Dorëzimi i letrës dhe marrja e saj në shqyrtim korrespondoi me qenien e E. Hoxhës në Moskë. Për të shqyrtuar përmbajtjen e saj u mbledh Byroja Politike (më tej BP) nën drejtimin e Mehmet Shehut.⁴ Në letër propozohej që numri i FA

³ AQSH, Fondi 490, V.1955, D.32. VKM. “Mbi pakësimin e FA të RPSH”, 03.09.1955.

^{*} Samiti i Gjenevës, mbajtur më 18 korrik 1955. Në të morën pjesë kryetarët e qeverive të katër Fuqive të Mëdha: President i SHBA, Dwight D. Eisenhower, kryeministri anglez Anthony Eden, kryeministri francez Edgar Faure dhe kryetari i Këshillit të Ministrave të BS, Nikolai A. Bulganin. Ulja e tensionit ndërkombëtar ishte synimi kryesor i këtij samiti. Dhënia fund e garës nukleare, ndalimi i të gjitha armëve të dëmtimit në masë, negociatat për bashkimi i Gjermanisë, krijimin e një sistemi kolektiv të sigurisë europiane ishin disa ndër problemet e diskutuara. Pavarësisht se palët ndanin mendime të ndryshme, në fund të bisedimeve pati një “detantë” mes protagonistëve. Pikërisht prej këtej buroi dhe togfjalëshi “The Geneva spirit”.

^{*} Më 15 maj 1955, në pallatin Belvedere në Vienë u nënshkrua traktati i paqes me Austrinë. Nënshkrimi i traktatit të paqes me Austrinë hidhte poshtë pretendimet sovjetike për praninë e trupave të saj në Hungari dhe Rumania, për të siguruar linjën e saj mbrojtëse. Sipas traktatit, BS ishte e detyruar t’i tërhiqte trupat e tij nga këto dy vende brenda 40 ditëve që traktati merrte efekte ligjore.

⁴ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1955, D.28, fl.1. Procesverbal i mbledhjes së BP të KQ të PPSH, “Mbi letrën e KQ të PKBS në lidhje me pakësimin e FA të RPSH.

të Shqipërisë të pakësohej me rreth 8000 efektivë. Arsyeja që jepej për këtë shkurtim ishte ulja së tensionit ndërkombëtar pas konferencës së Gjenevës dhe me qëllim forcimit të ekonomisë së vendit.⁵

Përpara shtrimit të problemit në Byronë Politike, Mehmet Shehu fillimisht e kishte diskutuar me Beqir Ballukun, përfaqësues i Shqipërisë në Këshillin e Mbrotjtjes në Traktatin e Varshavës. Të dy përfaqësuesit më të lartë të Shqipërisë në TV shfaqën hezitim të miratonin letrën në mungesë të Enver Hoxhës [kjo ishte praktikë në vendet komuniste, por duke pasur parasysh edhe pasojat e vendimmarrjes në radhët e ushtrisë hezitimi ishte i kuptueshëm. E.S.]⁶ Kështu që byroja dhe ministri i Mbrotjtjes Beqir Balluku e miratuan letrën në parim. Diskutimet në Byronë Politike dëshmojnë se kërkesa e ardhur nga TV për shkurtimin e FA nuk pati reagime të forta.

Së pari, në kushtet e vështirësive të mëdha ekonomike që ndodhej vendi ynë, këto shkurtime krijonin pak frymëmarrje për ekonominë. Edhe pse 50% të shpenzimeve për ushtrinë përballoheshin nga BS në bazë të marrëveshjes së vitit 1949⁷, shteti shqiptar vazhdimisht kërkonte ndihma ushtarake, ushqimore dhe veshmbathje nga BS, në pamundësi për të plotësuar vetë nevojat. Së dyti, në këndvështrimin e udhëheqjes komuniste, shkurtimi i numrit të FA nënkuptonte forcimin e pozitës ndërkombëtare të saj. Gjithashtu, udhëheqja shqiptare e shikonte këtë masë si nismë paqësore të bllokut socialist duke folur me nisma konkrete.⁸ Në BP ky vendim ngacmoi diskutime. Duket se anëtarët e BP ndanin mendime të ndryshme mbi mënyrën se si do të veprohej për shkurtimet e kërkuara nga TV. Liri Belishova* e shikonte problemin si një çështje sekrete për të cilën duhet të thërritej një mbledhje e përbashkët e BP dhe kryesisë së qeverisë. Ideja se kjo çështje i përkiste qeverisë⁹ u mbështet edhe nga Gogo Nushi,* nisur nga fakti se në BS lajmi i shkurtimit të një

⁵ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1955, D.28, fl.1. Procesverbal i mbledhjes së BP të KQ të PPSH, "Mbi letrën e KQ të PKBS në lidhje me pakësimin e FA të RPSH.

⁶ Nga procesverbali i mbledhjes së BP, del qartë se M. Shehu e kishte pyetur Leviçkinin, nëse E. Hoxha kishte dijeni për përmbajtjen e letrës dhe nëse jo të vihej në dijeni sa më shpejt.

⁷ *Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura (më tej AQFA)* Fondi 100/1[Shtabi i Përgjithshëm], V.1949, D. 158, Marrëveshje e nënshkruar në Moskë, për BS nga marshall Sokollovski dhe Ministrinë e Mbrotjtjes Popullore nga i ngarkuari i jashtëzakonshëm i RPSH në BS, Mihal Priifti.

⁸ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1955, D.28, fl.2. Në argumentin e dytë Byroja Politike kishte parasysh se shkurtimet në FA kishin prekur gjithë vendet anëtare të TV. Kështu vetë BS do të bënte një shkurtim prej 640.000 vetash.

* **Liri Belishova**, (14 tetor 1926 - 23 prill 2018) e para anëtare e BP femër, nga viti 1948- 1960. U përjashtua nga BP pak kohë para prishjes me BS dhe u internua.

⁹ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1955, D.28, f.2. Gogo Nushi mbështeti idenë se ndryshime të tilla në BS u dhanë nga qeveria.

* **Gogo Nushi**, (1913 -1970), anëtar i Byrosë Politike. Ka mbajtur disa poste të rëndësishme në qeverinë komuniste shqiptare.

numri të konsiderueshëm të FA, ishte dhënë nga qeveria. Sistemimi në punë i ushtarakëve të liruar ishte një tjetër problem. U propozua që pas çmobilizimit ata të përdreshin në formën e reparteve ushtarake të organizuara për ndërtimin e objekteve si rafineria e Cërrikut, hidrocentrale, etj.¹⁰ Beqir Balluku propozoi që në numrin prej 8000 vetash, 7000 efektivë të shkurttoheshin nga FA, kurse 1000 nga radhët e Ministrisë së Brendshme (MB) nga forcat e kufirit¹¹.

Dilemat e KQ të PPSH dhe debatet për shkurtim e FA

Ky problem u shtrua edhe në mbledhjen e Këshillit të Ministrave më 3 shtator. Mehmet Shehu, duke parashtruar orientimin e marrë nga BS për shkurtimin e FA e justifikoi atë me problematikat ekonomike, që burojnë nga mbajtja e një ushtrie të madhe. Ai tha se FA, sidomos për shtetin shqiptar, ishin jashtëzakonisht të rënduara, në krahasim me popullsinë. Mbajtja e tyre rëndonte shumë ekonomikisht.¹² Ana tjetër e kësaj nisme kishte kontekst politik. Duke analizuar situatën në botë, në kuadër të uljes së tensioneve, edhe Shqipëria duhet të bëhej pjesë e shteteve që duhet të jepnin shembull se ishin kundër politikave militarizuese.

Më 6 janar 1956 u thirr në Moskë konferenca e Sekretarëve të Parë të Partisë të vendeve të bllokut komunist. Dy problemet e lartpërmendura, ulja e tensionit në marrëdhëniet ndërkombëtare dhe pakësimi i forcave të armatosura nën moton e bashkekzistencës paqësore, do të ishin boshti i konferencës. Në fjalën e tij, Hrushovi e nënvizoi edhe njëherë rëndësinë e doktrinës së re në politikën e jashtme. Të gjitha vendet e kampit socialist duhet t'i bënin më aktive përpjekjet e tyre në politikën e jashtme, të forconin lidhjet e tyre ndërkombëtare.¹³ Për udhëheqjen shqiptare kambana e alarmit binte në mënyrë të veçantë për raporte me fqinjët.

Enver Hoxha do të raportonte në mbledhjen e BP për këtë takim më 14 janar. Direktiva e marrë nga Moska ishte që FA t'i nënshtroheshin përsëri shkurtimit. Shifra e FA së bashku me forcat e kufirit duhet të ishte në shifrën prej 23000 vetash.¹⁴ Ministrin të Mbrojtjes Popullore dhe njëkohësisht anëtar i BP, Beqir Ballukut iu ngarkua detyrë nga kjo mbledhje që së bashku me drejtorinë Administrative të KQ të PPSH të merrnin masat e nevojshme për shpërndarjen e kuadrove që do të liroheshin nga funksionet ushtarake duke i vendosur sipas aftësive dhe mundësive që ekzistonin në organet e ndryshme të pushtetit dhe

¹⁰ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1955, D.28, fl.5.

¹¹ Po aty, fl.4.

¹² AQSH, Fondi 490, V. 1955, D.60, fl.2. Procesverbal i mbledhjes së KM, datë 3.09.1955

¹³ Casas Bekes, Anna Locher and Christian Nuenlist, Records of the Meetings of Warsaw Pact Deputy Foreign Ministers, PHP publication series, Washington, D.C./ Zurich, September 2005, p.3.

¹⁴ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1956, D.30, fl.1. Protokoll. Nr.3 i mbledhjes së BP të KQ të PPSH

në prodhim.¹⁵ Prej vitit 1954 deri në vitin 1956, ky ishte shkurtimi i tretë që zbriste numrin e efektivëve nga 41000, në 23000 efektivë.

Një tjetër zhvillim i rëndësishëm ishte thirrja e mbledhjes së parë të KPK të TV, që u organizua në Pragë nga data 27-28 janar 1956. Në hapje të saj pjesëmarrësit u njohën me deklaratën e Molotovit në lidhje me politikën e jashtme sovjetike. Në këtë deklaratë me emfazë theksohej suksesi i normalizimit të marrëdhënieve me Jugosllavinë, përfundimi i traktatit me Austrinë, stabilizimi marrëdhënieve diplomatike me Gjermaninë Perëndimore, hapja ndaj botës së tretë, por edhe i ashtuquajturit rrezik i vazhdueshëm i luftës për shkak të programit militarizues të NATO-s. Por Hrushovi krahas këtyre arritjeve kërkoi zgjidhje për problemet ekonomike të vendeve anëtare të TV që vinin si pasojë e buxheteve të ngarkuara ushtarake të tyre. Sipas tij në kushtet e reja lindte nevoja për zvogëlim të prodhimit të artikujve luftarakë.¹⁶ Ky problem nuk e prekte Shqipërinë pasi ajo nuk kishte një industri lufte. Por shkurtimet sigurisht kishin pasojë në ndihmat ushtarake që ajo përfitonte. Të prekur ndjeshëm nga propozimi i Hrushovit ishin Çekosllovakia dhe Polonia.

Mehmet Shehu ishte drejtuesi i parë i mbledhjes së parë të KPK, më 28 janar 1956 në Pragë.¹⁷ Ai e mori fjalën në seancën e parë. Fjalimi i tij ishte pothuajse klishe. Nga njëra anë përshëndeti dhe aprovoi iniciativat dhe politikën paqësore të BS, ndërsa nga ana tjetër sulmoi SHBA dhe NATO-n. Shehu në fjalën e mbajtur e bëri aleancën e Atlantikut Verior përgjegjëse për politikën militarizuese, luftën nukleare e në mënyrë të veçantë për përpjekjet për të riarmatosur Gjermaninë Perëndimore. Ai nuk harroi të përshëndeste krijimin e ushtrisë kombëtare të Gjermanisë Lindore dhe quajti krijimin e saj një faktor paqeje dhe sigurie në Evropë.¹⁸ Pjesa që paraqet interes në këtë fjalë është analiza e marrëdhënieve të Shqipërisë me fqinjët si dhe zhvillimet në Ballkan. Në kushtet e ndjekjes së një politike tepër të tensionuar, një angazhim i tillë buronte nga kërkesa e vazhdueshme e llogarisë nga Moska. Edhe në komunikatën që doli pas mbledhjes së parë të KPK, një ndër problemet ku vihej theksi ishte pikërisht përmirësimi i marrëdhënieve të vendeve të bllokut me fqinjët. Ndër vendet që specifikoheshin në këtë komunikatë për këtë problem, ishin: BRSS, Turqia, Bullgaria, Greqia, Shqipëria, Italia, Çekosllovakia dhe

¹⁵ Po aty..f.1.

¹⁶ Meeting of PPC, Prague, 27-28 January, Editorial Note (shkarkuar gusht 2013) <http://www.php.isn.ethz.ch>. Në fjalën e tij Hrushovi solli si shembuj prodhimin e aeroplanëve të tepërt në disa vende të Evropës Lindore. Por këtë fenomen ai e shpjegoi me rrezikun e një lufte nga ana e Perëndimit.

¹⁷ Shqipëria ishte shteti i parë në renditjen alfabetike të vendeve pjesëmarrëse.

¹⁸ “Fjalimi i shokut Mehmet Shehu në seancën e parë të mbledhjes së KPK në Pragë”, Zëri i Popullit, 28 janar 1956, f.1. Krijimi i ushtrisë së Gjermanisë Lindore u anonçua më 18 janar 1956, pak ditë përpara thirrjes së mbledhjes së parë të KPK, pas krijimit të TV.

Gjermania Lindore.¹⁹

Në vazhden e praktikës së mëparshme në faqet e “Zërit të Popullit,” në janar u pasqyruan fjalimet e të gjithë pjesëmarrësve në KPK²⁰. Po kështu, komunikata dhe deklarata e lëshuar nga KPK u botua gjithashtu në “Zërin e Popullit,” të datës 31 janar. Në përmbajtjen e saj u shpreh unanimiteti i anëtarëve mbi gjendjen ndërkombëtare, në mënyrë të veçantë asaj të krijuar në Europë. Ulja e tensionit ngelej përsëri kryefjalë, si moto e Gjenevës.²¹ Delegacioni shqiptar i reflektoi menjëherë vendimet e marra në KPK sidomos atyre që u përkisnin çështjeve organizative. Të gjitha nismat e ndërmarra për shkurtimin e FA u morën në shqyrtim në mbledhjen e 4 shkurtit të BP. Propozimet u paraqitën nga ministri i Mbrojtjes B. Balluku dhe u mor vendim që:

- në bazë të kushteve të reja të kryhet riorganizimi i ushtrisë deri më datë 30 prill 1956;
- kuadrot që do të mbeten jashtë efektivit mbas riorganizimit të ushtrisë të sistemohen në punë sipas mundësive dhe aftësive të tyre brenda afatit që caktohet në pikën e parë.²²

Letra e hapur e Enver Hoxhës për FA

Pas kthimit nga Moska, Enver Hoxha u drejtoi sekretarëve të parë të rretheve më 29 tetor 1955 një “Letër Udhëzuese” ku i njoftonte për vendimin e marrë për çmobilizimin e 9 mijë efektivëve nga FA të Ushtrisë Popullore (UP) dhe nga organet e Punëve të Brendshme. Në letër u gjet edhe mënyra për të shmangur pakënaqësitë. Të çmobilizuarit u propozua të bëheshin pjesë e administratës. Në këtë letër thuhej se me këta kuadro “të forconi aparatet e Partisë dhe shtetërore në qark, rreth e deri në fshat..., të punoni që në të ardhmen ata të mund të zgjidhen në forumet e organeve të sipërpërmendura”. Usharakët e çmobilizuar sipas orientimeve të letrës do të zëvendësonin në detyrë dy kategori: “njerëzit e paaftë dhe të padëshirueshëm” që ishin bërë pengesë për realizimin e planeve të shtetit. Pra, kjo ishte një kategori besnikësh të regjimit që nga shërbimi në ushtri tani do të kalonin për të demonstruar besnikëri në sektorët e tjerë të jetës në vend. Kriteri përzgjedhës ishte pjekuria e mirë politike dhe besnikëria ndaj kauzës së partisë dhe shtetit.”²³

¹⁹ CIA, WarsawPact Consultative Committee First Meeting, 27 january 1956 (Prague), p.43-44. <https://www.cia.gov/library/readingroom/docs/1966-05-06.pdf>.

²⁰ “Në Komitetin Politik Konsultativ të vendeve pjesëmarrëse të TV”, Zëri i Popullit, 29 janar 1956. f.3-4.

²¹ “Deklaratë”, Zëri i Popullit, Tiranë, 29 janar 1956, f.1

²² AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1956, D.32, f.161. “Mbi çmobilizimin e një pjese tjetër të FA të RPSH” (protokoll Nr. 6/1).

²³ Enver Hoxha, Vepra 13, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”, 1973, f.81. “Mbi sistemimin në punë të ushtarakëve të çmobilizuar -29 tetor 1955”.

Ndikimi që këto shkurtime mund të kishin në politikën e brendshme u reflektua në letrën e 8 nëntorit 1955. Të gjithë ushtarakëve të liruar nga detyra, E. Hoxha iu drejtua me “Letër oficerëve të FA të RPSH që kalojnë në rezervë”. Duke kërkuar nga oficerët e dalë në rezervë të kuptonin drejtë arsyet e shkurtimeve edhe në këtë letër përshëndetëse dhe falënderimi dy janë argumentet kryesore:

- Shkurtimi i FA në interes të uljes së tensionit ndërkombëtar.
- Nevoja e forcimit të ekonomisë popullore.

Letra i mëshon idesë që ushtarakët po liroheshin nga detyra si një angazhim ndërkombëtar.

Këtë tezë Enver Hoxha e rimori edhe në fjalën e tij në kongresin e III-të të PPSH në maj 1956. Duke folur për pakësimin e ndjeshëm të personelit në FA, ai solli shembullin e ushtrisë sovjetike, që kishte zbritur nga 1.200.000 në 640.000.²⁴ Ky argument krahasues sillet si një provë e re konkrete e politikës paqësore të shtetit sovjetik dhe ndjekjes së hapave nga Shqipëria në emër të aleancës. Por në fakt një lexim i vëmendshëm i raportit të kongresit zbulon se pakësimi më së pari erdhi në kuadër të lehtësimit të ekonomisë. Dhe jo vetëm ekonomisë shqiptare, por edhe asaj sovjetike, e cila suportonte ekonominë e dobëta ushtarake të vendeve anëtare të TV. Në fjalimin e tij Hoxha theksoi se Shqipëria si vendet e tjera të kampit të socializmit luftonte konkretisht për paqen dhe çarmatimin. Për këtë arsye u pakësuan dhe FA, duke i sjellë ekonomisë së vendit lehtësim. Por ekonomia e vendit sipas tij pati përveç përfitimit ekonomik edhe përfitim në vlera njerëzore, pasi oficerët e dalë në lirim do të kryenin detyra të rëndësishme në sektorë të ndryshëm të jetës në vend. Duke sjellë si shembull të përpjekjeve për çarmatim dhe paqe vendet socialiste, ai fshikulloi shtetet e perëndimit “...deri tani vetëm me fjalë flasin për paqen dhe për çarmatim.”²⁵

Nga radhët e ushtrisë u larguan përgjithësisht ata ushtarakë që nuk kishin shkollimin e duhur. Ashtu si ishte udhëzuar pjesa dërrmuese e këtyre ushtarakëve u emëruan kryetarë kooperativash apo byroje.²⁶ Kjo masë e ndërmarrë nga TV i tregoi Enver Hoxhës se ai nuk do të tolerohej të mbante një ushtri të madhe. Një ushtri që nuk justifikonte shpenzimet. Edhe pse

²⁴ AQSH, Fondi 14 AP/OU, V.1956, D.8, fl.34. Raport mbi veprimtarinë e KQ të PPSH, mbajtur nga Sekretari i Parë.

²⁵ Po aty, fl.34.

²⁶ Bisedë e zhvilluar me gjeneral major Rrahman Përlaku, nëntor 2014. Për të sqaruar ushtarakët e dalë në lirim u ngarkua gjeneralmajor Etem Gjinushit, në funksionin e shefit të kuadrit të MMP. Ai zhvilloi me ta një takim në mjediset e garnizonit “Skënderbej.” Pyetjes së sallës se cilët ushtarakë do të largoheshin ai ju përgjigj: “Ata që nuk kanë arsim ushtarak përkatës dhe arsimin e përgjithshëm”. Reagimi nga salla ishte “Na dhjeve gjeneral”.

Hrushovi do të shfaqej shumë shpejt si një antistalinist i hapur, në rastin e Shqipërisë ai po vazhdonte në gjurmët e Stalinit që e kishte këshilluar Hoxhën për të mbajtur një ushtri të vogël.

Ky reduktim ishte i fundit që do të ndodhte në forcat e armatosura. Prishja me Bashkimin Sovjetik do të dëshmonte se ulja e numrit të trupave aktive nuk ishte pjesë e politikës së brendshme. Përkundrazi militarizimi i shpejtë dhe i vrullshëm i jetës do të ishte trendi që do të karakterizonte leadershipin komunist deri në rënien e regjimit në vitin 90-të, duke lënë trashëgimi një forcë ushtarake që në raport me popullsinë dhe ekonominë kishte kaluar çdo parashikim.

Përfundime

Anëtarësimi në organizatën e sigurisë kolektive të vendeve të kampit socialist, Traktatin e Varshavës, e vuri ushtrinë shqiptare në një përballje mes të qenurit një ushtri e madhe në numër por me aftësi të kufizuara mbrojtëse dhe reformimit në një ushtri të vogël elitare. Në mendësinë e udhëheqjes komuniste që bazohej në modelin partizan të luftës zvogëlimi në numër i forcave të armatosura ishte një sforcim i rrethanave të krijuara në politikën ndërkombëtare. Të detyruar të ndiqnin shfaqjen propagandistike të dirigjuar nga Bashkimi Sovjetik pas konferencës së Gjenevës më 1955, zvogëlimin e padëshiruar të forcave të armatosura, regjimi komunist e shiti si “një provë kontributi në uljen e tensionit ndërkombëtar”.

Por nëse në marrëdhëniet ndërkombëtare kjo mund të konsiderohej si një arritje, në politikën e brendshme kjo ishte një fitore si e Pirros. Njerëzit e larguar nga ushtria ishin një potencial i mundshëm të ktheheshin kundër regjimit. Kjo bëri që me këta njerëz aparati shtetëror të merrej në mënyrë të veçantë. Të bënte një punë “sqaruese” dhe bindëse që ata të shkonin në prodhim, sidomos në kooperativat bujqësore, duke e konsideruar atë si një detyrë të lartë patriotike që u ngarkohej nga partia dhe shteti.²⁷

²⁷ Enver Hoxha, vepër e cituar...

Bibliografia

Arkivat:

1. Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë [AQSH]

Fondet:

F:14/Arkivi i Partisë – Organet Udhëheqëse, 1953, 1954, 1955, 1956, F:14/ AP – Marrëdhëniet me Partinë Komuniste të Bashkimit Sovjetik 1953,1954,1955,1956.

Arkivi Ministrisë së Punëve të Jashtme [AMPJ]

Marrëveshjet Ushtarake me Bashkimin Sovjetik, 1954.

Traktati i Varshavës,195,1956

Arkivi Qendror i Forcave të Armatosura [AQFA]

Fondet:

F: 100/1- Shtabi i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura [SHPFA] 1949,1952,1954,1955,1956.

F100/3 – Sekretariati 1955, 1956.

2. HOXHA, Enver, Vepra 13, Tiranë: Shtëpia Botuese “Naim Frashëri”. Tiranë:1973.

3. LALAJ, Ana, “Shqipëri në Paktin e Varshavës, 1955- 1968”, në: Studime Historike, 2004, nr 1-2.

4. LALAJ, Ana, “Përse Enver Hoxha pranoi ta nënshkruante Traktatin e Varshavë” në: Panorama, Tiranë, Nr. 72, 12 shtator 2004.

5. Parallel History Project on Cooperative Security Records of the Warsaw Pact Political Consultative Committee.

www.php.isn.ethz.ch/collections/colltopic.cfm?lng=en&id=14465&nav1=1&nav2=1&nav3=1

6. SMAÇI, Etleva, disertacion doktorate, “Shqipëria në Traktatin e Varshavës”, Tiranë, 2017.

PËRPPJEKJE PËR KONSOLIDIMIN E SHKOLLËS USHTARAKE NË VITET 1950-1971

Prof. Asoc. Dr. Edmond Braneshi
Fakulteti i Mbrojtjes dhe Sigurisë, AFA

Trajtesë e shkurtuar.

Në shkrimin “Përppjekje për konsolidimin e shkollës ushtarake në vitet 1950-1970” jepet një informacion i hollësishëm për tërësinë e problemeve të intensifikimit të arsimit ushtarak si: programet, niveli i kursantëve, përsosja e strukturës organizative të shkollës në ecurinë e rritjes së saj, përmirësimi i bazës materiale për mësim e stërvitje (poligonet, kabinetet), ciklet si njësi mësimore edukative dhe bashkëpunimi midis tyre për unifikimin e metodave, veprimeve, terminologjisë apo ideve, ndarja e trupit mësimor nga ai komandues, çështje të punës shkencore e deri te veprimtaritë e ndryshme mësimore e sportive, gjë që dëshmon për një punë të madhe të shkallëshkallshme, bërë në këtë periudhë, për të konsoliduar shkollën ushtarake, e sapodalë nga lufta.

Përsosja e programeve mësimore dhe futja e lëndëve të reja kohë pas kohe, ngritja e nivelit të trupës mësimdhënëse dhe komanduese krijuan mundësi reale dhe përgatitën “terrenin” për kalimin e shkollës në sistemin trevjeçar dhe marrjen e “statusit” të shkollës së lartë, pas viteve shtatëdhjetë.

Fjalë kyçe: arsimim, arsimi ushtarak shqiptar, programe mësimore, cikle mësimore, kursant, instruktor, Shoqata Ushtarake Shkencore, shkollë ushtarake, modernizim, mësim, objektiva.

Hyrje

Ishte e natyrshme që pas çlirimit të vendit do të bëheshin përpjekje për të ringjallur dhe ngritur lart shkollën dhe arsimin ushtarak shqiptar. Ushtria e sapo dalë nga zjarri i luftës do të kërkonte drejtuesit, komanduesit, oficerët e saj. Në këtë periudhë të pasluftës do të mbizotëronin kryesisht kurset afatshkurtra dhe afatmesme, të cilat shërbyen për nevojat e ngutshme të vendit. Programet ishin modestë dhe u shoqëruan me një strukturë drejtuese e thjeshtë. Deri në fund të vitit 1948 struktura organizative pësoi disa ndryshime, ku bie në sy organizimi dhe ndarja e trupit mësimor në bazë ciklesh mësimore, të cilat vlerësoheshin si njësi mësimore edukative. U ngrit dega e stërvitjes, e cila ndiqte realizimin e stërvitjes në përpurthje me programin mësimor dhe objektivin e shkollës. Nisi të përvijoheshin linjat e organizimit të kurseve me bazë kompanie e toge dhe baterie (për artiljerët). Për të rritur nivelin arsimor, kulturor e të mësimdhënies për trupën komanduese e instruktorët u hapën kurse të ndryshme, si ai i gjuhëve të huaja dhe i kulturës së përgjithshme. Këto kurse ndihmuan mjaft në zgjerimin e njohurive me karakter shoqëror të kuadrit oficer komandues e mësimdhënës, të cilët njohuritë e fituara i vunë plotësisht në të mirë të mësimi të kursantëve.

1. Programet mësimore dhe zhvillimi i tyre

Në fillim të viteve 50-të, Shkolla e Bashkuar e Oficerëve kaloi nga përgatitja e kuadrove me kurse afatshkurtra e afatmesme në përgatitjen e tyre me një sistem më të plotë arsimor ushtarak, që varionte në dy dhe trevjeçar. Gjatë kësaj periudhe, duke u mbështetur edhe në udhëzimet e qeverisë për modernizimin e ushtrisë sonë, në shkollë në mënyrë të shkallëshkallshme u hapën degë të reja për përgatitjen e kuadrove të të gjitha llojeve të armëve e shërbimeve, pra shkolla në këtë periudhë mori fizionominë e plotë për përgatitjen e kuadrit të ri oficer.

Kështu, më 19 janar 1950 u krye riorganizimi i Shkollës së Bashkuar të Oficerëve: “Duke filluar prej vitit të ri të stërvitjes 1949-1950, theksohej në urdhrin e Ministrisë së Mbrojtjes, – përgatitja e oficerëve të kryhet me kurse të rregullta 2-vjeçare”¹. Ky vendim i rëndësishëm shtroi para komandës së shkollës detyrë të menjëhershme për hartimin e programit të plotë 2-vjeçar

¹ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, Viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, f. 90.

për specialitetet e këmbësores, të artilerisë, të prapavijës dhe të xhenios. Me gjithë përvojën e pakët, kuadrot hartuan programet e para mësimore.

Qëllimi i këtij programi ishte të përgatiste komandantë toge dhe të jepte njohuri për kompaninë. Për këtë arsye vendin kryesor në program e zinin lëndët e mëposhtme: përgatitja marksiste-leniniste, përgatitja taktike, përgatitja e zjarrit dhe përgatitja fizike. Në këto programe u vunë edhe lëndë të arsimit të përgjithshëm, si matematikë, fizikë, kimi, gjeografi, histori, gjuhë etj., me qëllim që kursantët që kishin arsimin 7-vjeçar, të merrnin një kulturë të përgjithshme si bazë për përvetësimin e programit të përgatitjes politike luftarake².

Në lëndën e taktikës programi përmbante kryesisht përgatitjen e ushtarit, të skuadrës, të togës dhe njohuri për kompaninë. Ndërsa programi i përgatitjes së zjarrit përmbante njohjen e armatimit të këmbësores që kishte ushtria e jonë dhe përvetësimin e rregullave të qitjes me këto armë.

Një çast mjaft i rëndësishëm ishte ndarja e trupës mësimore nga ekipi komandues³. Nëse para kësaj periudhe mësimet zhvilloheshin nga komandantët e togave, të kompanive, të kurseve apo nga instruktorët në degën politike, tani shërbenin ciklet si organizma mësimore dhe edukative. Përveç cikleve të krijuara më parë (në vitin 1948), u krijuan edhe cikle të reja, si ai i zjarrit dhe i arsimit të përgjithshëm. Të gjitha ciklet vareshin nga dega e stërvitjes. Ciklet përbëheshin nga shefi i ciklit, zëvendës shefi dhe instruktorët.

U kalua në ngritjen e kabineteve, si ai i topografisë, i taktikës së këmbësores, i zjarrit dhe i përgatitjes speciale të prapavijës. Këto kabinete ndikuan drejtpërsëdrejti në rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe në përgatitjen e oficerëve të ardhshëm të ushtrisë.

Krahas procesit mësimor edukativ, vëmendje të veçantë në shkollë iu kushtua organizimit dhe fillimit të veprimtarive sportive. Kështu në vitin 1952 u krijuan ekipet e atletikës, të mundjes, boksit, ngritjes së peshave, gjimnastikës dhe ekipi i futbollit “Luftëtari”, pjesëmarrës në Kampionatin Kombëtar të kategorisë së parë⁴. Gjithashtu, me rastin e 10-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, më 10 korrik 1953, shkolla organizoi dhe zhvilloi disa qitje eksperimentale treguese me mitraloz të rëndë, granatahedhës të lehtë model 55, mortajë 82 mm dhe pushkë model 30. Në këto qitje u tregua përgatitje e lartë, shpejtësi dhe saktësi, gjë që tregonte për punën e mirë që bëhej me kursantët në procesin mësimor edukativ.

² AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, Viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, f. 21.

³ Po aty.

⁴ Po aty, faqe 27.

Më vonë, shkolla kaloi në sistemin 3-vjeçar, ku kursantët, përveç njohurive ushtarake, do të merrnin edhe kulturë të përgjithshme sipas programit të reduktuar të shkollave të mesme të vendit⁵. Në këtë kuadër, para komandës dhe trupës mësimore dolën detyra të rëndësishme për hartimin e programit mësimor, me qëllim që oficerët e ardhshëm të ushtrisë të kishin njohuri edhe më të gjera jo vetëm në lëndët e taktikës, të zjarrit, të përgatitjes fizike, por edhe në ato speciale. Kështu, në programet e këtij viti u futën për herë të parë lëndë të reja, si historia e artit ushtarak dhe njohuri për mbrojtjen nga armët e dëmtimit në masë. Vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes taktike dhe përgatitjes së zjarrit natën, ku në programin e ri zinin rreth 20% të tij. Programi 3-vjeçar ishte ndërtuar në këtë mënyrë: 28 muaj mësim, 3 muaj provime, 2 muaj praktikë me trupa, e cila zhvillohej me vitin e dytë dhe të tretë dhe 3 muaj pushime.

Qëllimi i këtij programi ishte të përgatiste oficerë për të drejtuar me kompetencë togën, kompaninë dhe t'u jepej njohuri për batalionin. Krahas përpilimit të programit, vijoi puna për krijimin dhe pasurimin e bazës materiale mësimore. U ndërtuan kabinete të tjera të reja, si ai i artilerisë kundërajrore, artilerisë tokësore, xhenios, ndërlihdjes, si dhe u pasuruan ato ekzistueset. Njëkohësisht u ndërtuan poligone fushore taktike e zjarri për stërvitje në terren të efektivit të shkollës.

Gjithashtu, në vitet pasardhëse filluan të hapen degë të reja, dhe për pasojë cikle të reja. Kështu u hap kursi i topografisë dhe cikli përkatës (1953), kursi i mbrojtjes kundërkimike dhe kursi i tankistëve me ciklet përkatëse, (1954). Në vitin 1956, si rezultat i rritjes së kontingjenteve të kursantëve të artilerisë kundërajrore dhe domosdoshmërisë për një përgatitje më të thellë e cilësore të tyre, u krijua cikli i AKA-së (instruktorët e të cilit deri atëherë bënë pjesë në ciklin e artilerisë tokësore). Në vijim u hap kursi i parë për flakëdhënëse të lehta (1965), gjithashtu, nga cikli i AT u nda dhe u krijua më vete cikli i AKA-së, si dhe grupi i AT u nda dhe u formua më vete grupi i AKA-së⁶ (1968).

Vlen të theksojmë se, në këtë periudhë u rikonstruktuan dy kabinetet e xhenios, ai i fortifikatës dhe i shkatërrimeve e pengesave me mina. Në terren u ndërtuan pozicione fushore për skuadrën e togën e këmbësores, pozicion zjarri artilerie dhe pengesa fortifikuese. Nga cikli i tankeve u krijua kabineti i taktikës, kabineti i zjarrit dhe kabineti i teknikës, të cilët ngritën në një nivel më të lartë zhvillimin cilësor të mësimit dhe përgatitjen cilësore të kursantëve.

Më 1956, si rezultat i marrjes së masave nga qeveria për modernizimin e ushtrisë dhe pajisjen e saj me armë të reja, shkolla u pajis me teknikë të re,

⁵ Po aty, faqe 28.

⁶ Po aty, faqe 88.

me topa kundërajrorë 57 milimetra dhe 100 milimetra të elektrifikuar, me ADZAKA-6 dhe stacion radiolokativ. Kjo ishte një teknikë e re moderne që erdhi nga Bashkimi Sovjetik dhe vendet e demokracisë popullore, në përbërje të Traktatit të Varshavës. Ajo kërkonte nga kuadri mësimdhënës njohuri më të thella dhe nga kursantët përpjekje më të mëdha në përvetësimin e saj. Me ardhjen e kësaj teknike programet mësimore të ciklit të AKA-së pësuan ndryshime. Kështu u futën lëndë të reja si elektronika e radioteknika. Edhe nënrepartet e repartit të këmbësorisë u pajisën me armë të reja automatike e gjysmautomatike. Kështu, lindi si domosdoshmëri përvetësimi i këtyre armëve, për pasojë cikli i zjarrit bëri përmirësime të ndjeshme në programin e përgatitjes së zjarrit. Ndryshoi programi i përgatitjes për qitje dhe sasia e orëve për qitje. Kabinetet e shkollës u pasuruan më tej.

I dukshëm ishte edhe bashkëpunimi midis cikleve, kjo dukuri bënte që të unifikohejshin metodat, veprimet, terminologjia, idetë, vizioni etj. Ky ishte një nga shqetësimet e komandës së shkollës. Për këtë, duke iu referuar masave të plan-kalendarëve të komandës së atyre viteve, shumë prej tyre i shërbenin pikërisht lidhjes e bashkëpunimit të cikleve me njeri-tjetrin. Kështu kishte mësim treguese, konferenca metodike, mbledhje të përbashkëta ku zhvilloheshin me pjesëmarrjen e shumë cikleve, në mënyrë që temat të ishin me një linjë⁷. Gjithashtu bashkëpunimi nuk kërkohet vetëm brenda shkollës, por edhe jashtë saj, që do të thoshte, ciklet të bashkëpunonin me drejtoritë apo degët përkatëse të MMP. Ky bashkëpunim do të bënte që tërë procesi mësimor dhe veprimtaritë në shkollë të ishin të gjitha në funksion të vizionit dhe udhëzimeve të Ministrisë. Një pikë tjetër e rëndësishme për komandën ishte dhe vënia e komandave të reparteve e nënreparteve në funksion të procesit mësimor, duke bashkëpunuar me shefat e cikleve dhe pedagogët përkatës, duke hequr mendimin që “ne përgjigjemi vetëm për rregullin e disiplinën dhe mësimin e kanë ata”. Kjo kërkonte dhe rritjen e nivelit profesional e kulturor të komandave, në mënyrë që ata të angazhoheshin më shumë me mësimin.

Në shtator 1958 në strukturën e Shkollës së Bashkuar ndodhën ndryshime në kuadrin e sistemit 3-vjeçar të shkollës. Kështu u vendos që viti i parë të bëhej përgatitor, duke krijuar një batalion të veçantë, i emërtuar batalioni përgatitor ku të zhvilloheshin lëndët e arsimit të përgjithshëm sipas programit të reduktuar të shkollës së mesme. Kjo bëhej e domosdoshme për shkak të nivelit të ulët arsimor të kursantëve. Kështu në vitin e parë bëhej përgatitje në terren dhe njëkohësisht zhvilloheshin lëndë si matematika, fizika, gjeometria, historia, gjeografia, gjuhë e huaj, por tani me një ndryshim cilësor nga më

⁷ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 2, viti 1957 - Urdhër, raport, pasqyrë të komandës së repartit ushtarak nr. 1200 Tiranë, mbi rezultatet e përgatitjes politiko-luftarake për vitin 1957 dhe detyrat për vitin mësimor 1958.

parë, sepse sasia e orëve dhe niveli pedagogjik i arsimtarëve ishte rritur⁸. Në vitin e dytë e në vazhdim bëheshin lëndët ushtarake.

Më 1960, cikli i taktikës filloi nga puna për hartimin e rregullores së re të luftimit ushtar, skuadër, togë, kompani, në përpilimin e së cilës u angazhuan instruktorë me përvojë teorike e pedagogjike, që punuan shumë vite për këtë, krahas ngarkesës mësimore që kishin; gjithashtu, u punua dhe teksti mësimor “Për organizmin dhe zhvillimin e veprimeve luftarake në lloje të ndryshme luftimi të nënrepartëve”, i cili përfshinte programin mësimor të asaj kohe.

Programi i përgatitjes taktike përfshinte veprimet luftarake të ushtarit deri në kompani për të gjitha llojet e luftimit, si dhe merreshin njohuri për veprimet luftarake të batalionit, kjo për këmbësorinë. Për kurset e specialitetit, taktika trajtonte në programin e saj edhe veprimet luftarake të batalionit në lloje luftimi, duke iu dhënë njohuri për brigadën⁹. Në përfundim të temave për llojet kryesore të luftimit, për të konkretizuar njohuritë teorike dhe për të krijuar shprehitë e organizimit, drejtimit e zhvillimit të veprimeve luftarake të nënrepartëve e repartëve me kursantët zhvilloheshin stërvitje komplekse 2-3 ditore.

Si rezultat i pajisjes së ushtrisë me teknikë e armatime të reja, lindi nevoja që cikli i zjarrit të bënte ndryshimet e duhura në programin mësimor sipas specialiteteve. Ndryshime pësoi dhe programi i përgatitjes për qitje dhe sasia e qitjeve që zhvilloheshin me kursantët. Lënda “Teoria e qitjes” kërkonte ndryshime dhe nivel më të lartë cilësor. Për këtë u fillua nga puna për përpilimin e teksteve “Bazat e qitjes me armët e këmbësorisë” dhe “Detyra zjarri” që përfunduan më 1964. Veçori ishte se pas vitit 1961, lënda e përgatitjes së zjarrit, që jepej nga oficerët komandues, u dha tërësisht nga instruktorët e ciklit të zjarrit, gjë që solli përmirësime cilësore në zhvillimin e saj.

Gjithashtu, për nevojat e procesit mësimor, nga cikli i kimisë u përgatitën dhe u botuan tekstet “Udhëzuesi për degazimin, dezaktivizimin dhe dezinfektimin e veshmbathjes, pajimeve dhe mjeteve të MKK” dhe “Udhëzuesi për shfrytëzimin e makinës autodegazuese MAD-48D dhe i përshkrimit të shkurtër teknik të automobilin vetëspërkatës AVS-120”.

Kursit të radiolokacionit, që përfshihej në grupin e AT, iu shtuan disa lëndë të reja në programet mësimore, si “Bazat teorike të elektroteknikës”, “Bazat teorike të radioteknikës”, “Bazat teorike të automatikës” dhe “Bazat teorike të radiolokacionit”, të cilat ndihmuan në ngritjen teorike dhe formimin e shprehive praktike në përdorimin e teknikës radiolokative.

⁸ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, f. 44.

⁹ Po aty, faqe 56.

Rritja cilësore e kontingjentit kandidat për kursant dhe evoluimi i programeve arsimore bëri që nga tetori i vitit 1961 kursantët që mbaronin Shkollën e Bashkuar të Oficerëve “E. Hoxha” ishin me arsim gjysmë të lartë ushtarak¹⁰.

Ministri i Mbrojtjes Popullore në udhëzimet që i dërgonte Shkollës së Bashkuar të Oficerëve për vitin mësimor 1963 kërkonte që të zbatoheshin në shkollë në mënyrë krijuese e me guxim kërkesat e rregulloreve taktike të luftimit në kushtet e terrenit malor dhe të strukturës organizative të Ushtrisë Shqiptare. Riorganizimi i ushtrisë bëri që të krijoheshin reparte në afërsi të rajoneve ku ata do të kryenin detyrën luftarake. Pikërisht ndryshimet e reja që u bënë në parimet e luftimit duke u përshtatur me strukturën e kushtet konkrete, duke shtuar këtu dhe punimet nëntokësore që filluan të kryheshin në rajonet e veprimeve luftarake, shtruan detyrën e përmirësimit dhe të pasurimit të programeve mësimore, të literaturës, të bazës materiale konkretizuese dhe veçanërisht të përgatitjes së vetë instruktorëve e përmirësimit të metodave të mësimdhënies. Për këtë u vu detyrë të rishikoheshin programet, mësimet, metodikat dhe të ndërtohej poligoni i taktikës.

Problemet e arsimimit ushtarak ndiqeshin vazhdimisht edhe nga Ministria e Mbrojtjes. Kështu, në detyrat e lëna nga komisioni i kontrollit të MMP¹¹, theksohej që komanda e shkollës duhej të drejtonte vëmendjen kryesore në rritjen e rezultateve në mësim, duke ngritur në një shkallë më të lartë metodën e zhvillimit të mësimin dhe përmbajtjen e tij. Gjithashtu duhej të përmirësohej përmbajtja e seminareve në përgatitjen taktike, duke pasqyruar në to parimet kryesore të luftimit në kushtet e teatrit shqiptar dhe ndryshimet e vazhdueshme strukturore. Këto u bënë objekt diskutimi në mbledhjet e cikleve, me qëllim që të përcaktohej më mirë përmbajtja e tyre dhe metoda që do të ndiqej gjatë zhvillimit të mësimin.

Po kështu, për të parë nivelin e kursantëve, në fund të vitit mësimor, ata merreshin në provime shtetërore nga komisioni i MMP, i cili kryesohej nga një ushtarak me gradën e gjeneralit. Në aktin mbi zhvillimin e provimeve shtetërore me kursantët e kurseve të dyta të shkollës, në korrik 1963 ishin përcaktuar nivelet e vlerësimit nga komisioni përkatës si më poshtë: kursantë me kategorinë shkëlqyeshëm; kursantë me kategorinë e parë; kursantë me kategorinë e dytë; kursantë me kategorinë e tretë¹². Të gjitha këto kategori ishin kaluese që do të thoshte: diplomohesh oficer. Në përfundimet e këtyre provimeve, ndër të tjera, theksohej: “...kursantët kanë përvetësuar në mënyrë

¹⁰ Po aty, faqe 60. (VKM nr. 381, datë 28.10.1961).

¹¹ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 1, viti 1963 - Detyra për Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, të lëna nga komisioni i MMP (shkresa nr. 128, datë 6 mars 1963).

¹² AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 4, viti 1963 - Akt i MMP mbi zhvillimin e provimeve shtetërore me kursantët e kurseve të dyta të komandës së repartit ushtarak nr. 1200 për vitin 1963.

të kënaqshme programet. Shkalla e përgatitjes së tyre është plotësisht e mjaftueshme për t'u besuar atyre në fillim detyrën e komandantit të togës dhe në një kohë të afërt, pas një periudhe përgatitjeje në repart, edhe detyrën e komandantit të kompanisë (baterisë)”¹³. Rezultate më të mira dhanë kursantët që vinin nga Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, sidomos ato të llojeve të armëve e shërbimeve.

Në vitin mësimor 1964-1965 cikli i arsimit të përgjithshëm u shkri, sepse kursantët që plotësonin kontingjentet e shkollës ishin me arsim të mesëm, kryesisht nga Shkolla Ushtarake “Skënderbej” dhe nga shkollat e mesme të vendit. Nga këto lëndë jepej vetëm gjuha e huaj¹⁴. Kjo ishte një arritje për kohën, pasi **për herë të parë atë vit kursantët u pranuan vetëm me arsim të mesëm**. Kjo ndikoi në rritjen e nivelit arsimor të tyre, për pasojë, në rritjen e cilësisë së oficerëve të rinj.

Në ciklin e taktikës kujdes iu kushtua zhvillimit të temave të kompanisë e të batalionit dhe të drejtimit të veprimeve me hartë e skema. Stërvitjet taktike të skuadrës e togës së këmbësorisë në mbrojtje e në mësymje në fund përfundonin me qitje luftarake. Element i ri që u fut në programin mësimor të lëndës taktike pas vitit 1961 ishte dhe marshimi, i cili organizohej, përpunohej dhe trajtohej me kujdes, sidomos gjatë shkuarjes së efektivit në fushimet dimërore (në Feken) dhe ato verore (në Karpen të Kavajës). Veçori paraqiste stërvitja në këto fushime, e cila zhvillohej me orar të zgjatur, sidomos ajo dimërore në kushte të vështira atmosferike, në terren malor të mbuluar me borë e në temperatura të ulëta. Stërvitjet dyditore (komplekse) dhe marshimet gjatë stërvitjes dimërore bëheshin me situatë taktike, duke përpunuar dhe elementet e ngritjes së fushimeve, duke ndërtuar guva në dëborë dhe elemente të sigurimit luftarak¹⁵.

Me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 5, datë 12 janar 1966, Shkolla e Bashkuar e Oficerëve kaloi nga programi trevjeçar në dyvjeçar¹⁶. Kjo ndodhi sepse kursantët ishin të gjithë me arsim të mesëm dhe nuk ishte më nevoja për vitin përgatitor.

Nga cikli i zjarrit në vitin 1967, nën drejtimin e MMP-së u organizua një mësim tregues me kuadrot kryesorë të ushtrisë për organizimin dhe zhvillimin e qitjeve me togë në luftim mbrojtës. Një vit më pas, u zhvillua për herë të parë stërvitje kimike e toksike me përdorim real të lëndëve kimike luftarake në Bizë

¹³ Po aty.

¹⁴ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, Viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, faqe 70.

¹⁵ Po aty, faqe 73.

¹⁶ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 30, Viti 1966 - Vendimi nr. 5 datë 12 janar 1966 mbi kalimin në program dyvjeçar të Akademisë Ushtarake “Mehmet Shehu” dhe të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”.

të Martaneshit. Për të realizuar me sukses stërvitjen me përdorimin e lëndëve helmuese luftarake dhe të lëndëve radioaktive u bashkëpunua me Laboratorin Qendror të Kimisë dhe me Institutin e Rrezatimeve Bërthamore.

Gjithashtu, gjatë viteve 1968 deri 1971, nga efektivit kursant e instruktor të xhenios u ndërtuan poligoni i fortifikatës, një rajon mbrojtjeje i pajisur me tunele këmbësorie dhe QZ të tipit monolit, betonarme me transhe e hendeklidhje, ku stërviteshin edhe kurse të tjera të shkollës. Gjithashtu u ndërtua në poligonin e shkollës dhe poligoni i pengesave e i shkatërrimeve, si dhe ai i urave prej druri, ku zhvilloheshin mësim praktikë. Për atë periudhë u krijua punësoria e xhenios (klasë), që shërbente për riparime të bazës materiale mësimore. Cikli i AT nxori nga shtypi librin “Teksti mësimor i qitjes së artilerisë tokësore”. Po nga ky cikël grupi i instruktorëve të lëndës së taktikës AT botuan tekstin mësimor “Taktika e AT, topi (skuadra), togë dhe bateri” në formë përmbledhjeje leksionesh. Në qershor 1971 në qitjet e artilerisë të zhvilluara në Martanesh, të gjithë kursantët pjesëmarrës arritën rezultate shumë të mira. Një nga arsyt kryesore të këtyre rezultateve ishte përmirësimi i bazës materiale.

Në fund të viteve 60-të, mbi strukturën e sistemit të ri arsimor ushtarak për përgatitjen e kuadrit të ri në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve u bënë shumë diskutime dhe, pas kësaj, u vendos si më poshtë: Kontingjentet e kursantëve që vinin në shkollë do të kryenin një vit shërbim në ushtri në rol të ushtarit, dy vjet mësim në shkollë, një vit stazh me trupa në rol të komandantit të togës. Diplomimi i tyre do të bëhej pas një viti praktikë me trupa në detyrën e oficerit (komandantit të togës)¹⁷. Nga MMP kërkohej që shkolla të përgatiste kuadro komandantë toge të shkëlqyer dhe komandantë kompanie të mirë.

2. Shkollat ushtarake dhe roli i tyre

Në fund të viteve '60-të, shkollat ushtarake, programet përkatëse po shiheshin me syrin e vazhdimësisë së arsimimit hap pas hapi dhe të plotësimit të njohurive të nxënësit, kursantit, oficerit me kulturë të përgjithshme dhe profesionale sipas nivelit të detyrave. Kjo kishte të bënte me politikat arsimore të asaj periudhe, sidomos gjatë vitit 1969, të orientuara nga qeveria si një domosdoshmëri objektive për të zbatuar politikat e shtetit, ku ndër të tjera, ishte hedhur dhe ideja e vendosjes së trekëndëshit revolucionar “mësim, punë prodhuese, stërvitje ushtarake”¹⁸. E rëndësishme ishte se shkollat ushtarake të niveleve të ndryshme, si Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, Shkolla e Bashkuar e Oficerëve dhe Akademia Ushtarake po shiheshin si një proces arsimimi në funksion të njëra-tjetrës. Në këtë kuadër ishte e nevojshme të rishikohej procesi

¹⁷ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, f. 90.

¹⁸ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 133, Viti 1969 - Materiali me nr. 23 i protokollit, datë 20 shkurt 1969 “Raport i komisionit të punës së Akademisë Ushtarake “Mehmet Shehu” për problemin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës”, faqe 3.

mësimor për të ripërcaktuar objektivat, synimet dhe strukturën e programeve të këtyre shkollave, duke i parë si hallka të të njëjtit “zinxhir arsimor ushtarak”.

Për të pasur një sistem unik u hodh ideja që Shkolla Ushtarake “Skënderbej” të riorganizohej në një gjimnaz të profilizuar ushtarak për llojet e ndryshme të specialiteteve që kishte ushtria. Programi do të përmbante këto raporte: kulturë të përgjithshme 47.2%, përgatitje ushtarake 27.8%, punë prodhuese 5.55%, praktikë me trupa 5.55% dhe pushim 13.9%. Me këtë përbërje skënderbegasit krahas kulturës së përgjithshme, do të merrnin njohuri të mjaftueshme për ushtarin dhe skuadrën. Më konkretisht, me qëllim që Shkolla Ushtarake “Skënderbej” të luante më mirë rolin e saj në funksion të qëllimit që kishte, për të nxjerrë nxënës me njohuri të plota e kulturë të përgjithshme e ushtarake për të vazhduar çdo shkollë tjetër të lartë ushtarake e civile, ajo do të qëndronte gjimnaz ushtarak 4-vjeçar i profilizuar, duke iu përshtatur më mirë nevojave dhe natyrës së ushtrisë.

Shkolla e Bashkuar e Oficerëve përgatiste oficerë të aftë për komandant toge e kompanie (baterie), shefa shërbimi batalioni (grupi) dhe merrnin njohuri për batalionin (grupin); ndërsa për prapavijën (logjistikën) përgatiste shefa shërbimi brigade. Për të siguruar përgatitjen e gjithanshme të oficerit deri komandant kompanie (baterie), mendimi ishte që kandidatët të ishin me shkollë të mesme, ndërsa procesi mësimor të zhvillohej në bazë të arsimit të lartë të përgjithshëm. Kjo ishte e nevojshme për disa arsye:

Së pari, Shkolla e Bashkuar duhej të përgatiste oficerin e aftë për të vepruar i pavarur në jetën (veprimtarinë) ushtarake dhe të kishte mundësinë për të vazhduar studimet e mëtejshme në Akademi.

Së dyti, oficeri do të ishte, para së gjithash, edukator i efektivave ushtarë dhe pedagog që do të stërviste e përgatiste me cilësi të lartë nënrepartin.

Së treti, zhvillimi i gjithanshëm i vendit dhe pajisja e ushtrisë me teknikë dhe armatim të kohës kërkonte kuadro me arsim të lartë.

Së katërti, në të ardhmen e afërt efektiv i ushtrisë do të përbëhej nga ushtarë që do të kishin arsimin e mesëm (e ndoshta dhe gjysmë të lartë), kështu që komandanti i tyre kërkohej të ishte më i ngritur, me dije e kulturë më të gjerë që të kishte mundësi të mësonte vartësit.

Së pesti, dhënia e mësimin në bazë të arsimit të lartë e bënte kursantin më të interesuar për rritjen e njohurive kulturore, arsimore e profesionale dhe njëkohësisht i jepte mundësi atij që, pasi të kishte fituar një përvojë të mjaftueshme me trupa, të ishte në gjendje të kryente edhe detyra të tjera më të larta pa vazhduar studimet në Akademinë Ushtarake.

Realizimi i këtyre detyrave kërkonte një afat studimi trevjeçar. Kjo do të

siguronte që kursanti të mishëronte vetitë e oficerit, si komandant, edukator dhe specialist; përvetësimin e teorisë dhe praktikës për të drejtuar luftimin e skuadrës, togës, kompanisë (baterisë) dhe të merrte njohuri për batalionin (grupin); një shpërndarje më të drejtë harmonike të lëndëve sipas viteve dhe një planëzim më të saktë e metodik. Ky sistem njohurish do të jepej nëpërmjet lëndëve kryesore (marksizëm-leninizmit, taktikës së përgjithshme e speciale, lëndëve speciale e teknike sipas llojeve të armëve), lëndëve ndihmuese (të gjitha lëndët e tjera dhe lëndët e arsimit të lartë të përgjithshëm si matematika, fizika, kimia, mekanika etj. në përputhje me specialitetin përkatës) dhe praktikës mësimore e në trupa.

Cikli mësimor do të ndërtohej në këtë mënyrë: viti i parë, përgatitja e reduktuar vetmore e ushtarit dhe e skuadrës, lëndët e arsimit të lartë të përgjithshëm, përgatitja rreshtore, rregulloret bazë etj; viti i dytë, përgatitja e togës, lëndët speciale etj.; viti i tretë, përgatitja e kompanisë (baterisë), njohuri të përgjithshme për batalionin (grupin), si dhe lëndë speciale teknike. Viti mësimor do të ndahej 8.5 muaj mësim, 1 muaj punë prodhuese (ose punime operative), 1 muaj praktikë në trupa dhe 1.5 muaj leje. Kështu kombinohej edhe trekëndëshi mësim, punë prodhuese, praktikë me trupa.

Në **Akademinë Ushtarake** ndërtimi i sistemit të arsimit, afatet, përmbajtja dhe baza e zhvillimit të procesit mësimor ishin të lidhura ngushtë me Shkollën e Bashkuar. Studimi në Akademi duhej të ishte vazhdimi dhe rritja e dijeve¹⁹ për marrjen e arsimit të lartë ushtarak.

Mendimi ishte që Akademia Ushtarake të përgatiste komandantë reparti (batalioni, grupi) dhe oficerë shtabi njësie taktike, si dhe shefa të llojeve të armëve e shërbimeve për këto njësi. Kjo kërkonte që Akademia Ushtarake të përgatiste kuadro me dije të thella taktike dhe që të merrnin njohuri të mira për artin operativ. Kjo bazohej në nevojën që kishte ushtria për kuadro të aftë që zgjidhnin problemet në mënyrë të pavarur, si në batalion (grup), ashtu dhe në shtabin e brigadës, me përparësi që pas një periudhe praktike në trupa, të drejtonin brigadën. Por, njëkohësisht u hodh ideja që Akademia Ushtarake të mos përgatiste komandantë batalioni (grupi), por brigadë e lart. Kjo kishte lidhje me atë që Shkolla e Bashkuar do të përgatiste komandantë batalioni.

Lidhur me afatet e studimit në Akademi (me që ishte hedhur ideja 3-vjeçare për Shkollën e Bashkuar), ajo duhej të vazhdonte studimet për 2 vjet. Kjo, sepse niveli i kuadrove ishte rritur dhe në të ardhmen do të vazhdonte të rritej si në drejtim të nivelit të përgjithshëm arsimor, ashtu dhe në atë ushtarak. Afati dyvjeçar i studimeve në Akademinë Ushtarake do të thoshte që, oficeri i

¹⁹ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 133, Viti 1969 - Materiali me nr. 23 i protokollit, datë 20 shkurt 1969 "Raport i komisionit të punës së Akademisë Ushtarake "Mehmet Shehu" për problemin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës", faqe 8.

dalë nga Akademia, më vonë do të vazhdonte kurse më të larta për të zgjeruar njohuritë e tij kryesisht në drejtim të artit operativ.

Përmbajtja e viteve mësimore të ishte: viti i parë, niveli i batalionit (grupit), viti i dytë, niveli i brigadës së këmbësorisë dhe brigadës së artilerisë dhe ai operativ. Gjithashtu kishte dhe një mendim tjetër më ambicioz që përgatitja e batalionit (grupit) të bëhej gjysmë viti, e brigadës (brigadës së artilerisë) një vit dhe e korpusit gjysmë viti. Struktura e fakulteteve të ishte: fakulteti gjitharmësh, fakulteti i artilerisë tokësore, fakulteti i artilerisë kundërajrore, fakulteti i prapavijës (logjistikës), fakulteti i xhenios, fakulteti i ndërlidhjes dhe fakulteti i kimisë. Për lëndët kryesore të përbashkëta do të ishte kjo ndarje: lënda e marksizëm-leninizmit 15% deri 17%, taktika dhe arti operativ 50% deri 60% dhe pjesa tjetër për lëndët speciale.

Këto përpjekje do të ndikonin për ndryshime të tjera në strukturën programore të shkollave ushtarake. Kështu, pas viteve 70-të, arsimi ushtarak kaloi në sistemin trevjeçar dhe u quajt shkollë e lartë ushtarake, kursantët u quajtën studentë dhe ciklet katedra. Tashmë studentët e shkollave ushtarake pranoheshin vetëm me arsim të mesëm. Për rrjedhojë, në vetë strukturën organizative të shkollave u reflektuan ndryshime, duke u krijuar fakultete prej të cilave vareshin katedrat. Kështu, në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve fakultetet u ngritën mbi bazën e këmbësorisë, të artilerisë, të tankeve dhe të specialiteteve të tjera. Secili kishte një numër katedrash në përputhje me lëndët që mbulonte.

3. Shoqata Ushtarake Shkencore

Në fundin e viteve 50-të u krijua Shoqata Ushtarake Shkencore dhe organizmat përkatëse, këshilli i saj dhe rrethet shkencore ushtarake. Të gjitha këto synonin në ngritjen e një niveli më të lartë të njohurive tekniko-ushtarake prej oficerëve të shkollës, në mënyrë që edhe shoqëria të bëhej një faktor i rëndësishëm dhe një mbështetje e domosdoshme për rritjen e cilësisë së përgatitjes luftarake²⁰, duke u bërë një punë më e organizuar për studimin e thellë dhe sistematik të çështjeve të reja, që dilnin si rezultat i futjes në përdorim të armëve të reja e teknikës luftarake.

Shoqata Ushtarake Shkencore përbëhej nga oficerë që shfaqnin dëshirën të punonin në mënyrë aktive në këtë drejtim ose për natyrën e punës duhej të merrnin pjesë nëpër cikle ku çdo specialitet formonte një rreth të punës shkencore ushtarake. U ngritën rrethi i ciklit të taktikës, i cili përfshinte instruktorët që zhvillonin përgatitjen taktike në shkollë, si dhe oficerë të tjerë që dëshironin të futeshin sidomos xhenierë, kimistë, rrethi i përgatitjes së

²⁰ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 1, viti 1959 - Udhëzime mbi organizimin e punës shkencore ushtarake në shkollë. Plani i punës metodike dhe shkencore ushtarake për vitin mësimor 1959.

zjarrit, rrethi i artilerisë etj. Të gjitha këto rrethe formonin Shoquatën Ushtarake Shkencore. Për çdo rreth caktohej kryetari dhe sekretari. Organi më i lartë i Shoquatës Ushtarake Shkencore të shkollës ishte mbledhja e përgjithshme e shoquatës. Këshilli zgjidhej me afat prej dy vjetësh me vota të hapura. Nga këshilli zgjidhej kryetari, zëvendëskryetari, sekretari dhe anëtarët, sasia e të cilëve caktohej nga mbledhja. Shoqëria ushtarake shkencore kishte për detyrë: të ndihmonte efektivin në studimin e teorisë ushtarake dhe të teknikës, përvojën e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, në përpunimin dhe përgjithësimin e formave dhe metodave të zhvillimit të luftimit në kushtet e sotme; të ndihmonte në gjetjen dhe përpunimin e metodave të reja dhe futjen e tyre në përgatitjen dhe edukimin e efektivit të shkollës dhe të ushtrisë; të zhvillonte punë krijuese dhe racionalizuese në drejtim të bazës materiale mësimore, të teknikës luftarake, armatimit etj.

Këshilli i Shoquatës Ushtarake Shkencore merrej me organizimin, planëzimin dhe udhëheqjen e drejtpërdrejtë të punës së Shoquatës. Ai kishte për detyrë: të përpunonte tematikën dhe planin e punës së Shoquatës; të organizonte rrethet dhe të drejtonte punën e tyre; të përgatiste dhe të zhvillonte mbledhjet e përgjithshme të Shoquatës; të kryente pranimin e anëtarëve të rinj dhe të ndihmonte në përpunimin e propozimeve mbi çështjet e ndryshme.

Veprimtaria e Shoquatës Ushtarake Shkencore kishte edhe mbështetjen e komandës së shkollës, e cila jepte ndikimin e vet. Komanda hartonte planin e punës metodike dhe shkencore ushtarake, i cili kishte për qëllim ngritjen e nivelit shkencor të përgatitjes luftarake në shkollë dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Disa nga masat që përmbushnin këtë plan ishin mbledhjet metodike mësimore, konferencat metodike (të artilerisë, të zjarrit, të taktikës etj.), mësimet metodike të përbashkëta, ku merrnin pjesë cikli i taktikës, i artilerisë, i tankeve dhe i xhenios, shkëmbim përvoja midis instruktorëve të cikleve të ndryshme e komanduesve, mësimet treguese, mësimet të hapura, përpunim temash shkencore ushtarake, përpilim leksionesh dhe metodikash e deri te përpilimi i referateve e artikujve të ndryshëm. Siç shihet dhe nga këto masa, angazhimi i të gjithë cikleve me instruktorët përkatës ishte i plotë, ku gjithsecili sillte përvojën më të mirë, duke formatuar një konceptim më të drejtë të të gjitha problemeve (çështjeve) që trajtoheshin në procesin mësimor.

Gjithashtu, ndër vite, puna ushtarake shkencore u fokusua edhe në shtimin e fondit të literaturës ushtarake, përpilime tekstesh, broshurash dhe manualesh mësimore për kursantët e oficerët, gjetjen e formave dhe metodave më të mira për përgatitjen e kursantëve, organizimin e studimit, të konsultave etj., dhe në thellimin e mëtejshëm të veprimeve luftarake të skuadrës, togës, kompanisë në

mbrojtje²¹ në terren malor me sistem tuneli.

Duke iu referuar planit të punës shkencore ushtarake dhe detyrave individuale për vitin 1964, u botuan një sërë tekstesh mësimore, leksionesh, metodikash, artikujsh etj., të cilët mbushën vakumin e literaturës mësimore për arsye ndryshimi programesh.

Puna shkencore po kthehej në traditë, duke i paraprirë problemeve teorike dhe përpunimit të mendimit shkencor. Organizimi dhe zhvillimi i veprimtarive shkencore ishin të lidhura drejtpërsëdrejti me procesin e mësimit dhe me detyrat e Forcave të Armatosura në fushën e mbrojtjes e të sigurisë së vendit. Kështu, në shtator 1967 u përgatit dhe u mbajt sesiioni shkencor me temë: “Lufta kundër desantit ajror të armikut”. Përveç materialit kryesor u përgatitën dhe disa kumtesa në mbështetje e zëbrthim të kësaj teme nga ciklet e tjera të shkollës. Në vitet në vazhdim u bënë eksperimente për të përcaktuar forcën shpuese të armëve të këmbësorisë, si dhe u organizuan dhe u zhvilluan qitje treguese me armët e reja, me të cilat ishte pajisur ushtria jonë. Instruktorët e stërvitjes së zjarrit dhanë ndihmesën e tyre dhe në repartet e njësitë e ushtrisë për futjen e formave e metodave të reja të stërvitjes së zjarrit në ushtri nëpërmjet përgatitjes e drejtimit të disa mësimëve treguese, rezultatet e të cilave bënë jehonë në shtypin ushtarak të kohës nëpërmjet disa artikujve të shkruar nga instruktorët e ciklit të zjarrit.

Në këtë kuadër, pikësynimi i komandës së Shkollës së Bashkuar të Oficerëve ishte që ajo të bëhej vatrë shkencore e përhapjes së përvojës mësimore dhe qendër ushtarako-shkencore për të përpunuar tema të ndryshme, dispensa, tekste mësimore²², që t’i shërbenin shkollës dhe ushtrisë.

4. Bashkëpunimi me shkollat ushtarake të vendeve mike

Në kuadrin e forcimit të marrëdhënieve me shkollat simotra të vendeve mike shpesh organizoheshin dhe aktivitete të përbashkëta, të cilat ndikonin pozitivisht në procesin mësimor, duke përfshirë si mësimdhënësit dhe kursantët. Kështu në vitin 1959 u bë një marrëveshje midis Shkollës së Bashkuar të Oficerëve dhe Shkollës Ushtarake që mbante emrin e heroit të Bashkimit Sovjetik “Kapiten O. Jarosh” të Çekosllovakisë.

Qëllimi i kësaj marrëveshje ishte “...që të forcohet akoma më shumë miqësia luftarake ndërmjet ushtrive çekosllovake dhe shqiptare, që të shkëmbehet përvoja midis dy shkollave dhe të rriten rezultatet e përgatitjes luftarake të

²¹ AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 1, viti 1964 - Urdhër nr. 131 i komandantit të shkollës, datë 3 mars 1964, mbi punën shkencore ushtarake të shkollës për vitin 1964. Plan i punës shkencore ushtarake dhe i detyrave individuale për vitin mësimor 1964.

²² AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, Viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve, faqe 91.

kursantëve...”²³ Për të realizuar këtë, midis dy shkollave u organizuan disa lloje garash. Garat fillonin me nisjen e vitit mësimor 1959-1960 dhe mbaronin në qershor të vitit 1960. E veçanta ishte se në garë merrnin pjesë i gjithë efektivit kursant i specialiteteve këmbësori dhe tanke. Objekti i garës ishte i gjerë, pasi aty përfshiheshin një sërë rubrikash si përgatitja rreshtore, përgatitja fizike, përgatitja e zjarrit, tregarëshi dhe veprimtaria kulturore masive. Stimuli i kësaj gare do të ishte që, toga fituese do të kalonte një muaj në shkollën mike. Kjo do të shërbente për forcimin e lidhjeve të mëtejshme dhe për shkëmbimin e përvojës.

Vlen të theksojmë se në këtë marrëveshje ishin të specifikuar të gjitha kushtet e garave dhe mënyrat e vlerësimit (pikët) për çdo rubrikë. Në përgatitjen rreshtore do të vlerësoheshin sipas programit që te rreshtimi i togës në vijë, në vijë të zhdërvjellët e deri te veprimet me armë e parakalimet²⁴. Në përgatitjen fizike do të vlerësoheshin në ushtrimet në hekur, paralele, kalim kali e litar²⁵. Në përgatitje zjarri vlerësimi ishte për qitjet sipas ushtrimeve të përcaktuara²⁶. Në garat e qitjes ndërmjet togave tankiste, togat do të zgjidheshin me short dhe vlerësimi përfshinte disa faza, duke filluar që te vënia e tankut në gatishmëri, kryerja e marshimit 20 km jashtë rrugëve ekzistuese e deri te qitja përkatëse²⁷. Vlerësimi në punën kulturore masive bëhej në rang batalioni dhe jo toge si në rubrikat e tjera. Në këtë fushë do të vlerësoheshin veprimtaritë e ansambleve të batalioneve: në estradë e teatër, në balet, në instrumente, në kor²⁸ etj., dhe solistët. Përveç këtyre, efektivat e shkollave do të ishin në garë gjithashtu: në piktura, në marrjen e distinktit “miku i librit”, në sasinë e shfaqjeve brenda dhe jashtë shkollës etj. Në vlerësim rol do të kishte përmbytja e cilësia.

Pra, siç shihet, këto nuk ishin vlerësime individuale, gjë që kërkonin një angazhim e mobilizim nga secila togë, kompani, batalion e nga çdo komandues e instruktor mësimdhënës, nga çdo cikël e komandë shkolle, me qëllim që të jepnin vlerat më të mira të shkollës dhe të ushtrisë që përfaqësonin. Detyrimisht kjo do të kishte vlera absolutisht pozitive në rritjen e efektivitetit të orës mësimore, por dhe në ngritjen e nivelit të aktiviteteve kulturore e masive, si pjesë e domosdoshme e jetës kulturore ushtarake.

²³ AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosje nr. 122, Viti 1959 - Marrëveshje mbi shpalljen e garave socialiste midis Shkollës Ushtarake me emrin e heroit të BS “Kapiten O. Jarosh” të Çekosllovakisë dhe Shkollës së Bashkuar të Oficerëve “E. Hoxha”, faqe 2.

²⁴ Po aty, faqe 4.

²⁵ Po aty, faqe 5.

²⁶ Po aty, faqe 6.

²⁷ Po aty, faqe 9.

²⁸ Po aty, faqe 16.

Përfundime

Vitet pesëdhjetë – shtatëdhjetë të shekullit të kaluar përbëjnë një etapë të rëndësishme në historinë e arsimit ushtarak shqiptar. Kjo mund të etiketohet si faza e “tranzicionit”, e cila do të çonte në konsolidimin e shkollës ushtarake deri në marrjen e “statusit” të shkollës së lartë.

Ajo shënoi një hap të ri në përgatitjen e oficerëve me arsim ushtarak të mirëfilltë, me një shtrirje kohore dy e trevjeçare dhe, për rrjedhojë, shkolla ushtarake fiton statusin e arsimit gjysmë të lartë.

Kjo fazë u karakterizua nga ndryshueshmëria e vazhdueshme e strukturës mësimore dhe organizative, krijimi në vijimësi i cikleve të reja e zgjerimi i programeve.

Mesi i viteve 60-të solli një risi: pranimin e kursantëve me shkollë të mesme. Kjo i dha një shtysë rritjes cilësore të hallkës kursant, rikonceptimit të programeve për t’iu përgjigjur auditorit përkatës dhe ngritjes së nivelit të kuadrit mësimdhënës.

Gjatë kësaj periudhe, vëmendje e veçantë iu kushtua përgatitjes së poligoneve, kabineteve si dhe rifreskimit e ripasurimit të herëpashershëm të tyre, punës ushtarako-shkencore, bashkëpunimit të trupës mësimdhënëse me atë komanduese në të mirë të ecurisë së mësimin, përgatitjes së materialeve mësimore, ku u angazhuan të gjitha ciklet, si dhe rritjes së vazhdueshme të nivelit profesional të tyre.

Kujdes i vazhdueshëm iu kushtua bashkëpunimit midis cikleve me qëllim që të unifikohehin metodat, veprimet, terminologjia, idetë, vizioni etj., nëpërmjet mësimave treguese, konferencave metodike, mbledhjeve të përbashkëta apo veprimtarive të tjera mësimore.

Shkolla ushtarake shqiptare u bë qendër dhe institucion ambicioz për përgatitjen cilësore fizike e veprimtarive sportive kulturore e masive.

Me çeljen e shkollave të reja ushtarake (Akademia Ushtarake 1958, Shkolla Ushtarake e Detarisë 1961, Shkolla Ushtarake e Aviacionit 1962) u plotësua fusha e arsimimit për të gjitha llojet e forcave, të armëve e shërbimeve. Hapja e këtyre shkollave ishte domosdoshmëri e kohës dhe nevojë e ushtrisë, e cila tregonte dukshëm rritjen dhe forcimin e saj si dhe kompletimin me teknikën e kohës. Këto shkolla do të plotësonin arsimimin për të gjitha llojet e armëve e shërbimeve me komandantë të zotë e specialistë të aftë, duke iu përgjigjur politikave të shtetit shqiptar dhe nevojave të ushtrisë.

Bibliografia

1. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 2, viti 1957 - Urdhër, raport, pasqyrë të komandës së repartit ushtarak nr. 1200 Tiranë, mbi rezultatet e përgatitjes politiko-luftarake për vitin 1957 dhe detyrat për vitin mësimor 1958.
2. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 1, viti 1959 - Udhëzime mbi organizimin e punës shkencore ushtarake në shkollë. Plani i punës metodike dhe shkencore ushtarake për vitin mësimor 1959.
3. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 5, viti 1960 - Urdhër i komandës së shkollës nr. 187, datë 20 qershor 1960 mbi botimin në shkollë të një reviste ushtarako-politike.
4. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 1, viti 1963 - Detyra për Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, të lëna nga komisioni i MMP (shkresa nr. 128, datë 6 mars 1963).
5. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 4, viti 1963 - Akt i MMP mbi zhvillimin e provimeve shtetërore me kursantët e kurseve të dyta të komandës së repartit ushtarak nr. 1200 për vitin 1963.
6. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 1, viti 1964 - Urdhër nr. 131 i Komandantit të shkollës, datë 3 mars 1964, mbi punën shkencore ushtarake të shkollës për vitin 1964. Plani i punës shkencore ushtarake dhe i detyrave individuale për vitin mësimor 1964.
7. AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 133, Viti 1969 - Materiali me nr. 23 i protokollit, datë 20 shkurt 1969 "Raport i komisionit të punës së Akademisë Ushtarake "Mehmet Shehu" për problemin e revolucionarizimit të mëtejshëm të shkollës".
8. AQFA, Fondi 474, Dosja nr. 6, Viti 1984 - Historiku i Shkollës së Lartë të Bashkuar të Oficerëve.
9. AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosje nr. 122, Viti 1959 - Marrëveshje mbi shpalljen e garave socialiste midis Shkollës Ushtarake me emrin e heroit të BS "Kapiten O. Jarosh" të Çekosllovakisë dhe Shkollës së Bashkuar të Oficerëve "E. Hoxha".
10. AQFA, Fondi Shtabi i Përgjithshëm, Dosja nr. 30, Viti 1966 - Vendimi nr. 5 datë 12 janar 1966 mbi kalimin në program dyvjeçar të Akademisë Ushtarake "Mehmet Shehu" dhe të Shkollës së Bashkuar të Oficerëve "Enver Hoxha".

KRIJIMI I USHTRISË KOMBËTARE SHQIPTARE NGA QEVERIA E PËRKOHSHME E VLORËS (1912-1914)

Kolonel në pension Sali Onuzi

Sigurimi i Kuvendit Kombëtar dhe i veprimtarisë së Qeverisë kërkonin organizimin e forcave të armatosura. Për këtë qëllim, Ismail Qemali më 26 nëntor formoi një komision organizues dhe u dërgoi pleqësive të fshatrave një qarkore me anën e së cilës porositej të mobilizonin njerëzit e aftë për armë dhe t'i mbanin ata në gatishmëri¹. Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi Qeverinë e përkohshme dhe Ismail bej Vlorën kryeministër. Po atë ditë u zgjodh Ministër i Mbrojtjes Mehmet Darralla. Strukturën dhe përbërjen e Ministrisë së Mbrojtjes nuk e njohim. Dimë që zëvendësministër u caktua Xhelal Staravecka dhe komandantë ushtarakë u caktuan Isa Boletini, Hajredin bej Cakrani, Riza bej Gjakova etj. Pas formimit të saj, Qeveria dërgoi një forcë të vogël të armatosur me vullnetarë, patriotë (vullnetarë kosovarë) për të ruajtur bregun e Vjosës². Ajo ngriti komisione të mbrojtjes kombëtare nëpër krahina dhe urdhëroi mobilizimin e batalioneve redif e mustafëz për mbrojtjen nga forcat greke që kishin ardhur deri në Himarë. Kërkesa e saj për të çarmatosur ushtarët turq në Myzeqe e për të armatosur ushtarë shqiptarë nuk u pranua as nga Turqia, as nga Austro-Hungaria dhe Italia. Në janar 1913, Qeveria kish ngritur dhe armën e Xhandarmërisë, e cila në fund të vitit numëronte 4

¹ Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Historia e Shqipërisë vëll. II, viti 1984, f.497; Historia e popullit shqiptar. AShSh, viti 2002, f.35.

² Po aty, Vëll. III, V. 1984, f.89.

detashmente me nga 300 xhandarë secili³. Por puna e mbrojtjes do të kishte një hop në fillim të majit 1913.

Më 5 maj 1913 (më 22 prill sipas kalendarit të vjetër), Qeveria e Përkohshme e Vlorës do të diskutonte e miratonte Rregulloren për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës, ministër i së cilës ishte Mehmet Derralla, i zgjedhur nga Kuvendi Kombëtar më 4 dhjetor 1912. Në përbërje të Ministrisë së Luftës do të ishte Shtati (Shtabi) Madhor⁴. Për



shkak të njohjes dhe kredibilitetit që gëzonte, Major Ali Shefqeti do të emërohej në detyrën e lartë e të nderuar të Kryetarit të këtij Shtabi⁵.

Kjo ishte bërë e domosdoshme pse kishin kaluar 5 muaj që Ministria e Luftës (nga 4 dhjetor 1912) funksiononte pa një akt themelor normativ (me siguri në bazë urdhrash të veçantë për çështje konkrete që dilyn). Ministria e Luftës do të kishte gjithashtu edhe zyrën qerrtarë (të prapavijës apo intendencës), zyrën herrtarë (të organizimit e personelit) dhe zyrën shëndetare (të cilat në disa

³ Historia e Ushtrisë Shqiptare; Organizimi, pjesa e parë (vitet 1912-1914), SHBU, Tiranë 2000, f.80.

Dr. Hasan Shkëmbi: Policia shqiptare (vështrim historik-analitik) Migerallb, 2014; f.74.

⁴ Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës. Fotokopje e saj ndodhet e afishuar në stendat e Muzeut Historik Kombëtar në pjesën e veprimtarisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Botuar në gazetën Ushtria dhe Koha, nr. 35(6735), datë 4 maj 1994, f.3. *Shih:* Kolonel Kristian Millotat, Oficeri i Shtabit të Përgjithshëm, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1993.

Shënimi i autorit: Miratimi i Rregullores së përkohshme të Ministrisë së Luftës, më 5 maj 1913, është arsyeja pse Qeveria shqiptare pas 80 vjetësh (Vendim nr. 562, dt.6.12.1993) shpalli si datë të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë shqiptare datën 4 maj. Këtu ka pasur me siguri një gabim në llogaritjen e ditëve nga njëri kalendar në tjetrin, në mos pastë ndonjë “arsye” tjetër. Pa asnjë argument teksti akademik i Historisë së popullit shqiptar, botim i vitit 2002, vëllimi III, f. 40 e shtyn krijimin e Zyrës së Shtatmadhorisë në fillim të qershorit 1913, nisur gabimisht nga fakti pse ajo me 3 qershor paraqiste ne Qeveri projektin e Rregullores së Milicisë Shqiptare, për të cilën kishte punuar gjatë majit.

⁵ Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28.XI.1912-22.I.1914). Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë 1963; dok. nr. 11249 dhe 11746. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave të shtetit nr. 1176/2, Tiranë, më 26 11.1992 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes.

Shih: Onuzi, Sali, major Ali Shefqeti (Shkupi, i pari shef i Shtabit Madhor të Ushtrisë kombëtare shqiptare.” Gazeta “Luftëtari”, organ i Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 73 (6674) datë 28 nëntor 1992.; Onuzi, Sali: Kryetari i të parit Shtab Madhor shqiptar, major Ali Shefqeti. Revista Mbrojta, nr. 6, viti 1993, f.36-37; Shtabi i parë madhor, Ushtria e Koha, nr. 35(6735) dt.04.05.1994, f.3.

artikuj e botime janë dhënë tjetër për tjetër). Për ekzistencën e zyrës së Intendencës në Ministrinë e Luftës, shkruan vetë Ali Shefqeti, në një shkresë dërguar Ministrisë së Financave. Gjithashtu, gjendet edhe në një shkresë e 29 marsit 1914 për uniformat e oficerëve dhe ushtarëve drejtuar gjeneralit holandez Dever, firmosur dhe vulosur po me atë vulë, “Qarku Qerta”⁶.



Ali Shefqeti (1913)

Në nyjën e dytë të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej edhe ndërtimi i brendshëm i vetë Shtabit Madhor i cili, nga ana e tij, përbëhej nga: 1- Qarqet e Shtabit Madhor (të themi drejtori a departamente); 2- Shkruesin e Shtabit Madhor (sekretari arkivi); 3- Komisioni i rregulloreve; 4- Komisioni i trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë; dhe 5- Komisioni i ndërtimit (xhenios, si të thuash).

Rregullorja në mënyrë sintetike kish fiksuar edhe detyrat dhe të drejtat e Shtabit. Në nyjën 4 të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej se “Zyra e Shtabit Madhor asht e detyrume për me i radhit nomet, rregulloret dhe ushtrimoret e armëve të ndryshme që i duhen ushtrisë dhe për me e sigurua disiplinën e ushtrisë e qetësinë e vendit”⁷. Rregullorja kërkonte që, derisa të bëhej organizmi themelor, qarqet e Shtabit Madhor do të vepronin si një komision, i cili do të studionte projektet që do t’i paraqiteshin, të cilat edhe mund t’i ndryshonte dhe, bashkë me raportin përkatës, do t’ia kalonte Qeverisë nëpërmjet Ministrisë së Luftës. Kështu vetë Shtabi Madhor vepronte në fillimet e tij si një Komision (Qark)⁸. Kjo



Vula e Shtabit Madhor

⁶ Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28.XI.1912-22.I.1914). Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë 1963; dok. nr. 34, 29 mars 1914. Onuzi, Sali, Realiteti historik dhe vlera e një fotografie; “Ushtria dhe Koha”, organ i MM, nr. 90 (6766), dt.6 nëntor 1993, f. 3; Onuzi, Sali: Kompania model e ushtrisë kombëtare. Shqiptare. Dita, nr. 1913, 5 dhjetor 2017, f.19.

Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës, vep. e cituar.

⁷ Po aty, nija 4, paragrafi i parë.

⁸ Po aty: nija 4 paragrafi i dytë.

Shënimi i autorit: Miratimi i Rregullores së përkohshme të Ministrisë së Luftës, më 5 maj 1913, është arsyeja pse Qeveria shqiptare pas 80 vjetësh (Vendim nr. 562, dt.6.12.1993) shpalli si datë të krijimit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë shqiptare datën 4 maj. Këtu ka pasur me siguri

del dhe nga vula që ai përdorte: Qarku i Shtatit Madhor (1913) dhe firmosur nga Kryetari i Shtatmadhorisë Ali Shefqeti. Ky është padyshim një tregues i gjendjes së vështirë financiare, në mos edhe i mungesës së kuadrove përkatës, të cilët duhej të ishin të diplomuar si oficerë shtabi. Në Vlorë ishin paraqitur në dispozicion të qeverisë 70 oficerë dhe 150 nënoficerë shqiptarë⁹. Shtabi Madhor do të hartonte projekt-detyrat dhe raportet e zyrove të tjera, të cilat ai i konsultonte me to (ndryshoheshin kur duhej), i parapëlqente (ose jo) dhe ia kalonte gjithashtu Ministrisë së Luftës. Fakti që Ministria e Luftës e shtetit të ri shqiptar u konceptua dhe u ndërtua me Shtab Madhor që në vitin 1913, tregon se ndërtimi i ushtrisë së rregullt filloi nga lart-poshtë, karakteristikë për një shtet ligjor modern¹⁰.

Rregullorja e përkohshme e Ministrisë së Luftës në një 7 të saj përcaktonte se “Do të ishin në veprim nomet (ligjet) e Turqisë deri sa të radhiteshin nomet (ligjet) dhe rregulloret e reja.”¹¹ Kjo ndodhi edhe në organizmin ushtarak, ku mbeti në fuqi dhe u zbatua ligji për mobilizimin e redifëve (rezervistëve) dhe mustafëzve (forca vendore territoriale) që kishin qenë para shpalljes së Pavarësisë. Këto batalione u mobilizuan dhe luftuan kundër reparteve të ushtrisë greke që po përparonin në Shqipërinë e jugut. Në krye të tyre në terren ndodhej Xhelal Koprencka (firmosësi i Pavarësisë) zëvendësministri i Ministrisë së Luftës¹². Komandantë të batalioneve me redifë (rezervistë) ose mustafëz (territorialë) ishin vetë bejlerët, të zotët e bujqve ushtarë, që veç komandimit, përgjigjeshin edhe për logjistikën dhe ndërrimin e batalioneve në front. Hajredin bej Cakrani, njëri nga firmosësit e Deklaratës së Pavarësisë dhe feudal i madh nga Cakrani i Mallakastrës, që kishte mbaruar studimet e larta ushtarake në Stamboll, kishte qenë para 28 nëntorit dhe ishte edhe pas tij, komandant i batalionit “mustafëz” të Lushnjës, plus dhe komandant i operacionit qeveritar në front kundër grekëve. Për këto reparte dhe veprimtarinë e tyre pothuajse nuk bëhet fjalë në tekstet e historisë, por ato shkrihen e shihen thuajse të gjitha si “forca vullnetare”, kur në fakt ato kishin detyrim ligjor, po se po patriotik, të shërbenin e luftonin, siç edhe bënë një pjesë e mirë e tyre: batalionet e Beratit, Mallakastrës, Skraparit, Tepelenës, Përmetit, Leskovikut

një gabim në llogaritjen e ditëve nga njëri kalendar në tjetrin, në mos pastë ndonjë “arsye” tjetër. Pa asnjë argument teksti akademik i Historisë së popullit shqiptar, botim i vitit 2002, vëllimi III, f. 40 e shtyn krijimin e Zyrës së Shtatmadhorisë në fillim të qershorit 1913, nisur gabimisht nga fakti pse ajo me 3 qershor paraqiste ne Qeveri projektin e Rregullores së Milicisë shqiptare, për të cilën kishte punuar gjatë majit.

⁹ Hasani, Proletar; Sula, Engjëllushe; Zemani, Asllan : Historia e Ushtrisë, 2000, f.62.shqiptare, (Organizimi) Pjesa e pare (vitet 1912-1914). ShBU, Tiranë, f. 62.

¹⁰ Kolonel Kristian Millotat, Oficeri i Shtabit të Përgjithshëm, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1993.

¹¹ Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës, vep. e cituar, nija 7.

¹² Cakrani, Hajredin bej. Kujtimet e një firmëtari. Botimet Ymeraj 1, 2017, f.101.

e Gjirokastrës në jug kundër pushtuesve grekë¹³ dhe në Shkodër redifët dhe mustafëzët, nga Shqipëria e Mesme (Shijaku, Tirana, Kavaja e Elbasani) dhe nga Dibra kundër pushtuesve malazezë¹⁴. Por në praktikë nuk shkonte gjithçka siç shkruhej. Ministri i Luftës Mehmet Derralla më 31 janar 1914 i shkruante komandës së bylykut të Dukatit që të dërgonte emrat e 57 redifëve (rezervistë) që ishin nisur për të pasur nën këqyrje pozitën e Llogorasë dhe siç kish raportuar ajo vetë, ishin arratisur.

Më 2 shkurt, komandanti i batalionit Alem Mehmeti njoftonte se atje nuk kish mbetur asnjë redif¹⁵. Edhe komandanti i batalionit mustafëz, Sadullai, i shkruante më 7 dhjetor 1912 Ministrisë së Luftës se “200 ushtarët që pati, 100 në Delvinë e 100 në Sarandë, ishin arratisur nga mungesa e ushqimit dhe ai ishte kthyer në Tepelenë vetëm me ordinancën e tij”¹⁶. Kajmekami i Vlorës Mustaf Asimi njoftonte më 15 dhjetor 1912 se, ushtria populllore që ndodhet në anë të Mesaplikut ka mungesa municioni e ushqimi e sidomos rregulli e disipline dhe armiku iu bën thirrje për dorëzim¹⁷. Kryetari i Shtabit Madhor Ali Shefqeti (Shkup më 3 qershor 1913) i përcjell për studim ministrit të Punëve të Brendshme, Myfit bej Libohovës, variantin e parë të Rregullores së Milicisë Shqiptare, para se të bisedohej në Këshillin e Ministrave. Kjo rregullore sot gjendet në Arkivin e Shtetit Shqiptar si një dëshmitare e punës së Shtabit Madhor të atëhershëm, madje ajo është botuar e bërë publike. Edhe Konsulli Austro-Hungarez Lejhanetz njoftonte Vjenën se Zyra (e Shtabit Madhor) hartoi “Rregulloren mbi formimin e Milicisë Shqiptare”, sipas së cilës kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohej një ushtri e rregullt¹⁸. Më pas del urdhri për formimin e Kompanisë Këmbësore model të ushtrisë, ku shtrohet edhe nevoja e fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak¹⁹. Nga informacioni i konsullit Lejhanetz del se “administrata ushtarake shqiptare kishte ndërmend të bënte më parë studime mbi sistemet e ndryshme ushtarake europiane, e më pas të vendoste ose të

¹³ Historia e artit ushtarak të popullit shqiptar prej rendit skllavopronar deri më 1939.(projekt për diskutim), Tiranë 1986. Vëll.2.Ministria e Mbrojtjes Popullore. Akademia ushtarake, f.360

¹⁴ Po aty, f.363-364.; Nosi, Lef: Dokumente Historike 1912-1918. Shtypshkronja “Nënë Tereza”, Tiranë, 2007, f.11-37; Rexhepi, Përparim, Mbrojtja e Shkodrës 1912-1913, Tiranë, Globus 2001, f.36-38; Shehi Baki, “Ndroqi”, V.II, Tiranë 2016, f.11-69.

¹⁵ AQSH. Qeveria e përkohshme e Vlorës, Fondi i Kryesisë dok. nr 11061, f.383.

¹⁶ AQSH. Fondi i Ministrisë së Luftës. Dosja VI.1.f.1.

¹⁷ Po aty, dt.15 dhjetor 1912.

¹⁸ AQSH. Qeveria e Përkohshme e Vlorës Fondi Ministria e Luftës. Dosja VI-1, f.1.

Raport i konsullit Lejhanetz nga Vlora dt. 28.VI 1913.HHSt.APA. Turkei XII, karton 417/Liasse XIV/6a,6c.Marrë nga Puto Arben , Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914,Tiranë,1978, f.119.

¹⁹ AQSH, Qeveria e Përkohshme e Vlorës, Fondi i Ministrisë së Luftës, nr. i dok.11239.

merrte njërin prej tyre ose të krijonte një sistem të ri, të vetin, që u përshtatej kushteve të vendit. Ndaj Konsulli, i përcillte Vjenës lutjen e kësaj administrate për t'i vënë sa më shpejt në dispozicion një numër librash shërbimi, lidhur me organizimin, stërvitjen dhe shërbimin e brendshëm të armëve të ndryshme të ushtrisë si: këmbësoria, kalorësia, artileria, xhenio, prapavija dhe shëndetësia²⁰. Në fakt brenda 26 ditëve nga krijimi i Shtabit, më 31 maj 1913, Kryetari i tij informonte Ministrinë e Luftës, mbi punën që po bëhej për krijimin e kompanisë model të ushtrisë, sipas të cilës do të ndërtohej Ushtria Kombëtare. Aty shtrohej edhe nevoja e fillimit së afërmi të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Më 4 shtator gazeta "Dielli" në SHBA shkruante se "Qeveria mbledh ushtarë me 240 grosh në muaj, jo me pahir, por nëse secili do vetë. Flitet se Guberna shqiptare do të mbledhë gjer në 20 mijë veta të cilët do të jenë të veshur, mbathur dhe armatosur mirë, me topa, mitraloza dhe municione etj."²¹ Në arkivin e shtetit ruhet edhe një foto e kompanisë model të krijuar me emrat e oficerëve të tyre. Gjithashtu, te kjo gazetë, më 31 tetor 1913, me burim nga Vlora njoftohej se "Në Vlorë janë tre taborë (batalione S.O) ushtarë të Shqipërisë të veshur, të mbathur e të armatosur dhe të stërvitur mirë, me topa etj." Janë edhe 7 çeta shqiptare (pra vullnetare) të organizuara fare mirë, me nga 300-500 njerëz secila. Kryetarët e çetave janë këta: Mehmet Pavari, Nexhip Bënja, Salih Butka, Dino Çiçi Gjinokastra, Namik Delvina, kapedan Spiro Korça dhe Çerçiz Topulli"²². Me detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor, major Ali Shefqeti komunikonte me telegraf dhe transmetonte vendime të Qeverisë apo urdhra e udhëzime të Ministrisë së Luftës e të vetë Shtabit për veprime luftarake, dërgim oficerësh, armatimi e municioni në territore të ndryshme të vendit, në jug kundër forcave pushtuese greke dhe në Dibër ku po zhvillohej kryengritja e shtatorit të vitit 1913. Shtabi i drejtuar prej tij i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro - Hungari, topa, mitraloza, uniforma dhe ajo që të befason më shumë edhe "një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t'i shërbenin administratës ushtarake të qeverisë." Ali Shefqeti do të bashkëpunonte me sukses edhe me grupin e oficerëve holandezë që do të vinin në vendin tonë sipas vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut 1913, për organizimin e xhandarmërisë.

Që më 1913, Shtabi Madhor i pati hyrë një pune të veçantë për terminologjinë ushtarake. Për këtë çështje, ai kishte angazhuar një komision të posaçëm në të cilin bënë pjesë oficerë të kulturuar si: Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejдини (dëshmor i atdheut nga Elbasani,) ish-profesor i frëngjishtes në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Veprimtarisë së këtij komisioni i takojnë shumë terma

²⁰ Raport i konsullit Lejhanetz, 28.,VI 1913, dok. i cituar.

²¹ Gazeta "Dielli", nr. 258, 31.10.1913, f.2.

²² Po aty.

që përdorim sot në fushën ushtarake. Historiografia zyrtare shqiptare nuk e ka evidentuar dhe vlerësuar sa duhet veprimtarinë ushtarake të Qeverisë së Vlorës. Prof. Arben Puto në “Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914”, i referohet vetëm konsullit Lejhanetz për një “zyrë të shtatmadhorisë, që me nënvleftësim e quante një lloj organi ushtarak i Qeverisë së Përkohshme²³. Për më tepër, teksti i Akademisë Ushtarake i vitit 1986 as nuk e përmend këtë “zyrë shtatmadhorie”. Profesor Arben Puto del në përfundimin se Qeveria e Vlorës mori disa masa organizative paraprahe, por nuk arriti asnjëherë të krijonte as dhe bërthamën e një ushtrie kombëtare²⁴. Ndërsa teksti i akademik i Historisë i vitit 2002 e ri përsërit konsullin austriak dhe e quan krijimin e një ushtrie të rregullt një “objektiv i parakohshëm, i paralelizueshëm në ato rrethana”²⁵. Po këtë shkruan edhe “Historia e popullit shqiptar gjatë shekullit XX”²⁶. Ky mendim për administratën ushtarake nuk na duket bindës dhe mendojmë se duhet hetuar e diskutuar më tej. Në kujtimet e tij, Ismail Qemali shkruan: “si u ktheva (nga Londra, S.O) në Vlorë në qershor 1913 Qeveria e përkohshme i dyfishoi përpjekjet për organizimin e vendit dhe për ruajtjen e rendit. Mund të ishin quajtur fare mirë detyra të pamundshme për t’u kryer, por punën e bënte më të lehtë karakteri i shqiptarit. Durimin, maturinë dhe patriotizmin e paepur të të cilit, mes gjithë atyre ngatërresave e halleve, nuk ka fjalë e lëvdatë që ta përshkruajë. Pikërisht falë virtyeteve të kësaj rrace.... qeveria ime ia doli mbanë t’i sjellë stabilitet shtetit dhe të sigurojë një administratë normale”²⁷. Krijimi i Ministrisë së Luftës, i Shtabit Madhor, i bazës ligjore e normative, krijimi i xhandarmërisë, mobilizimi në luftë i disa batalioneve redif e mustafëz, plus tri kompanive me nizamë shqiptare, krijimi i një kompanie model të ushtrisë së rregullt dhe nën shembullin e saj të tre batalioneve me ushtarë aktivë dhe një grupi me 120 kalorës, a nuk përbënin të gjitha këto një bërthamë të ushtrisë së rregullt apo një ushtri të vogël në numër? Kjo veprimtari nuk mbeti vetëm në disa masa organizative paraprahe.

Ngritja e ushtrisë së rregullt dhe asaj të përhershme ishin një nevojë e kohës, por ato nuk u realizuan sipas parashikimeve, për shkak të kushteve shumë të vështira në të cilat u detyrua të vepronte Qeveria për mosnjohjen e saj nga përfaqësuesit e fuqive të mëdha si qeveri kombëtare dhe ndërhyrjeve të tyre të padrejta. Ndoshta autorët e tekstit akademik të shekullit tonë e quajnë të parakohshme (!) (6 muaj pas shpalljes së Pavarësisë kombëtare dhe krijimit të Qeverisë) krahasuar me 5 vjet pas pushtimit italian në Luftën e Dytë Botërore,

²³ Puto, Arben, vep. e cit. f.119.

²⁴ Po aty f.120.

²⁵ Qemali, Ismail. Kujtime. Toena, 2009, f.424.

²⁶ Kasmi, Marenglen: Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane në shekullin e XX (1900-1945), Tiranë 2020, f.59.

²⁷ Po aty.

kur më 10 korrik 1943 filloi organizimi i ushtrisë së rregullt ANÇ që do të përfundonte më 24 maj 1944. Kohët kanë veçoritë e tyre dhe krahasimet nuk janë të goditura. Qeveria e Vlorës vepronte në një territor të lirë, të çliruar dhe në kushte lufte me pushtues të egër. Ajo nuk kish pse të vonohej, forcat ushtarake ishin një detyrë urgjente e kohës dhe ajo iu përgjigj asaj me sa mundësi pati.

Ndërkohë duhet shënuar se, batalionet me redifë dhe ato mustafëz, brenda territorit ku shtrinte veprimtarinë e saj Qeveria e Vlorës në fakt i përkisnin një ushtrie të rregullt, pse ishin organizuar mbi bazën e ligjit ushtarak, me organika standarde për moshën e pjesëmarrësve, numrin e tyre, komandën, uniformën dhe armët që i mbanin në magazinat e ushtrisë etj. Fakti që nuk ishin forca aktive, të përhershme, d.m.th, nizamë apo ushtarë aktivë, nuk i bën ato ushtri (forca) të parregullta. Ato edhe sot janë pjesë e forcave të armatosura në katër anët e botës. Shto këtu dhe faktin që Qeveria kishte vendosur më 13 janar 1913 dhe realizoi krijimin e armës së xhandarmërisë. Kujtojmë se xhandari i vitit 1913 ishte edhe ruajtës i rendit, edhe ushtar i luftës, një forcë ende e pa diferencuar. Pra, ishte pjesë e ushtrisë së rregullt. Prandaj edhe në përbërjen e Shtabit Madhor kishte një komision të trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë. Diferencimi i kësaj arme, ndarja e xhandarmërisë nga policia dhe ushtria u bë më vonë deri në vitin 1920.



Krijimi i ushtrisë nga Qeveria e Ismail Qemalit është regjistruar edhe në raportet e dy oficerëve të huaj, kapitenit austriak Ulmanky dhe gjermanit Claner, të cilët siç shkruan Prof. As. Dr. Marenglen Kasmi, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë dyjavore në Shqipëri. Kapiteni Ulmanky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni Clanner vizitoi Shqipërinë e Jugut. Raporti që ata hartuan rreth vizitës së tyre në Shqipëri është jo vetëm tepër i hollësishëm, por edhe të krijon bindjen e një analize të thellë dhe të kujdesshme për gjendjen e shoqërisë shqiptare në prag të ardhjes së Wiedit, si për situatën politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë²⁸. Dy kapitenët në raportin e tyre shkruajnë: “Qeveria e Ismail Qemalit në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale

²⁸ Po aty.

shqiptare ishte më e veçantë. Ajo konsiderohej si Qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe mbante lidhje diplomatike me qeveritë europiane. Në të vërtetë ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit. Qeveria, - shkruajnë autorët, - kishte xhandarmërinë e saj dhe në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, kishte një forcë ushtarake, me një ministri lufte, si dhe një shtab madhor që drejtonte ushtrinë, e cila gjithsesi ishte në fazën e saj të formatimit. Krahësuar me qeveritë e tjera lokale, ajo e Vlorës kishte të ardhurat më të mira si pasojë e vjeljes së taksave portuale... Brenda vendit mbizotëronte një farë qetësie e rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Po ashtu, shërbimi postar dhe ai telegrafik funksiononte në të gjithë vendin. “Ky raport i dy kapitenëve nga dy vende të njohura për organizimin modern ushtarak në Europë dhe përfundimi i tyre se Qeveria e përkohshme e Vlorës kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, mendojmë se vlen shumë për çështjen që po trajtojmë dhe mund të themi se i vë kapak asaj. Ndërkohë nuk duhet të harrojmë se kjo ushtri nuk ishte një ushtri evidencash dhe rrogëtarësh, por një forcë që kish luftuar e luftonte në front, për të ndalur përparimin e forcave sidomos atyre greke për të pushtuar Vlorën e territore të tjera nën autoritetin e Qeverisë së Përkohshme të Vlorës dhe që përkrahte, aq sa kishte mundësi, edhe me oficerë, armatim e municion kryengritjen e Dibrës të shtatorit 1913.



Kongresi shqiptar i Triestes, 1913

Bibliografia:

1. Akademia e Shkencave, Instituti i Historisë, Historia e Shqipërisë vëll. II, viti 1984; Historia e popullit shqiptar. AShSh, viti 2002.
2. Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës. Fotokopje e saj ndodhet e afishuar në stendat e Muzeut Historik Kombëtar në pjesën e veprimtarisë së Qeverisë së Përkohshme të Vlorës. Botuar në gazetën Ushtria dhe

- Koha, nr. 35(6735), datë 4 maj 1994. Shih: Kolonel Kristian, Millotat, Oficeri i Shtabit të Përgjithshëm, Shtëpia Botuese e Ushtrisë, Tiranë 1993.
3. Drejtorja e Përgjithshme e Arkivave të shtetit nr. 1176/2, Tiranë, më 26.11.1992 drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes. Shih: Onuzi, Sali, major Ali Shefqeti (Shkupi, i pari shef i Shtabit Madhor të Ushtrisë kombëtare shqiptare.” Gazeta “Luftëtari”, organ i Ministrisë së Mbrojtjes, nr. 73 (6674) datë 28 nëntor 1992.; Onuzi, Sali: Kryetari i të parit Shtab Madhor shqiptar, major Ali Shefqeti. Revista Mbrojta, nr. 6, viti 1993. Shtabi i parë madhor, Ushtria e Koha, nr. 35(6735) dt.04.05.1994.
 4. Qeveria e Përkohshme e Vlorës dhe veprimtaria e saj (28.XI.1912-22.I.1914). Botim i Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave Shtetërore të RPSH, Tiranë 1963; dok. nr. 34, 29 mars 1914.
 5. Onuzi, Sali, Realiteti historik dhe vlera e një fotografie; “Ushtria dhe Koha”, organ i MM, nr. 90 (6766), dt.6 nëntor 1993. Onuzi, Sali: Kompania model e ushtrisë kombëtare. Shqiptare. Dita, nr. 1913, 5 dhjetor 2917.
 6. Hasani, Proletar; Sula, Engjëllushe; Zemani, Asllan: Historia e Ushtrisë, (Organizimi) Pjesa e parë (vitet 1912-1914). ShBU, Tiranë, 2000.
 7. Rregullore për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës, vep. e cituar, nija 7.
 8. Cakrani, Hajredin bej. Kujtimet e një firmëtari. Botimet Ymeraj 1, 2017.
 9. Historia e artit ushtarak të popullit shqiptar prej rendit skllavopronar deri më 1939.(projekt për diskutim), Tiranë, 1986. Vëll.2.Ministria e Mbrojtjes Popullore. Akademia ushtarake.
 10. Nosi, Lef: Dokumente Historike 1912-1918. Shtypshkronja “Nënë Tereza”, Tiranë, 2007, Rexhepi, Përparim, Mbrojtja e Shkodrës 1912-1913, Tiranë, Globus 2001. Shehi, Baki, “Ndroqi”, V.II, Tiranë 2016.
 11. AQSH. Qeveria e Përkohshme e Vlorës. Fondi Ministria e Luftës. Dosja VI-1.
 12. Gazeta “ Dielli”, nr. 258, 31.10.1913.
 13. Qemali, Ismail. Kujtime. Toena, 2009.
 14. Kasmi, Marenglen: Marrëdhëniet shqiptaro-gjermane në shekullin e XX (1900-1945), Tiranë 2020

KUJTESË PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake!

“Revista Ushtarake” (RU) është organ teoriko-shkencor i Akademisë së Forcave të Armatosura, në interes të FARSH. Misioni i saj është promovimi i vlerave kërkimore, i zhvillimeve të reja dhe i debatit shkencor në FA. Tematika e saj trajton çështje me karakter teoriko-shkencor e analitik, në ndihmë të veprimtarisë së FA-ve, duke ofruar zgjidhje për çështjet më të rëndësishme në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, në nivel strategjik, operacional dhe taktik, në vend, rajon e më gjerë.

Ftojme studentët/kursantët, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AFA, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësive të FARSH të bëhen pjesë e shkrimeve në RU.

Në vijim, po japim kriteret për strukturën e artikujve të Revistës Ushtarake, të cilat duhet të respektohen nga autorët e shkrimeve.

Punimi shkencor duhet të përbëhet nga disa pjesë kryesore:

- 1. Titulli** i artikullit të jetë sintezë e problematikës që ai trajton, i organizuar në mënyrë koncize dhe të përmbledhur.
- 2. Autori, bashkautor/bashkautorët:** Poshtë titullit vendoset emri i autorit me titujt shkencorë përkatës dhe funksionin aktual i tij/saj.
- 3. Trajtresa e shkurtuar (Abstrakti):** Përmbledhja në shqip dhe në anglisht (nga 200 deri në 400 fjalë).

4. Fjalët kyçe: (3 - 5 fjalë).

5. Hyrja. Në hyrje duhet të prezantohet përmbajtja e punimit dhe qëllimi i tij. Gjithashtu duhet të tregohet metodologjia që do të përdoret, burimet dhe ku qëndron rëndësia e punimit.

6. Pjesa kryesore. Çështjet. Punimi mund të ndahet në disa çështje në varësi të temës së zgjedhur dhe duhet të kenë lidhje me njëra-tjetrën.

7. Përfundime / rekomandime. Në pjesën e përfundimeve duhet të shkruhet rreth temës së zgjedhur dhe çfarë është arritur të provohet dhe cilat përfundime veçohen. Përfundimet i japin përgjigje problemeve të parashtruara në hyrje dhe të diskutuara në pjesën kryesore.

8. Bibliografia. Në fund të temës duhet të përfshihet një bibliografi e plotë e materialeve që janë përdorur në citime ose referenca të vendosura sipas rendit alfabetik.

9. Format: Punimi duhet të respektojë kërkesat e formatit. Faqja duhet të jetë e formatit A4; lloji i shkrimit: "Times New Roman"; madhësia e shkrimit 12. Kryeradha (paragrafi i ri) përcaktohet me pt 6 (hapësira midis paragrafëve). Punimi duhet të jetë maksimumi 8-10 faqe kompjuterike. *Përmbledhja në anglisht është një kërkesë e domosdoshme e standardeve ndërkombëtare.*

10. Grafikët, tabelat dhe fotot duhet të jenë të formatuara në grup, duke shmangur shpërbërjen e tyre. Nëse një foto ose grafik është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi përkatës i tij.

11. Referencat dhe bibliografia: Çdo shkrim duhet të paraqitet me referenca (*footnote*) të mjaftueshme dhe të sakta. Referencat duhet të respektojnë në mënyrë korrekte rregullat kombëtare e ndërkombëtare. Ato duhet të jenë të përfshira në punim, sipas sistemit të referencave *Chicago Style (footnote)*.

Shembull:

- Libra me një autor: 1. Michael Pollan, *The Omnivores Dilemma: A Natural History of Four Meals* (New York: Penguin, 2006), 99-100.

- Dy ose më shumë autorë: 1. Geoffrey C. Ward dhe Ken Burns, *The War: An Intimate History, 1941-1945* (New York: Knopf, 2007), 52.

- Burime të përgjithshme interneti: Uebi i Këshillit të Evropës. Marrë nga <http://www.cm.coe.int>,

Pra, duhet të përfshihen: mbiemri, emri (i autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numri ISBN, website-in ku ndodhet artikulli.

Shënim!

1. Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit.
2. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë e as qëndrime politike apo partiake.
3. Artikulli duhet të dërgohet në adresën elektronike dhe/ose me CD.

Bordi Drejtues i Revistës Ushtarake është organi i vetëm që vendos, sipas Rregullores së RU, përzgjedhjen përfundimtare të shkrimeve për çdo edicion të Revistës Ushtarake.

Për çdo informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni në:

Adresa: Akademia e Forcave të Armatosura, (AFA)
Instituti Kërkimor Shkencor Ushtarak (IKSHU)
Departamenti i Publikimeve Doktrinare
Grupi i Redaktimit dhe i Publikimit
Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri
Nr. Tel: 516 /1975, 516/ 1977

